

Baton Haxhiu

Shkëlzen Maliqi

**- Shembja e Jugosllavisë,
Kosova dhe rrëfime të tjera**



BATON HAXHIU

SHKËLZEN MALIQI

- SHEMBJA E JUGOSLLAVISË,

KOSOVA DHE RRËFIME TË TJERA



BATON HAXHIU

**SHKËLZEN MALIQI - SHEMBJA E JUGOSLLAVISË, KOSOVA
DHE RRËFIME TË TJERA**

Botimi i dytë

(Botimi i parë: UET Press, 2011)

Copyright © autori

Kolona: **Biografi**

Design & Layout: **ORBIS, Prizren**

Ky libër është i formatit eBook.

Botimet Filozofia Urbane



ISBN: 978-9951-641-18-0

Prishtinë, 2013

www.filozofiaurbane.com

Hyrje

Si u bëra i famshëm “brenda natës”

Baton Haxhiu: Para vitit 1982 Shkëlzen Maliqin në Kosovë pak kush e ka njohur si njeri të shkrimit. Në jetën e shkronjave dhe debateve por edhe të politikës thuhet se ju ka futur një letër e hapur e botuar në Revistën Nin të Beogradit. Letra e hapur drejtuar akademikut serb Pavle Iviç ju bëri që të dilni nga gëzhoja e anonimitetit. Pse në të vërtetë e shkruat letrën?

Shkëlzen Maliqi: është e vërtetë se në kohën që shkrova atë letër reagim në Kosovë nuk më njihnin... Posa isha kthyer nga Beogradi, ku pata kaluar një periudhë bukur të gjatë të jetës, 16 vjet. As në Beograd nuk kam pas krijuar emër publik. Atëherë isha 35 vjeç dhe nuk kisha asgjë pos bibliotekës personale, nja tre- katër mijë librave, që i kisha sjell nga Beogradi. Që nga shtatori i vitit 1982 po prisja të gjeja ndonjë punë. Kjo nuk shkonte aq lehtë edhe pse “lidhjet” i kam pasur shumë të forta. Babai im, Mehmet Maliqi, ishte atëherë ministër i rendit në Kosovë, post shumë i fuqishëm dhe i frikshëm. Njerëzit sot do të mendonin, si edhe atëherë, se ka mjaftuar një fjalë e tij për të më gjetur punë çfarë dëshiroja. Por, unë isha shumë modest dhe i kujdesshëm... Kërkoja punë të qetë, mundësisht në Bibliotekën kombëtare, si bibliotekist i thjeshtë, dhe që punësimi të bëhet sipas rregullave. Kështu edhe prita 6

muaj. Dhe në atë kohë, deri sa po prisja punësimin, i kaloja qetë, duke lexuar dhe shkruar nga pak, kryesisht poezi... Një ditë, nëse më kujtohet saktë ka qenë fundi i nëntorit ose fillimi i dhjetorit të 82-shit, e pata lexuar një shkrim në javoren “NIN” të Beogradit që komentonte librin “Shqiptarët dhe trojet e tyre” të botuar në atë kohë në Tiranë. Bashkëbiseduesi i NIN-it ishte akademiku serb Pavle Iviç. Ai riaktualizonte debatin për etnogjenezën e shqiptarëve, duke hedhur poshtë tezën ilire dhe afirmuar tezën trakase. Në atë shkrim kishte shumë paragjykime kundër shqiptarëve dhe Kosovës. Iviçi e kritikonte ashpër nacionalizmin shqiptar nga pozitat e një nacionalizmi të pafrenuar serb. Unë e shkrova një reagim, ia dërgova NIN-it dhe u çudita kur doli një javë më pas pa ndërhyrje dhe shkurtime. një javë më pas u befasova edhe më shumë kur reagimi im doli i përkthyer si kryeartikull në shtojcën për kulturë të “Rilindjes”. Nuk e kam pritur këtë lloj audience. Nuk e kam menduar as në ëndërr që brenda natës do të bëhem i famshëm, që kjo letër do të përcaktojë fatin tim në të ardhmen, duke më lidhur për publicistikën dhe politikën, për çka deri atëherë as që më ka shkuar mendja se do të më bëhen angazhimet kryesore për një çerek shekulli.

BH: A do të thotë kjo se nëse ajo letër nuk do të botohej në NIN, Shkëlzen Maliqi nuk do të ishte ky që është sot, një autor i angazhuar që ka botuar me qindra shkrime, reagime dhe intervista në mediumet e ndryshme në Kosovë, ish Jugosllavi, Shqipëri dhe në Perëndim?

ShM: Po, të gjitha filluan me atë letër, mirëpo nuk mund të them se ky ka qenë momenti përcaktues. Unë në njëfarë dore isha i përgatitur. Në atë kohë në Serbi kishte filluar një fushatë mediale e padurueshme antishqiptare dhe mua edhe më herët më është kërkuar dora për të

reaguar. Sigurisht se në një pikë do të futesha në lojë. Megjithatë, në atë moment kjo ishte një sfidë e panjohur për mua... Dhe nuk kam mundur as ta imagjinoja se në të vërtetë po fillonte një histori e thyerjeve të mëdha që do të përcaktonin jo vetëm fatet individuale por edhe ato kolektive. Sigurisht se nuk kam qenë ndonjë profet i thyerjeve. Në fillim unë ndihesha vetëm i fyer. Më vonë e kam kuptuar, si edhe të tjerët, se ato kanë qenë dridhjet e para të një sërë tërmetejeve të fuqishme që do ta rrënojnë federatën jugosllave. Në dhjetor të vitit 1982 nuk kam mundur të dijë se letra NIN-it, jo aq si përmbajtje, por si gjest, do ta ketë një peshë të veçantë, jo vetëm për mua personalisht.

Por, para se të vazhdoj, dua ta tregoj historinë e botimit të shpejtë dhe pa censurë të letrës sime në NIN, në ato rrethana. Kjo histori dëshmon se edhe në rastësi ka sistem. E kam kuptuar atë më vonë nga Nait Vrenezi. Redaktori i rubrikës së letrave të NIN-it në atë kohë ka qenë Luba Stojiq, tani i ndjerë. Ai ka qenë me profesion psikolog, koleg i Naitit nga studimet. Këtij Stojiqit, pra, i kishte rënë në dorë reagimi im dhe i kishte pëlqyer, por nuk e ka pas idenë se kush mund të jetë ky Shkëlzen Maliqi.

BH: Thuhet se serbishten e ke shkruar perfekt dhe me stil të lartë...?

ShM: Po, vërtet unë atëherë e shkruaja serbishten bukur. Dhe kjo edhe e kishte befusuar Stojiqin. Andaj i kishte bërë telefonatë Nait Vrenedit për ta pyetur nëse njih dike nga Prishtina që quhet Shkëlzen Maliqi. Naiti i tregon se kush jam, sepse ne njiheshim që nga gjimnazi i Prizrenit dhe kemi studiuar në Universitetin e Beogradit në të njëjtën kohë. Unë e njihja mirë Luba Stojiqin, sepse kishte një farë fame ndër studentët, i kisha lexuar edhe shkrimet e tij, dhe e shihja shpesh

edhe në kafenetë e famshme të Beogradit si “Pod lipom”, “Gërmeç”, “Kolarac” etj. Por, meqë unë isha më i ri se ai, ka mundur të më njihte si fytyrë ose me nofkën time Zeni ose Zen, siç më quanin në Beograd, por jo edhe me emër dhe mbiemër. E thash më herët se deri në moshën 35 vjeçare nuk kam botuar shkrime. Në të vërtetë, më 1980 unë e pata botuar një pjesë të studimit tim mbi estetikën bizantine, konkretisht analizën e krizës ikonoklaste, që ishte si një libër i vogël, kishte 6 tabakët të autorit. Por revista filozofike ku u botua shkrimi kishte qarkullim të vogël dhe vetë tema mesjetare nuk ishte aq atraktive që të bëja emër publik. Sidoqoftë, pa marrë parasysh nëse Stoiçi ishte kujtuar se cili jam, atij i kishte pëlqyer shkrimi im dhe ai është botuar pa konsulta me redaktorët përgjegjës të NIN-i.

Por, për mua befasia më e madhe ndodhi në Prishtinë. Shkrimi im menjëherë u përkthye dhe u ribotua te “Rilindja”, krahas atij të akademik Iviçit. Pastaj u ribotuan edhe shkrimet polemike të radhës që i botonte “Nin-i”. Kjo polemikë pati një audiencë dhe jehonë jashtëzakonisht të madhe. Për herë të parë pas vitit 1981 po botohej një shkrim publicistik i një autori shqiptar i cili nuk ishte defensivë, por demaskonte fushatën e nacionalizmit serb. Unë në Prishtinës isha pothuajse krejtësisht i panjohur, dhe për shkak të guximit dhe stilit të lartë të shkrimit, shumë njerëz më kanë thënë se kanë qenë të bindur se ky është pseudonim i ndonjërit prej akademikëve, profesorëve ose autorëve të njohur kosovar.

BH: Një histori klasike e suksesit dhe të bërit me famë brenda natës...

ShM: Po, ashtu disi... E papritur dhe shokuese. Përkrahja më vinte edhe nga instancat më të larta shtetërore. Një telefonatë më pat bërë

edhe Fadil Hoxha, në atë kohë anëtar i Kryesisë së Jugosllavisë. Ai ma uronte guximin dhe qasjen. “Na ke zbardhë fytyrën”, tha. Për dallim nga të tjerët, Fadil Hoxha më ka njohur mirë jo vetëm pse babai im ka qenë në udhëheqësinë e ngushtë të komunistëve të Kosovës, por ai më njihnte edhe personalisht. E kam takuar disa herë në rastet e ndryshme, qoftë në Prishtinë, qoftë në Beograd. Një herë ai më patë njohur në rrugë kur unë kaloja pranë Kuvendit të Serbisë dhe më ftoi për drekë në restorantin e Kuvendit. Po, kështu, Fadil Hoxha ka luajtur rol të madh në vitin 1969 duke intervenuar tek policia që të mos burgosesha si aktivist i grupit rebel majtist të lëvizjes studentore të vitit '68 në Universitetin e Beogradit...

Intelektuali i parë që reagoi ndaj fushatës antishqiptare

BH: Do të kthehemi më vonë te ‘68-shi.... Tani ju lutëm ta vazhdoni rrëfimin për motivin e futjes në polemikë me një akademik serb në të përjavshmen Nin?

ShM: ... Po, motivi është i qartë. Ishin bërë 15 vjet që unë jetoja në Beograd dhe kisha njohur relativisht të mira të skenës serbe, dhe se kush është dhe çka përfaqëson akademiku Iviç në Serbi. Me fillimin e fushatës antishqiptare në mediat serbe, unë po zemërohesha gjithnjë e më shumë pse s’kishte kundër reagime ose pse kur reagohej, ato ishin të zbehta, madje më dukeshin edhe kundër produktive. E dija se garnitura e udhëheqësve serbë, pas vdekjes së Titos, kishte marrë kursin radikal ndaj Kosovës. Ma kishte thënë këtë edhe babai im, më 1981, pasi që ishte emëruar në detyrën e vështirë dhe delikate të Ministrit

të Punëve të Brendshme në Këshillin Ekzekutiv të Kosovës, që ishte Qeveria në atë sistem. Më kujtohet se diku nga fundi i vitit 1981, ne po ktheheshim me makinë nga Prizreni për në Prishtinë, dhe diku te Qafa e Dulës, Mehmeti ma bëri me dije se udhëheqësit serbë, sidomos ministri i brendshëm, - nuk më kujtohet më emri i tij - janë më radikal në çështjen e Kosovës se edhe vetë Aleksandar Rankoviçi¹ famëkeq! Më la të kuptoj se në takimet mes dy udhëheqësive, të Serbisë dhe të Kosovës, ka tensione të jashtëzakonshme, deri edhe kërcënime për likuidime nga mujsharët e ri të Beogradit, të cilët po shfrytëzonin vakumin e autoritetit pas vdekjes së Titos dhe demonstratat e Kosovës të vitit 1981.

Unë e pata pyetur Mehmetin për organet federative jugosllave, si qëndron puna me pushtetin dhe disponimin e tyre, se a ka “federata” fuqinë për t’ia ndalin hovin pretendimeve serbe. Por nuk pata marr ndonjë përgjigje të qartë për raportin real të forcave në federatë. Mehmeti më pat thënë se kuadrot kosovare po rezistonin në shumë nivele. “Nuk do të lejohet zhbërja e autonomisë së Kosovës. Ne i kemi të gjitha të drejtat e republikës, pos emrit, dhe nuk do të lejojmë kthimin mbra-pa”.

Pra, në vitin e fundit të qëndrimit në Beograd, më 1981, e ndiqja me vëmendje skenën dhe prapaskenën e politikës serbe. Isha i informuar për trendët në publicistikën dhe qarqet intelektuale serbe. Në rastin konkret, për të cilin më pyet, fakti është se unë në atë kohë zihesha përbrenda nga mllefi dhe pakënaqësia me fushatën antishqiptare. Gjithnjë e më shumë më preokuponte kjo, sidomos kur shihja edhe indolencën

1 Ministër i rendit dhe numri dy në nomenklaturën e komunistëve të Jugosllavisë deri në vitin 1966, kur u detyrua të japë dorëheqje për shkak të gabimeve dhe “devijimeve” në shërbimet sekrete dhe polici”. Është vlerësuar si ithtarë i dorës së fortë dhe nacionalizmit serbomadh.

dhe pafuqinë e inteligjencës kosovare që t'i përgjigjet fushatës. Dhe erdhi një ditë kur nuk mund të përmbahesha...

BH: Të gjithë heshtnin e Shkëlzen Maliqi i ra hise të reagojë?! Po si të lindi kjo ide?

ShM: E kisha idenë për këtë edhe më herët deri sa isha në Beograd, por mendoja se nuk më takon mua reagimi. Ka të tjerë atje në Kosovë që janë më të informuar, më pranë detyrës dhe obligimit për të kundërshtuar fushatën antishqiptare... Vetëm kur u ktheva në Kosovë, duke qëndruar disa muaj në Prishtinë dhe duke u futur në disa qarqe intelektuale, kuptova se mos-reagimi ndaj fushatës nuk i kishe burimet vetëm në represionin e shtuar dhe pasigurinë dhe frikën e njerëzve nga pasojat, nga ndjekja, burgosja, përjashtimi nga puna etj. Kuptova se intelektualëve në Prishtinë u mungonte jo vetëm guximi por edhe informimi dhe qasja e duhur për çështjen, po mendoj në rrethanat e atëhershme dhe mundësitë që ekziston për reagime. Atëherë vendosa që të reagoj vetë, t'i them ato kundër-argumentet ndaj fushatës që prej kohësh i vloja nëpër mend. E pata bërë këtë me shpresën se mund të shërbente si model edhe për të tjerët. Ndoshta kam qenë naiv, s'di, por disi e kisha bindjen, dhe vetëbesimin, se ekzistonte hapësira e mjaftueshme edhe brenda sistemit dhe ideologjisë së atëhershme jugosllave, për demaskimin e nacionalizmit serb, i cili po e dirigjonte ashtu ashiqare fushatën denigruese antishqiptare.

Por, kur e kujtoj sot pozicionin tim të atëhershëm, mendoj se kam pas deri diku një përparësi, ose fat, që guximi im në demaskimin e nacionalizmit serb, të mos kishte menjëherë pasojat. Thjesht, unë kam qenë një intelektual shqiptar jashtë kategorive të zakonshme, pasi që kam qenë deri diku i mbrojtur, me disa favore relative, të cilat të tjerët

nuk i kanë pasur. E para përparësi ka qenë që isha i biri i Mehmet Maliqit, që në atë kohë mbante detyrën e ministrit të rendit të Kosovës dhe po e luftonte irredentizmin shqiptar, siç etiketoheshte në atë kohë lëvizja për republikën e Kosovës ose më parë ajo për bashkimin e Kosovës me Shqipërinë. Për këtë lidhje të ngushtë familjare unë kam pasur probleme me patriotët dhe nacionalistët shqiptarë, dhe jo aq me pushtetin që ende ishte komunist. E dyta përparësi ishte që unë nuk i kisha frikë kacafytjeve publike me nacionalistët serbë ngase isha i bindur se e kam gjetur formulën e polemizimit me ta. Kjo formulë ishte e thjeshtë : kujdesesha që të mos paraqitem nga pozitat e nacionalizmit shqiptar, çka nuk e kisha të vështirë sepse për nga bindja nuk isha nationalist. Kjo pikënisje ime jo-nacionaliste sot mund të tingëllojë si pozicionim nga ana e “integritetit jugosllav”, siç më kanë perceptuar disa qarqe në Kosovë, p.sh. Mehmet Kraja, por nuk ka qenë as ashtu. Unë vetëm besoja se arma më e fuqishme e konfrontimit publik me nacionalizmin serb ka qenë shfrytëzimi i legatit të komunizmit jugosllav, të titizmit, që parimisht përjashtonte dominimin e ideologjive nacionaliste, sidomos të nacionalizmit serb. Në themelet e atij sistemi, sado që nuk ka qenë krejtësisht konsistent, ka qëndruar vlera e luftimit e të gjithë nacionalizmave, sidomos të atij serb. Dhe kjo është dashur të shfrytëzohet si një mjet për demaskimin e koalicionit që kishte aritur Lidhje Komuniste e Serbisë me forcat ultranacionaliste dhe serbomëdha. Në diskursin publik të asaj kohe ende ekzistonin fusha të tëra të pakontrolluara nga lëvizja serbomadhe. Ekzistonte hapësira dhe mënyrat e ndryshme të demaskimit legjitim të dyfytësisë së pretendimeve serbomëdha. Forcat reaksionare në Serbi angazhoheshin gjithnjë e më hapur dhe në mënyrë ultimative për ndryshimin e kushte-

tutës të vitit 1974 dhe kthimin e hegjemonisë serbe. Nëse kjo nuk do të ndodhte, ato kërcënoheshin se do të heqin dorë nga Jugosllavia për të krijuar Serbinë e Madhe, që pos Kosovës do të përfshinte edhe Malin e Zi, Bosnjën dhe Hercegovinën, më shumë se gjysmën e Kroacisë me pothuajse tërë bregdetin e Adriatikut dhe, më në fund, nuk hiqnin dorë as nga Maqedonia. Dhe kjo edhe do të dalë sheshit shumë shpejtë pas hartimit dhe botimit, kinse “ilegal” të Memorandumit të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Serbisë, që u pat kuptuar menjëherë si një ultimatum i adresuar ndaj federatës jugosllave: o do të rivendoset hegjemonia e Serbisë në Jugosllavi, o Serbia do të kërkojë rrugët tjera për zgjidhjen e çështjes serbe...

BH: Po, cila ishte qasja që sajove...

ShM: Qasja që kisha zgjedhur unë në shkrimet që bëja në ato rrethana ishte ajo e moskontestimit të luftës që po zhvillohej kundër nacionalizmit dhe irredentizmit shqiptar. Por, këtë e bëja me sherr sepse me këtë hapej rruga për të sulmuar edhe çdo nacionalizëm tjetër, dhe para së gjithash nacionalizmin serb, i cili qëndronte në ballë të fushatës së egër antishqiptare. Teza ime ishte se nacionalizmi shqiptar në Kosovë nuk mund të luftohet nëse ajo zhvillohet nga pozitat e nacionalizmit edhe më të rrezikshëm serb. Sigurisht se ky postulat nuk ka qenë ndonjë shpikje ime, sepse e thash që ishte një legat i titizmit, i atij sistemi që për katër dekada e legjitimonte dhe ishte bazament i federatës jugosllave. Por, unë në të vërtetë nuk isha titist dhe komunist për nga bindja. Në shkrimet e asaj kohe, pos disa përjashtimeve, nuk përdorja diskursin dhe fjalorin komunist....

Lavdatat dhe kërcënimet

BH: Kjo që thatë po ma kujton një vlerësim superlativ për ju të të ndjerit Ismail Bajra. Në një tubim, nëse nuk gabohem në vitin 1986, ky ish ministër i informatave në qeverinë jugosllave pat deklaruar se për demaskimin e nacionalizmit serb më shumë ka bërë Shkëlzen Maliqi si individ se sa alamet institutet për histori dhe të gjithë ata doktorë dhe magjistër të historisë për shkollimin dhe avancimin e të cilëve Kosova kishte investuar aq shumë para! Dhe është vërtet çudi që në vitet '80 me akademikët serbë fillimisht konfrontohej hapur dhe me fuqinë e argumentit, një anonimus që quhej Shkëlzen Maliqi, dhe jo akademikët kosovarë!? E kam këtu parasysh edhe kritikën që ia keni bërë në atë kohë, më 1985, "Librit për Kosovën", që e kishte botuar një akademik tjetër serb, Dimitrije Bogdanoviç, ku në mënyrë edhe më sistematike dhe më shteruese demaskohej nacionalizmi serb. Ky artikull ka pasur jehonë të madhe në opinionin jugosllav. Gazeta kroate "Vjesnik" e kishte botuar gati në tërësi dhe pastaj polemikat u barten sërish në një javore të Beogradit, në NIN. Ajo çka më intereson është përgatitja e Shkëlzen Maliqit. Për një konfrontim të tillë ju është dashur të jeni të përgatitur. Nuk ka pikur e gjithë kjo metodë dhe strategji, të cilën e përmende më herët, ashtu nga qielli! Pse, pra, gjithë këtë betejë nuk e bënë historianët dhe akademikët kosovarë, por Shkëlzen Maliqi?

ShM: Nuk ndihem shumë komod me këtë krahasim... Po, është e vërtetë, Ismajl Bajra më pat lavdëruar në atë rast, por ai dinte edhe të kërcënohej, kur shkruaja gjërat që nuk i shkonin për qejfi. Dua të

them se kam qenë vetëm një individë, jo “institucion”... Ndërkaq, historiografia kosovare vërtet ka qenë provinciale, e kontrolluar dhe e trembur. Të them të drejtën, unë për temat historike edhe nuk kam pasur ndonjë përgatitje speciale. Qasja ime edhe nuk ka qenë historike ose historiografike. Me trajnim jam filozof, dhe kam pasur njohuri edhe për sociologji, teoritë politike dhe letërsi dhe artet. Por kjo që ti e quan strategji, nuk ka qenë diçka që e unë e kam përvetësuar si të tillë, për ta përdorur me vetëdije të plotë. Unë do të thosha se reagimet e mia kanë qenë më shumë ekzistenciale. Thjesht, unë jam munduar që të reflektojë pa bllokada mentale që i kishin të tjerët problemet reale të kohës. Po i përcillja me interesim të madh zhvillimet politike. Kam lexuar shumë raporte, rezoluta dhe komente dhe kam menduar shumë për problemet që janë ngritur rreth krizës së Kosovës. Ky interesim i imi nuk ka qenë “akademik”, por i detyrueshëm, si reagim ndaj një kërcënimi ekzistencial. Si një shqiptar që kisha jetuar shumë vjet në Beograd, e ndjeja se kriza po godiste në vetë qenien time, në identitetin e përbërë që kisha, në ambiciet letrare dhe të tjera që i kultivoja fshehtazi, dhe synimet jetësore që i kisha e që nuk i kisha realizuar ende. Në atë kohë unë vetën e shihja më shumë si poet dhe filozof. Synoja që të realizoja një jetë ma shumë refleksive, prej intelektual, por nuk kisha idenë e qartë se si bëhet kjo. Kam qenë person i tërhequr dhe në kërkimet e mia kishte shumë hezitime. Kam qenë i vetmuar, melankolik, me një prirje për tu ballafaquar me tema të mëdha të universit, të jetës dhe vdekjes, kryesisht apolitike... Por kriza që shpërtheu në Jugosllavi ishte si një furtunë, ishte sfidë e jashtëzakonshme që më detyronte ta ndryshoja vetën, të kërkoja përgjigje më imediate se kush jam dhe çka dua, duke thyer ose edhe copëtuar në dysh atë identitetin e përbërë që kisha... Pas

pranverës të vitit 1981 gjithnjë e më shumë preokupohesha me temat shqiptare dhe çështjen e Kosovës. Dhe reagimi që bëra nga fundi i vitit 1982, kundër akademikut Iviç, ndikoj edhe në fatin tim, sepse jeta ime pastaj mori kahe tjetër dhe unë u bëra pakthyesëm publicist, gazetar dhe politikan. Ky ishte rezultati i këtyre zhvendosjeve të dhunshme të interesimeve të mia.

Formula e kundërgoditjes

BH: Po, edhe kjo që tha, megjithatë tregon se Shkëlzen Maliqi nuk ke pikë nga qielli...

ShM: Po, mirë, ndoshta ke të drejtë, por në një kuptim tjetër. P.sh. për shkrimin kundër akademikut Iviç mund të pohoj se ka qenë një reagim i përgatitur dhe i menduar që më herët. Temën e edhe qasjen unë e kisha zhvilluar që nga vera e vitit 1982, pasi që në një Kongres të Lidhjes së Komunistëve të Serbisë (ka qenë ndoshta ndonjë Plenum, mbledhje plenare e Komitetit Qendror të LKS, kjo sot s'ka ndonjë rëndësi), kishte plasur sherri dhe polemika ndërmjet akademikut kosovar Idriz Ajeti dhe dy intelektualëve serbë, edhe ata anëtarë të forumit më të lartë komunist, Jovan Deretiç, dekan në Fakultetin Filologjik të Beogradit, ku unë punoja në atë kohë, dhe filozofit Petar Zhivadinoviç, të cilin e njihja shumë mirë nga koha e studimeve. Gazetat serbe i patën dhënë mjaft hapësirë sulmeve të Deretiçit dhe Zhivadinoviçit ndaj Idriz Ajetit, ku ata politizonin ashpër temën e prejardhjes ilire të shqiptarëve. Edhe Ajeti sikur e provokonte këtë politizim me një qasje jo edhe aq fleksibile ndaj asaj se çka konsiderohet e vërtetë shkencore dhe si dhe kur ajo plasohet në foltoret dhe plenumet thjesht ideologjike,

ku pos argumenteve historike, është dashur të kihet edhe artikulum dhe argumente të forta politike. Unë e pata përcjell me indinjatë këtë polemikë, madje e pata shkruar edhe një reagim për këtë, që mbeti i papërfunduar. Këtë shkrim e kam humbur, por idetë dhe pjesët e tij, i pata shfrytëzuar në polemikën që zhvillova disa muaj më vonë me akedemikun Pavle Iviç.

BH: A mund të shpjegosh më konkretisht se cili ka qenë modeli i reagimit tënd?

ShM: Shiko, në atë Kongres ose Plenum një organ partiak po shqyrtonte çështjen e prejardhjes së shqiptarëve, çka ishte nonsens i rrezikshëm për shkencën dhe politikën. Dhe kur kjo u përsërit në mënyrë edhe më të vrazhdë në intervistën e Pavle Iviçit, ishte një shembull i qartë se nacionalizmi serb po depërtonte fuqishëm në Lidhjen e Komunistëve të Serbisë. Në një forum të partisë në pushtet po shqyrtohej se a janë shqiptarët autoktonë në trevat ku banojnë sot! Kjo për mua ishte skandaloze! Në vend të hipotezës ilire të prejardhjes shqiptare, që dominon në shkencën historike serioze, në qarqet intelektuale serbe po ringjallej, e motivuar politikisht, hipoteza e prejardhjes trakase. Për nationalistët dhe komunistët serbë motivi për shqyrtimin e kësaj çështjeje nuk ishte aspak ideja se duhet të mbrohet një e vërtetë shkencore nga, siç i quanin ata, shtrembërimet nacionaliste, por ata synonin që ta hedhin poshtë tezën e prejardhjes ilire. Nga ky intervenim nuk “përfiton” asgjë shkenca por serbët dhe Serbia. Historiografia e ngarkuar dhe nationalistët serbë nga Lidhja e Komunistëve, pra nga pushteti i atëhershëm, kërkonte vulosjen e “dëshmisë” se shqiptarët nuk janë autoktonë në trevat ku jetojnë sot, por se janë të ardhur nga diku tjetër, konkretisht nga pjesët lindore të Ballkanit, nga Trakia. Për

më shumë, implicite dhe pa argumente të verifikuara historiografike, sugjerohej se dyndja e fiseve proto-shqiptare nga Trakia, kishte ndodhur pas ardhjes së sllavëve dhe serbëve në Ballkan, kështu që dilte se serbët janë populli më i vjetër dhe më autokton në Kosovë. Kur kësaj i shtohet insistimi tjetër që serbët nga koha e mesjetës i kanë të ruajtur më shumë dokumente dhe monumente historike dhe të kulteve fetare, kjo çonte deri te përfundimi se tapia mbi Kosovën i takon vetëm serbëve, se Kosova ka qenë dhe duhet të mbetet amshueshëm pronë serbe. Pasi që në vitin 1982 me tema të tilla po merreshin komunistët serbë, duke akuzuar komunistët shqiptarë se shkenca kosovare dhe shqiptare po e “falsifikonte” historinë, kjo menjëherë kuptohej si akuzë e rëndë dhe diskualifikuese që lidhej me proceset aktuale politike dhe daljen në shesh të çështjes së statusit të Kosovës pas demonstratave të vitit 1981 dhe reagimit të ashpër të Serbisë dhe organeve të federatës jugosllave, deri në shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme, kundër kërkesës që Kosova të bëhet republikë e shtatë e federatës jugosllave.

Unë thash se në atë kohë e kisha pak a shumë të elaboruar këtë temë, që unë e shtroja si një shembull të keqpërdorimit të argumentit historik për nevojat e politikës ditore dhe të promovimit të aspiratave të nacionalizmit serb. Kur akademiku Iviç doli edhe më qartë me pohimet e njëjta në revistën politike javore NIN, nuk kishte më aspak dilema që lufta kundër nacionalizmit dhe irredentizmit shqiptar, që e kishin promovuar komunistët serbë, po i hapte rrugën depërtimit të fuqishëm të një nacionalizmi tejet agresiv serb. Titoja kishte vdekur më 1980 dhe tani, me krizën e Kosovës, po ringjallehin disa mite, ideologji të vjetra dhe tema më shumë se dyzetë vjet të harruara! Dhe ajo që po ndodhte në Beograd, mobilizimi masiv i forcave antititiste dhe antikomuniste,

dalja në skenë dhe pushtimi i shpejtë i institucioneve, organizatave dhe shoqatave nga nacionalistët ekstrem serbë, mua ma kallte datën sepse këtë e shihja si një paralajmërim dhe kërcënim me luftë.

BH: Pra, Shkëlzen Maliqi, në këto rrethana, përcaktohet për një qasje dinake...?

ShM: Nëse do ta kundërshtoja hapur në atë kohë komunistët serbë dhe partinë komuniste, kjo do të ishte kundër produktive, sepse në këtë ende qëndronte sistemi, boshti i pushtetit dhe i diskursit ideologjik sundues. Ndërkaq, nuk dukej krejt e pashpresë që të kontestohet botëkuptimi i akademik Iviçit, më vonë edhe Dimitrije Bogdanoviçit dhe të tjerëve, që i takonin edhe ashtu qarqeve që madje edhe zyrtarisht konsideroheshin nacionaliste.

Modeli im për demaskimin nuk ishte i përsosur, por qëndronte në vijën e sistemit që në aspektin institucional e mbronin edhe titistët kosovar me në krye Fadil Hoxhën. Unë nuk e idealizoj aspak Kushtetutën e vitit 1974, e as sistemin titist, por jam i bindur edhe sot se nuk ka qenë strategji e keqe mbrojtja e kësaj Kushtetute edhe pas vitit 1981. Pa atë Kushtetutë që quhej “konfederale”, me instrumente të fuqishme mbrojtëse që i kanë pasur republikat dhe dy krahinat socialiste, nacionalizmi dhe hegjemonizmi serbomadh do të kishte më shumë gjasa për depërtim të shpejtë dhe imponim me forcë të zgjidhjeve të njëanshme. Kosova e ka ngadalësuar shumë zgjidhjen e çështjes serbe ashtu siç ishte paraparë në Memorandumin e ASHAS. Nacionalizmi serb humbi nëntë vjet për të nënshtruar dhe ri-okupuar Kosovën, dhe kjo kohë u shfrytëzua nga republikat tjera për të përgatitur shkëputjen. Kohën dhe energjinë që e kishte humbur me Kosovën në vitet '90, Serbia është dashur që ta kompensojë me një politikë agresive dhe luftënxitëse në

vitet '90, ndërkaq që Sllovenia dhe Kroacia u përgatiten me kohë për luftën, e edhe Bosnjës dhe Hercegovinës iu dha shansi që ta rezistojë agresionin që synonte gllabërimin e kësaj republike!

Paralajmërimi i luftës

BH: E përmendet disa herë luftën në kontekstet e ndryshme. Në njërën nga bisedat kur po e përgatisnim këtë libër ju më patët thënë se qysh në fillim të viteve tetëdhjeta keni qenë të bindur se në Jugosllavi do të shpërthejnë luftërat. Çka ju beri të besoni: gjuha që është përdorur pas vitit 1981? Thellësia e njohjes së mentalitetit dhe intelektualëve serbë, apo kishit ndonjë informacion shtesë?

ShM: Nuk kam pas ndonjë informacion special për këtë. Ka qenë klima e ringjalljes së frymës militariste në Serbi ajo që më ka bërë të parandieja se zhvillimet çojnë drejtë luftërave. Por, mund të them se në ato vite më së shumti më frikësonte ndryshimi i shpejtë i fjalorit dhe diskursit publik në Serbi. Më 1981, pas demonstratave në Kosovë, në Beograd u bë një hallakatmë e madhe, u shpall gjendja e jashtëzakonshme, në çdo institucion shtetëror dhe publik mbaheshin kujdestaritë e vazhdueshme, sikur çdo ditë pritej ndonjë sulm, agresion drejtë Beogradit i shqiptarëve të Kosovës dhe i Shqipërisë së Enver Hoxhës! Kuptohet, fjalori dhe diskursi ende ishte komunist, flitej për kundërrevolucion, irredentizmin shqiptar që po e rrezikonte unitetin dhe stabilitetin e Jugosllavisë, për domosdonë e “diferencimeve” nga nacionalistët dhe irredentistët shqiptarë dhe, kjo me më pak insistim, edhe të gjithë nacionalizmave tjerë. Unë ato ditë të marsit dhe të pril-

lit të vitit 1981, flisja çdo mbrëmje me familjen, sidomos gjatë kujdestarive të shpeshta që isha i detyruar t'i mbaja në Fakultetin Filologjik të Beogradit, ku isha i punësuar. Ishte një situatë paradoksale se unë si shqiptarë nga Kosova po e ruaja njërin nga institucionet serbe, që jo-zyrtarisht njihet si njëra nga çerdhet e nacionalizmit serb, prej rrezikut krejtësisht të shpifur nga shqiptarët! Më kujtohen bisedat e gjata me vëllain tim të ndjerë, Gazmendin, ai punonte atëherë në Televizionin e Prishtinës si regjisor. Gazi më tregonte se çka po ndodhte, pasi që unë atëherë nuk kisha mundësi të udhëtoja në Prishtinë, sepse ishim si të mobilizuar. Një urdhëresë interne në Fakultet i ndalonte udhëtimet e personelit. Ishte, pra, tamam një atmosferë para luftës. Një informatë që më ka bërë më së shumti përshtypje në ato bisedat me Gazin ishte ajo e mënyrës së hyrjes së forcave policore serbe në Kosovë pas shpërthimit të trazirave në Kosovë. Unë e kam ende të gjallë përfytyrimin që e kisha bërë në imagjinatën time se si kolona e autoblindeve dhe kamionave me policinë serbe po e kalon kufirin të fshati Merdare dhe sapo që futet në Kosovë, pa një pa dy, policët zbresin nga automjetet dhe qëllojnë me rafale çdo krijesë që lëvizte dhe që atyre u dukej se është shqiptar.

Edhe pse nuk e kam vërtetuar kurrë, unë i besoj këtij përshkrimi. Zakonisht jam shumë i kujdesshëm, nuk nxitohem në vlerësime. Përpiqem gjithnjë që të bëjë analiza kritike të të dhënave që i marrë nga të tjerët. Mirëpo, këtë përshkrim të hyrjes së policisë serbe në Kosovë e kam besuar menjëherë ngase përputhej me atë se çka dija për disponimin deri atëherë të fshehur revanshist të nacionalistëve dhe shovenëve serbë. Për këtë jam bindur edhe më shumë kur kam dëgjuar për mënyrën tejet brutale të ndërhyrjes së forcave speciale policore në konviktet e Prishtinës, me 1 prill të vitit 1981. Këto nuk ishin inter-

venime të një policie komuniste, sado edhe ajo ka ditë të jetë shumë brutale dhe e pamëshirshme. Ishte e qartë se po ndërhynte Serbia si shtet dhe në emër të serbëve, duke treguar kështu dhëmbët dhe duke u kërcënuar me luftë.

Kam pasur në ndërkohë disa informata edhe të dorës së parë, ose të përfolura, për disponimet e qarqeve nacionaliste serbe që në atë kohë tuboheshin rreth shkrimtarit Dobrica Qosiq.

Si e njoha nacionalizmin serb?

BH: E ke njohur Qosiqin?

ShM: Jo personalisht. E kam dëgjuar në disa tribuna dhe tubime publike që nga viti 1968, dhe sidomos nga fillimi i '70 kur me te u afruan profesorët e mi, grupi antitist nga Fakulteti filozofik...

BH: Po me duket interesant pohimi për njohjen e hershme me idetë e nacionalizmit serb. Çfarë ishte konteksti? Në cilat rrethana?

ShM: Në vitet 70 unë kam bashkëjetuar me një vajzë prindërit e së cilës kanë qenë nga Dalmacia, nga ishulli Hvar. Babai i Smilkës, koloneli Andro Gabeliq, ka shkruar editoriale dhe ishte edhe komentues për çështje ushtarake në gazetën zyrtare "Borba", në atë kohë i dalur në pension dhe shumicën e kohës e kalonte në Hvar. Por, sa herë që vinte në Beograd ai mbante lidhjet me disa qarqe intelektuale me ndikim nga Beogradi. Gabeliqët shkonin mirë me një malazez, Dragisha Ivanoviç, i cili ka qenë rektor i Universitetit të Beogradit nga fundi i 60-ve, dhe madje në atë kohë është shpall edhe doktor nderi i Universitetit të Prishtinës. Ivanoviçët kishin lidhje me Dobrica Qosiqin dhe qarkun e

tij, sidomos me një gjeneral në pension nga jugu i Serbisë, nga qyteti Vranje ose rrethina, Zhivojin Nikoliq Bërka, e që edhe Gabeliqët e kishin mik të shtëpisë. Për çudi, pjesë e këtij qarku ka qenë më herët, në vitet '60, edhe gjenerali kroat Franjo Tugjman, i cili më vonë u bë kryetar i Kroacisë që shpalli pavarësinë e kësaj republike. Për Tugjmanin kam dëgjuar për herë të parë prej Gabeliqëve, tregonin mbi debatet për çështjen kombëtare kroate dhe serbe, që janë zhvilluar mes tyre, derisa Tugjmani shërbente në Beograd dhe ishte kryetar i klubit të njohur futbollistik "Partizan", që mbahej si klub i armatës jugosllave. Unë me shoqen time nuk ua varnim shumë veshin muhabetëve dhe pyetjeve të këtyre pleqve, por disa herë na ka ardhur për vizita gjenerali Bërka, që gjatë Luftës së Dytë Botërore kishte luftuar në Jug të Serbisë, në Vranje dhe Luginën e Preshevës, pastaj edhe në rrethinën e Gjilanit, në Karadak dhe Maqedoni, dhe që nga lufta i njihte mirë edhe udhëheqësit nga Kosova, Fadil Hoxhën dhe të tjerët. Pas aproimit të kushtetutës së vitit 1974 të Jugosllavisë, me të cilën u avancua shumë autonomia e Kosovës, gjenerali Bërka pat hyrë një pasdite në dhomën time në banesën e Gabeliqëve, kinse për të më pyetur për një informatë që e kishte shqetësuar. Mu drejtuar ashpër me tonin e gjeneralit që është mësuar të jep vetëm urdhëra: "A është vërtetë që ti dhe Smilka po punoni në një kishë te Piroti dhe se aty, mbi portë, është zbuluar një mbishkrim bullgar?" Po, i thash unë, përmendet perandori bullgar Ivan Aleksander Asen dhe se kisha është ndërtuar në shekullin XIV (vitet 1331-1332). Bëhej fjalë për një mbishkrim në kishën e fshatit Staniçenje që mund të dëshmont se kufijtë e Bullgarisë mesjetare shtriheshin më në perëndim, përtej Pirotit dhe në drejtim të Nishit. Gjenerali këtë assesi nuk donte ta besonte. Më tha diçka se motra e

perandorit Ivan ka qenë e martuar me perandorin serb Dushanin, dhe se ato toka i paskan takuar Serbisë si pajë e martesës... Dërdëlliste, pra, kështu diçka... Por, ai e pat shfrytëzuar rastin dhe ma mbajti një “ligjëratë” plotë nerva dhe vrer për pasojat katastrofale të Kushtetutës së vitit 1974. Me atë rast unë po dëgjoja për herë të parë idetë dhe akuzat që do të përpunohen dhjetë vjet më vonë në një dokument famëkeq, Memorandumin e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Serbisë. Gjenerali Bërka më fliste me diskursin e Qosiqit për “padrejtësinë” që i kishte bërë Titoja Serbisë duke e avancuar statusin e Kosovën, siç u shpreh, “në një shtet brenda shtetit”. Në një të ardhme kjo dosido se do të sjellë probleme, më thoshte duke u hakërritur, kinse unë po bëja pjesë në atë “mëkatën” e Titos. Ia kishte inat sidomos Fadil Hoxhës, e konsideronte se Titoja ia ka besuar udhëheqjen e Kosovës pa merita sepse ai nuk ishte sinqerisht për Jugosllavinë ngase, sipas tij, “Fadili ishte i ardhur nga Shqipëria si një këlysh dyfytyrësh i Enver Hoxhës”, i cili po i përgatisë kuadrot që Republika e Kosovës në të ardhmen të bashkohet me Shqipërinë.

Kjo ka qenë hera e parë që kam dëgjuar për Republikën e Kosovës, dhe mund të them sinqerisht se nuk më ka bërë përshtypje. E konsideroja gjeneralin, gjithnjë sipas disponimit tim të atëhershëm, si një pensionist të frustruar, gjysmë të çmendur, një njeri anakronik.

BH: Në cilin vit ndodhi kjo?

ShM: Mbase në vitin 1977. Atëherë isha gati krejtësisht i shkëputur nga politika, e punoja studimin për estetikën bizantine, dhe vetëm gjatë verës merresha me konservimin e freskave, për të siguruar jetesën. Kjo ndeshje me historinë dhe çështjen e Kosovës, atëherë më dukej aksidentale, por së shpejti do të më kthen në tema historike dhe realite-

tin e raporteve politike. Nga viti 1978, kur u punësua në Fakultetin Filologjik, Dega e Albanologjisë, të Universitetit në Beograd, pata rast të lexoja shumë libra dhe artikuj për çështjen e Kosovës, sidomos ato nga fundi i shekullit 19. dhe fillimi i shek. 20. Pos Dimitrie Tucoviçit, Milan Shuflajit, Miroslav Kërlezhës madje edhe Milovan Gjillasit, që ishin udhërrëfyes më të mirë për trajtimin e drejtë të kësaj çështjeje, i pata lexuar edhe ato lektura të çmendura të ideologëve serbomadh dhe shovenëve si Stojan Protiç (Ballkanikus), Vlladan Gjorgjeviç, Jovan Cvijiq etj., që shqiptarët i trajtonin si bisha të egra, njerëz me bishta, të paafte për t'u civilizuar dhe krijuar shtetin e tyre. Dhe aty mësova burimin e disa tezave që i pata dëgjuar nga gjenerali bezdisës i qarkut të Qosiqit.

Dhe kur më 1981 dhe 1982 shtypi serbë nxori tërthorazi ose hapur këto tema dhe qasje jo vetëm shoviniste dhe raciste por edhe ashiqare luftënxitëse, unë kuptova se zhvillimet do të mund të marrin kahe serioze. Titoja nuk ishte më gjallë kurse nacionalizmi serb po çonte kokë...

BH: A ke menduar atëherë se Jugosllavia po shkon drejt shkatërrimit?

ShM: Jo, ishte herët... Jugosllavia pas Titos edhe për një kohë dukej relativisht stabile, kafshatë e madhe dhe e papërballueshme për revan-shizmin serb. Gjasat për luftë më janë dukur më të vogla se gjasat për tejkalimin e krizës me mjete politike. Atëherë ende nuk shtrohej as çështja e shembjes së shpejtë të sistemit komunist në Evropën Lindore. Unë isha skeptik vetëm për një çështje, edhe kjo pak si me mjegull, se mos republikat tjera jugosllave nuk do të bëjnë kompromis me Serbinë,

duke flijuar Kosovën dhe shqiptarët për hir të interesave të tyre dhe frika nga Serbia.

Më 1982 unë u ktheva në Prishtinë, i lodhur nga Beogradi por edhe pa ide të qartë se çka po kërkoja në Kosovë. Në një moment, para se kisha vendosur që të kthehem në Prishtinë, e kisha biletën dhe ftesën për Paris, të provoja të jetoja dhe punoja atje. Por problemi ishte se nuk e dija gjuhën frënge, isha 35 vjeç dhe nuk më fillohej nga e para. Po ta dija atëherë se lufta është e pashmangshme, ndoshta do të shkoja në Paris.

Themelimi i organizatës së parë opozitare

BH: Këtë që folët mund ta quajmë më shumë parandjenjë të luftës. Por një moment tjetër ju ka bërë që të besoni se lufta do të nisë patjetër – revolta e Stari Tërgut, mbyllja e minatorëve në zgafellë dhe greva e urisë për shtatë ditë rresht. Në atë kohë, me sa di, Ju po organizonit një tubim të parë opozitar në Kosovë, degën e UJDI-të, si një iniciativë e intelektualëve që kishin për qëllim demokratizmin e Jugosllavisë, por që nuk deklarohet si parti, ishte vetëm shoqatë. Çka ka qenë kjo shoqatë? Një iluzion karshi forcave të luftës dhe destrukcionit?

ShM: Vërtet ka qenë një koincidencë që ditën kur minatorët shqiptarë zbritën dhe u mbyllën në zgafellat e minierave të “Trepçës”, që u bë pretekst për shpalljen e serishme të gjendjes së jashtëzakonshme, nuk di e sata me radhë ishte, unë me disa shokë e patëm caktuar tubimin e parë të degës kosovare të shoqatës së parë alternative politike jugosllave të njohur me akronimin UJDI në gjuhën serbokroate, që shënonte Shoqa-

tën Jugosllave për Iniciativë Demokratike. Në mbrëmje të asaj dite, më 22 shkurt të vitit 1989, ne që po e organizonim tubimin nuk e kishim të qartë se sa veta do të vinin dhe nuk kishim as ndonjë agjendë të saktë. E menduam thjesht si një konsultë me njëzetë-tridhjetë veta. Tubimi është dashur të mbahet në sallën e Bashkësisë Kulturore-Arsimore të Kosovës, ku unë punoja në atë kohë. UJDI konsiderohej si shoqatë dhe kjo Bashkësi kishte një farë mandati të kujdeset për shoqatat dhe asociacionet, qoftë edhe për themelimin e tyre, kështu që nuk e konsideronim si ndonjë presedencë të madhe, edhe pse BKA ishte pjesë e sistemit, organizatë shtetërore që financohej nga Lidhja Socialiste e Kosovës. Më herët kishim bërë përpjekje që të organizonim edhe një lëvizje ekologjiste të Kosovës. Edhe për këtë unë isha njëri prej iniciatorëve. Kurse UJDI në fillim të shkurtit të vitit 1989, kur ishte mbajtur kuvendi iniciues në Zagreb, ende nuk njihesh si formacion në kuptimin e plotë politikë dhe opozicionar. Ishte një shoqatë demokratike, jo parti politike, që regjimi duhej ta toleronte sepse nuk e rrezikonte monizmin në mënyrë direkte. Në Kuvendin themelues të UJDI-t kanë marrë pjesë rreth 100 veta. Nga Kosova kemi qenë unë, Muhamedin Kullashi dhe një filozof i ri serb me prejardhje nga Bosnja, Drago Gjuriq. Këtë të fundit unë e kisha rekomanduar që të punësohej në BKA.

Në të vërtetë, para Kuvendit me 2 shkurt ka qenë edhe një konsultë tjetër në rrethin më të ngushtë, që është mbajtur në fund të nëntorit të vitit 1988, po kështu në Zagreb. Në këtë konsultë të parë nga Kosova kam qenë vetëm unë, dhe në te nuk kanë marrë pjesë më shumë se 20 deri 30 veta: kanë qenë nga Kroacia Branko Horvat, Zharko Puhovski, Lino Velak dhe Miodrag Pupovac, nga Sllovenia, nëse nuk gabohem, Rastko Moçnik dhe Miha Kovaç me një grup studentësh që bënin shumë

zhurmë, pastaj edhe disa veta nga Serbia dhe Bosnja dhe Hercegovina, që sot nuk më kujtohet se cilët kanë qenë konkretisht, por gjithsesi i kanë takuar rrethit të Vesna Peshiqit, Nebojsa Popovit, Zharko Koraqit nga Beogradi, ose të Zdravko Grebos dhe Gajo Sekuliqit nga Sarajeva. Jam i sigurtë se kanë qenë dy miqtë e mi nga Beogradi, Lidija Boshkoviç dhe Branimir Stojanoviç - Tërsha, sepse shoqëroheshja me ta tërë kohën. Sidoqoftë, ky takim debatik parapërgatitor, që për temë kishte çka duhet të bëjmë ne intelektualët në kushtet e krizës së madhe që po e kërcënonte Jugosllavinë, ka qenë i financuar nga Ambasada e SHBA-ve në Beograd (ose Konzulata në Zagreb që i bie E njëjtë), dhe aty edhe ishte ngjizur ideja dhe projekti për UJDI-n. Unë që atëherë kisha marrë përsipër që të rekrutoja të interesuarit nga Kosova për kuvendin themelues. Kështu edhe i pata bindur Muhamedinin dhe Dragon për UJDI-in dhe shkuam bashkë në atë Kuvend, me 2 shkurt 1989, që pastaj e hapi mundësinë për krijimin e degëve të UJDI-t në të gjitha republikat dhe dy krahinat autonome të Jugosllavisë. Dhe pas krijimi të këtyre degëve ishte bërë si rregull që të trimëroheshin edhe grupet e njerëzve që kishin ndërmend të themelonin parti politike të profileve të ndryshme, kryesisht nacionaliste. Ne në UJDI edhe ashtu qëllim e kishim krijimin e kushteve për konkurrencë politike, për thyerjen e monopolit të partisë komuniste. Dhe kjo edhe ndodhi gjatë vitit 1989 në krejt Jugosllavinë, diku më shpejtë, diku me hezitime, me përjash-tim të Kosovës, ku themelimi i UJDI-t por edhe i partive opozitare do të vonohej për dhjetë muaj, sepse në fund të shkurtit, siç e përmenda, ndodhi greva e Trepçës për të cilën folëm më herët dhe u shpall gjendja e jashtëzakonshme, dhe regjimi serb ndaloi çdo tubim politik në Kosovë.

Pra me 22 shkurt, diku para mbrëmjes, deri sa unë me Isuf Berishën dhe disa shokë të tjerë po e përgatisnim sallën dhe deklaratën themeluese, i ndjeri Nahil Luma, që ishte kryetar i Bashkësisë Kulturore-Arsimore të Kosovës, ishte lajmëruar “nga lartë” për shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme dhe pezullimin e menjëherëshëm të gjitha aktiviteteve dhe tubimeve në Kosovë. Nahilit i vinte keq, u konsultua me dikën në Lidhjen Socialiste, dhe atëherë edhe morëm vendimin që krijimi i degës së UJDI-t për Kosovë të shtyhet për më vonë. Lajmëruam shumicën e atyre që i kishim ftuar për pezullimin e tubimit, por ndejtëm në sallë deri në ora 8,30 ose edhe 9 të mbrëmjes duke i kthyer ata që nuk i gjetëm, ose që kishin ardhur pa ftesë. Më kujtohet se ndër këta formalisht të “paftuarit” ka qenë edhe kryeministri i ardhshëm i Qeverisë së Kosovës në ekzil, Dr. Bujar Bukoshi me gruan e tij Flutrën. Më herët nuk e kam njohur qiftin Bukoshi, por me atë rast shkëmbyem ca fjalë, kuptova se ata po banonin te Enver Tali, daja i dhëndrit tim Shpend Bajrami, dhe që prej atëherë kemi mbetur miq... Më duhet të them se në këtë përpjekjen e parë për të themeluar degën e UJDI-t nuk ka qenë fare prezent Veton Surroi si opcion për ta kryesuar këtë organizatë. Vetonin e kemi inkuadruar dhe projektuar për kryetar të Degës dhjetë muaj më vonë, kur edhe u themelua Dega, me 9 dhjetor 1989.

Greva e Trepçës

BH: U ndalem te greva e Trepçës...

ShM: Po, greva... Ky ka qenë një reagim sublim, në vazhden e rezistencës publike që kishte filluar në vjeshtë të vitit 1988 me marshet massive nga të gjitha qytetet e Kosovës drejt Prishtinës. Në vitin 1988 pop-

ullizmi i dirigjuar serb arriti kulminacionin. Regjimi i Millosheviçit po organizonte gjithandej Serbisë dhe Malit të Zi mitingje masive dhe agresive, si pjesë e presionit ndaj Kosovës dhe republikave tjera, që të ndryshohet kushtetuta e vitit 1974. Këto mitingje masive, si ai në tetor '88 kur në Ushqe të Beogradit Milosheviçi kishte tubuar një milion veta, turmë kjo delirike, e tmerrshme, kërcënuese, diçka që i ngjante delireve dhe kërcënimeve të falangave fashiste në Itali dhe të atyre naziste në Gjermani në kohën e Musolinit dhe Hitlerit, kur patën ardhë në pushtet dhe po e përgatisnin luftën e Dytë Botërore. Popullizmi dhe fashizmi serb për qëllim imediat kishte ndryshimin e dhunshëm të udhëheqësive rezistuese në tri njësitë federative, në dy krahinat e Serbisë, Kosovën dhe Vojvodinën, dhe në Malin e Zi, që pokështu konsiderohej si një provincë serbe “artificialisht” e ndarë nga Serbia. Dhe deri sa udhëheqësitë e Vojvodinës dhe të Malit të Zi nuk arritën t'i rezistonin turmave që i patë ndërsyer kundër tyre Millosheviçi që synonin ribashkimin e “trojeve serbe”. Fallangat këndonin “Oj Serbijo iz tri dela, ti ces opet biti cela!”...

BH; Si do ta përktheje këtë?

... “Oj Serbi e ndar në tresh, e bashkuar sërish do të jesh!”

BH: Ja gjete edhe rimën, ha-ha-ha...!

ShM: ... Por, në Kosovë s'kishte mundësi për përsëritjen e skenarit... Në Vojvodinë turma para komitetit të partisë të kësaj krahine e kishte rrëzuar udhëheqësinë duke e gjuajtur me jogurta, andaj ngjarja quhej “Jogurt revolucion”, kurse në Kosovë ndodhi një rezistencë sa e papritur po aq edhe tejet masive e shqiptarëve. Ata protestonin kundër ndërrimit me presion të liderëve kosovarë, të cilët, edhe pse të dobë-

suar dukshëm, megjithatë kundërshtonin ndryshimin e kushtetutës së Kosovës. Kjo revoltë shqiptare ka qenë e stimuluar nga udhëheqësia e atëhershme, Azem Vllasi dhe Kaqusha Jashari, të ndihmuar edhe nga drejtorët e firmave të mëdha si Aziz Abrashi dhe Burhan Kavaja të Trepçës, Llazër Krasniqi i KEK-ut etj. Megjithatë, mund të thuhet se ky organizim ishte edhe një shpërthim i papritur dhe spontan i vetë masave shqiptare, që ishin thellësisht të pakënaqur me tendencat që të asgjësohet autonomia e Kosovës. Unë atëbotë e botova një koment në të përjavshmën “Dani” të Sarajevës, me titull “Po ndodhin edhe kombësitë” (Dogadaju se i narodnosti!) si përgjigje slloganit që e kishin plasuar nacionalistët serbë në mitingun e madh në Ushqe të Beogradit “Ka ndodhur kombi [serb]!” (Dogodio se narod!) Dhe pasi që ky demonstrim masiv i shqiptarëve, që nëpër borë dhe kijamet kalonin në këmbë disa dhjetëra kilometra nga Gjakova, Peja, Prizreni, Mitrovica, Gjilani etj., për të protestuar në Prishtinë, nuk dha rezultat, dhe në udhëheqësinë e Kosovës u instaluan liderët më të frikësuar dhe më të parezistueshëm ndaj presioneve, në gjithë Kosovën për disa muaj mbizotëroi depresioni, një stepje në pritjen e më të keqes, e cila do të ndodhte në pranverë kur ishte caktuar afati i zyrtarizimit të ndryshimit të kushtetutës. Intelektualët e Kosovës publikuan Apelin 212 kundër ndryshimit të Kushtetutës së Kosovës, që në tubimet popullore nuk ishte përkrahur, por politikanët e instaluar po lëshonin pe ndaj presioneve të Beogradit. Edhe unë isha ndër nënshkruesit e Apelit, por ai nuk pati ndonjë efekt, vetë se megjithatë shtoi pakënaqësinë në opinion dhe vuri në lëvizje klasën punëtore, që ende e konsideronte vetën faktor në sistemin socialist. Minatorët e “Trepçës” reagueshan në prag të ndryshimit të Kushtetutës. Ishte një ndërmarrje e madhe, heroi-

ke dhe dinjitoze... Minatorët zbritën në horizontet e nëndheshme të minierës, dhe në thellësinë prej 800 metrash të zgafellës organizuan grevën e urisë, që menjëherë u zgjerua grevë të përgjithshme që për një javë paralizojë jetën në Kosovë. Qytetarët e Kosovës treguan qartë se janë kundër ndryshimit të kushtetutës, por ishte e kotë, regjimi i armatosur deri në dhëmbë nuk zgjodhi mjete, u rishpall gjendja e jashtëzakonshme, organet federative u detyruan edhe një herë që të ndjekin diktatin e Serbisë, por me dy pasoja largëvajtëse të rrënimit të tri shtyllave mbajtëse të sistemit socialist dhe të shtetit federal. E para, me grevën e Trepçës, humbi legjitimitetin boshti i sistemit komunist ngase nuk u respektua revolta e klasës punëtore dhe u dëshmuua se në këtë sistem nuk ekzistonte më “diktatura e proletariatit” dhe se solidariteti i punëtorëve po zëvendësohej me solidaritetin kombëtar, etnik. E dyta, humbi legjitimitetin edhe politika e barazisë nacionale që e kishte instaluar Titoja. Së fundit, u tret edhe baraspesha delikate mes republikave që kishin lidhur kontratën federale pasi që Sllovenia shfaqti solidarizim me revoltën e minatorëve dhe deklaroi se në Trepçë po mbrohej Jugosllavia e KAÇKJ-it (AVNOJ-it) duke kërcënuar Serbinë që të tërhiqet nga pretendimi i ndryshimit të dhunshëm të Kushtetutës së Kosovës, sepse kështu po sfidohej seriozisht dhe pariparueshëm edhe federata jugosllave. Porosia implicite ishte: nuk do të ketë më Jugosllavi nëse nuk dëgjohej zëri i minatorëve dhe shqiptarëve! Dhe kur kjo ndodhi, pra kur Serbia ripushtoi Kosovën dhe i uzurpoi të gjitha postet përfaqësuese të Kosovës në federatë, në kryesinë tetë-anëtarëshe dhe instancat tjera, u prish ekuilibri i ndarjes së pushtetit në federatë. Serbia arriti që t'i vinte nën kontroll 4 nga 8 njësitë federale (pos vetë Serbisë, edhe Malin e Zi, Vojvodinën dhe Kosovën), dhe kishte goxha

ndikim edhe në Bosnje-Hercegovinë dhe Maqedoni. Ishte vetëm pyetje e ditës kur Millosheviçi do të sigurate edhe votën e pestë në Kryesinë tetëanëtarëshe, dhe kështu instalonte “hegjemoninë e ligjshme” Të Beogradit mbi Jugosllavinë. Në Slloveni, që udhëhiqej nga Millan Kuçani, politikani më i zoti në atë kohë në tërë Jugosllavinë, u kuptuan qëllimet e regjimit serb dhe kjo republikë menjëherë mori kursin e ndarjes....

Tubimi në Cankarjev Dom të Lubjanës?

BH: Kam dëgjuar prej një miku, në atë kohë, se edhe Shkëlzen Maliqi ka pasur një farë ndikimi për reagimin e sllovenëve dhe organizmin e tubimit protestues në Cankarjev Dom të Lubjanës? Ti në atë kohë shkruaje rregullisht për mediat sllovene dhe ke pasur edhe kontakte me intelektualët dhe politikanët sllovenë. Ky pohim për ndikimin në politikën sllovene a është teprim, apo realitet?

ShM: Është teprim... Por, është e saktë se në atë kohë unë kam qenë mjaft prezent në mediat sllovene. Atje botoja shkrimet rregullisht. Por, mbase është ekzagjerim ajo që thatë për ndikimin e këtyre shkrimeve të mia, që unë i shkruaja në serbokroatisht e ata i përkthenin në sllovenisht. Është e vërtetë se nja dy-tre ditë para Mitingut në Cankarjev dom kisha këmbyer disa telefonata me miqtë nga Lubjana, posaçërisht me shkrimtarin Jasha Zlobec dhe sociologun Sllavko Gaber; i pari më vonë është bërë ambasador i Sllovenisë në Bruksel, kurse i dyti ministër i arsimit që realizoi reforma të thella në sistemin shkollor slloven. Me ta pata këmbyer informata rreth grevës së Trepçës dhe paso-

jave të mundshme. Më kujtohet se kemi biseduar edhe për mënyrën e reagimit dhe të solidarizimit. Ideja ishte se duhet të organizohet diçka. Unë tash nuk jam i sigurt nëse vetë kam dhënë sugjerime konkrete për reagimin dhe koordinimin e aktiviteteve. E di vetëm se nuk kisha mundësi që të udhëtoja për Slloveni dhe se nuk e kam zakon që t'i këshilloj të tjerët për gjërat që u takon përgjegjësishë dhe ndërgjegjes së tyre. Sllavko Gaberi më ka treguar më vonë se tubimi i Cankarjev domit ka qenë ide e rrethit të tij, se ata kanë bërë presion dhe e kanë bindur Kuçanin, sepse në udhëheqësinë e atëhershme sllovenë ka pasur dilema dhe hezitime për idenë e solidarizimit me Kosovën, frikë se mos po kalohet Rubikoni dhe provokohet ndonjë reagim i ushtrisë jugosllave, që do të ishte zhvillim i dëmshëm për vetë Slloveninë. Por tash, në retrospektivë, mund të them se Gaberi me rrethin e tij sigurisht se kanë ndikuar në Kuçanin, në aspektin e aktivizimit dhe solidaritetit, që sllovenët duhet të bëjnë diçka për Kosovën dhe minatorët. Por, jam i bindur se gjeniu i Kuçanit ka qenë vendimtar për dhënien e një dimensionit aq të madh, që ai të thotë në tubimin fjalinë e famshme: “Në Trepçë po mbrohet Jugosllavia e AVNOJ-it”. Kuçani e kishte kuptuar momentin, se në të vërtetë Millosheviçi po e kalonte kufirin. Me intervenimin e dhunshëm në Kosovë, ai po i shkatërronte themelet e federatës dhe të sistemit. Në Cankarjev dom Kuçani e dha alarmin e fundit se Sllovenia nuk mund të pajtohet asesi me imponimin e dhunshëm të hegjemonisë serbe. E vërteta është se sllovenët në atë moment kritikë e patën kuptuar se ngjarja e Trepçës dhe zhvillimet në Kosovë paraqesin rrezik jetik për Slloveninë, kurse brenga për Kosovën, e edhe për Jugosllavinë, ishte diçka dytësore. Por, tubimi në Cankarjev Dom megjithatë ishte diçka madhështore, sepse sllovenët me këtë reagim

treguan se janë të paktën parimor në mbrojtjen e interesave të tyre dhe të konceptit të vetëm të federatës, ose më saktë të konfederatës, e cila ishte e pranueshme për ta, dhe jo të mbajnë qëndrime dyfytërëshe si liderët e republikave tjera.

Kontributi im në këtë gjë, s'di nëse ka qenë ndonjë gjë e madhe, ka qenë, ndoshta, vetëm ajo e ndihmesës së tërthortë për aspiratat sllovene. Me shkrimet analitike që i botoja rregullisht në gazetën sllovene, kryesisht në javoren "Telex" dhe pastaj në "Subotna priloga", shtojcë e shtunës e gazetës qendrore "Delo", i kam thënë shumë hapur gjërat që në fillim nuk i kanë thënë në atë mënyrë as gazetarët dhe analistët sllovenë. Ky diskurs im kritik ka pasur jehonë. Në një pritje që e pat organizuar Millan Kuçani si kryetar i Sllovenisë për pjesëmarrësit e Konferencës ndërkombëtare të Pen Klubit slloven në Bled, ku kam qenë me Ali Podrimjen dhe Ibrahim Rugovën, në maj të vitit 1990, Kuçani, kur u njoftuam, më pat thënë: "Ti qenke ai Maliqi për të cilin Millosheviçi ankohet në çdo takim me te. Ai më qorton pse po lejoj që në gazetën sllovene të botohen në vazhdimësi gënjeshtret e Maliqit për Serbinë dhe Kosovën! Më thotë 'Duhet ta ndaloni këtë maskara!'" Unë e pata pyetur Kuçanin se çfarë i përgjigjej ai Sllobos. Ai tha se në fillim i thoshte se nuk kishte dëgjuar për mua dhe nuk i kishte lexuar shkrimet. Më vonë, i bezdisur nga insistimet dhe telefonatat e Millosheviçit, ishte përgjigjur se në Slloveni partia dhe shtetit nuk e kanë zakon që të ndërhyjnë në punën e gazetave. "Nëse ju në Beograd keni argumente dhe dëshmi se ato që Maliqi shkruan janë gënjeshtër, pse nuk reagoni me shkrim. Shtypi slloven është i lirë dhe reagimet e juaja patjetër do të botohen!"

BH: Dhe a ka pasur reagime nga Beogradi?

ShM: Në shtypin slloven jo. Ka pasur reagime që u referoheshin shkrimeve të mia të botuara në Slloveni. Kryesisht në shtypin e verdhë dhe mediat nacionaliste serbe, psh. në “Večernje Novosti”, “Ekspres Politika” ose “Jedinstvo” e Prishtinës. E kam një numër të “Jedinstvos” ku në ballinë me shkronja të mëdha lexohet titulli “Maliqi më i rrezikshëm se Rugova”, e që i referohej shkrimeve të mia që botoheshin në sllovenisht. Nuk po e them këtë për t’u lavdëruar apo krahasuar me Rugovën, por si një kuriozitet.

Shkatërrimi i Jugosllavisë ndodhi në Kosovë

BH: Po frika sllovene nga Serbia ku bazohej? Analizat e mëvonshme kanë treguar se Millosheviçi në të vërtetë kishte bërë marrëveshje me liderët sllovenë për daljen e Sllovenisë nga federata.

ShM: Po, ka pasur spekulime për këtë. Mirëpo, lejimi ose edhe, siç e kanë quajtur disa, përjashtimi i Sllovenisë nga federata, ka qenë rezultat i vonshëm i proceseve dhe tentimeve agresive të Beogradit për të rivendosur hegjemoninë mbi Jugosllavinë. Në vitin 1990 dhe 1991 Beogradi ka tentuar që të sigurojë shumicën në Kryesinë e federatës të përbërë nga tetë anëtarë përfaqësues të gjashtë republikave dhe dy krahinave. Millosheviçi siguroi katër vota në Kryesinë e federatës, i mungonte vota e pestë për të bërë diçka si puç legal dhe për të shpallur gjendjen e jashtëzakonshme në Kroaci, ku në pushtet më 1990 kishte ardhur Tugjmani, e sipas nevojës edhe në republikat tjera nëse edhe ato do të kundërshtonin aspiratën e Beogradit dhe të armatës jugosllave

që po shndërrohej në armatë pro-serbe ose puro serbe. Millosheviçi ishte shumë afër realizmit të këtij skenari, kur arriti që përfaqësuesin e Kosovës, Riza Sapunxhiun, ta zëvendësojë me një njeri kukull dhe karikaturë që quhej Sejdo Bajramoviç. Por, në momentin vendimtar kur mendohej se e ka edhe votën e pestë, ndodhi një e papritur. Përfaqësuesi i Bosnje Hercegovinës në Kryesinë e federatës, Bogiq Bogiqeviçi, përndryshe me kombësi serbe, nuk u fut në këtë skenar, nuk i dha përkrahje ridefinimit të federatës dhe marrjes së pushtetit nga armata. Kur dështoi ky skenar i “puçit legal” Millosheviçi iu kthye provokimit të luftërave, dhe fillimisht përjashtoi Slloveninë, e cila në ndërkohë edhe e kishte ndërtuar komplet legjislaturën e ndarjes nga federata. Dhe kjo ka qenë e mundur falë çështjes së Kosovës. Kosova e ka ndihmuar pavarësimin e Sllovenisë si dhe të Kroacisë.

BH: Në çfarë kuptimi? Kosova ka qenë tmerrësisht e shtypur dhe e okupuar, me një regjim të zbehtë të Rugovës, i cili kishte krijuar iluzionin e republikës me kufij të hapur andej e këndej, që do të vegjetoj për disa vjet në hapësirën prej 50 metra katror, sa i kishte selia e Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës...?

ShM: Po, kjo duket paradoksale, por është e vërtetë se rasti i Kosovës qëndron në boshtin e shkatërrimit të federatës jugosllave, dhe këtu sërish do ta kujtoja fjalinë e Kuçanit se në Trepçë mbrohet Jugosllavia e AVNOJ-it, e konceptuar si federatë e gjashtë republikave dhe dy krahinave të barabarta. Kjo fjali e Kuçanit ka pas një mbështetje të fortë në Kushtetutën e vitit 1974, ku Kosova ka qenë e definuar si pjesë konstitutive e federatës. Nuk ka qenë thjesht njëra prej shtyllave anësore, ku nëse ajo do të hiqej, godina e sistemit do të mund të mbahej me ato 7 shtylla të tjera. Jo, Kosova ka pasur pozitë konstitutive dhe konstruk-

tive në kuptimin që nëse ajo pozitë do t'i merrej, pa lejen e Kosovës, i gjithë sistemi, i gjithë ndërtimi kompleks, do të shembej.

Shpesh, edhe analistët më të zotit dhe më të njohur, në librat që janë shkruar për fundin e Jugosllavisë, fillimin e shkatërrimin të federatës jugosllave e shohin në disa ngjarje tjera të rëndësishme historike, p.sh. shpalljen e pavarësisë së Sllovenisë, pastaj edhe të Kroacisë, etj. Por, në të vërtetë, federata jugosllave është bllokuar dhe mbetur pa kushtetutë valide dhe të aplikueshme me aktin e marrjes së autonomisë së Kosovës, më 26 mars të vitit 1989, dhe pastaj aprovimit të kushtetutës së Serbisë në vitin 1990, kur është abroguar dhe shkruar Kosova në një provincë të pa identitet e Serbisë. Prej momentit që Kosova ka humbur subjektivitetin dhe fuqinë e vetos në federatë, Kuvendi i Jugosllavisë, si organ më i lartë legjislativ, është bërë jofunksional, ka vegjetuar dhe nuk ka mundur të aprovojë asnjë ligj apo akt këndellës për federatën, e as çfarëdo mase tjetër që do të pengonte shkatërrimin e sistemit. Kuvendet e Sllovenisë dhe të Kroacisë, menjëherë pas bllokimi të Kuvendit federativ, kanë filluar me të shpejtë përgatitjen dhe aprovimin e ligjeve që çonin drejtë pavarësisë së këtyre republikave, ndërkaq që instancat federale jugosllave nuk kishin më fuqinë dhe instrumentet legale për të kundërshtuar dhe ndalur këto sfida të pavarësisimit, sepse me mungesën e delegacionit të Kuvendit të Kosovës në Dhomën e Republikave dhe Krahinave, që kishte rolin të ngjashëm me një Senat, Kuvendi federativ faktikisht ishte vënë jashtë funksionit normal. Delegacionet e Sllovenisë dhe të Kroacisë, kur shtrohej çështja e aplikimit të ligjeve federative që do të abrogonin aktet e kuvendeve të këtyre republikave, kërkonin që paraprakisht të riparohet vetë Kuvendi federativ ku mungonte përfaqësimi legjitim i Kosovës. Serbia nuk e lejonte këtë, por nuk kishte fuqi

as që të impononte vendime të gjymta, sepse secila prej republikave, për çdo vendim, kishte të drejtën e vetos. Sllovenia dhe Kroacia, madje edhe vetë Serbia, e cila aprovoi e para një kushtetutë të vetën krejtësisht separatiste, kanë shfrytëzuar deri në maksimum këtë vakum, mungesën e instancës boshte të legjislaturës federale, e cila ndodhi pasi që u hoq autonomia e Kosovës si njësi konstituive.

Gjashtëdhjetat

Familja ime

BH: Pasi që shqyrtuam disa tema të viteve dramatike dhe specifike të mënyrës së shkatërrimit të Jugosllavisë, në seancat e radhës do të doja që të prekim disa tema tjera, për të nxjerrë para opinionit një ide më të gjerë se kush është Shkëlzen Maliqi. Më intereson se si ishte Shkëlzen Maliqi para se te niset për studime. Si jetonte, çfare familje kishte. Si dukej shtëpia, të jetuarit e kohës dhe marrëdhëniet me prindërit. Mentaliteti dhe struktura patriarkale e familjes shqiptare sa reflektohej në familjen Maliqi që normalisht jetonte me fuqinë dhe autoritetin e babait luftëtar, veteran, partizan i LDB.

SHM: Shumë pyetje përnjëherë...

BH: Po, nisja si hyrje në biografi...

SHM: Unë kam pasur një histori të veçantë të zhvillimit. Në përgjithësi kam pasur fëmijëri të lumtur, pa të keqe, pa trazira. Por, megjithatë, kam qenë një djalosh shumë i ndieshëm dhe me goditje të fatit në dukje relativisht të vogla, por që kanë ndikuar në zhvillimin tim në një drejtim që më ka bërë një tip gati tuaf, të tërhequr dhe të tëhuajtuar,

që nuk adaptohesha lehtë në jetën sociale. Si karakter jam introvert, nuk tregoj brendinë time, nuk flas shumë, nuk rrëfhem...

BH: Kjo që po bën në këtë moment a është përjashtim nga karakteri yt?

SHM:... Ha,ha... Jo, është në kuadër të përgjegjësive që i kam pasi që jam futur në jetën publike. Po flas për ngjarjet e një periudhe historike, ku edhe unë kam qenë pjesëmarrës, por edhe për vetën time dhe përjetimet e brendshme. E kuptoj rëndësinë e pyetjes sepse edhe vetë, kur dua të njoh një personalitet, ose një epokë, kam dëshirë ti njoh rrethanat sociale, të familjes, detajet për jetën e përditshme, për mënyrën e sjelljeve të njerëzve, etikecinë dhe zakonet, sistemin e vlerave.... Familja ime, pra, ka qenë e shquar në ato kohëra. Ishte një familje që kishte kapur trendin e historisë, ishte rreshtuar me fituesit dhe këta fitues kishin vizion dhe premtorin ndryshime dhe progres, një shoqëri të re të drejtësisë, të barazisë të të gjithëve...

Gjyshi im Haziri, çauş i sultan Abdylhamitit

Babai im është lindur në Prizren, në pranverë të vitit 1919. Me prejardhje Maliqët janë nga Luma, nga katundi Shtiçen afër Kukësit. Katërgjyshët ishin shpërngulur nga Shtiçeni në Prizren, diku rreth kapërcyellit të shekujve 18 dhe 19. Gjyshi im, Haziri, ka qenë çauş i sulltanit të fundit të Perandorisë Otomane, Abdulhamitit. Kur gjonturqit e përmbysën sulltanin, gjyshi im arratisët nga Stambolli, lë atje krejt pasurinë dhe shtëpinë që kishte në lagjën Ortakoy dhe kthehet në Prizren. Dhe më pas nuk ka arritur të kthehet në Stamboll. Nuk e lejuan zhvillimet historike... Kosova, si edhe trevat shqiptare dhe i gjithë

rajoni në atë kohë përjetonte ndryshime dramatike, marramendëse. Kryengritja shqiptare më 1912, çlirimi i Kosovës dhe Shkupit, pastaj dy luftërat ballkanike, kur Kosova u pat pushtuar nga Serbia, shpallja e pavarësisë së Shqipërisë së gjymtë në Vlore, konferenca e Londrës, Lufta botërore, Trakti i Versajes, tentimet e Serbisë që edhe pas Luftës së Parë Botërore të pushtoj veriun e Shqipërisë dhe Durrësin për të dalur në det, rezistenca e kaçakëve, - të gjitha këto kanë ndodhur në një dhjetëvjetësh, 1912-1922 . Mirëpo, gjyshi im Haziri edhe nëse e ka pasur idenë që një ditë të kthehet në Stamboll dhe të kujdeset për pasurinë, nuk e lejuan dot zhvillimet historike, sepse historia herë është tinzake, herë e zhurmshme, por kurrë nuk ndalet...

BH: çka ndodhi me gjyshin tënd?

Gjyshi ka vdekur më 1924, duke i lënë katër fëmijë, hallën e madhe Melihate, që ne e quanim Tatli Halla, e lindur në Stamboll me gruan e parë të tij. Në Prizren ai ishte martuar për së dyti me gjyshen time Tehviden. Me te Haziri ka pasur dy djem, Sinanin dhe Mehmetin, dhe një vajzë sugare, Shyqërijen. Babai im ka qenë 5 vjeç kur ka vdekur gjyshi; pra, është rritur si jetim. Kanë qenë kohërat e vështira mes dy luftërave botërore. Gjyshi ua kishte lënë shtëpinë, një godinë të vjetër dhe modeste, jo tipike prizrenase por disi më shumë e stilit fshataresk, që me gjasa ishte ndërtuar në pjesën e parë të shekullit 19. Shtëpia gjendej në lagjen Islana, afër gjimnazit të Prizrenit. Unë e doja shumë këtë shtëpi, ku banonte axha im Sinani, dhe gjyshja Tehvida, sepse ka pasur një bahçe të madhe me shumë pemë, një dru mane tepër e madhe që ia siguronte hijen shtëpisë, pastaj kishte kumbulla, pjeshka, molla, dardha. Kishte edhe mushmolla dhe hurma. Gjyshi ua kishte lënë edhe një arë në fushën e Prizrenit, pran rrugës për Nashec, nja 5

kilometra larg Drinit, në pjesën më të pëlleshme të rrafshit që pas lufte ishte nacionalizuar dhe bërë pronë e ndërmarrjes bujqësore “Progres”. Por, me gjasa, kjo arë nuk ka qenë edhe aq e madhe dhe e mjaftueshme për të pasur jetë normale...

Mehmeti jetim, furaxhi në Shkup dhe komunist

Babai na tregonte se fëmijëria e tij ka qenë mjaftë e vështirë. Ai ka filluar të punojë si djalë shumë i ri, në moshën nëntë ose dhjetë vjeçare, së pari si kallfë te një këpucëtar që bënte kryesisht papuçe, pastaj kishte zënë punë edhe te disa zejtarë tjerë, nuk më kujtohen cilët, për t’u përcaktuar më në fund që të punojë si bukëpjekës. Për furrat tregonte se ka bërë edhe punë të rënda, duke mbajtur mbi supë thasët me miell me peshë të madhe, për çka në tallje thoshte se ka ndikuar që të mbetet për nga shtati pak si më i shkurtë... Por, ama, prej se ishte bërë furrtar nuk vuante më nga uria. Pos që gatuanin dhe mund të hanin bukë, pite, gjevrekë dhe simite të famshme të Prizrenit, ai me kolegët mbanin gjysmë-legalisht edhe tepsinë dhe tavën e tyre në të cilat ata thuajse për çdo ditë gatuanin gjella të ndryshme për vete, duke blerë vetëm domatet, specat dhe qepët, kurse mishrat i siguronin nga ushqimet që i dërgonin për t’i pjekur në furrë pasanikët. Merrnin nga një copë mish dhe nga një lugë yndyrë prej dhjetëra tepsive dhe tavave që i sillnin pasanikët, dhe kështu siguronin për çdo ditë gosti të mrekullueshme.

Diku nga mesi i viteve ’30, babai im shpërngulet në Shkup, ku sërish punësohet si furrtar. Kishte mësuar më parë shkrim leximin, pak në medrese dhe pak në shkollën trevjeçare sa ishte në atë kohë arsimimi i obligueshëm në Mbretërinë e Jugosllavisë. Ka lexuar gazetata e kohës, p.sh. “Politikën” e Beogradit, ku më së shumti e impresiononte lufta e

Abisinisë, ku edhe kishte krijuar një lloj respekti dhe kulti ndaj Haile Selasies, perandorit të Etiopisë, që udhëhiqte luftën kundër pushtuesve italian. Më sa më kujtohet prej tregimeve të tija, atëherë kishte krijuar bindjet antifashiste dhe është afruar me disa nxënës shqiptar të Medresesë së Shkupit, që simpatizonin lëvizjen komuniste, p.sh. Ramadan Vraniqin. Në vitin 1939, pas pushtimit të Shqipërisë nga Musolini, ky qëndrim antifashist i tij sforcohet. Por atë vit Mehmeti shkon në shërbim ushtarak, në Zajçar të Serbisë. Në prill të vitit 1941 Jugosllavia sulmohet nga Gjermania dhe Italia, dhe ushtria jugosllave kapitullon për dy javë. Mehmeti nuk e pret kapitullimin, por dezerton ditët e para të luftës dhe niset këmbë për Prizren. Natën lëviz kurse ditën fshihet. Në ushtri kishte qenë një lloj intendenti dhe kontabilisti. Me 6 prill, kur Gjermania e Hitlerit sulmoi Jugosllavinë, ai i mbante në zyrën e intendanturës kasafortën me pagat e oficerëve, që sapo kishin arritur. Në rrëmujën që kishte ndodhur, Mehmeti do të shpërndajë vetëm një pjesë të rrogave të oficerëve, kurse shumica e dinarëve i mbetën në dorë. Edhe pse dinari i Mbretërisë Jugosllave shumë shpejt do ta humb vlerën, këto të holla i shërbyen mirë që t'i ndërrojë shpesh rrobat, të sigurojë konak dhe ushqim gjatë udhëtimit në këmbë që zgjati dy muaj. Kthehet në Prizren dhe vendos lidhjet me grupet komuniste. Nuk kalon shumë kohë dhe e burgosin italianët dhe e dërgojnë në burgun e Tiranës. Në burg qëndron deri nga fundi i shtatorit të vitit 1943. Pas kapitullimit të Italisë, Shqipërinë e pushton Gjermania, dhe bëhet një lloj i revizionit të të burgosurve, ku Mehmeti me disa shokë me dinakëri shfrytëzojnë amnistinë që Gjermanët shpallën për maqedonasit, përkatësisht ata i konsideronin për bullgarë, në burgun e Tiranës. Me që e dinte maqedonishten, Mehmeti paraqitet me emër bullgar dhe

me disa komunistë të tjerë futet në radhët e të liruarve që po transportoheshin në Maqedoni, me gjasa për tu rekrutuar në ushtrinë bullgare. Por, deri sa kolona po kalonte rrugëve të Tiranës, komunistët kishin organizuar largimin dhe strehimin e të ikurve te jatakët e lëvizjes së rezistencës. Mehmeti kthehet në Prizren, por shokët e këshillojnë që të iki në mal. I bashkohet aradhave partizane kosovare që operonin kryesisht në Malësinë e Gjakovës. Ka marr pjesë në Konferencën e Bujanit, por jo si delegat. Ka qenë gatues i bukës dhe kuzhinier. Gjatë atij dimri, ai do të sheh për herë të parë nënën time Remzije Stavilecin. Ajo ka qenë atëherë vajzë e re, 16 vjeçare, e ikur me prindërit, Sali dhe Zyra Stavilecin, nga Gjakova, sepse kishin rënë në sy si shtëpi që bashkëpunonte me komunistët dhe rezistencën. Edhe nëna ime ka qenë aktive në lëvizjen e rezistence, shoqe e ngushtë me dëshmoren Ganimete Tërbeshi.

Babai im ka pasur respekt të madh për familjen Stavileci sepse e kishte idol djaln e madh të Salihut, Sadik Stavilecin, i lindur më 1915. Daja im Sadiku është vrarë me Vojo Kushin dhe Xhorxhi Martinin me 7 tetor të vitit 1942 në një lagje afër qendrës së Tiranës. Mehmeti kishte dëgjuar në burgun e Tiranës historinë e martirizimit të këtyre tre herojve, dhe është fascinuar kur i ka parë prindërit dhe motrën e bukur të Sadikut, se si po kapërcenin në acar, hipur në kuaj, njërin prej lumenjve të rreptë të Malësisë së Gjakovës...

Historia e emrit tim: Linda si Bajram, e kthyen në Shkëlzen

Aty, në rranëzat e bjeshkës së Shkëlzenit, babait tim i kanë lindur dy ide që unë gjithnjë i kam përjetuar si një ngjizje romantike partizane e Shkëlzen Maliqit. Ideja e parë ka qenë që t'i kërkonte dorën, nëse do të kishin fat që të mbijetonin luftën, motrës së Sadikut, Remzijas. Dhe ideja e dytë ka qenë që djalit të parë që do t'i lind, t'ia vë emrin Shkëlzen.

Mahmeti, këtë histori të emrit tim e tregonte shpesh dhe me humor, sepse kur kisha lind, më 26 tetor të vitit 1947, kishte qëlluar të jetë festa e bajramit, dhe ai kishte qenë larg shtëpisë, duke ndjekur njësitë e shpërndara të ballistëve në Malin e Berishës. Unë kisha lindur në Rrahovec, dhe axha im Sinani, si më i vjetri në familje, me pajtimin e akra-ballëkut, kishin vendosur të më pagëzonin me emrin Bajram, sepse është emër i fatit, dhe ishte zakon që ai që lind në ditën e Bajramit, ta “meritoj” këtë emër. Por Mehmeti, kur u kthye pas disa javësh, ishte zemëruar fortë me këtë emër fetar, sepse duke u bërë komunist, ai ishte bërë njëkohësisht edhe ateist. “S'bën assesi Bajram. Emrin e ka Shkëlzen!” Për shumicën e kushërinjve të mi nga Prizreni ky ishte si një sakrilegj. Ata as që e dinin mirë gjuhën shqipe, dhe emrin tim nuk mund ta shqiptonin. Ankoheshin në turqisht “Av, av, ne dır mori bu qyli adi!” (“Ububu, që është ky emër prej katundari!”). Emrin tim gjithnjë do ta shqiptonin duke e thyer gjuhën, ose duke e kthyer në një emër tjetër që e njihnin, Skender, përkatësisht “Iskender”, siç e shqiptonin ata. Por, arsyeya e vërtet, aspak romantike, pse Mehmeti e kishte zgjedhur emrin tim, ka qenë e lidhur me një ngjarje gjatë luftës. Deri

sa një natë po bënte roje për njësitin e vetë partizan diku në Bjeshkët e Nemuna, i kishte qëlluar që parulla e lejekalimit të jetë “Shkëlzeni”. Si një djalosh nga Prizreni, gjuha e parë e komunikimit e të cilit ka qenë turqishtja, edhe ai e ka shqiptuar me mjaft vështirësi këtë emër. Atë natë e kishte ushtuar me qindra herë që këtë parullë ta thotë në mënyrë sa më të saktë. Më në fund, kur ia kishte arritur qëllimit, ta thotë saktë dhe rrjedhshëm, është betuar se ku do të jetë emri i djalit të tij të parë.

Daja Sadik Stavileci dhe Enver Hoxha: një histori apokrife

BH: Po më pëlqyeka kjo histori e emrit tënd....Por, më intereson edhe historia e Sadik Stavilecit. Sa ishte prezente në jetën tënde figura e dajës si hero dhe martir i kombit? Edhe ai ishte komunist...

ShM: Historia dhe shembulli i dajës Sadik vërtet ka qenë e rëndësishme për mua. Në shtëpinë tonë, si dhe te daja tjetër, Tasim Stavileci, Sadiku zinte vendin e kult heroit, ikonës familjare. Mua më pëlqente sidomos njëra fotografi, e formatit jo shumë të madh, e dajës Sadik si student. Portreti në gjysmëprofil, i buzëqeshur, me mantil të bardh, në një kopsht me lule, dhe në prapavi ndërtesa e spitalit në Bari, në Itali. Sadiku ka qenë i sëmurë nga tuberkulozi, dhe ishte fotografuar në ambientet e sanatoriumit ku po kurohej... Sadiku na dukej shumë i pashëm dhe me një karizmë që nuk e kuptonim mirë. Valboni, djali i madh i dajës Tasim, tani i ndjerë, me të cilin kam qenë moshatar dhe shumë i afërt, më tregonte shpesh një histori apokrife të vdekjes së dajës Sadik me Vojo Kushin dhe Xhorxhi Martinin në vitin 1942,

në Tiranë. Sipas kësaj legjende, të cilës Valboni i besonte shumë, nuk ka qenë Vojo Kushi trimi që ka kërcyer mbi tanksin e armikut, por ka qenë pikërisht Sadiku, por ja që të vërtetën e kishin shtrembëruar qëllimshëm Enver Hoxha dhe Partia e Punës për arsye se daja im, si njëri prej udhëheqësve të grupit të komunistëve të rinj, në kohën kur po bëheshin përpjekjet e bashkimit të grupeve të ndryshme dhe formimin e Partisë Komuniste të Shqipërisë, paskish qenë kundër zgjedhjes së Enver Hoxhës në krye të partisë. Arsyeja tjetër për retushimin e ngjarjes, gjithnjë sipas versionit që e kam dëgjuar edhe nga daja Tasim dhe gjyshja Zyhra, ka qenë prejardhja kosovare e Sadikut. “Në Shqipëri ka paragjykime ndaj kosovarëve. Ata nuk na duan... Bile edhe komunistët, edhe pse shiten si internacionalista, janë me paragjykime ndaj kosovarëve, i konsiderojnë malok e të pagëdhendur.” Kështu disi e shpjegonin faktin pse edhe shpallja e Sadikut hero i popullit është bërë me shumë vonesë.

Unë vetë nuk i kam besuar verbërisht këtij versioni apokrif që Sadikun e tregonte si kryeheroïn e njëres prej ngjarjeve më të rëndësishme nga historia e rezistencës antifashiste në Tiranë. Vdekja e tij së bashku me dy shokët gjithsesi ka qenë heroike, s’ka rëndësi se cili ka kërcyer mbi tank! Vetëm se djali i dajës Valboni, gjithnjë e kishte ëndërr që të sqarojë këtë padrejtësi dhe mashtrim. Në vitin 1971, kur familjarisht, për herë të parë pas 29 vjetësh patëm marrë lejen nga Tirana që të vizitonim dhe nderonim varrin e Sadikut, edhe një herë u pat ringjallë versioni familjar i neglizhimit të dajës Sadik për shkak të kujtesës hakmarrëse të Enver Hoxhës. Gjatë qëndrimit në Tiranë shpresonim se do të takonim ndonjë shok të dajës, që do të na tregonte se çfarë kishte ndodhur në të

vërtetë. Por, nuk takuam askënd dhe dëgjuam sërish vetëm versionin zyrtar. As që na u dha rasti të hulumtonim të vërtetën...

BH: A keni kërkuar më vonë, kur vdiq Enveri dhe u hap Shqipëria, se cila është e vërteta e Sadik Stavilecit?

ShM: Tani së voni kam zbuluar në internet një rrëfim të dëshmitarit që besoj se e tregon saktë se si kanë vdekur daja Sadik me Vojon Kushin dhe Xhorxhi Martinin. Kjo dëshmi është marrë nga kujtimet e Muharrem Llanajt, i cili pohon se ka qenë i katërti në grupin në përlëshjen që ka ndodhur në një rrugicë të Kodrës së Kuqe në Tiranë, në shtëpinë e Ije Farkës. Llanaj, sipas kujtimeve që citohen në një sajt të internetit, pohon se tre heronjtë kishin vdekur ashtu si thuhet në versionin zyrtar, vetëm se askund nuk përmendet edhe emri i tij, që ka pasur fat dhe çuditërisht i ka shpëtuar ekzekutimit.

Por, sidoqoftë, mbetet fakti që daja Sadik ka qenë kundër Enver Hoxhës. Dhe kjo është sigurisht arsyeja pse historiografia komuniste dhe propaganda enveriste e ka zgjedhur për kryehero Vojo Kushin, duke neglizhuar dy dëshmorët tjerë. Në familjen tonë thjesht mbahej mend kjo që Sadiku është deklaruar kundër Enver Hoxhës. Dhe unë që nga fëmijëria e kisha këtë si një argument më shumë për të qenë antienverist. Isha i bindur se daja Sadik e ka nuhatur mirë karakterin e Enver Hoxhës. E vlerësoja se ka qenë tepër inteligjent dhe largpamës. Enveri vërtet është treguar si tiran, udhëheqës me karakter të keq dhe i rrezikshëm, ka vrarë, burgosur dhe internuar mijëra njerëz, e ka izoluar dhe shkretuar Shqipërinë, një vend aq të bukur dhe të pasur e ka kthyer në mjerim dhe kolaps total.

Ndikimi i komunizmit

BH: Si ka qenë, pra, për Shkëlzen Maliqin, rrethana se je rritur dhe formuar nën hijen e dy komunistëve, të dajës hero dhe dëshmor dhe të babait udhëheqës i lartë në regjimin komunist në Kosovë? Në atë kohë ideologjia komuniste sundonte absolutisht? Sa ishte fuqia e ndikimit të babait dhe të rrethit mbi personalitetin e Shkëlzenit? Si e shije në moshën e re komunizmin?

ShM: Ndikimi i ideologjisë komuniste ka qenë i madh. Brezi im, ne që kemi filluar të shkollohemi nga fundi i viteve të dyzeta dhe të pesëdhjetat e shekullit të kaluar, ka qenë fuqimisht i indoktrinuar me idenë se komunizmi është një lëvizje revolucionare e përmasave botërore, që do ta përmbysë pashmangshëm kapitalizmin, eksploatimin e njeriut, mjerimin dhe luftërat, duke sjell barazi dhe lumturi për të gjithë. Kuptohet, ky ishte një vizion i të ardhmes. Komunizmi ishte ideal i së ardhmes, pasi që të realizohen të gjitha aspektet e revolucionit. Kurse, neve na thoshin se jemi duke jetuar në një realitet të ndërmjetëm ku gërshetoheshin mjerimi i së kaluarës dhe përpjekja revolucionare. Na thoshin se jemi në një kohë transitore, që quhej socializëm, si fazë e parë e revolucionit në rrugën e gjatë të realizimit të shoqërisë ideale. Sot e di se komunizmi ka qenë religjion, një “opium për masa” sa edhe religjionet tjera. Për dajën nuk mund të them më shumë seç thash më lartë, por supozoj se ka qenë besimtar i përkushtuar i revolucionit. Kurse, për babain mund të dëshmoj se ka qenë bash ashtu, një besimtar. Mirëpo, jo besimtar i verbër dhe fanatik, sepse kishte sens edhe për realitetin, për raportet reale në shoqërinë kosovare dhe ato në federatën jugosllave. Dhe kjo ishte tamam në atë masë sa

ishte realist dhe pragmatist edhe mareshali Josip Broz Titoja, prijësi i pakontestueshëm i federatës jugosllave. Doktrina e Titos ka qenë më e moderuar, më realiste në vlerësimin e fazave nëpër të cilat do të duhej të zhvillohej revolucioni dhe kalimi nga socializmi në komunizëm. Titoja shumë shpejt pat hequr dorë nga ideja e revolucionit permanent dhe të ngutshëm, nga lufta e klasave që diktonte ndjekjen dhe dhunën e pandërprerë ndaj armiqëve të revolucionit të të gjitha ngjyrave... Viti 1948, kur Jugosllavia u nda nga blloku lindor dhe stalinizmi, ka qenë vendimtar për zhvillimet në Jugosllavi dhe për brezin tim, sepse ne u rritem në frymën e titizmit, që vërtet ishte një revizion i doktrinës ortodokse komuniste, në drejtimin e një pragmatizmi. Duke u larguar nga stalinizmi, Jugosllavia inauguroi disa eksperimente shoqërore si vetëqeverisjen në ekonomi, politikën e mosinkuadrimit të vendeve të botës së tretë që kundërshtonte ndarjen bipolare të botës, ruajtjen e pjesëshme të pronës private, elementet e ekonomisë së tregut, kufijtë e hapur për lëvizjen e njerëzve etj. etj. Të gjitha këto socializmit jugosllav i dhanë ngjyrimet më pozitive, në krahasim me regjimet që ishin dominion i Bashkimit Sovjetik.

BH: Si kuptohej dallimi mes socializmit atje në Lindje, dhe sidomos në Shqipëri, dhe në Jugosllavi, përkatësisht Kosovë? Çfarë dije ti për Shqipërinë, pos që ishte një shtet i izoluar? Në Kosovë shumica e idealizonin Shqipërinë si shtet amë, dhe e adhuronin Enverin, kurse ti pohon se ke qenë që nga mosha e re anti-enverist? Si e kuptove këtë?

ShM: Në Jugosllavi në vitet '50 dhe '60 janë botuar shumë libra me përmbajtje antistaliniste, dhe ato kanë pas ndikim vendimtar në zhvillimin tim personal. Në bibliotekën e babait tim unë i kam gjetur, deri

sa isha gjimnazist, në moshën 16 ose 17 vjeçare, disa nga këto libra antistaliniste dhe i pata lexuar me një pasion këndjellës. Njëri prej këtyre librave, i një autori që më duket se quhej Ciolkovski, me titull “Komploti i madh”, ishte mjaft voluminoz, 600 apo 700 faqe i kishte, tregonte në detaje historinë e “devijimeve” të mëdha që kishin ndodhur në Bashkimin Sovjetik gjatë sundimit të Stalinit. Mësova për pasojat katastrofale të luftës kudër kullakëve dhe kolektivizimit me miliona viktime, për spastrimet e njëpasnjëshme masive të kuadrove dhe armiqve të ndryshëm, për proceset e shumta të montuara, për metodat më të vrazhda të ngulfatjes së lirisë së shprehjes të intelektualëve dhe artistëve, për zhdanovizmin, për burgjet famëkeqe dhe depërtimet e qindra mijëra njerëzve në Sibiri, surgjynosjet në Gullag... Njëra prej temave qendrore të literaturës antistaliniste ka qenë kritika e kultit të personalitetit, e fokusuar në Stalinin si despot dhe gjakpirës, që kishte likuiduar edhe bashkëpunëtorët më të ngushtë... Dhe krejt këto që mësova nga ky libër dhe disa të tjerë, e shpjegonin qartë edhe gjendjen në Shqipëri, regjimin e Enverit, proceset e montuara, likuidimet dhe internimet masive të njerëzve...

BH: Në shkollë a mësonit se Enveri është i keq, dhe Titoja i mirë?

ShM: Jo, çuditërisht, Enveri ka qenë tabu. Në gazetatat kosovare, deri vonë edhe në vitet '80, ka qenë tabu dhe e dënueshme publikimi i fotografive të Enverit dhe të udhëheqësve tjerë të Shqipërisë, madje as si përcjellje të teksteve ku ata sulmoheshin dhe paraqiteshin në dritën negative, si stalinistë. Revista “Fjala” ka pas problem në fillim të viteve '80 për shkak se kishte botuar fotografinë e Enverit...

BH: Po Titoja, megjithatë, ishte i mirë dhe i thurnin lavd dhe vargje, i këndonin këngë. A e ke kënduar edhe ti atë këngën “Shoku Tito ne të betohemi...”?

ShM: Po, e di atë këngë dhe shumë këngë tjera, i kemi dëgjuar në shumë raste në radio dhe manifestimet. Por, nuk më kujtohet se i kam kënduar edhe vetë, sepse unë nuk këndo, nuk di të këndo, nuk e kam zërin. Nga ana tjetër, unë nuk kam qenë jo vetëm anti-stalinist dhe anti-enverist por edhe anti-titist. Shiko, në ato libra që lexoja për stalinizmin, kritika fokusohej në problemin e kultit të personalitetit. Shumica e autorëve të këtyre librave kanë qenë komunistë, dhe ata në njëfarë dore fajin për devijime dhe revizionin e marksizmit dhe të pushtetit ia mveshnin Stalinit, karakterit të tij, kultit të personalitetit. Dhe unë, në atë kohë, edhe pse ato kritika të kultit të personalitetit për cak e kishin Stalinin, e bëja krahasimin e këtij kulti me atë të Enverit, por edhe të Titos. Dhe edhe pse kishte dallime të mëdha, pata ardhur në përfundim se nuk do të duhej të kishte as kult të Titos, sepse edhe ky kult ishte bërë sipas modelit të njëjtë sikur edhe kulti i Stalinit. Më dukeshin të pahijshme pamjet e kongreseve partiake, se si po festohej “datëlindja e Titos” me 25 maj, bartja e shtafetës nëpër të gjitha republikat dhe krahinat autonome, vënia e emrit Tito qyteteve, p.sh. Mitrovica e Titos, Vëlesi i Titos etj., - që e mbanin gjallë dhe e forconin kultin e Titos. Më çmendnin duartrokitjet për Titon, kur hynte në sallë ose gjatë fjalimeve, që zgjatnin disa minuta, deri sa edhe mareshali lodhej dhe ua jepte shenjën që të ndërpritej duartrokitja, sepse askush nuk guxonte ta bënë këto me vetiniciativë.

Zhgënjimi me Titon

BH: Nuk e kam prit këtë prej teje, sepse në shtypin kosovar, sidomos te “Bota sot” dhe disa gazeta tjera, Shkëlzen Maliqin e kanë akuzuar se ke qenë, e madje edhe se ka mbetur titist?! Kjo sigurisht sepse babën padyshim e ke pas të sistemit të atëhershëm dhe titist. Por, ky qëndrim i yti ndaj Titos, po ma kujton një stori të ngjashme. Mos ka ngjarë te Shkëlzen Maliqi po ai fenomen i braktisjes së kultit të idolit politik, përmes konfliktit të djalit me autoritetin e babait, që e ka përshkruar Migjen Kelmendi në librin e tij “Carrere Patria: Mungesa e atdheut?” Ky libër tregon se si Ramiz Kelmendi ndikoi që Migjeni ta idealizojë Shqipërinë dhe Enverin, e që më vonë është bërë zhgënjim i jetës së tij! A ke pas ti konflikt të tillë me Mehmet Maliqin, pasi që ai ka qenë titist, kurse ti, siç pohon, anti-titist?

ShM: Sa për akuzat se kam qenë e disa e thonë se jam ende titist, nuk i kam demantuar sepse nuk ia vlen, nuk ke si të shtyresh me njerëzit çfarë është p.sh. Bajrush Morina, që vetë ka qenë funksionar në forumet rinore komuniste dhe pastaj është bërë snajperist i antikomunizmit duke vazhduar me metoda ekskomunikuese, ku tani ndërrojnë vetëm parashenjat për atë çka është e lejueshme dhe e mirë, dhe çka nuk është e lejueshme dhe e mirë... Babai im ka qenë besimtar i Titos, kjo është e saktë. Unë jo. Edhe në periudhën e indoktrinimit intensiv dhe sistematik me titoizëm, nga fundi i pesëdhjetave dhe fillimi i gjashtëdhjetave të shekullit XX, kur unë po ndiqja shkollën fillore dhe të mesmen, nuk më kujtohet se kam pas ndonjë adhurim të veçantë për Tito, por as ndonjë averzion. Sigurisht, për periudhën më

të hershme nuk mund të them se indoktrinimi nuk ka ndikuar. Në atë kohë titizmi ka qenë ambienti jetësor si ajri që thithim, diçka që nuk kontestohet. Për më shumë, unë isha nga familja partizane e komuniste, që në Kosovë megjithatë kanë qenë të rralla. Në muret e banesës mbanim fotografitë e Titos. Në njërin nga ato fotografi Tito shihej me uniformë të mareshallit në shkallët e Oborit të Bardhë, Beli dvor, si rezidencë zyrtare dhe ceremoniale, i rrethuar me nja gjashtëdhjetë – shtatëdhjetë “besimtarë” të tjerë që kishin ardhur për t’ia uruar Titos 25 majin, Ditën e Rinisë, ose ditëlindjen e ceremoniale, ku ndër adhuruesit shihej edhe Mehmeti. Më kujtohet edhe një fotografi tjetër, e mëvonshme, me gjasë e bërë diku në vitet pas rënies së Rankoviçit, kur Titoja më rregullisht vizitonte Kosovën. Në këtë fotografi ishte mareshali i veshur me roba gjuetie, diku në Rugovë ose Brezovicë. Ishte i rrethuar me udhëheqësitë e Kosovës, Fadil Hoxhën dhe të tjerët, ndër ta edhe Mehmeti i buzëqeshur. Unë nuk mund ta mohoj që Mehmeti ka qenë pjesë e pushtetit të atëhershëm, ndër kryesorët në Prizren, dhe në nomenklaturën e Kosovës. Kam qenë, pra, pa dyshim një fëmijë i privilegjuar i pushtetmbajtësit, ndonëse kjo në atë periudhë të varfërisë dhe të prapambetjes së madhe të Kosovës nuk ka pasur ndonjë peshë të veçantë. Sot edhe vetë çuditem pse nuk jam bërë edhe unë besimtar i mareshallit. Ndoshta kam pasur fat që asnjëherë nuk kam hyrë ndër ata të zgjedhurit që merrnin pjesë aktivisht në manifestimet e organizuara për nder dhe lavdinë e marshallit. Për së gjalli Titon e kam parë vetëm nga larg, kur kalonte me suitën e tij rrugëve të Beogradit, dhe ato vetëm dy a tre herë edhe në makinë të hapur, duke e përshëndetur me dorë masën. Nuk kam marrë pjesë në asnjë miting të tij. Por, sigurisht, Titon nuk kishe nevojë ta shihje ashtu drejtpërdrejtë për ta adhuruar, sepse

fotografitë e tij ishin gjithkund, në televizion, në gazeta, nëpër muret e institucioneve, në shtëpitë e njerëzve...

Kur isha nxënës i shkollës fillore, bartja e shtafetës, ose pjesëmarrja në programet e ushtrimeve atletike që organizoheshin në stadione, të përcjellura me muzikë revolucionare, që quheshin Slet, është konsideruar si një nder dhe arritje e veçantë personale. Më i rëndësishmi prej këtyre Sletëve ka qenë ai në Beograd në stadionin e armatës jugosllave, në prani të vetë marshallit. Në ato vite, si nxënës i shkollës fillore, unë ua kisha zili të përzgjedhurve që bartnin shtafetën kryesore ku brenda kishte një letër urimi për Titon e që hapej dhe lexohej në çastin e dorëzimit, me 25 maj. Dhe pos kësaj shtefete kryesore kishte edhe qindra shtafeta lokale që i dërgonin firmat dhe organizatat, për shokun Tito, me porosi si prej idolatrie. Unë vetëm një herë e kam bartur nja 50 metra njërën prej atyre shtafetave lokale, në pjesën e rrugëtimit nëpër Prizren, por në rrugët anësore, larg Shadërvanit, ku vendosej bina qendrore. Po kështu, si fëmijë, të gjithë ne që nuk u futeshim në programet e festimeve të majit, ua kishim zili atyre ushtruesve të sleteve që për disa javë liroheshin nga mësimi dhe shkonin në Beograd për Sletin e Madh, qendror, para mareshallit. Unë, pra, nuk kam qenë i përfshirë në këto, pos atij rasti me një shtafetë lokale. Nuk kam shpjegim, thjesht ka ndodhur. Por kur jam rritur, madje edhe si gjimnazist, e pata ndërruar mendjen për këtë. Mospjesëmarrja nuk më është dukur më gjë e keqe. Kurse si student në Beograd, edhe pse kisha raste dhe ftesa, asnjëherë nuk kam qenë në spektaklin që organizohej më 25 maj në Stadiumin e Armatës në Beograd. Më dukej qesharak gjithë ai investim dhe program si për nder të ndonjë faroni.

A vdes prijësi?

Por, dua tash ta tregoj edhe një ngjarje interesante nga fëmijëria ime, që ka ndikuar që të kem një qëndrim më të rezervuar dhe ambivalent ndaj Titos dhe komunizmit. Është një përjetim nga viti 1957 kur nuk i kisha mbushur ende 10 vjet. Diku në pranverë të atij viti [e verifikua në Internet, ishte 15 marsi] në Paris pat vdekur njëri nga bashkëpunëtorët më të ngushtë të Titos, hebreu Mosha Pijade, piktor me formim, por në atë kohë kryetar i kuvendit të federatës. Një fqinje e jona, serbe, që shpesh vinte për kafe të mëngjesit në banesën tonë në Prizren, e kishte komentuar para Ijës (ashtu e quaja nënën time) dhe disa grave tjera, me vrazhdësi dhe pahijshëm vdekjen e Mosha Pijades me fjalët: “Të gjithë ata, një nga një, do të vdesin!”

Gratë kanë mbetur të shokuara dhe të skandalizuara. Për incidentin është dëgjuar menjëherë. Prizreni ka qenë kasabë e vogël, çdo fjalë ose aluzion i keq arrinte menjëherë në zyrën e Komitetit, o, çka ishte më e rrezikshme, te sigurimi shtetëror, UDBA famkeqe. Nuk më kujtohet saktë se cila e kishte denoncuar atë gruan gojëlëshuar, por e di se u pat bërë nami i madh për atë fjalë. Bisedat dhe shqyrtimet kanë zgjatur disa ditë, në mos edhe javë. Kam qenë prezent, i struktur në një kënd të dhomës së pritjes, duke u bërë sikur po lexoj diçka për shkollë, kur nëna ime dhe ajo fqinja po zhvillonin bisedën e parë sqaruese pasi që ishin përhapur fjalët për incidentin, se çka kish thënë ajo për vdekjen e Pijades. A ka qenë vetëm një fjalë goje e pashkathtë, një shaka e pakripë, çfarë ishte intonacioni, a e kishte thënë ajo ftohtë dhe logjikisht, si në silogjizmat e famshme, konstatimin se të gjithë njerëzit janë të vdekshëm, apo e ka thënë me dashakeqje duke aluduar në vdekshmërinë e prijësve komunist dhe, mozomakeq, edhe të Mareshalit Tito!? Më

kujtohet se ajo fqinja serbe ishte e tronditur dhe e frikësuar pa masë, qante dhe kërkonte falje, bënte be se nuk e ka pasur me të keq, se ishte vetëm lapsus. Ajo binte në gjunjë dhe e luste Ijën që ta ndihmonte, që incidenti të harrohet ose disi të zvogëlohen pasojat, duke e treguar rastin si një gabim pahiri dhe i padjallëzuar. Edhe Ijës i vinte keq, edhe ajo po kështu qante, por nuk ishte e gatshme t'i mohonte fjalët që i kishte dëgjuar, se aty kanë qenë edhe dëshmitaret tjera. Nëse do ta heshtte ose mohonte, para komisionit, ka mundur të ketë pasoja për te dhe, edhe më keq, për Mehmetin. Ija ishte vetëm shtëpiake, por Mehmeti funksionar, i pari i rrethit, i bien hija atij për rrenën. Dhe mohimi po kështu nuk do të ishte aspak qëndrim komunist, sepse do të gënjehej Partia e shenjtë! Fatkeqësisht, divi i së keqes kishte dalur nga shishja dhe nuk kishte mënyrë se si ta kthenin mbrapsht! Nëna ime vetëm shpresonte se ata të komitetit dhe të shërbimeve tjera do të kenë mirëkuptim për pendesën e singertë të saj, se afera do të kryhet me qortim ose vërejtje, dhe jo dënim më të madh, largimin nga puna ose edhe më keq. Në orët e mbrëmjes, kur për të njëjtën temë Ija me Mehmetin bisedonin gjerë e gjatë, kur nëna i tregonte se çka i kishte thënë dhe lutur fqinja, unë sërish bëhesha sy e vesh. Dhe u pata çuditë shumë me qëndrimet dhe reagimet ambivalente të Ijës. Edhe pse nuk e dëgjoja çdo fjalë të tyre, - ata më shumë pëshpërisnin - e pata kuptuar se ajo herë pohonte se është plotësisht e bindur në fajin e fqinjës, se e ka pasur me të keq, me qëllim e ka thënë atë fjalë, se ishte qartë një qëndrim kundër Partisë, dhe që ka aluduar në vdekjen e Titos, se edhe ai një ditë do të vdes. Por, pastaj, sikur pendohej, i vinte keq, e luste Mehmetin që të ndikojë atje në komitet e ku duhet tjetër, që rasti të mos dramatizohet, nuk do që ta brejë ndërgjegjja, pse ajo gruaja duhet të pësoj për një fjalë, ndoshta

edhe e ka thënë pahir dhe pasherr, ku ta di unë, mjafton që të qortohet rreptë, por jo edhe të përjashtohet nga partia, të humb punën, ose edhe më keq...

Përjetimi im i kësaj afere ka qenë tepër mbresëlënës. Sot më duket e pabesueshme që këtë ngjarje e kam memorizuar si tepër të rëndësishme, në moshën nëntëvjeçare! A e kam kuptuar atëherë plotësisht se për çka bëhej fjalë, apo kjo që po tregoj sot është një version i pastajmë ku kujtesa primare e rastit është plotësuar me melmesa të interpretimeve dhe dijeve të reja? Leximet e mëvonshme të literaturës antistaliniste kanë mundur t'i japin dritë dhe kuptim një drame të denoncimi për të cilën si nëntëvjeçar nuk kam pas shpjegime. Nuk jam i sigurt. Ndoshta edhe tash bëjë vetëm riinterpretim të interpretimeve. Por, megjithatë, për diçka jam i sigurt, se edhe si nëntëvjeçar e kam pas të ndërtuar në qëndrim moral për aktin e denoncimit. Dhe kjo mbase ka qenë edhe arsyeja pse gjithnjë e kujtoja me gjallëri të plotë këtë aferë. E di me siguri se në esencë, edhe pse ljen e kisha për zemër, dhe e kuptoja, që në këtë rast më shumë kisha konsiderata për gabimin e asaj gruaje, se për denoncimin e saj në Parti. Esenca ka qenë se ajo grua kishte thënë një të vërtetë logjike, se të gjithë, një nga një, një ditë, do të vdesim. Madje edhe mareshalli Tito.

Shkollimi në Kosovën komuniste

BH: Pasi që përshkrove këtë përjetim të kohës kur ke qenë nxënës, po më intereson se si ishte atëherë shkolla? Si perceptohej shkollimi në Kosovë në vitet '50 e më vonë? Si dukej bota femërore dhe

mashkullore në një mentalitet të atyre viteve. Sa ishte rixhide jeta në një Kosovë të tillë?

ShM: Shkolla ka qenë vend i iluminizmit. Sot e di se shkollimi masiv ka qenë një ndërmarrje e jashtëzakonshme. Për herë të parë në historinë e Kosovës është ngritur një infrastrukturë e madhe, sistem shkollor modern, që do të mundësojë edhe modernizmin e shpejtë dhe të përgjithshëm të Kosovës. Atëherë flitej se po kapërcehen shekujt, dhe vërtet ka diçka nga kjo. Shoqëria kosovare ishte tradicionale dhe konservatore, ekonomikisht e prapambetur, ende kishte zona ku sundonte kanuni dhe gjakmarrja, dhe jo ligjet e shtetit modern. Prizreni, p.sh., nga industria kishte vetëm një mulli elektrik. Të gjitha rrugët ishin të paasfaltuara, në rastin më të mirë kishte ndonjë pjesë e shtruar me kalldërm, makadam, ose kocka graniti. Por, kishte shumë veprimtari private zejtare, që pushteti ende nuk i shihte me sy të mirë, sepse konsideroheshin si pjesë e mikroborgjezisë, çka ata assesi nuk ishin, sepse nuk kishin fitime të mëdha. Dhe regjimi jo vetëm për sektorin privat, por edhe për fshatarët dhe një pjesë të inteligjencës, ishte represiv, sikur donte ti vinte kufijtë e qartë se deri ku mund të shkojë emancipimi i shqiptarëve, që ata të mos mashtrohen dhe mendojnë se Kosova është e tyre. Beogradi edhe atëherë kujdesej që Kosova të ketë një autonomi të cunguar, më shumë kulturore se politike. Dhe edhe në kulturë impononte një model restriktiv, të kulturës së rezervatit. P.sh. kishte tendenca që letërsia kosovare, që po zhvillohej me vëllazërit Esat dhe Hasan Mekuli, Hivzi Sylejmanin, Rexhai Surroin, Vehap Shitën e ndonjë të ri, të mos quhet letërsi shqiptare, por paradoksalisht letërsi jugosllave në gjuhën shqipe. Kjo e dyta ishte një lloj absurdi, por ashtu vinin direktivat nga Beogradi, dhe sa në një periudhë investohej në

themelimin dhe ngritjen e institucioneve, që i projektonin komunistet jugosllav më mendje hapur dhe më dashamirës të kulturës shqiptare, atëherë vinin të tjerët, që përmes shërbimeve sekrete dhe strukturave rankoviçiane në polici dhe armatë, e edhe në partinë komuniste, i pengonin dhe mbyllnin ato institucione. Kështu ka ndodhur p.sh. me Institutin Albanologjik, i cili u hap, pastaj u burgos dhe internua drejtori ose bashkëpunëtori kryesor Selman Riza dhe kjo u bë shkak që të mbyllet, dhe më vonë sërish u rihap. Kështu disi ka qenë edhe historiku i Bibliotekës së Kosovës, të cilës i ulej dhe ngritje rangu varësisht se çfarë ishin raportet ndërmjet politikave emancipuese të Partisë komuniste dhe UDB-së. Edhe atëherë, kuptohet në qarqet më të ngushta të udhëheqësisë komuniste, gjithnjë ka qenë e hapur çështja e statusit të Kosovës, a do të mbetet Kosova vetëm një rajon autonom, siç e quanin Oblast, apo krahinë autonome, që ishte një rang më i madh dhe e barazonte autonominë e Kosovës me atë Vojvodinës... Por, këto janë gjëra që kuptohen më vonë, jo në fëmijëri.

Prizreni: Bicikleta Pirrelli

Si fëmijë mua nuk më mungonte asgjë, madje kisha disa privilegje, p.sh. kisha biçikletën time personale të markës italiane “Pirelli”, që nuk e kishte askush të tillë, origjinale. Disa ia merrnin prindërve, por ishin të vjetra, roskope dhe modele për të rritur. “Pireli” im ishte çudë, me dizajnë tepër të bukur dhe me masa tamam për moshat 9 deri 13 vjeç. Unë nuk kam qenë vetjak. Shkoja me shokët, bëheshim edhe nga njëzet veta, edhe në disa rrugë afër varezave dhe vreshtave të Prishtinës ku nuk kishte fare trafik, dhe secilit i vinte radha për disa xhiro me biçikletën time. Biçikletën e patëm blerë në Ulqin, në vitin 1956 ose 1957. Edhe

ky pushimi në Ulqin ka qenë një risi dhe privilegj, sepse atëherë nuk shkohej në pushime verore. Verës në Prizren njerëzit kishin më shumë punë, sepse shumicës i duhej që të nxirrnin ndonjë fitim shtesë nga bujqësia. Prizreni kishte shumë bahçexhi që kultivonin perimet: domate, speca, qepujka, ose arpaxhikët e famshëm, që në Prizren dilnin më herët se në vendet tjera, klima është më e butë, depërton luginës së Drinit klima mediterane, dhe prizrenasve për këtë arsye i ka mbetur nofka ‘arpaxhikët’. Në Prizren më herët pjekën edhe qershitë, bostani dhe rrushi, dhe ne krenoheshim me këtë. Thjesht, kur i ke 9 apo 10 vjet, bota është e jote. Unë nuk kujtohem që të kisha ndonjë bezdi apo siklet. Në kujtesën time ato kanë qenë vitet e lumturisë, pa ngjarje a kujtime të hidhura... Po, vërtet, ka pas edhe ngjarje tragjike që i kam kuptuar si të tilla më vonë... P.sh. shpërngulja në Turqi. Por, në atë moshë, kur isha vetëm nëntë apo dhjetë vjeç, nuk e kuptoja mirë çka po ndodh. Ose të paktën në familjen time nuk bëhej dramë për këtë, edhe pse kishim shumë të afërt që u shpërngulën... Sigurisht se më vinte keq pse disa kushërinj dhe shokët me familje po iknin për Turqi, por ku ta di, Turqia kishte një kuptim abstrakt, ose lidhej me letrat dhe fotografitë që vinin nga Stambolli, Ankara, Bursa, Izmiri, Bandërma, Salihliu... gjithandej ku i kisha kushërinjtë... Dhe në fotografi ato vende nuk dalonin shumë nga Prizreni... Nocioni Turqi lidhej edhe me udhëtimet e shpeshta të gjyshes sime Zyhra, - ajo e kishte atje babën, vëllain dhe motrat, - ku qëndronte me muaj të tërë, dhe në kthim, gjithnjë sillte dhurata të ndryshme...

BH: Si ishin shkollat?

Sa i përket shkollës, edhe ajo ka qenë pjesë e lumturisë. Shkollën fillore e kam vijuar në Prishtinë dhe Prizren. Shkolla “Vuk Karaxhiç”,

sot quhet “Elena Gjika”, ka qenë pothuajse e njejtë si sot, shpesh ka-
 loj pranë saj, aty kanë mësuar edhe fëmijët e mi Agoni dhe Rozafa.
 Gjithçka ndryshon përreth saj e ajo mbetet e njejtë, i mungon ndoshta
 vetëm era e rëndë e atij vaji dezinfektues me të cilin i lyejin dërrasat
 e dyshemesë për çdo vit... Në këtë shkollë e pata kryer klasën e parë,
 dhe pastaj klasët 6 deri 8, pasi që në vitin 1955 me familje ikëm në
 Prizren, dhe më 1959 sërish u kthyem në Prishtinë. Në Prizren kam
 ndjekur klasët 2 deri 5 një shkollë të Papasqarshija, që kishte dy emra.
 Zyrtarisht quhej “Mlladen Ugareviç”, por për ne shqiptarët ishte “Ba-
 jram Curri”, emër që kishte mbetur nga koha e Luftës së Dytë Botërore,
 kur Kosova ishte pjesë e Shqipërisë. Deri në klasën e katërt unë e kam
 vijuar shkollën në gjuhën shqipe. Një gjë e çuditshme ka qenë se ne
 nxënësit, jashtë orëve mes veti komunikonim në gjuhën turke, që ishte
 gjuhë kryesore e komunikimit të kasabalive, të qytetarëve, edhe pse të
 gjithë e dinim se jemi shqiptar. Ky fenomen është i pranishëm edhe sot,
 kuptohet në përmasat më të vogla. Edhe nxënësit katolikë, - katedrala
 dhe mëhalla e tyre ishte pranë shkollës, - edhe ata jashtë klasëve me ne
 komunikonin turqisht... Më kujtohen p.sh. vëllazërit Kuzhnini, binjak,
 ata ishin pak më të vjetër, me të cilët gjithnjë komunikojmë në turqisht.
 Edhe më vonë kur i takoja në Zagreb, bisedën ia fillonim në gjuhën e
 kodit të përkatësisë një tradite të veçantë që e ka Prizreni, e pastaj ka-
 lonim në shqip.

Prizrenasit flasin turqisht në Vatikan

Bile me Kuzhninët e kam një episod interesant, s’di a është tash mo-
 menti që ta tregoj, por ne jemi bën pjesë në përkatësinë dhe dashurinë
 time ndaj Prizrenit dhe raportit të veçantë që kemi ne “kasabalitë” me

turqishten. Ndodhi që në vitin 1991 isha me Llazër Krasniqin dhe Kuzhninët në Romë, në një kongres të Partisë Radikale Transnacionale të Marko Paneles, dhe atje për çudi na patën ftuar nga Vatikani për një blic audiencë te papa Gjon Pali i Dytë, në Sheshin e Shën Pjetrit. Aty ai po mbante një audiencë masive me disa mija njerëz të ardhur nga të gjitha anët e botës. Ne do ta takonim papën për disa minuta, në një audiencë të veçantë, aty në shesh prapa binës solemne. Delegacioni i ynë para audiencës zhvilloj një bisedë me kryeministrin e Vatikanit, pak u stërgjatë me kërkesa për të cilat kryeministri thoshte qartë se duhet t'i adresohen Kishës, dhe jo qeverisë së Vatikanit. Kryeministri, p.sh. na shtronte pyetjen se a janë kosovarët të armatosur, kurse nga delegacioni ynë biseda kthehej në çështjen e ngritjes së rangurt të Kishës katolike në Kosovë në ipeshkvi, për çka ai sërish thoshte, “Shumë mirë, po ju kuptoj, por këtë kërkesë duhet ta shtroni tek Papa dhe kardinalët”, sepse ne ishim ne qeverinë e Vatikanit, dhe jo te kisha, kurse këta të delegacionit tonë e ngatërronin këtë sepse e shihnin kryeministrin me veshje klerike. Kështu ndodhi që u vonuam pak, në Sheshin e Shën Pjetrit arritëm në momentin e fundit. Në të vërtetë, unë me Agim Hysenin dhe Mihrije Rushanin mbetëm disa hapa mbrapa, kurse Llazër Krasniqi me Kuzhninët, Simonin dhe Mikelin, dhe Abdullah Karjagdiun, depërtuan me ngulm përpara duke kapërcyer pengesat që po i vendoste garda zvicerane, kujdestare e papës. Në momentin që po kapërcente gardhin, Abdullahu, u rrëzua keq dhe i rrjepi gjunjët, por nuk u dorëzua, e zuri vendin e tij në rreshtin e parë të mysafirëve specialë në audiencën. Njeri prej Kuzhninëve ndërkaq, duke vërejtur se kisha mbet mbrapa, po më jepte kurajo me zë në turqishten e Prizrenit: “Arkadash, var vakët, gjel beri! Atëll senda! Atëll” (“Vëllaçko, ke kohë,

eja këndej! Kërce edhe ti! Kërce”), por garda zvicerane në ndërkohë pat mbyllur çdo kalim dhe ne tre të vonuarit mbetëm të rrethuar nga turma, nja dhjetë metra larg papës, kurse Llazri me Kuzhninët dhe Abdullahun u kurulldisën në rreshtin e parë, pastaj patën edhe atë audiencë dhe bisedë të shkurtë me Papën, prapa binës, ku ai u kishte thënë se i mbanë në zemër shqiptarët dhe Kosovën. Megjithatë, sado që ishte kuriozitet ky komunikim i imi me binjakët, nuk e di a ishte Simoni apo Mikeli që më thërriste ashtu, në po atë vend, në Sheshin e Shën Pjetrit, pak më vonë Papa do të mbajë predikimin ku në pjesën hyrëse ai foli mjaft rrjedhshëm, nuk e kishte harruar përvojën e aktorit nga rinia e tij në Poloni, nga disa fjali përshëndetëse në më shumë se njëzet gjuhë, ndër to edhe në gjuhën shqipe, që ne besonim se e bëri për nder të delegacionit nga Kosova.

Shkollimi im në gjuhën serbe dhe Procesi i

Prizrenit

Po, tash, pas këtij digresioni për gjuhën turke, dua ta bëj edhe një tjetër për gjuhën serbe. Dhe kjo është gjëja më e rëndësishme e pavullnetshme që ka ndodhur në jetën time, dhe ka të bëjë me atë çka të intereson ty, me shkollimin tim. Në shkollën “Bajram Curri” unë e kam pas një mësues, Gjon Oroshin, i cili një ditë, në kohën kur unë po e përfundoja klasën e katërt, e kishte takuar babain tim dhe pasi që më kishte lavdëruar si djall të zgjuar ia kishte hapur edhe bisedën e ardhmërisë time. Mësuesit Gjon se çka i kishte rënë ndërmend që ta bind Mehmetin se është më mirë që shkollimin tim nga klasa e pestë të vazhdoja në gjuhën serbe! I kishte thënë “Shkëlzenit sigurisht që ke

ndërmend t'i mundësosh shkollimin e lartë. Ai është i aftë dhe duhet ti vazhdojë patjetër studimet në Beograd ose Zagreb. Pse nuk e çon në klasat serbe, le ta përsosë gjuhën dhe të përgatitet me kohë!” Mehmeti e kishte marrë seriozisht këtë ide. Atëherë vërtet nuk kishte mundësi të studimit në gjuhën shqipe, Universiteti i Prishtinës nuk ishte as në projektim. Pas konsultave me pedagogët tjerë, Mehmeti më regjistroi në klasën serbe. Nuk më kujtohet fare nëse kishte biseduar edhe me mua për këtë ndryshim. Megjithatë, duke e njohur si karakter, besoj se e kishte marrë pëlqimin tim, duke më bindur se kjo është për të mirën time. Në atë moshë, në rrethanat në të cilat jetonim, dhe në atmosferën që përshkrova se në Prizren gjuha nuk kishte aq rëndësi, me gjasa mua nuk më është dukur aspak e çuditshme që shkollimin do ta vazhdoja në klasat serbe, sepse e dija edhe atë gjuhë, ndoshta jo aq perfekt sa shqipen, por megjithatë mjaftueshëm.

BH: A të ka shkuar mendja se babai ka bërë ndonjë kalkulim me politikat e atëhershme të lojalitetit? Nëse nuk gabohem kjo është koha e famshme e procesit të Prizrenit, për këtë e ka botuar një fejtון apo libër Agim Zogaj. Mos ka qenë Shkelzeni i vogël mjet që një funksionar i lartë i rrethit të Prizrenit, të tregoj lojalitetin ndaj shtetit dhe UDB-së, e cila kishte dyshime për të gjithë kuadrat shqiptarë, përfshirë edhe Fadil Hoxhën?

ShM: Po, vërtet, të dënuarit në procesin e Prizrenit kanë dëshmuar më vonë se në hetimet kanë pasur shumë pyetje për Fadil Hoxhën dhe udhëheqësit tjerë të lartë të Kosovës, dhe ka shumë gjasa që krejt ky proces është kurdisur për të zënë në te Fadilin dhe për të komprometuar udhëheqësinë kosovare... Por, me gjasa Titoja e kishte penguar këtë. Sa i përket Mehmetit, në kohën e këtij procesi, ai ka qenë kryetari i

rrethit të Prizrenit, dhe njëri prej atyre që ia kanë montuar akuzën se ka punuar për Shqipërinë e Madhe ka qenë zëvendësi i tij, nuk më kujtohet emri, mund të shikoj më vonë në librin e Zogajt. Atë edhe e kanë burgosur në vendin e punës, në zyrën e rrethit, duke e ftuar edhe Mehmetin që të jetë dëshmitar që po kapet njëri nga “spiunët” dhe “tradhtarët”. Shumë më vonë, kur pata biseduar me Mehmetin për proceset e montuara dhe metodat staliniste, ai këtë zëvendësin e tij, (ndoshta për këtë që do ta them nuk duhet t’ia zbulojmë fare emrin), e merrte si shembull tipik të atyre të akuzuarve komunistë në proceset staliniste që, edhe pse të pafajshëm, kanë pranuar menjëherë krejt çka ua kanë mveshur shërbimet sekrete si veprimtari armiqësore, qoftë edhe shpifjet më të pabesueshme. Ky fenomen i thyerjes shpirtërore të komunistëve që akuzoheshin për tradhti haset shpesh në literaturën mbi stalinizmin. Ndaj tyre nuk është përdoruar fare tortura, por ata, paradoksalisht, menjëherë bëheshin të “butë”, bashkëpunues me shërbimet sekrete duke i ndihmuar “vullnetarisht” në montimin dhe konstruktimin e “tradhtisë”, dhe këtë jo për ta shfajësuar dhe shpëtuar veten, por përkundrazi, duke e rënduar në kryen e herës për tradhti - vetvetën! Është kjo sindroma e thyerjes së besimit komunist, por edhe çdo besimi tjetër, kur ai është besim i thellë, i verbër dhe fanatik. Në momentin që zoti, ose Stalini, ose Titoja etj., kthehet kundër besimtarit duke pohuar se ai është vetë djalli (në këtë rast “enverist”, “shqiptaromadh”), ai vendos jo të mbrohet dhe të mohoj, por të vetëviktimizohet. Mekanizmi psikologjik që vepron në këto raste është ai i mbrojtjes së besimit me çdo kusht, qoftë edhe duke u identifikuar me tradhtarin dhe tradhtinë, që në të vërtetë është pjesë e besimit. Sepse nuk është i rëndësishëm individi, as ai vetë si individ, por me rëndësi është që të

ngadhënjejë Partia dhe ideja... Sot është vështirë që të kuptohet ky fenomen... Por, po kthehem te pyetja, për mua është vështirë që të shkoj aq larg, sa të spekuloj për atë që tha se mos Mehmeti nga frika, ose për karrierizëm, e ka shfrytëzuar shkollimin tim në gjuhën serbe si mjet për të dëshmuar lojalitetin ndaj sistemit. Unë me te nuk kam biseduar për këtë, sepse kjo për të ka qenë temë e dhimbshme. Por, nëse duhet ti rishqyrtoj motivet e tij, pse më ka kaluar në klasën serbe, mendoj se vërtet e ka pasur për të mirën time, i bindur në argumentin e mësusit Oroshi. As frika e as karrierizmi nuk përkojnë me karakterin që ka pas Mehmetit. Ai nuk ka mundur ta dëshmojë lojalitetin ndaj “regjimit” dhe sistemit në atë mënyrë. Ai ka qenë titist lojal, nuk ka pas nevojë për dëshmi të tilla.

Vuajtjet e adoleshentit

Por, më vonë, si prind, e di se është bërë pishman, ka vuajtur shumë për këtë vendim, e konsideronte budallaki më të madhe që ka bërë në jetë. Ai e ka kuptuar si prind, pas disa vjetësh, në moshën adoleshente timen, që zhvillimi im kishte marrë një drejtim që atij i dukej i rrezikshëm. Djali i tij i madh po alienohej, tëhuajsohej nga familja dhe mjedisi. Unë vërtet në moshën adoleshente u bëra pak si tuaf, i tërhequr, fjalëpak, mbahesha më shumë me libra, lexoja dhe shkruaja poezi, nuk i respektoja fort adetet dhe largohesha nga “realiteti” dhe idetë që prindërve të mi u dukeshin normale, nëse jo edhe të shenjta... As unë vetë nuk jam i sigurtë a ka qenë kjo që i brengoste prindërit e mi, diçka e lindur në vetë karakterin tim, apo ishte pasojë e asaj që unë po mësoja në gjuhën serbe, që po krijoja gjithnjë e më shumë shoqëri serbe dhe jugosllave, dhe gjithnjë e më pak kisha kontakte me familjen

dhe komunitetin shqiptar. Deri sa isha në Kosovë kjo distancë që kisha ndaj realitetit kosovar disi maskohej, por më vonë, kur shkova për studime në Beograd, dhe nuk u ktheva prej atje për 16 vjet, - kuptohet lidhjet nuk i kisha këputur, vija për vizita disaditëshe në Prishtinë dhe Prizren, - prindërit e mi vuanin, mendonin se për këtë ka ndikuar gabimi që më kanë shkolluar në gjuhën serbe. Përndryshe, unë kam qenë gjithnjë djalë i qetë, nuk kërkoja shumë, jetoja në botën time. Ata kanë menduar, këtë problem e kanë shumë prindër në rrethanat e ngjashme, se më kanë humbur ashtu shpirtërisht, përgjithmonë.

BH: A të kishin humbur?

ShM: Jo, jo... Por, unë kam pas atë periudhë të jetës kur vërtet edhe vetë ndihesha i alienuar dhe nuk po gjeja mënyrat se si të komunikoj me prindërit. I kam pas vuajtjet e mia, ato të adoloshencës, të rritjes, të përcaktimit se kush jam dhe çka dua të bëhem, të një refuzimi permanent që të marr përgjegjësinë e plotë për fatin tim... Si adoloshent kam vuajtur mjaft nga sindroma e pakuptimësisë së jetës, më ktheheshin gjithnjë edhe mendimet për vetëvrasje. Mendoj se çdo njeri në adoloshencë krijon diçka që unë e quaj qëndrim themelor për jetën ose, më saktë, për vdekjen. Ballafaqimi me idenë e vdekjes, se një ditë unë nuk do të jem më, është tronditës për adoloshentin, por edhe më vonë. Dhe ndaj kësaj sfide secili individ herët a vonë formulon një qëndrim të vetin. Ky qëndrim pastaj bëhet bosht i orientimit, pikë referuese kryesore për çdo gjë që sjellë jeta, çelës i ballafaqimit me çdo sfidë. Secili e ka këtë. Mendoj në atë se me këtë formulim të qëndrimit ndaj jetës dhe vdekjes farkohet karakteri i njeriut. Karakteri i dobët i ik sfidës, është në kërkim të alibive, të mekanizmave mbrojtës, zgjedh rrugët më të lehta, kompromiset në jetë, dorëzohet pa luftë, identifikohet me

masën, bëhet xhemat, nuk flet me zërin dhe ndërgjegjen e tij por ashtu si kërkjnë dhe diktojnë rrethanat, gjithnjë sigurohet që të jetë i “paga-bueshëm” dhe të përshtatet. Karakteri i fortë, është e kundërta e kësaj: ai ballafaqohet hapur me sfidat e jetës, nuk e kërkon domosdo sigurinë, nuk mjaftohet me receta të gatshme, bëhet vetja dhe personalitet me vetërespekt, shqyrton gjërat me ndërgjegjen që ka, gabon dhe e pranon gabimet që i bën...

Përcaktimi për filozofi

BH: Tash po flet si një filozof...

ShM: Po, edhe e kam përgatitjen e filozofit, edhe pse prej kohësh nuk e studioj dhe praktikoj në mënyrë sistematike. E kam më shumë hobi. Por, tash që flas për atë kohë, kur po formohesha si personalitet, edhe pse ne jetonim në komunizëm dhe ideologjia komuniste dukej dominante dhe e pamposhtshme, në atë periudhë filozofia e vërtetë dhe më ndikuese e kohës ka qenë ekzistencializmi. P.sh. që nga rinia e hershme, kur kam filluar të lexoj shumë, në moshën 16 deri 18 vjeç, kam lexuar shumë ekzistencialistët francezë, Sartrin dhe Kamynë. Për temën e maturës në gjimnaz kam pasur Kafkën dhe Kamynë, e kam bërë një punim prej rreth 60 faqesh, tani e kam humbur. Ideja e absurdit për mua nuk ka qenë thjesht një konstrukt letrar i Kamysë, por e konsideroja si diçka të prekshme, që unë vetë e përjetoja, në mos edhe e mishëroja, gjë që më frikësonte e edhe paralizonte. Kjo vuajtje ka pasur edhe anën materiale, fizike, në ankthet që i përjetoja para çdo zgjimi, veçanërisht kur bëja pushimin e pasdites! Zgjohesha i djersitur sepse shihja ëndrra të këqija, kisha frikë, ndihesha si dikush që qëndron i

vetmuar para një humnere, ku nuk kishte kuptim as të bërtisje dhe të kërkoje ndihmë ngase askush nuk të dëgjonte... Për këtë ankth, që është zhdukur gradualisht në moshën e pjekurisë, kam spekuluar më vonë si një psikoanalist dhe vetë-analist amator se ndoshta është pasojë e pasigurisë që e kam përjetuar në jetë kur pata kaluar në klasën serbe, sepse më ka bërë tepër të ndieshëm, tuaf dhe të alienuar nga familja. Në klasën e pestë ndodhte që bëja gabime, e shqiptoja keq ndonjë fjalë, ose nuk e kuptoja ndonjë shprehje në gjuhën serbe dhe krejt klasa qeshte me mua... Për këtë ndoshta, në ato dy tre vitet e para që pata kaluar në klasën serbe, sikur pata një fazë të mbylljes dhe të reterimit në qëndrimet dhe në sjelljet, u kyça në veten time, tregohesha tepër i kujdeshëm që të mos gaboja... Por, më vonë, kur i kam bërë analizat më të thella, jam kthyer edhe në fëmijërinë e hershme, edhe në këtë periudhë i kam zbuluar elementet e këtij karakteri tim, si diçka që konsiderohet si karakter i lindur. P.sh. në moshën shtatë apo tetë vjeçare, unë e shihja një ëndërr që përsëritej, që ishte një vizion si i rrethit të cirkut, ku gjërat dhe njerëzit lëviznin, por gjithnjë silleshin rrotull pa e gjetur arsyen dhe cakun pse po sillen. Ishte një ndjenje sikur gjarpri të ketë si qëllim të jetës kafshimin e bishtit të tij, por nuk mund ta arrij kurr këtë. Një ilustrim të përafërt për këtë e kam pas zbuluar në filmin e Federiko Felinit që titullohet “8,30”, i cili përfundon me lëvizjen qarkore dhe muzikën e cirkut, si rekapitulim i idesë së “kaosit të organizuar” që i jep ngjyrë çdo ekzistence jo vetëm individuale por edhe kolektive... Ose, një ankth tjetër që e kam pasur si fëmijë, e që më vonë e kam zbuluar se i përshtatet plotësisht teorisë së solipsizmit, ishte ai i mundësisë të mashtrimit kolosal që na vjen nga shqisat, edhe nga të pamurit. Unë imagjinoja se krejt bota, gjithçka që shoh përreth, është

vetëm një fanitje mashtruese, diçka si fatamorganë. Paramendoja se jam krejtësisht i vetmuar në botë dhe se kjo që shihja, qielli, toka, lumi, shtëpitë, janë sikur një perde mashtruese, një teatër i hijeve i kurdisur dhe rikurdisur për çdo ditë, çdo orë, çdo sekondë apostafat vetëm për mua. Dhe paramendoja se nëse unë do të mund ta rrotulloja shikimin shumë shpejtë, për pjesën e milionit të një sekonde, do ta kapja inskenimin mashtrues, do të shihja dhe kuptoja se prapa asaj që shoh me sy, nuk ka asgjë, as natyrë, as njerëz, as qytet, as prindër, e madje se nuk ekzistojnë as unë vetë. Duket një fantazi e çuditshme, çmendurake. Por, thjesht gjithnjë më kthehej si vizion, dhe unë isha tepër i turpshëm që ta diskutoja me ndonjë tjetër person.

BH: Mua më duket si pjesë e ndonjë romani filozofik...

ShM: Po, është një filozofi naive, dhe ndoshta të duket si digresion letrar... Por, për mua këto digresione kanë kuptim, sepse në këtë bisedë nuk po flas vetëm me ty Baton, por edhe me vetveten. Është interesant, po e bëj tash edhe një digresion, se për këtë formim timin kanë ndikuar edhe lëvizjet e shpeshta të familjes time nga Prizreni në Prishtinë, dhe anasjelltas. Mehmeti çdo dy apo katër vjet e ndërronte punën, herë ishte i nevojshëm në Prizren, herë në Prishtinë, e një apo dy vjet ka qenë me shërbim edhe në Mitrovicë, por atëherë i kam qenë tre a katër vjeçar dhe kujtimet i kam të mjegullta. Kur kështu lëviz shpesh nga një qytet në tjetrin dhe nga një mjedis në tjetrin, nuk krijon lidhje stabile me shokë dhe pedagogë. Nuk mund as të lëshosh rrënjë dhe as të krijosh shprehitë stabile dhe karakterizuese për personalitetin. Dhe çka është edhe më interesante për këtë biografinë si prej nomadit, unë e kam bërë gjithnjë dallimin e ashpër mes Prizrenit, ku ndihesha i lumtur dhe më i hapur, dhe nuk e kisha as atë ankthin që e tregova më parë,

të zgjimit i djersitur dhe i frikësuar, - nga njëra anë -, dhe Prishtinës, që nuk e pëlqejë si qytet, dhe ku ndihesha se jam person tjetër, me ato ide dhe sjellje të zymta, i vetmuar, me ankthe.

Ikja nga mentaliteti provincial

BH: Por, megjithatë, në fund ke vendosur të jetosh në Prishtinë, jo në Prizren...

ShM: Nuk kam vendosur vetë, por kështu kanë qenë rrethanat. Prej vitit 1964, familja ime më nuk ka lëvizur nga Prishtina, por unë kam vazhduar, më 1966, studimet dhe jetën në Beograd. Me Prizrenin jam ndarë si gjimnazist kur pat filluar të më ngullfatë konzervativizmi provincial i njerëzve. Më pëlqente pa masë qyteti dhe kisha shumë kushëri dhe miq, por më bezdisnin shumë disa tipa që më ndalnin në rrugë dhe më mbanin leksione për veshjen që kisha, ose flokët e gjata etj. Thoshin “A e di bre ti se i biri i kujt je?! Ti duhesh me qenë shembull për të mirë, dhe jo kështu për çoroditje!” Më vonë, dikush kishte përhapur thashëthemën se unë si student në Beograd po merrja drogë, dhe këto bezdisje u bënë edhe më të padurueshme, kështu që një kohë nuk shkoja fare atje, pos për ndonjë gëzim apo ngushëllime te kushërinjtë, kur nuk mund të mungoja, dhe kjo vetëm për një a dy ditë.

BH: Kur e përmende drogën, a e ke provuar? A je sfiduar që ta lehtësosh dhe ëmbëlsosh jetën, pasi që vetë tha se ke pas ankthe dhe jetën e ke parë si absurd?

ShM: Jo, jo. Me drogën kam qenë i rrethuar, e konsumonin shumë të njohur që kisha në Beograd, kryesisht hashishin dhe marihuanën, por unë isha rezistues, më mjaftonte duhani, që e pija shumë, nga pesë apo

edhe gjashtë paqeta në ditë. Por, ta them drejt hashishin e pata provuar një herë në vitin 1968 ose 1969, dhe kjo vetëm për ta kuptuar shijen dhe nuk më pat lënë asnjë gjurmë dhe përshtypje. Po kështu, e kam provuar një herë edhe marihuanën nga Holanda, ku ishte legalizuar, me një mik piktor. E zbulova se është si duhani, por me një shihje më të ashpër dhe më të rëndë, të barit që tymoset. Asgjë speciale dhe sërish pa asnjë efekt në mua. Kur e kam kaluar krizën e adoleshencës dhe të tundimeve për vetëvrasje pa e gjetur ndonjë mbështetje shpëtimtare p.sh. në besimin në zot, as për krizat e pjekurisë nuk kërkoja ngushëllimet në stimuluesit e jashtëm. Kur më ofronin drogë, unë përgjigjesha “nuk më duhet, e kam në vete drogën.”

Si u binda se nuk ka zot?

BH: Po çështjen e religjionit dhe të zotit si e zgjidhe?

ShM: Në fillim isha ateist, sepse kështu më kishte thënë babai. Po e rikonstruktoj në imagjinatë një bisedë të këtyllë mes babait dhe birit: “Babi, a ka zot? Pse gjyshja dhe halla i luten zotit për çdo ditë?” Mehmeti përgjigjet: “Gjyshja dhe halla janë besimtare, ashtu janë edukuar prej hoxhallarëve dhe dervishëve. Në kohët e moçme njerëzit nuk e kanë kuptuar dialektikën e natyrës, pse bjen shiu dhe bora, pse njerëzit vdesin etj. Pastaj, kanë qenë edhe mbretërit që e mashtronin popullin që sundonin. E kanë shpikë zotin, për me i frikësu njerëzit me ferrin, që të janë të dëgjueshëm. Por, shkenca marksiste ka zbuluar se religjioni është mashtrim, opium për popull.” Prej gjithë atyre fjalëve sigurisht se kam kuptuar dhe mbajtur në mend vetëm një: “Nuk ka zot!”

Por, i mbaj mend qartë grindjet e pafund dhe të ashpra me një shok timin të fëmijërisë, Sebën, që banonte në Bokli Sokak, pranë kinemasë “Bistrica” (sot “Lumbardhi”), dhe edhe ai me familjen u shpërngul për Turqi. Por para ikjes një ditë kishim hipur me Sebën mbi murin ballor të Kalasë, po e shikonim nga lartë Prizrenin, numëronim xhamitë dhe kishat dhe nuk po pajtoheshim në asnjë pikë për besimin dhe zotin. Ai po hakërritej dhe po mundohej të më bindte se ka zot: “Mos gabo me e mohue, është gjynah dhe mëkat i madh, ta dërgon Perëndia një rrufe dhe të vret në vend!” Unë ndërkaq po mundohesha ta bind atë se nuk ka zot: “Ku është ai zoti i yti tash, pse nuk po më vret rrufeja? Pse nuk vjen këtu dhe vërteton fjalët e tua?” Edhe Sebës i kishte thonë babai i tij se ka zot. Je religjioz ose nuk je, pse të thotë ndonjë autoritet që paska ose nuk paska zot. Mendoj se kjo është dobësia e çdo religjioni, se të vjen si dogmë dhe diktat. Ta mëshojnë si vulë, kur lind, me aktin e pagëzimit – je krishterë, apo mysliman, apo diçka tjetër. Kuptohet, kjo vlen edhe për ateizmin, kur ta japin në trashëgimi si vulë ose tatuazh që nuk mund të shlyhet. Unë e kam menduar fort punën e zotit dhe besimit. I kam studiuar librat e shenjtë. Kam lexuar çka thonë filozofët. Çdo besimtar i ri krishterë duhet t’i lexojë traktatet e Spinozës për kontradiktat e Biblës. Kështu në mënyrë kritike duhet të lexohet edhe Kurani. Kuptohet, kjo këshillë vlen nëse je fare i gatshëm që të shqyrtosh paanshëm se a ka apo jo zot. Përfytyrimet e zotit në librat e shenjtë janë naive. Disa filozofë kanë thënë se edhe nëse është e saktë se nuk ka zot, ai është dashur që të shpiket gjithsesi, sepse shumicës së njerëzve i duhet, nuk munden pa te, jetën do ta kuptonin si ferr, do të zhdukej morali, askush askujt nuk do t’i bindej për asgjë... Nëse s’ka zot, gjithçka është e lejuar!, ka thënë Dostojevski Kurse disa filozofë të

tjerë, thonë se nëse duhet të ekzistojë zoti dhe religjioni, atëherë ky zot do të duhej të ishte krejt ndryshe seç përfytyrohet, jo antropomorf, jo si zoti i Biblës dhe Kuranit, por zot që do të ishte një mendje e pastër dhe e gjithëfuqishme. Religjioni i filozofëve, nëse mund të quhet religjion, është deizmi. Në deizëm gjithësia paragjykohet të jetë tërësi inteligjente, e strukturuar nga një, të them ashtu, mendje fantastike. Kurse varianti tjetër i besimit, po aq legjitim, është ai që nuk ndjek shtegun racionale, të cilësdo super mendje, por zgjedh rrugën mistike të shkrirjes së unit në gjithësi. Në këtë rrugën e dytë është budizmi, sidomos zen budizmin. Nuk është religjion i strukturuar, nuk ka zot, rituale dhe lutje, dhe nuk ka as djaj me të cilët të kërcënon perëndia e frikshme, një perëndi hakmarrëse dhe xheloze, e cila të dënon, të lëçitë dhe të dërgon në ferr, nëse merr guximin që të mos i besosh. Por, unë nuk jam bërë as deist, as zen budist. Po të kisha kohë, ose të jetoja në një kohë tjetër, më pak të trazuar, ndoshta do të gjeja motivin që të hulumtoja këto rrugë, ose të banoja më shumë apo edhe plotësisht, në filozofi dhe poezi, që janë vokacionet e mia më të pëlqyera se këto punë me të cilat po merrem në 25 vjet e fundit dhe më të cilat po plakem dhe sosem.

Lektyra rinore

BH: Po, tashti ndoshta mund t'i kthehesh filozofisë dhe studimeve serioze?

ShM: E lëmë këtë temë...

BH: Ose ndoshta ti qasemi ndryshe. Më duket se tha që jeta të bënë filozof, e edhe të largon nga ajo. Dua të di më shumë për

rrethanat, çka lexoje atëherë më së shumti. Si ka hyrë Shkëlzeni në atë që e quajmë jetë intelektuale. Çfarë shkallësh është dashur të kaloje, në lexime dhe përvoja, për të arritur deri te vendimi që të studiosh filozofinë?

ShM: Mendon në leximet e literaturës serioze, apo edhe çka kam lexuar si fëmijë?

BH: Të dyja, nëse ka lidhmëri... Dhe të ndërtosh mundësisht një ide, një përfytyrim të skenës intelektuale, të ambientit intelektual në Kosovë, dhe në Beograd, dallimet dhe ngjashmëritë. Dhe ku e sheh ti vendin tënë në ato dallime dhe ngjashmëri.

ShM: Po, gjithçka ka lidhje me gjithçka, dhe unë në periudhat e ndryshme kam lexuar sende të ndryshme, prej stripave deri te traktatet filozofike e edhe shumë sende që në anglisht i thonë bulshit, kaka të buallicës, kotësira. Në fillimet literatura më e preferuar kanë qenë revistat për fëmijë jugosllave, “Politikin Zabavnik” dhe “Plavi Vjesnik”. Përmbajtja e tyre ka qenë pothuajse kryekëput perëndimore, të përkthyer. Stripat më të popullarizuar kanë qenë “Princ Valianti” dhe “Flash Gordoni”, por edhe klasikët e Disneyt. Kishte edhe ndonjë strip jugosllav, po nuk ishin aq cilësor dhe interesant, sepse edhe skenaret i kishin më të dobëta. Në Kosovë botohej “Pionieri”, që e kishte konceptin pedagogjik për debillat – deri vonë ka pas mbetur i tillë – sepse aty gjeje vetëm propagandë dhe vetëm tekste, vjersha dhe ilustrime “pozitive”, joinventive, moralizuese etj.

Jeta në kryeqytetin e Jugosllavisë

Studimet në Beograd

BH: Pse zgjodhe Beogradin për studime? Si e pranojë këtë familja jote?

ShM: Beogradi ishte zgjedhje e natyrshme për mua. Më herët tregova se si isha përgatitur për studime në gjuhën serbe. E kisha vetëm një dilemë: ta studioj letërsinë apo filozofinë. Më parë kisha tundime edhe për akademinë e arteve, ose edhe regjinë. Por për këto dy të fundit më dukej se nuk kisha përgatitje paraprake. Sa i përket letërsisë nuk më dukej se ajo mund të mësohet. Dhe mua nuk më interesonte teoria por vetë shkrimi. Kështu që më në fund vendosa që nëse duhet të merrem me teori, atëherë le të jetë kjo nëna e teorive, filozofia, që edhe siguron dije më të gjëra dhe më të thella.

Pse Beogradi kjo atëherë as që shtrohej si pyetje. Rreth dy mijë kosovarë studionin në Beograd në kohën që unë u regjistрова në Degën e Filozofisë, më 1966. Në Zagreb dhe universitetet tjera kishte shumë më pak shqiptarë, dhe në atë kohë nuk kishte diskriminime të hetueshme. Beogradi ishte kryeqytet i federatës dhe ishte tërheqës jo vetëm për studentët nga të gjitha anët e Jugosllavisë, por edhe të kuadrove politike dhe tjera që vinin nga të gjitha republikat dhe dy krahinat autonome. Prej Kosovës kishte dyndje drejt Beogradit edhe për punë sezonale,

por edhe të përhershme. Thuhej se në Beograd në atë kohë jetonin dhe punonin rreth 20 mijë shqiptarë. Disa pohonin se janë më shumë, mbi 50 mijë, por mua më dukej ekzagjerim.

Prindërit e mi nuk ishin shumë të lumtur me përcaktimin tim për filozofi. Kjo sikur ua forconte bindjen se po e vulosja fatin tim të tuafit. Por, nuk e kundërshtuan. Në gjimnazin e Prishtinës, atëherë quhej “Ivo Llola Ribar”, kisha arritur që të dëshmohesha si talent në filozofi, dhe kjo u jepte besim se megjithatë do të kisha ndonjë karrierë të harrit. Kjo ngase në gjimnaz kisha një arsimitare të filozofisë, zonja Aksiq, emri nuk më kujtohet, që ishte gruaja e funksionarit komunist Dr. Stanoje Aksiq, që ka qenë Kryetar i Kuvendit të Kosovës. Për këtë Aksiqin, po më kujtohet si digresion, thoshin se doktoratën, që për subjekt e kishte zhvillimin e autonomisë së Kosovës në Jugosllavinë socialiste, e kishte kopjuar paturpshëm nga magistratura e Asllan Fazliut, edhe ai funksionar komunist, gjyshi nga ana e nanës i Petrit Selimit. Profesoresha Aksiq na pat dhënë për hartim një temë nga filozofia, ku unë me dijet e mia që kisha atëherë, në 70 ose 80 rreshta, e kisha bërë një si instant sintezë të Marksit dhe Frojdit, përkatësisht të marksizmit dhe psikanalizës. Nuk ka qenë ndonjë gjë ekstra, thjesht një hartim shkollor, por profesoresha jo që e kishte vlerësuar lartë dhe lavdëruar para klasës, por ia kishte lexuar të gjitha klasave në gjimnaz, dhe kjo më bëri me atë reputacion të “filozofit”. Nxënësit tjerë dinin diçka për Marks, sepse marksizmin e kishim si lëndë, por për Frojdin dhe psikanalizën shumica nuk kishin dëgjuar. Për më shumë, profesoresha më kishte lavdëruar edhe te burri i vet, dhe ky ia kishte përcjellur Mehmetit, me fjalët “Djalë e ke fillozof, është më i dalluari në shkathtësinë e shkrim-it në krejt gjimnazin, ia kalon edhe atyre që serbishten e kanë gjuhë

amëtare”. Kjo ka ndikuar te Mehmeti që të rikujtojë propozimin “profetik” të mësuesit im Gjon Oroshi, se vërtet isha përgatitur si e ma mirë për studime në Beograd.

Mehmeti ka qenë me sjellje dhe si karakter pater familias me autoritetin që nuk kontestohet. Por jo edhe aq tipik sepse si prind nuk ishte despot por, përkundrazi, tregohej i kuptueshëm, nuk nxehej dhe nuk nxitonte, shumë rrallë e ngriste zërin, e edhe më rrallë na ndëshkonte. Por, kjo jo që nuk ia ulte autoritetin por e bënte më imponues, më të pakontestueshëm. Shpesh, në konfliktet e pakëndshme të adoloshencës, kur kërkoja më shumë liri për vetën, më lehtë e kisha me Ijën, e cila më ndëshkonte aty për aty, me ndonjë shuplakë ose dajak të rastit, se sa me qëndrimin qortues dhe refuzues të Mehmetit, të cilin ai nuk e thoshte, por unë e dija se është i tillë, qortues, dhe se qëndron si pengesë për atë lirinë time të synuar. Ky është një mekanizëm i çuditshëm se si vepron autoritetit prindëror, i babait si pater familias, edhe kur ai duket parimisht i “butë” dhe jorepresiv. Autoriteti i tij funksionalizohej përmes agjentëve të tjerë socialë, ku në vend të babait flisnin hapur nëna dhe gjyshet, ose edhe një korr i farefisit, pedagogët, e po kështu edhe ca qytetarët të cilët më shikonin dhe vlerësonin, në situata të ndryshme, jo si individ, por si djalin e Mehmetit. Të them të drejtën, unë këtë e kam pas kompleks, për të mirë dhe për të keq, i cili pastaj, kur jam rritur, është shndërruar për një kohë mjaft të gjatë edhe në rivalitet dhe konflikt politik.

Raportet me Mehmetin

Por sot mund të them, - kur i lë anash problemet që i kisha me refuzimin e autoritetit të tij, - se Mehmeti si prind ka qenë shumë kor-

rekt, një babë i kuptueshëm. Shumë njerëz ende paragjykojnë se familja Maliqi ka qenë me privilegje dhe e pasur në atë regjim komunist, por nuk ka qenë ashtu. Ne gjithnjë kemi jetuar në kushte modeste, vetëm me një pagë, atë të Mehmetit. Ishim familje relativisht e madhe, pos prindërve, kemi qenë katër fëmijë, unë si më i vjetri, motrat Drita dhe Rita dhe vëllau Gazmendi, dhe me ne shumicën e kohës kanë jetuar edhe dy gjyshet, Zyhra Stavileci, që ka vdekur në moshën e shtyer si 96 vjeçare, më 1996, dhe Tehvida, nga ana e babait, që ka vdekur më herët, në vitin 1975. Kur banonim në Prishtinë, me ne jetonin edhe kusherinjtë, p.sh. djalli i dajës Valbon Stavileci dhe djali i axhës Fisnik Gështeja, sepse ata vijonin studimet në Prishtinë. Paga e Mehmetit, kuptohet, nuk ka qenë prej atyre të vogla, ai ka pas edhe ndonjë shtesë, ka qenë invalid i luftës dhe bartës i Përkujtimorës së veteranit të luftës nga vitit 1941, por asnjëherë nuk ka mundur të ketë kursime. Mehmeti ka qenë shumë parimor dhe modest në shfrytëzimin e privilegjeve për përfitime personale dhe të familjes. Nuk ndërtoi shtëpi private, nuk kishte as shtëpi vikendi, as pasuri të patundshme. E pat blerë vetëm një truall në vitin 1970 në Shtoj të Ulqinit, kur ato ishin shumë të lira, por kurrë nuk arriti që të ndërtonte gjë, dhe këtë pastaj e pat shit vëllau Gazmendi në vitet '80. Mehmetit i kishte mbetur, edhe në kohën kur komunizmi po degjenerohej, ideali se komunisti i vërtetë nuk vrapon pas privilegjeve dhe pasurisë. Ne si fëmijët e tij nuk kemi marrë e as kërkuar bursa shkollimi, nuk kemi shfrytëzuar asnjë privilegj tjetër, të kemi banesa ose vende të punës speciale, që shpesh spekulohet se i kanë pasur anëtarët e nomenklaturës komuniste. Unë vetë as që kam dashur të shfrytëzoj privilegjet, dhe që nga dita e parë që jam nisur në studime, e kemi bërë një marrëveshje që shpenzimet e studimeve të

mia t'i mbulojë Mehmeti, - nuk do të kërkonim bursë, - gjë që ka qenë sakrificë mjaft e madhe për familjen. Ato mjete që kisha për studime nuk kanë qenë të mëdha, shpesh mbetesh pa asnjë metelikë dhe nga disa ditë vuaja nga urria...

Filozofia e pastër

BH: Po më interesojnë më shumë detale të këtilla nga jeta studentore e asaj kohe. Si e gjete Beogradin? Si dukej jeta e një studenti në Beograd në atë kohë?

ShM: Siç e thash më herët, në Beograd pata shkuar në vitin 1966, nga fundi i shtatorit, për të studiuar filozofinë e pastër...

BH: E pastër...? Çfarë kuptimi ka kjo?

ShM: Nuk ishte emërtim zyrtar, por e përdornin studentët. "Pastërtia" ishte një theksim se po futeshim në një botë të mendimeve dhe dijeve mbi puro esencat. Nuk më kujtohet nëse ka pas kuptimin thjeshtë veçues në kohën kur ishte shpikur, për të dalluar p.sh. studimet e filozofisë nga ato të përziera filozofi-sociologji ose me gjuhë dhe letërsi, por mua më dukej gjithnjë sikur po thoshim "po studioj alkimi", në vend "po studioj kimi". Sidoqoftë, të kërkosh eliksirin e "pastërtisë" së mendimit në ato rrethana ishte iluzore dhe qesharake, ashtu siç është bërë për të qeshur edhe alkimia. Përndryshe, këtë pozitë të filozofit si të një njeriu gjysmë i lëçitur nga shoqëria e shprehte edhe frazeologjia e kohës, në gjuhën serbo-kroate si dhe në shqipe, ku për çdo pretendim që të thuhet mendime të mëdha reagohej me "mos filozof!", "ç'po më filozofon aty!" Nga ana tjetër, filozofia kishte edhe një aureol të frikshëm të autoritetit suprem, sepse një variant i filozofisë së "papastër",

pra të aplikuar në realitet, e përjetonim si ideologji sunduese të kohës, ajo konsiderohej edhe udhëheqëse e revolucionit jugosllav. Ishte kjo filozofia marksiste-leniniste, e cila në Jugosllavi nuk ishte aq rigjide dhe staliniste por, megjithatë, sundonte mbi kokat e njerëzve e edhe në marrëdhëniet shoqërore dhe ekonomike. Dhe kur e mendoj sot këtë, si raport të filozofisë ndaj asaj ideologjie sunduese të kohës, më duket që pretendimi për të qenë “filozofi e pastër” do të duhej të kishte edhe një çik subverziviteti.

BH: Për çfarë subversiviteti bëhet fjale? E kishe idenë se ku po shkoje dhe çka kërkoje nga jeta?

Frika nga revanshizmi rankoviçian

ShM: Nuk kisha frikë, nëse mendon për këtë. Në Beograd kam qenë disa herë si gjimnazistë, e edhe në paralagjen që quhej Mali Mokri Lug me brigadën rinore që bënte punë vullnetare në ndërtimin e autostradës Vëllazërim-Bashkimi me brigadat, kemi qëndruar aty një muaj gjatë verës së vitit 1963. Që atëherë e kisha përshtypjen se Beogradi është një qyteti modern dhe i emancipuar evropian, që dallonte shumë nga profili provincial dhe i kasabave otomane të Prishtinës apo Prizrenit. Por, në verën e vitit 1996, kur shkova për tu paraqitur për studime, dhe kisha edhe një provim pranues që e kalova lehtë, kuptova se familja kishte edhe një shqetësim tjetër shtesë, madje edhe frikë, për largimin tim në Beograd. Gjatë asaj vere kishte ndodhur tërmeti i madh politik në kreun e shtetit, që do të lë pasoja të mëdha për Zhvillimet në federatë. Në korrik të vitit 1966 në ishullin Brioni, rezidencën verore të Titos në Istria, ishte mbajtur Plenumi i Katërt i Komitetit

Qendror të LKJ, i quajtur pastaj Plenumi i Brionit, në të cilin është larguar nga pushteti Rankoviçi. Arsyeja ishte se policia sekrete që ai e udhëhiqte i kishte përgjuar funksionarët e lartë të shtetit, ndër ta edhe vetë Jozip Broz Titon dhe gruan e tij Jovankën. Por aty Rankoviçit ia shtuan edhe akuzat tjera për deformimin e shërbimeve sekrete dhe veprimin nga pozitat e nacionalizmit serb. Ka qenë goxha termet politik. Numri një i nomenklaturës po e largonte numrin dy të nomenklaturës, dhe kjo ngjarje në atë pjesën e padukshme të ajsbergut të raporteve mes republikave në federatën Jugosllavisë, ndonëse autoriteti i Titos ishte tepër i madh, megjithatë patjetër lexohej jo vetëm si një spastrim për shkak të devijimit nga vija e partisë komunistëve, por edhe si ringjallje, në rrethanat e reja, të konfliktit të vjetër në boshtin e shtetit jugosllav, si konflikt mes një kroati, Titos, dhe një serbi, Rankoviçit.

Prindërit e mi e reflektonin mundësinë e trazimit të Beogradit... I kishin dro shpërthimit të ndonjë revanshizmi nga forcat rankoviçiane dhe nacionaliste serbe, ose nga ndonjë akt individual i hakmarrjes, që mua më dukej pak si teprim ose si një mënyrë dinake e tyre për të mandryshuar mendjen që të mbetem tek studimet e filozofisë. Dhe kjo frikë, gjatë atij viti dhe vitit vijues kishte edhe një burim tjetër, do të thosha, nga aspekti i tyre, më objektiv. Pas rënies së Rankoviçit, Mehmeti, që ishte anëtar i Qeverisë së Kosovës, ishte angazhuar në komisionin krahinor që po hetonte krimet e UDB-së në Kosovë gjatë kohës së Rankoviçit, që përfshinte aksionin e mbledhjes së armëve, presionet për shpërnguljen e shqiptarëve në Turqi, proceset e montuara dhe rastet tjera të dhunës policore. Mehmeti më pat treguar se komisioni po hetonin shumë raste të vrasjeve që i kishte bërë UDB-ja, nëse nuk gaboj rreth 70, pastaj një varg rastesh që konsideroheshin si të dyshimta

por që nuk kishte dëshmi të mjaftueshme, si dhe raste të panumërta të represionit dhe torturave që nuk ishin thjesht tejkalim i kompetencave por shprehje e urrejtjes nacionale dhe, siç vlerësohej zyrtarisht, “veprimtari e maskuar nga pozitat e nacionalizmit serbomadh”. I kishin hyrë arkivave dhe dosjeve, dhe po punonin që sa më shpejtë ta bënin raportin për njerëzit e UDB-së në Kosovë. Ajo që e brengoste Mehmetin ishte se shumica e kuadrove të UDB-së nuk kishin marrë ende dënimin e merituar. Vërtet disa më kryesorët ishin suspenduar ose larguar nga puna, por për të tjerët vazhdonin hetimet. Ata që u përjashtuan kalonin menjëherë në Serbi, shumica në Beograd, pa therrë në këmbë, i përjashtonin vetëm nga partia. Duke i ditur historitë dhe prirjet e tyre kriminale. Mehmeti frikësohej për mua dhe motrat dhe vëllaun, mos po na ndodhte diçka. Netëve që nuk u ktheja në shtëpi deri në ora 23, i shkonte mendja atij dhe Ijës se mos nuk më ka sulmuar ose rrëmbyer ndonjë prej atyre të UDB-së, që po hetoheshin. Një natë, këtë e bëja rrallë, isha vonuar tepër shumë duke qenë në vizitë te një familje me prejardhje nga Rusia që banonte në lagjen Ulpiana të Prishtinës, por që unë i njihja edhe më herët, nga Prizreni. Ishte një prej atyre familjeve fisnike o pasunare të rusëve të Gardës së Bardhë, i thoshim “belogardejci”, që kishin ikur në Jugosllavi nga Rusia pas suksesit të revolucionit bolshevik. Ishte një familje interesante për mua, që kishte përjetuar një tragjedi. Vajze e tyre, e vetmja që kishin, disa vjet më parë kishte bërë vetëvrasje në Prizren, në moshën e re, 14 vjeçare, dhe nuk di pse edhe ky rast hetohej si i dyshimtë në lidhje me krimet e UDB-së. Kjo familje më kishte ftuar për këtë, nëse unë mund të kuptoja diçka më shumë nga Mehmeti, që formalisht nuk ishte në krye të Komisionit, e kryesonte Ali Shukriu si kryetar i Këshillit ekzekutiv të Kosovës, por

praktikisht ishte shefi opertiv dhe buldozheri i hetimeve. Mehmeti ka qenë i njohur për këtë që kur e merrte ndonjë detyrë, sidomos këto të rënda dhe fushatat, i jepte me gjithë forcën që kishte, duke punuar edhe nga 16 ose edhe 18 orë në ditë. Unë në atë kohë isha “rusofil” në kuptimin se lexoja shumë literaturën ruse, sidomos Dostojevskin, Majakovskin, Çehovin, Gogolin, Pasternakun etj., dhe mendoja se nuk kishte letërsi më interesante dhe më cilësore se ajo ruse. Kështu, atë natë, kjo familje ruse, nuk më kujtohet mbiemri i tyre, kishte përgatitur borshq për ushqim, dhe ne bëm muhabet të mirë, flisnin kryesisht ata, kështu që unë ndejta deri nga ora 2 pas mesnatës, në ndërkohë që familja ime më kishte kërkuar gjithandej duke bërë poterë dhe alarmuar të gjithë shokët që kisha.

Atë natë Mehmeti më tregoi sinqerisht pse ishte brengosur. Më tha “Nuk di ti çka janë në gjendje të bëjnë ata”. Me ata mendonte në UDB-ën e deklasuar. Për t’u vetëdijesuar dhe parapëgatitur për qëndrimin në Beograd, Mehmeti ma dha ta lexoj një draft të raportit preliminar të hetimeve me shenjë Tepër rezervat, që e kishte përgatitur komisioni hetues i Këshillit ekzekutiv të Kosovës, kështu atëherë quhej qeveria e Kosovës, si dhe disa nga dosjet tjera, po kështu tepër rezervat mbi krimet e UDB-së në Kosovë që i kishte në çantën e tij. Të nesërmën, kur ia ktheva dokumentat, më tha: “A u binde? Kujdes, pra, se ata mund të na hakmerren për punën që po e bëjmë kundër tyre!”

Si ishte Beogradi në vitin 1966

BH: Çfarë ishin përshtypjet e tua pas leximit? Kishe frikë?

ShM: Të them të drejtën, edhe pse shënimet që i lexova atë natë, - nuk më zyri gjumi deri në mëngjes, - ishin tepër tronditëse, unë nuk pata nxjerë konkludime të frikshme imediate. Nxora një konkludim të përgjithshëm se edhe ky sistem jugosllav, si edhe ai sovjetik, boshtin e fuqisë e kishte te shërbimi sekret, se ishte shtet policor, por paksa i zbutur, me represionin e tipit selektiv, e që në atë kohë po tentonte që të zbutet edhe më shumë. Dhe me që rastet që po hetoheshin ishin kryesisht të viteve '50, e kisha përshtypjen se i takonin më shumë një kohe të shkuar, dhe se në vitin 1966, gjërat kishin ndryshuar. Këtë ndjenjë e pata edhe kur u vendosa në Beograd. Nuk kishte shenja të rezikut. Përkundrazi, Beogradi atëherë ishte një qytet që po hapej ndaj botës dhe jeta aty ishte tepër e sigurtë dhe interesante për një të ri kureshtar çfarë isha unë. Për dallim nga vitet '50 që për një pjesë të studentëve shqiptarë ishin të vështira sepse ataurvejoheshin nga shërbimet sekrete, pas Rankoviçit nuk e kishe më përshtypjen për këtë. Nuk bënte shumë dallim nëse je shqiptar. Po mendoj në aspektin e trajtimit zyrtar, sepse në raportet e përditshme kishte raste të diskriminimit të fshehtë, e ngandonjëherë edhe të hapur. Por, dua të them se atëherë çështja e Rankoviçit, apo e Udbës, nuk ishte diçka që merrej si kërcënim imediat. Unë së shpejti u ballafaqova me policinë sekrete si pjesëtar i një grupi studentësh opozitar, por policia sekrete ishte bërë më e kujdesshme, më selektive dhe më e butë në metodat, nuk mund të bënte më veprime kriminele pa pasoja sepse po krijohesh një opinion i lirë që mund ta kontrollonte, dhe një hapësirë manovruese për

kundërshtarët e regjimit, që p.sh. nëse ndjekeshin në Beograd, mund të lëviznin ose të botonin shkrime në Zagreb ose Lublanë, dhe e kundërta. Pastaj kishte edhe avokatë të guximshëm që mbronin disidentët, e edhe organizatat ndërkombëtare për të drejtat e njeriut në atë kohë filluan të fuqizoheshin, të publikonin raportet që e vinin në siklet shtetin për masat represive. Për burgosjet e studentëve shqiptarë në vitet '50 nuk kishte reagime publike, kurse kur ishte burgosur Arben Xhaferi pas demonstratave të vitit 1969 në Tetovë, me një grup të madhe të organizatorëve të demonstratave të Tetovës në dhjetor të vitit 1968, ndërta më kujtohen emrat e vëllazërve Xhemil dhe Faik Daci, jo vetëm që e ka mbrojtur avokati i njohur Jovan Baroviç, i njohur në atë kohë si mbrotës i disidentëve dhe të rasteve më delikate politike, por reagues edhe studentët e Beogradit. Shërbimet sekrete edhe pas Rankoviçit vazhdonin me metodat e vjetra, p.sh. edhe për vdekjen e Baroviçit disa vjet më vonë ka dyshime serioze se në të vërtetë akcidenti i trafikut në të cilin humbi jetën ishte aranzhuar nga shërbimet sekrete, por ama këtë nuk e bënë më njerëzit e Rankoviçit, por të regjimit që tani kalojë në mënyra më të rafinuara të veprimit, jo ato direkte staliniste.

Sidoqoftë, unë e kisha bindjen se njerëzit e Rankoviçit në atë kohë nuk ishin më në gjendje që të bënin asgjë kundër sistemit, të paktën jo në mënyrë të hapur. Ata nuk kishin ndikim të hetueshëm në opinion. Për më shumë, në kohën kur fillova studimet në Beograd, në jetën e përditshme, si dhe në atë publike, as që flitej shumë për Rankoviçin, e edhe më pak për ndonjë kërcënim të mundshëm nga UDB-ja, që për pasojë do të kishte përkeqësimin e raporteve ndëretnike. Për rastin e Rankoviçit Serbisë iu është dashur një inkubim më i gjatë i virusit të

dyshimit. Atje ende ishte car Titoja, dhe nuk kishte fare gjasa për ndonjë rebelim imediat.

Virusat e nacionalizmave shkatërrues

BH: Ky virus nga erdhi?

ShM: Një katalizator i zgjimit më të artikulluar të nacionalizmit serb kanë qenë ngjarjet në Kroaci, i ashtuquajhuri “Maspok” i fillimit të ’70, dhe vlimet e ngjashme në Slloveni, ku në këto republika edhe nomenklatura komuniste kërkonte më shumë pavarësi nga qendra, Beogradi, dhe këtë filluan ta bëjnë hapur, sidomos në Kroaci, duke mobilizuar masat, besimtarët kayolikë, por edhe ppunëtorët, studentët... Atëherë, krahas nacionalistëve kroatë, do të paraqitën në publik edhe disa nga kampionët e nacionalizmit serbomadhi, që do të janë shumë aktivë edhe pas 20 vjetëve, ku në krye ishin shkrimtarët Dobrica Qosiç, Matija Beqkoviç, Moma Kapor etj.. Më kujtohet p.sh. Brana Crnçeviçi, një shkrimtarë i komedive të lehta, i cili ndaj propagandës të mediave nacionaliste kroate, përgjigjej me kundërpropagandë nacionaliste serbe. E mbaj në mend një titull bombastik në gazetën “Jezh” të Beogradit (“Iriqi”, gazetë humori, që u shndërrua në humor të zi dhe zëdhënës të politikës antikroate) që sulmonte ashpër gazetën javore VUS, ose Vjesnik u srijedu, nga Zagrebi, me një titull që kishte plot aluzione dhe akuza të rënda: “A VUS-TAŠE NA NOGE USTAŠE!”, që kuptimin e drejtë e kishte se “E tani edhe ata të VUS-it u ngritën në këmbë” por që në kuptimin e zhdrejtë, falë lojës së fjalëve, merrte kuptimin se “Ustashët u ngritën në këmbë!” Jezhi kështu akuzonte një gazetë që ishte organ zyrtar i Kroacisë se është gazetë ustashe, pra se në Kroaci

po ringjallej organizata famkeqe ekstreme dhe fashiste e cila në Luftën e Dytë Botërore e kishte krijuar shtetin e pavarur kroat.

Mirëpo, mendoj se virusi më akcelerues i nacionalizmit serb, i cili do të tregohet vdekjeprurës për Jugosllavinë, ka qenë në reagimet ndaj aprovimit të Kushtetutës të vitit 1974, kur Titoja dhe dora e djathtë e tij, Edvard Kardeli, një komunist slloven me prirje që të jetë ideolog dhe strateg teorik i Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë, patën shpikur një model të avancuar të decentralizimit, që sipas tyre paraqiste kompromis mes aspiratave të avancuara të Zagrebit dhe Lublanes për vetëqeverisje sa më të gjërë, dhe që njëkohësisht të rruhet edhe një instancë e pushtetit integruar qendror përmes ushtrisë së përbashkët, që do të ishte garancë se të gjithë serbët do të jetojnë në një shtet dhe s'do të ketë nevojë që të hapet çështja serbe. Kjo llogari e Titos dhe Kardelit nuk doli e saktë.

Gjashtëdhjetë e teta

Demonstratat e studentëve në Beograd

BH: E pate përmend më herët '68-shin. Më interesojnë vitet e para të studimeve tua. Si të zuri “revolucionin” i '68-ës. Të zunë edhe demonstratat e '68 që u organizuan në Kosovë. Një shqiptar i gjendur në këto “revolucione” si dukej.

ShM: Nuk ishin revolucione, ishin protesta, demonstrata. Për ato të Kosovës nuk di shumë, nuk kam qenë në Prishtinë, dhe nuk kam marrë pjesë në asnjë mënyrë. Kurse ato të Beogradit nuk kishin të bëjnë me shqiptarët. Edhe pse ka pasur mendime, ndoshta edhe sot mund të aktualizohen, se Kosova ka qenë shkas për demonstratat e Beogradit, se ato janë organizuar sipas një skenari antikosovar. Të paktën, kështu mendohej në Kosovë, e kam dëgjuar edhe vetë këtë interpretim gjatë verës së vitit 1968 në Prishtinë nga djali i dajës Valbon Stavileci dhe disa miq të tij. Ata thoshin se demonstratat e studentëve në Beograd i kishte organizuar Dobrica Qosiqi, pasi që një javë më parë ishte përjashtuar nga Komiteti Qendror i Lidhjes së Komunistëve të Serbisë, për shkak se kishte kritikuar ashpër avancimin e autonomisë së Kosovës dhe nisjen e procesit që ai parashihte se po e çon Serbinë pashmangshëm drejt humbjes së Kosovës. Unë që kisha ardhur nga ato demon-

strata u thosha se kjo s'ka lidhje, se kërkesat e studentëve kanë qenë tjera, në asnjë pikë nuk kanë qenë të lidhura me Qosiqin dhe Kosovën.

Por, nuk mund t'i bindja, sepse vërtet ato dy ngjarje kishin ndodh shumë afër, dhe unë në atë bisedë nuk mund të dëshmoja se cili ka qenë shkaku i demonstratave, kush dhe si e ndezi fitilin. Ata thoshin, kjo është kyçe, që pas Rankoviçit u largua edhe Qosiqi, si njeriu i tij, dhe Serbia me këto demonstrata reagoi kundër Titos, ndoshta jo më mënyrë të hapur, por ashtu që uji i vadës të shkojë në mullirin e Serbisë dhe jo të Kosovës.

Vërtet, për fillimin e demonstratave nuk mund të dëshmoj, sepse natën e 2 qershorit unë kam qenë në konviktin “Rifat Burxheviç”, në një lagje lindore të Beogradi, larg Qytetit të Studentëve që është në Beogradin e ri, në Perëndim, ku kishin shpërthyer demonstratat. Unë atë natë kisha mësuar deri vonë për provimet dhe nuk dija se çka po ndodh, dhe vetëm në mëngjes më kishte zgjuar Gafur Kiseri, unë atëherë banoja përkohësisht si “ilegal” në dhomën e tij, sepse e kisha lëshuar dhomën time private që e paguaja me qira; Gafuri po më thoshte: “Qu se po kallet Studentski gradi! Policia i ka bo lesh studentët. Po thonë se do të shpallet greva e përgjithshme e Universitetit!” Kuptohet, ai e tha në turqisht, sepse ne mes veti kryesisht komunikonim si kasabali. Unë e parandjeva saktë se çka do të ndodhte sepse kohë më parë kanë qenë demonstratat e studentëve në SHBA, Gjermani, Poloni dhe në Francë, dhe ne i përcillnim në detaje dhe organizonim aksione të ngjashme të solidaritetit. U veshja shpejt dhe u nisa për në Beograd të ri, të shoh për së afërmi se çka po ndodh, por rrugës në tramvaj morra vesh prej udhëtarëve që kishin kaluar andej se qarkullimi me Beogradin e ri ishte bllokuar pas përleshjeve që kishte pas natën, se ka pas shumë

të burgosur dhe të lënduar dhe se të gjitha urat po kontrolloheshin nga policia. Andaj ndërrova drejtimin dhe u nisa në Fakuletin tim, në Godinën e Kapetan Mishës, ku atëherë ishte Fakulteti Filozofik, dhe në pjesën ballore të tij Rektorati i Univerzitetit. Atje i gjeta disa nga shokët e grupit tim, që prej 9 dhjetorit të vitit 1966, vepronim si një grup radikalësh që organizonte protesta të ndryshme.

Demonstratat kundër luftës në Vijetnam

BH: Grup radikal, më 1966?

ShM: Nuk ishte formuar më 1966, por u inicua atëherë. Në vitin 1966, në dhjetor, pra unë sapo kisha filluar studimet, janë organizuar demonstratat kundër luftës në Vijetnam, kundër politikës amerikane. Filluan si një protest e zakonshme, ishim mbledhur në sallën e Heronjëve të Fakultetit Filologjik nja 1000 studentë, u mbajtën fjalimet, brohorisnim në përkrahje të luftës çlirimtare të vijetnamezëve dhe kundër imperializmit amerikan pa asnjë referencë kritike ndaj çështjeve të brendshme të Jugosllavisë, dhe në përfundim të mitingut, me sa më kujtohet, organizatorët nuk bën apel që demonstrata të vazhdojë edhe rrugëve të Beogradit. Por ndodhi diçka që më befasoj dhe zemëroj shumë, besoj edhe të tjerët. Masa që u derdhte jashtë nga ndërtesa e fakultetit në Sheshin e Studentëve, u zu e befasuar nga një sulm i papritur dhe tepër i ashpër i policisë, e cila i kishte vendosur disa autobusa dhe trolejbusa në mes të rrugës për të shpërndarë masën në disa grupe, dhe kur kaloje matanë tyre në hapësirën jo edhe aq të gjerë të atij sheshi, të prisnin kordonet e policisë që pa një pa dy i rrahnin pamëshirshëm studentët me pendreka, shkopinj të gomës! Duke qenë ndër radhët e

parë të atyre që dilnin, dhe duke mos parë prej atyre që ishin përpara dhe bllokadave të autobusëve, unë deri në momentin e fundit as që kisha idenë se po na sulmonin, dhe policin që e kishte ngritur shkopin e vëreja vetëm në sekondën kur ata që ishin para meje po tentonin t'i mbronin kokat me duar dhe po iknin majatas dhe djathtas, disa prej tyre duke zënë thua dhe duke rënë në asfaltë, kurse ai shkopi që më doli para syve, dhe një serrat si prej fashisti gjakëpirës, më qëlluj me gjithë forcë në lulë të kafkës që për disa çaste më terroi gjithçka para syve. S'di si ia arrita që të shmang goditjen e dytë dhe të futem në rrugicën e parë që kthehet djathtas dhe del në rrugën Knez Mihailova, ku nja 100 metra më larg ishte Qendra kulturore dhe informative amerikane, të cilën e mbronin policët. Duke u futur andej pash nja dy tre student që kishin rra në tokë dhe rreth tyre nga tre apo katër policë që i mëshonin me shkopa ose këmbë, si të çmendur. Rrugica ku isha futur edhe nga ana tjetër ishte e bllokuar nga policia, për më shumë atu kishin dalë edhe policët me kuaj, dhe edhe ata po i mëshonin çdokujt që tentonte t'i afrohej Qendrës amerikane. Aty para syve të mi e pash se si një polic mbi kalë tentoi ta godiste një studente me shkop gome, por kali u step para vajzës dhe ajo vetëm sa u grith dhe frikësua, kurse polici rra në asfalt, ashtu si një kungull, na dukej se theu qafën se nuk lëvizte më vendit!

Atë ditë, kur i pash ato fytyra fashiste të policëve, i bindur se nuk i patëm provokuar, u bëra kundërshtar i regjimit. Deri atëherë dyshoja, por atëherë u binda, dhe për nja një muaj e kisha në maje të kokës një të ajur që ishte si topi i ping-pongut dhe që ma përkujtonte vazhdimisht se kisha kaluar inicimin për tu bërë rebel! Ne atëherë, ai grupi në atë rrugicën që përmenda, arritëm që të ktheheshim dhe të bënim një

rreth të madhe nga ana e Kalemegdanit për të shkuar, me grupe tjera që bashkoheshin në një kolonë, drejt ambasadës amerikane, që ishte në Bulevardin e Knjaz Miloshit, shumë pranë ambasadës së Shqipërisë. Pasi që policia nuk na lejonte që t'i afrohemi ambasadës amerikane, ne demonstruesit u sorollatëm edhe pak rrugëve të Beogradit, pranë ndërtesës së shtatmadhorisë së armatës jugosllave brohoritëm “Vojska s nama” (“Ushtria me ne”), që të nesërmen në raportet e policisë dërguar organizatës së studentëve ishte shndërruar në “Vojska spava!” (“Ushtria po fle!”), që mua do të më irritonte edhe më shumë sepse kuptova se regjimi jo që ishte brutal dhe i pamëshirshëm ndaj një proteste që neve na dukej e arsyeshme dhe e domosdoshme, por edhe gënjeshtare sepse një brohoritje që thjesht kërkonte solidarizimin e ushtrisë në protestën ndaj imperializmit amerikan, e kishte shndërruar në parullë subverzive “ushtria po flet!”, sikur ne atëherë po kërkonim grushtet, çka në atë moment nuk ishte e saktë.

Ajo që na zemëronte pa masë ishte dyfytërsia e qeverisë jugosllave, e cila deklarohet kundër luftës së Vietnamit, por njëkohësisht luftonte për statusin e tregtisë së privilegjuar me SHBA-të, ose ndonjë favor tjetër, nuk më kujtohet saktësisht, për çka edhe supozohej se kishte reaguar aq ashpër ndaj protestës së studentëve.

Angazhimi në grupin anarho-liberal

Sidoqoftë, të nesërmen në fakultet themeluan një këshillë joformal të studentëve për shqyrtimin e represionit të policisë, dhe aty qëllova dhe unë. Ajo vajza që kishte pasur prekje të afërt me kalin e trembur që nuk sulmonte njerëzit, kishte qëlluar të jetë e dashura e Vllada Mijanoviçit. Aty unë njoha edhe disa studentë më të moshuar, unë

ende ish brucosh, këta kanë qenë Vllada Mijanoviç, Bozhidar Borjan, Millan Llalliq, Millosh Vasiqi dhe disa të tjerë, që i kam harruar edhe me emër e edhe si fytyra. Ky i fundit, Vasiqi, ka qenë rekrutuesi im për inkuadrim në grupin që po formohej. E thash më parë se nuk kemi qenë të strukturuar, s’kishim emër dhe funksione, por ishim të vendosur që të vazhdonim protestat kundër luftës në Vietnam dhe ne ashtu spontanisht, filluam të organizonim protesta publike dhe aksione të solidarizimit me studentët e Gjermanisë, të Francës, të Polonisë, për lirimin e kompozitorit grek Mikis Teodorakis, që e kishte burgosur hunta e Patakosit, organizuam mitingun e përkujtimit të Çe Gevarës që ishte vrarë nga CIA, etj. Si grup që ishim as që na shkonte mendja të organizoheshim si parti në vete, ideja jonë ishte vetëm korrigjimi i revolucionit jugosllav.

BH: Si ndodhi “rekrutimi” që e përmende?

ShM: Fakulteti filozofik ka pasur një oborr të mrekullueshëm të mbyllur, ku kalonim shumë kohë, dhe një ditë më është afruar Millosh Vasiqi, (që më vonë është bërë gazetar i njohur dhe i guximshëm në javoren Vreme) me të cilin kisha zënë muhabet që nga ditët e para të studimeve, edhe pse ishte një gjeneratë para meje. Miloshi m’u drejtua me një zë të ulët duke shikuar përreth mos po dëgjon dikush: “Ti, Zeni, – ashtu më quanin – ke një surrat konspirativ. Duam të bëjmë një grup kundër këtij regjimi që po degjenerohet, dhe unë kam mendimin se ti e ke vendin në këtë grup.” Nuk e kundërshtova, e pranova me kënaqësi, dhe më bëri përshtypje sidomos cilësimi se paskam “surrat konspirativ”, më dukej si një kualifikim për punë revolucionare. Dhe vërtet ky grupi ynë ka qenë shuma aktiv gjatë vitit 1967 dhe pranvera e vitit 1968, duke qenë korrent me protestat studentore në botë, por edhe

reaguar pqa vonesë ndaj zhvillimeve aktuale në vend. Kështu që kur ndodhi ai shpërthimi i vitit 1968 në Qytetin e Studentëve në Beogradin e ri, që ne nuk e kishim organizuar, as e kemi pritur që të ndodhte në atë kohë, ne e kishim një organizim i gatshëm që do ta shfrytëzonte ngjarjen për t'u imponuar si liderët e protestës ose të paktën faktor më radikal "vetëdijesues". Në të vërtetë, disa javë më parë me disa profesorë disidentë antititistë të Fakultetit Filozofik grupi ynë ka pas konsulta gjatë një pikniku në malin Avalla, rreth strategjisë së lëvizjes dhe mënyrës se si presioni ndaj pushtetit të bëhej më efikas. Unë nuk isha në atë piknik, por më kishte treguar Mijanoviçi, se vjeshta do të jetë "e ngjeshur me ngjarje". Një konkluzë provizore ka qenë se me fillimin e vitit të ri shkollor, sepse atëherë ishte muaji maj dhe ishin shumë afër provimet, do të provonim organizimin e një proteste o greve më masive të studentëve, si ato që kishin ndodhur në Francë apo Poloni, për të ndryshuar kahjen e zhvillimeve në Jugosllavi, që neve na dukej se po devijonte drejt diferencave të mëdha sociale, ekonomisë së tregut dhe kapitalizmit. Konsideronim se Jugosllavia me reformën ekonomike, që kishte filluar të fuste elemente të ekonomisë së tregut dhe të konkurrencës, po rrëshqiste drejt restaurimit të kapitalizmit. E përmenda edhe më herët se ne titistët i quanim "borgjezi e kuqe"

BH: Vërtet paskeni qenë mjaftë dogmat. Po më tingëllon sikur një enverizëm, por nga Beogradi...

ShM: Për dogmat, po kemi qenë, por jo edhe enverista, sepse nuk e pëlqenim as stalinizmin...

Demonstratat e vitit 1968

BH: Po më intereson rrjedha e vetë demonstratave. Si u zhvilluan demonstratat e 1968-shit në Beograd dhe sa zgjatën?

ShM: Zgjatën një javë. Ishte ngjarje fantastike, gati delirike, e stërdendur si kohë. Më vonë kam parë një film amerikan “Luleshtrydhe dhe gjak” (*The Strawberry Statement*, i realizuar më 1970) që e ka për temë protestat e studentëve në SHBA kundër luftës në Vietnam, që përafërsisht ilustronte edhe atmosferën në univerzitetin e Beogradit, të cilin ne studentët e patëm riemëruar në Universitet të Lirë “Karl Marx”. Qendra e protestës ishte fakulteti ynë. Me 3 qershor grupi ynë menjëherë u kyç si forca më e organizuar dhe më radikale në formulimin e kërkesave të grevës. Ishin disa këshilla, një i fakultetit, që ishte shumë aktivë dhe e bëri oborrin e fakultetit tonë, ndoshta pse aty ishte edhe Rektorati, skenë qendrore të protestës, ku mbaheshin tubimet kryesore. Dhe ishte edhe Këshilli i përgjithshëm grevistë si një zgjërimit i Kryesisë së Organizatës së studentëve të UB, që bashkëpunonte edhe me organet e univerzitetit. Unë isha i ri, nuk u përfshiva në këta këshilla, por grupi ynë njeфарëdore kishte organizim të veçantë dhe mbanim lidhje me profesorat tanë, dhe përcjellnim me kujdes në çfarë drejtimi zhvilloheshin negociatat me pushtetin, duke mbajtur vijën më radikale të kërkesave. Ditën e parë mua më angazhuan në punët e logjistikës dhe organizimin e tubimeve gjatë ditës dhe të tubimit qendror në mbrëmje, që zakonisht fillonte pas ditarit kryesor në Televizionin e Beogradit. Ditari ishte në 7,30 të mbrëmjes, dhe pasi që dëgjonim se çka është thënë për demonstratat dhe kërkesat e studentëve, fillonte mitingu të cilët zakonisht e moderonte Dragolub Miqunoviçi (së voni

ka qenë Kryetar i Kuvendit të Jugosllavisë i zgjedhur nga lista e DOS-it), që në atë kohë ishte asistent në filozofi, i shakthtë dhe elokuent në komentimin dhe përqeshjen e shkrimeve të gazetave dhe raporteve të televizionit. Dhe kur mbaronin fjalimet dhe komentet, aty edhe aprovonim ndonjë kërkesë o vendim special për grevën, fillonte programi i përkrahjeve nga profesorët dhe personalitetet e njohura, shkrimtarë, artistë, regjisorë, këngëtarë, muzicentë, që edhe performonin programe të ndryshme, aktronin ose këndonin, ose lexonin poezi dhe prozë.

BH: Ishin improvizime, apo përkrahje e hapur me platformë opozitare?

Sh.M: Po sigurisht se ngjarja ishte politike, por jo edhe opozitare në kuptimin e sotëm. Aty nuk flitej kundër komunizmit. Gabimet dhe devijimet përmendeshin, por nuk sulmohej sistemi. Prej gjithë atyre personaliteteve emrave kishim më shumë përkrahje morale... Një paraqitje që mbahej në mend ka qenë ajo e aktorit slloven Stevo Zhigon, por që luante në skenat e Beogradit, i cili para studentëve aktroi monologun nga “Vdekja e Marasë” të Bruknerit... Dhe vinin edhe aktorët tjerë, yjet e filmit jugosllav, shkrimtar me famë, solo këngëtare, ose dërgonin letra dhe telegrame urimi dhe solidarizimi, kështu që ato mbramjet zgjatnin dhe shndërroheshin në programe shumë cilësore artistike. Dhe më pastaj, kur i përcillnim këta mysafir të çmuar, një pjesë e studentëve që rrinim në fakultet tërë natën, i mbyllnim të gjitha portat e godinës, që ishin klasike, goxha të mëdha, dhe aty në oborrin e bukur të rektoratit bënim ahengje të zgjatura. Ushqim kishim boll sepse na vinte me thasë nga qytetarët: sendviqa, qumësht, jogurt, pashteta, ëmbëlsira, e bile kishim edhe birra dhe venë, ose edhe ndonjë pije më

të fortë. Unë pata blerë konjak shqiptar, që në atë kohë sihitej në Beograd, ishte i lirë dhe pëlqehesh shumë. Ishte shumë më cilësor se konjakët që atëherë prodhoheshin në Jugosllavi. Në atriumin e ndërtesës së rektoratit ishte një piano dhe ne studentët mblidheshim rreth tij, zakonisht pianos i binte Dragan Minderoviçi, një pianist i shkëlqyer, dhe njeri tepër i mirë, kemi qenë shok të ngushtë. Pogramin e fillonim zakonisht me këndimin e një himni që ishte komponuar për nder të protestës, më kujtohet vetëm refreni “Leva, leva, leva...” (E majta, e majta, e majta...), dhe atëherë vazhdonim me këngën “Bandiera rosa” që ne e këndonim edhe në variantin anarhist duke e thënë si “Bandiera nera” dhe e përfundonim me vargun “Viva l’anarchismo et la liberta!”. E këndonim edhe një këngë të partizanëve italian “Ciao bella...”, dhe pastaj kalonim te Bitëlsat, “Yellov submarin”, dhe kështu nuk na zinte gjumi deri në mëngjes... Unë vetë gjatë asaj jave kam qenë si në trans, dhe kam fjetur për ato shtat ditë gjithsejt vetëm nja 10 deri 12 orë. Një natë tek shkallët e rektoratit, pata fjetur vetëm nja dy apo tre orë, isha shtrirë në tepihun e pushimores së shkallëve, dhe shkallën e parë e kisha shfrytëzuar si mbështetje për kokën. Një shoqe më tregoj pastaj se kisha fjetur me një gjumë të thellë si qengj, që serbët i thonë “kao zaklan” (një shprehje e tmerrshme që ka kuptimin “i fjetur si i prerë në fyt!”), dhe se më kishte puthur. Një natë tjetër kisha shkuar në konviktin Rifat Burxheviç, diku pas mesnatës, te Gafur Kiseri, por jam zgjuar në ora 5 të mëngjesit dhe menjëherë jam kthyer në fakultet, ku më prisnin detyrat. Gafuri ishte çuditur kur ishte zgjuar në mëngjes që kisha ikur aq herët. Po kështu një pasdite më pat ftuar kolegu i klasës dhe poeti Millan Llalliq në lagjen Bezhanja, të hanim fasule tek shtëpia e tij, dhe aty po kështu pas drekës më kishte zënë gjumi i thellë për dy

orë, dhe kur u zgjova, e lash poetin që të pushojë, kurse unë u ktheva menjëherë në fakultet, jo vetëm për mitingun e radhës, por edhe sepse atë natë ishte finalja e kampionatit evropian në futboll, luanin Italia me Jugosllavinë në Romë, dhe unë isha fan i futbollit, e kisha aranzhuar ta shikoja meçin tek një shofer që banonte në bodrumin e fakultetit, ku çdo natë dy studentë kujdestarë shikonin lajmet e ditës dhe të mbrëmjes dhe raportnin tek Këshilli i grevës se çfarë është thënë në tv për grevën. Për atë ditë raportues ishim unë dhe Petar Zhivadinoviçi, po ai që në vitin 1982 do të polemizonte me Idriz Ajetin për prejardhjen ilire apo trakase të shqiptarëve. Me te isha marrë vesh që pas lajmëve ta “tradhëtonim” pak “revolucionin” dhe ta shikonim finalen. Nuk më kujtohet sot a ka qenë kjo loja e parë e finales që përfundoi me barazim, apo loja e dyta, që e fitoi Italia, sepse atëherë rregulli ishte se nëse loja e parë përfundonte ne barazim nuk kishte ekzekutim të penaltive, por luhej edhe një ndeshje nga fillimi, pas dy ditësh.

Çka kërkonin studentët?

BH: Po kërkesat e demonstratave çfarë kanë qenë?

ShM: Të them të drejtën nuk më kujtohen saktësisht. Për këtë gjë sikur kam një amnezi, nuk do të mund të përgjigjesha me një formulim të saktë. Për shembull, demonstratat që ndodhën në Kosovë po atë vit në nëntor, edhe pse kanë qenë shpërthim spontan dhe njëqelizor, atyre mund t’ia përcaktoj më qartë kërkesën dhe kuptimin. Kosovarët, një pjesë e tyre, kanë kërkuar më shumë autonomi, që Kosova të bëhet e barabartë në Jugosllavi dhe për disa qëllimi ka qenë bashkimi me Shqipërinë. Kurse, unë për vete pa i shikuar dokumentet e asaj kohe,

nuk mund të them se cili ka qenë qëllimi kryesor i demonstratave të Beogradit, pos se kërkonim ndryshime dhe korrigjimin e kursit të revolucionit... Por, kjo që unë më parë përmenda pjesën festive, se ne po kalonim atje mirë, si në një heppening i hareshëm, vërtet ka qenë një përjetim i thellë, krahas të cilit me kohë është zbehur qëllimi i gjithë asaj, ndoshta sepse në ndërkohë për vetën pata filluar të dyshoj dhe të ndryshoj qëndrimet. Por, ne jse, për këtë mund të flas pak më vonë, kurse tash do të kthehesha në pjesën e aktiviteteve, se në grevë ne kishim edhe role dhe detyra të ndryshme, si kjo që përmenda se dikush duhej të dëgjonte lajmet. P.sh. unë kam qenë për nja dy ditë, diku nga fundi i demonstratave, njeriu i kontakteve të Fakultetit filozofik, që një kohë të madhe e kaloja në Fakultetin e Dramës, që atëherë ishte në një ndërtesë afër, në rrugën Knez Mihalova. Unë aty kujdestaroja pranë telefonit dhe përcillja ose merrja informatat e këshillave grevistë, atij qendror dhe të fakulteteve, kjo për arsye se në Fakultetin filozofik policia kishte ndërprerë lidhjet telefonike kurse në atë të Dramës telefonat punonin. Unë, pra, qëndroja te telefoni, dhe i kisha pranë korrierin ose korireren kujdestarë që lëvizte andej këndeje me pusulla lajmesh, kërkesash dhe porosish të ndryshme.

Kurse, ditët e para kam punuar në logjistikë tek një shaptilograf, ku shumëzoni afishet dhe dokumentet. Ishte ky shaptilograf i skriptorës së fakultetit që e mbante një hajgarexhi, e kishte emrin Steva, dhe ishte i njohur me atë që imitonte dhe improvizonte në mënyrë perfekte fjali- met e Titos. Nuk e bënte këto falas, por kërkonte shpërblim, 5 dinarë ose sipas disponimit. Aq mirë e imitonte sa që ne në fakultet Titon filluam ta thërrisnim me emrin e këtij Stevës, kurse gruan e tij e quanim – Angja. Kur p.sh. e shihnim në sallat e ndryshme bustet e Titos në

bronzë apo gips, bërtisnim “Ja Steva në bronzë” e më bukur dhe me dy kuptime tingëllonte “Steva në gips!”, përkatësisht “Steva në alqi!” Kemi pas shumë këngë dhe barcoleta për Stevën dhe Angjën. Por ai Steva i vërtetë përgatiste skriptat për studentët të lëndëve të ndryshme, dhe merrej me stërshitjen e librave antikuarë. Mua më donte shumë dhe më ofronte librat me lirim, e ndonjë edhe falas. Me përgatitje ishte historian dhe shpesh më thoshte me gjysmë shaka, duke e bërë zërin si të Titos: “Ju shqiptarët jeni fukara dhe budallenj pse nuk thoni se pushtuesi më i madh në histori, Aleksandri, ka qenë ilir, përkatësisht shqiptar. E mbase shqiptar ka qenë edhe mësuesi i tij, filozofi më i madh i të gjitha kohërave, Aristoteli!” Steva pat vdekur tragjikisht pas disa vjetësh, e kishte shkel makina duke e kapërcyer në këmbë autostradën që përshkon Beogradin e ri.

Paraburgimi

Sidoqoftë, gjatë demonstratave në atë skriptori shumëzoni materialet dhe proklamatat, dhe pastaj edhe i shpërndanim nëpër rrugët e Beogradit. Këtë po ta tregoj se aty pata një përjetim interesant dhe një moment të rrezikshëm, por që në fund doli pa pasoja. Në mëngjesin e 4 qershorit, ishte diku ora 6 ose 6,30 e mëngjezit, milicia më pat burgosur deri sa po shpërndaja afishat, te po ai Shesh i studentëve, ku dy vjet më parë e pata përleshjen e parë me organet e rendit që ma lënë një gungë në majën e kokës. Në të vërtetë unë e kisha bërë një rreth të madh rreth fakultetit, duke i shpërndarë me qindra afisha që informonin qytetarët për qëllimin e protestës, me kërkesat që kishim dhe apeli tek qytetarët që të na bashkoheshin ose të japin përkrahje politike, morale dhe kontribute tjera (ushqim, batanije, veshmbathje...). Ishte mëngjezi kur

kishte shumë lëvizje njerëzish që nguteshin në punë, atëherë punohej nga ora 7 e mëngjesit, ose të atyre që kishin dalë në rrugë dhe rrinin afër kordonit të policisë që kishte rrethuar fakultetin, dhe shikonin se çka po ndodh, si kureshtar që i brengoste ose mrrekulonte protesta. Dhe kur po përgatitesha që të kthehem në fakultet, sepse kisha shpërndarë me qindra afishe, një polic trupshkurt dhe trashalluc mu afrua dhe mi shtrëngoj duart. “Ndal, çka bënë ashtu!” Unë i thash: “Jam student i dërguar nga Këshilli grevist. Po shpërndaj informata për qytetarët.” “Nuk bëni mirë. Nuk keni drejt të shqetësoni qytetarët!”, më tha milici dhe ftoi dhe një tjetër që ishte afër: “Shko merre një makinë, ky djalosh do të burgoset për kundërvajtje! Djalosh, je i burgosur!” Ai më shtrëngoj edhe më fortë, kështu që mua më ranë nga dora në trotuar afisheet që më kishin mbetur. Polici reagoi me zë të lartë: “Ç’bënë ashtu! Mbledhe atë pleh që gjuajte, do të na duhet si provë”. Unë u pata lakuar që ti mbledh afisheet, por në çast u bëra pishman. Ç’më duhet ti bindem urdhërave të këtij arroganti! Ai u skuq në futur nga zemërimi pse nuk e dëgjova dhe filloi të më bërtiste dhe grushtonte. E ftoi sërish kolegun që të ngutet me makinën. Unë me një dorë mbrohësia nga goditjet e tij, kurse nën sjetull shikoja murin që ndante Sheshin e Studentëve nga Parku i Studentëve, që ishte aty fare pranë, nja dy ose tre hapa prej vendit ku isha ndaluar nga milici. Në çast më shkrepri ideja se do të mund të provoja të shkëputesha dhe ta kapërceja atë mur, në mënyrë që t’u shpëtoja burgosjes dhe, ndoshta, rrahjes në stacionin e policisë. Dhe në një moment vërtet u shkëputa nga ai dhe me dy tre hapa arrita te muri dhe kërceva mbi te...

Dhe këtu duhet të ndalem në tregimin e kësaj storie, për të marrë fryme dhe kërkuar që të imagjinosh diçka të jashtëzakonshme që më

ka ndodhur në atë moment, një befasi kulmore çfarë nuk kam përjetuar në jetë. Kur u ngjita si atlet mbi murin dhe me gjysmën e trupit isha matanë dhe më duhej vetëm edhe pak mund ta kapërceja murin dhe të hidhesha në hapësirën e parkut, mu paraqit një pikturë e pabesueshme blu. Kopshti ishte i mbushur më qindra policë, disa të ulur në banka, disa rinin në këmbë, disa ishin shtrirë në barin e gjelbërt... Ishte si një kosh i bletëve të kaltërta. Qindra policë më «prisnin» andej ku unë e kërkoja shpëtimin. Gati që nuk plasa gazit! Por, jo, u ndala, duke përjetuar një gjendje të çuditshme të eksitimit dhe të qetësisë njëkohësisht. U ula me ngadalë poshtë, dhe iu dorëzova krejtësisht i qetë policit trashallucë që ishte xhindosur shumë nga sjellja ime, dha tani që më kishte kapur sërish, po më godiste edhe më fortë me grushta. Ai me kolegun e tij i kishin mbledhur afishet, më futën në një makinë Fiat 1400. Trashalluci insistonte që të ishte përcjellës i imi deri në stacionin e paraburgimit që ndodhej në rrugën që qonte nga Dunav stacioni, që nuk ishte fort larg nga qendra. Polici më shante gjithë kohën dhe më rrihte pa ndërprerë, me ca goditje të çuditshme, të ushtruara, që kur e qëllonte trupin, e dredhte disi grushtin. Supozoja që “taktika” ishte që të shkaktonte dhembje, por të lënte sa më pak shenja në trup. Gjatë asaj vozitjeje që nuk zgjati shumë, nja 10 minuta, unë nuk e kisha sikletin e goditjeve, e mbroja sa ishte e mundshme kokën, që edhe nuk ishte vështirë sepse në ulëset e prapme të makinës ai nuk kishte hapësirë që të lëvizte grushtin për goditje më të sërta. Hallin e kisha që në ulësen nga ana e majtë e ime ishte një pistoletë e markës Beretta; e njoha sepse e kishim në shtëpi një të tillë. Për këtë Berettë nuk isha i sigurtë si u gjind aty, a ishte thjesht një pakujdesi dhe harresë, apo ndonjë provokim dhe montim i poshtër, për të inskenuar çka di unë çfarë marifeti, akuzë për tentim sulmi të

armatosur në policinë, apo edhe likvidim timin! Nuk mund të them se nuk u pata frikësuar, më shkonte mendja në skenaret e ndryshme që kisha lexuar se i bënë policia totalitare, prandaj isha i lumtur që ai vetëm më godiste dhe nuk e vërente pistoletën. U lehtësova dhe morra frymë thellë vetëm kur arritëm në stacion, ku ai ndërpreu grushtimin dhe më dorëzoi tek një dhomë që dukej si kafaz jo edhe aq i madh 3 me 4 metra, ku para meje i kishin futur nja 10 veta të tjerë, kryesisht studentë grevistë, në mes të tyre edhe disa kolegë që i njihja, si dhe dy a tri prostituta.

BH: Sa zgjati paraburgimi?

ShM: Deri në mbrëmje nga ora 7 kur më pat marrë në pyetje një gjykatës për kundërvajtje. Ata kolegët e mi studentë i patën lëshuar më herët, vetëm u kontrolluan dokumentet dhe morën disa shënime, kurse mua më ndalen sepse nuk kisha me vete letërnjoftimin, e më vonë e kuptova te gjykatësi se polici që më kishte rrahur, e kishte bërë padinë se kinse e kisha goditur atë mizorisht në këmbë gjatë tentimit të arratisjes pasi që isha arrestuar për shqetësimin e qytetarëve. Për këtë kam prit deri në mbrëmje së bashku me ato prostitutat në një si korridor të gjerë. Mua më dënuan me 10 ditë burgim, por më lëshuan në mbrëmje sepse e kisha të drejtën e ankesës.

BH: A u ankove?

ShM: Jo

BH: I mbajte 10 ditë burg?

ShM: Jo.

BH: Nuk të kërkuan më?

ShM: Erdhën pas nja dy muajve dy policë te dera e shtëpisë në Prishtinë, deri sa isha në pushimet verore të universitetit, me kërkesën e policisë të Beogradit vetëm për verifikim nëse unë banoja në adresën që kisha dhënë gjatë marrjes në pyetje. Më pas nuk më kanë trazuar.

Bisedat informative në polici

BH: Ke qenë edhe herave tjera i burgosur dhe i dënuar?

ShM: Jo. Kam qenë vetëm në biseda informative. Më patën ftuar dy herë në njësinë hetimore të Burgut Qendror në Beograd te njëfarë inspektori Panteliq, që ishte “kujdestar” për grupin tonë. Ai i merrte në pyetje të gjithë shokët e mi. Për një rast më kujtohet pse më kishte ftuar. Miku im Bozhidar Borjan një ditë bëri shaka të pakripë me një koleg student që e konsideronim frikacak. I kishte telefonuar këtij kolegu duke u prezantuar si inspektori Panteliq dhe e kishte urdhëruar që të paraqitet patjetër tek ai të nesërmen në ora 4 pasdite, siç bënte zakonisht. Ishte një shaka që besonim se ai do ta kuptonte si të tillë, por ai i gjori nga frika e madhe e kishte anashkaluar rregullin që kishim për mosparaqitjen në polici nëse nuk ka ftesë me shkrim për këtë. Ai pra ishte paraqitur te Panteliq, dhe ky edhe pse i befusuar, e kishte marrë në pyetje dhe pastaj e kishte hetuar dhe zbuluar edhe prapavinë e shakasë. Unë isha i involvuar sepse telefonata ishte bërë nga zyra e Lidhjes së studentëve të fakultetit, ku unë isha anëtar i kryesisë dhe kujdestar për atë ditë. Borjani dhe unë kemi qenë për disa vite të pandashëm dhe e quanim vetëm “spadala”, që ndoshta mund të përkthehet si “kopuka”. Bënim edhe shaka tjera. Njëra prej shakave të tij ishte edhe

kur më kërkoj 50 qindarka, si sot 50 cent, për propozimin tim në kryesi të lidhjes së studentëve dhe 50 dinarë nëse zgjedhem. Por kjo ka qenë në vjesht të vitit 1968, pas demonstratave. Borjani ka qenë njeri prej ideologëve të lëvizjes studentore, hartues i platformës dhe programit revolucionar të Lidhjes së Studentëve pas demonstratave të vitit 1968. Më vonë e patën dënuar me burg dhe kur doli nga burgu, posa ia kthyen pasaportën, iku në Gjermani, ku jeton edhe tash. E patën dënuar kot për botimin e një reviste filozofike të shapirografuar, “Krug” ose “Qarku”. Edhe pse ishte botim për distribuim intern në pak kopje dhe kishte vetëm tekste filozofike, policia hetuese e morri këtë si kundërvajtje sepse botimi nuk kishte marrë leje.

Dinakëria e Titos ndal protestën

BH: Po ti, me që ke qenë i involvuar në aktivitetet e grupit, a nuk ishenë rezik që të përfundosh në burg?

ShM: Unë jam tërhequr nga ky grupim ekstremist studentor nga fundi i vitit 1969 ose në vitin 1970, kurse gjykimet dhe burgosjet filluan pas këtij 1970.

BH: Cila ishte arsyeja e tërheqjes?

ShM: Është tregim i gjatë, por unë qysh në përfundimin e demonstratave të vitit 1968 u pata ndesh me një problem moral. Po e tregoj me radhë së pari vetë rrjedhën e demonstratës, se u ndala te kthimi nga paraburgimi. Kur u ktheva në fakultet, aty kishte ndryshuar gjithçka, ishte vënë rregulli në çdo segment dhe po bëheshin negociatat në të gjitha nivelet që të strukturohet dhe mbushet me përmbajtje adekuate kërkesa themelore ndaj pushtetit dhe çfarë hapa duhet të ndërmerren

në situatat e ndryshme të reagimit të regjimit. Një rrethanë e çuditshme ishte që Titoja kishte qëlluar në vizitë disaditore në Rumuni, dhe derisa greva po vazhdonte, ai kishte vendosur të qëndrojë atje sipas programit, pa u deklaruar fare për demonstratat. Në udhëqësinë jugosllave edhe ashtu ishte paraqitur një si çarje në dysh mes atyre që kishin një qëndrim më mirëkuptues për revoltën e studentëve, disa prej tyre janë përpjekur që të ndalin dhunën edhe natën e parë, e kam fjalën për Velko Vllahoviçin dhe Milosh Miniqin, por edhe ata vetë ishin sulmuar nga policia. Ata edhe pas shpalljes së grevës, po negocienin për variantet e buta të daljes nga kriza, ndërkaq që forcat më rigjide ishin që të mos lëshohet pe dhe të ndërmerren masa më drastike ndaj liderëve.

BH: Si përfunduan protestat?

ShM: Si me shkopin magjik. Titoja ishte kthyer nga Bukureshti ditën e gjashtë të protestës, dhe mbajti një fjalim ku i dha përkrahje studentëve. A tha se gati të gjitha kërkesat ishin të arsyeshme dhe premtoi masat për ndryshimin e gjendjes. Por, e tha edhe me një bisht, përafërsisht kështu: 90 për qind të kërkesave janë më vend, 90 për qind të studentëve janë të sinqertë dhe kanë të drejtë, por është edhe një 10 për qindsh që i ka qëllimet e këqija dhe veprojnë nga pozitat e ekstremizmit. Këta 10 për qind ishim ne të Fakultetit filozofik, dhe profesorat tanë. Dhe me këtë fjalim Titoja e bëri shumicën e universitetit në anën e tij. Atë natë, pas fjalimit të tij, filloj një festim folklorik në fakultetet e mëdha, në fakultetin e teknikës, në medicinë, juridikë, të gjithë të lumtur dolën në rrugë dhe kërcenin valle, i këndonin këngët mareshalit, “Druzhe Tito mi ti se kunemo da sa tvoga puta ne skrenemo ...” Shoku Tito ne të betohem, nga rruga jote nuk do të largohem” etj. Madje edhe

na Fakultetin tonë shumica e studentëve, ata të degës së pedagogjisë dhe historisë, e kuptuan ndërhyrjen e Titos si fitore, edhe ata festonin. Kështu protesta për një natë u kthye në fitore personale të Titos, ai diti si të reagonte.

BH: Edhe ti festoje fitorën apo humbjen?

ShM: Unë atë natë nuk isha fare në Beograd, isha nisur për Prishtinë, dhe po zhvilloja betejën e parë të madhe me ndërjegjen. Më kishin lajmëruar se nënën e kisha të sëmurë, dhe edhe pse dyshoja se ky mund të jetë truk, se vetëm po donin të më largonin nga ajo ngjarje, megjithatë nuk mund të anashkaloja situatën, sepse e dija se nëna vërtet po vuante, ishte e frikësuar, dhe më e vogla që kam mundur ta bëja për te në atë situatë ishte të shkoja ta vizitoja, ta qetësoja disi. Kështu i hypa trenit, erdha në Prishtinë, dhe kriza nervore e Ijës u qetësua. Në ndërkohë kishte folur Titoja, televizioni lajmëronte gjerësisht për fitoren e Titos dhe të studentëve, për festën dhe se të gjithë ishin të lumtur, pos atij 10 përqindshit që u cilësua me qëllime ekstremiste. Kjo akuzë që në fillim dukej si një akuzë në ajër dhe demagogji e momentit, më pastaj do të tregohet si humbje e madhe e grupit tonë.

Pasi që u normalizua situata, ishte koha e provimeve, unë doja të kthehesha menjëherë, por prindërit ishin kundër, thoshin të rija edhe një kohë derisa gjendja të mos qetësohet krejtësisht. Por nuk i dëgjova. Ndejta në Prishtinë veç një natë, dhe mbrëmjen tjetër udhëtova për Beograd, për të parë se çka po ndodh me humbësit.

BH: Nuk i besonit Titos?

ShM: Kisha dyshime, por premtimet ishin të forta. Megjithatë në Fakultetin Filozofik ende nuk dorëzoheshim, dhe vazhdonim nëse jo

grevën, - ajo ishte ndërprerë, - por e kishim një lloj mobilizimi politik, çdo ditë kishim debate politike. Në mbrëmje mbaheshin edhe më tej tubimet politike që i quanim “Konvent”, por jo më në oborrin e famshëm, ku mund të tuboheshin deri 800 veta, ndoshta edhe më shumë, por në një sallë në katin e dytë që e shfrytëzonte Katedra e Historisë së Artit, ku mund të tuboheshin rreth 150 deri 200 veta. Këto debate kryesisht përqendroheshin në shqyrtime si të bëhet presioni që të përmbushen premtimet që i kishte dhënë Titoja, për luftimin e keqpërdorimeve dhe të korrupsionit. Në të vërtetë ishin përpjekje të kota që të vazhdohet me “revolucionin”, sepse Titoja kishte arritur ta përçajë lëvizjen studentore dhe së shpejti, nga fundi i qershorit, pamundësojë edhe rrugën institucionale të veprimit, pasi që LKJ e Beogradit morri vendimin për shpërndarjen e organizatës bazë të Lidhjes së Komunistëve në Fakultet. Kjo ndodhi nja dy javë pasi që edhe mua më kishin propozuar dhe pranuar si anëtar të LKJ. Unë kam marrë pjesë në mbledhjet e partisë të asaj kohe, si pjesëtar i grupit tonë, zakonisht me një detyrë speciale që të ulem pranë një studenti nga Lika e Kroacisë, mbiemrin e kishte Xhapiç, emri nuk më kujtohet, ne e thirrnim me nofkën gjeneral Xhap, sipas atij gjenerali të famshëm vijetnamez që e kishte mundur ushtrinë koloniale franceze. Ky Xhapi i Kroacisë ishte aktivist në grupin tonë, por tepër i zhurmshëm dhe grindavec, kërcente ndaj çdo fjale që nuk i pëlqente, dhe Vllada Mijanoviçi më udhëzonte që “për hir të çështjes dhe disiplinës” ta kontrolloj dhe ndaloj atë, sepse unë nuk nexehesha gati asnjëherë. Ky ka qenë, pra, një momentum kur unë isha afruar me Lidhjen e komunistëve, kur me dijen dhe motivimet që kisha atëherë, besoja se mund të veprohet brenda saj, nga një pozicion që objektivisht

ishite fraksionist. Por, më përjashtuan para se të bëja asnjë ditë të stazhi zyrtar.

BH: Nuk ke qenë anëtarë i LKJ-së?

ShM: Jo, fare. Më vonë, gjatë shërbimit ushtarak në Zagreb, në vitin 1975, sërish më kishin propozuar për anëtarësim në LKJ. Ka qenë atje një kolonel Rosiq përgjegjës për partinë, kishte shërbyer edhe në Kosovë dhe e kishte njohur Mehmetin, dhe atij iu kishte tek të më bënte anëtarë partie. Në fillim unë e refuzoja butë, i thosha nuk jam i politikës, më interesojnë gjërat tjera, por më vonë, kur më pyeti hapur, edhe unë u përgjigja hapur se nuk jam në vijën e LKJ-së, i thash se nuk mund të bëhem pjesë në një partie që sapo kishte përjashtuar 10 profesorët e mi nga Fakulteti. Kjo pastaj alarmoi komandën e garnizonit, dhe për këtë refuzim më “dënuan” me heqjen e të gjitha shpërblimeve që i pata grumbulluar për të dal më herët nga shërbimi. Kështu mbeta në ushtri nja tre javë më shumë seç dolën ata të brezit tim...

Largimi nga grupi anarko-liberal

Por, ti kthehem vitit 68. Ai udhëtimi im në Prishtinë gjatë demonstratave, ato dy netë të kaluara në tren, udhëtimi zgjaste nga 7 ose 8 orë, më kishin krijuar një ndërgjegje të papastër se unë në të vërtetë nuk mund të bëhesha “revolucionar” sepse kisha dobësi ndaj emocioneve dhe ndjenjave familjare. Treni ishte vendi i mirë për këtë lloj mendimesh. Po kështu, e kisha parasysh një vërejtje që ma kishte bërë Bozha Borjani, një natë kur po më tregonte gjerë e gjatë për leximet e tij të Leninit, dhe mundohej që përmbajtjen e librit të tij “Ç’të bëhet” ta bartë në realitetin e Jugosllavisë. Unë edhe nuk isha tepër aktiv në

këtë bisedë, dhe ai në një moment më tha se jam “pa ndërgjegje të përgjithshme”. Kjo fjali më fort tingëllon në serbisht “Ti si čovek bez opšte savesti”.

BH: Me që i përmende udhëtimet me tren, si dukej një udhëtim Beograd-Prishtinë? Dallimet që kishe përjetuar ndërkohë si reflektoheshin të Shkëlzen Maliqi.

ShM: Nga fundi i vitit 1969 dhe në fillim të vitit 1970, unë pata filluar të dëshpërohesha në lëvizjen studentore, sidomos me keqpërdorimin e emrit tim në raportet e policisë sekrete dhe në gazetatat që na sulmonin për çdo ditë si grup anarko-liberal. Për këtë arsye Mehmeti kishte ofruar dorëheqje në Këshillin e Federatës, ku ishte anëtarë, dhe me që kjo direkt godiste ekzistencën e familjes time, e ndjeja si shqetësim të madh. Këtë barrë nuk mund e mbaja në ndërgjegjen time. Unë atëherë u tërhoqa nga grupi ekstremist, siç na quanin. Pas kësaj, diku në vitin 1971 kam arritur një pakt me Mehmetin dhe familjen, raportet ende i kishim të ftohta, por sërish flisnim, jo për politikë, sepse nuk pajtoheshim, por për gjërat e përditshme dhe problemet familjare. Prej atij viti unë u pavarësova edhe financiarisht, pos për ndonjë rast urgjent, kur kisha ndonjë nevojë shtesë, familja më ndihmonte.

Nga fundi i vitit '69 dhe fillimi i viteve '70 edhe grupi i ynë radikal në Fakultet edhe ashtu nisi të shpërndahet, dhe unë atëherë pata gjet edhe motive tjera që të largohesha nga grupi. Vazhdoja të shoqërohesha me Bozha Borjanin, deri sa nuk u largua në Gjermani, dhe me Natasha Kandicin, vëllazërit Lazar dhe Voja Stojanovicin, Velimir Curguzin – Kazimirin ose Kaza, vëllazërit Dragan dhe Zoran Minderoviç, Milan Cirkovicin – Cirën, Svetlana Kojic Slapsak, që ishin po ashtu afër lëvizjes së '68, por me më shumë prirje intelektuale për të kritikuar

dhe bërë galletë me çdo gjë. Cira, Kaza, Zorani dhe Svetlana, publikuan një numër të magazinës me titull “Frontisterion” e konceptuar si gazetë e kohës antike me lajme dhe komente që i referoheshin aktuelitetit, p.sh. vizitave të Titos vendeve të Afrikës dhe Azisë. Ata patën prodhuar edhe audio verzionet e Frontisterionit, ku kishin bërë poezi dhe këngë për Titon dhe Jovankën, kundër figurave tjera të kohës si dhe një “buqetë të këngëve vëllavrasëse”, që karikonte falsitetin e ideologjisë së vëllazërim-bashkimit, si reagim ndaj Maspokut kroat dhe kundër-propagandës serbomadhe, që sot mendoj se kanë qenë diagnoza dhe anticipime të sakta se çka do të ndodhë njëzet vjet më vonë kur nacionalizmat këputën zinxhirët dhe shkatërruan në themel titizmin dhe Jugosllavinë.

Vitet e shtatëdhjeta

Shqiptari me plis në Beograd

BH: Për Kushtetutën e vitit 1974 kemi fol edhe në pjesën e parë, por tani dua të flasim nga perspektiva e asaj kohe. Por, mua po më duket se bëmë shumë digresione, dhe se më ke mbet borxh një pyetje, që të flasim edhe pak për Beogradin, për atë se si e ndiente atje vetën një shqiptar i ri i ardhur nga provinca nga fundi i viteve '60 dhe në vitet '70? Dhe si ndiheshin edhe shqiptarët tjerë që studionin atje?

ShM: Po, sigurisht, kushtetuta e 1974 ndodhi 8 vjet pas ardhjes sime në Beograd. E edhe atëherë, virusi vetëm u instalua, nuk ishte në gjendje që të veprojë dhe bëjë dëme të mëdha. Kushtetuta rivendosi raportet themelore, dhe problemet në atë moment ishin të themi më shumë pozicionuese dhe stratifikuese, nuk mund të shpërthenin menjëherë. Kjo do të ndodh vetëm pas vdekjes së Titos më 1980.

Kurse, për ate që të intereson se si ndihesha unë si shqiptar në vitin 1966 dhe vitet vijues, në Fakultetin filozofik, në konviktin e studentëve, dhe në atë qytet, mund të them se Beogradin e gjeta në një atmosferë që fare nuk ishte serbe, por kozmopolite, kuptohet në përmasat jugosllave, por që e pasuronin deri diku edhe studentët nga Afrika dhe vendet e painkuadruara, të cilëve Jugosllavia në atë kohë ua jepte bursa. Si

studentë ne atëherë kishim brenga tjera me regjimin dhe pakënaqësinë globale të rinisë prej SHBA-ve e deri në Poloni, dhe ky ishte virusi ynë i vërtetë i kohës, dhe jo nacionalizmat dhe revanshizmat lokalë. Rankoviçi ishte një kryepolic që nuk ishte i popullarizuar as në Serbi. Kurse të tjerët, ne që nuk ishim serbë, largimin e Rankoviçit dhe ndëshkimin e aspiratës të nacionalizmit serb, e konsideronin si diçka pozitive, dëshmi se Titoja po i spastronte hesapet me dogmatët dhe dorën e fortë dhe se ishte vigjilent edhe ndaj nacionalizmit serb.

Sa i përket shqiptarëve në Beograd, kishte plotë që atje studionin, por unë i njihja dhe shoqëroheshja vetëm me disa prej tyre. Për dallim nga kosovarët tjerë, siç kishte profetizuar mësuesi im Gjon Oroshi, unë kam qenë vërtetë i përgatitur dhe i adaptuar për një integrim normal në jetën e rinisë në kryeqytetin e Jugosllavisë. Në shumë aspekte nuk ndiheshja provincial. Kisha lexuar shumë dhe kisha informata të bollshme për filozofinë, letërsinë, filmin, dramën. Sigurisht se kam pas edhe komplekse, fola më herët për disa, por ato nuk kanë qenë të provincialit, në kuptimin se po vija si një njeri i gëdhundur sipas një kallëpi provincial. Vetëm një gjë megjithatë më bënte të çuditshëm dhe të ndiheshja i veçuar. Emri im Shkëlzen, që ua thyente gjuhën beogradasëve dhe jugosllavëve. Kjo u dukej e çuditshme disave, që unë isha shqiptar, e disa as që besonin, sepse, siç thoshin, as e kisha pamjen e as që sillleshja ashtu siç ate e përfytyronin një shqiptar...

BH: Kjo po më intereson, çfarë ishte perceptcioni i një beogradasi për një shqiptar dhe vend si Kosova? Mbi cilat dilema shtrihej

mendimi i tyre për Kosovën dhe shqiptarët. Dhe për një person atipik shqiptarë, çfarë ka qenë Shkelzen Maliqi?

ShM: Për Kosovën shumica nuk dinin asgjë, as që kishin qenë ndonjëherë. E dinin se atje jetonin ca shqiptar, kishin dëgjuar për Bekim Fehmiun, Faruk Begollin dhe Nexhmije Pagarushën, nga politikanët për Fadil Hoxhën, si funksionar të lartë të shtetit, dhe Mahmut Bakallin, si udhëheqës i ri i politikës që po krijonte karrierë të shpejtë... Pos këtyre yjeve shqiptarët që kishin parë kanë qenë hamallët dhe punëtorët e krahut, dhe kuptohet, aty këtu njihnin ndonjë student... Por për mua, që isha aq mirë i gëdhendur në një kallëp të imixhit dhe të sjelljeve, edhe të gjuhës, - shumica thjesht nuk mund të besonin, - ashtu në shikim të parë, e as në të dytin, - se isha shqiptar. Atëherë, ndoshta edhe nuk kam qenë, ha,ha, ha... Në shumicën e rasteve njerëzve nuk u interesonte çka isha, por kur binte fjala nga je dhe kush je, atëherë çuditëshin. Kjo mua nuk më brengoste shumë, por më kishte nxitur një kohë që të bëja një eksperiment. Në vitin e parë të studimeve, ose ndoshta ka qenë viti i dytë, një dimër të tërë unë e pata bërë një look të gjysmë katundarit shqiptar, i mbaja xhinsat, por edhe çizmet e gomës, ato më të lirat të "Borovos", që i bartnin fukaratë dhe pastruesit e natës, përkatësisht larësit me zorrë të rrugëve të Beogradit, ndër të cilët kishte më së shumti romë dhe shqiptarë. Dhe, kjo ishte kryesorja, e mbaja një plis në kokë, disa muaj me rrallë. Ndodhi që një mike m'i kishte porositur t'ia sjellja nga Kosova nja 10 plisa. E pëlqente shumë formën e përsosur të plisit, por nëse nuk gabohem donte të qëndiste diçka mbi ta dhe të bënte kapela të modës, që llogariste se do të janë shik. Unë ia solla plisat por njërin e lash për vete dhe ashtu për batutë, nisa ta

mbaja edhe publikisht, të shoh se si do të reagojnë njerëzit në rrugë, në fakultet etj....

BH: Nuk mund të paramendoj... Sikur nuk shkon me karakterin tënd çfarë të njohim. Dhe si reagues njerëzit?

ShM: Nuk kishte fare reagime! Ndoshta të duket e pabesueshme, por kështu ishte! E vetmja befasi ishte se sërish pothuajse askujt nuk ia mbushja syrin se isha shqiptar. Më shumë me perceptonin si ndonjë turist tuaf ose djalosh të qejfit, intelektual i ri me syza me dioptri të madhe, që plisin e mbante për qallëm ose si batutë. Nëna e një mikes time, kolege nga studimet, ishte mbesë e familjes së famshme të babës ose axhës së Ivo Lola Ribarit², e cila e dinte se jam shqiptar, u ofendua shumë kur kuptoi se unë isha i biri i një funksionari të lartë të regjimit në Kosovë, sepse kishte menduar se jam thjesht një student i varfër nga Kosova, dhe më ftonte gjithnjë për drekë ose darkë, nga dëshira që t'i ndihmojë një fukaraje që edhe dukej se i mungonte pesha, sepse atëherë vërtet isha me konstrukt dhe me peshë i dobët! Kur e kishte kuptuar se kështu dukeshja nga "lazdrimi", nuk më ndalte më për drekë dhe më shikonte me sy të keq edhe kur nuk e mbaja më plisin dhe fill-ova të vishem me modën e kohës, si gjithë rinia e Beogradit. Për plisin edhe sot çuditem pse e bëra këtë. Madje, në një rast, në ligjëratat e estetikës të Dragan Jaremiqit, tek i cili kam diplomuar më vonë, ky profesor më pat përjashtuar nga ora, sepse isha i ulur si gjithnjë në bankën e fundit, dhe e hedhja në ajër dhe e prisja plisin ashtu kot, duke bërë gallatë me një shoqe të bankës. S'di, nuk kam qenë gati kur ekzibicion-

2 Njëri nga herojtë më të çmuar nga rezistenca jugosllave partizane në LDB, emrin e tij në atë kohë mbante edhe gjimnazi i Prishtinës.

ist në çështjet e imixhit dhe të sjelljeve, por atëherë mbase kisha nevojë që ta bind edhe vetën se jam shqiptar.

Në atë disponim e mbaja plisin në kokë edhe kur e pata vizituar Prizrenin, diku në kohën e pritjes së vitit të ri 1967. Dhe më ngjau një ditë që të vizitoja një shok timin serb me të cilin kisha luajtur futboll të vogël në një ekip, Ivica Bllagojeviçin, ka qenë fqiu i parë me banesë kur jetonim në Prizren, dhe duke u futur serbez në dhomën e ditës në banesën e tij, nuk e gjeta Ivicën por babain të shoqëruar nga nja shtat-tetë veta, shumica fytyra të panjohura, që dukeshin sikur ishin në “konsulta” speciale ose si grup që përgatiste ndonjë konspiracion. Edhe ata të gjithë e hapën gojën nga befasia kur më panë ashtu me plis, sepse më njihnin si djalë të urtë të qytetit. Më e bukura e kësaj skenë, e kësaj hutie të tyre por edhe e çudisë time, ishte se Milosavi, babai i Ivicës, kishte qenë më parë ndër shefat e UDB-së në Prizren, dhe në atë kohë, pas hetimeve që ishin kryer, sapo ishte degraduar, unë këtë nuk e dija, dhe ai së shpejti do ta lëshonte Kosovën. Me këtë gjest timin besoj se jam dukur si dikush që kishte ardhur kastile me plis në kokë për të provokuar atë grup, sepse më pastaj besoja se të gjithë ata ishin serbë, madje imagjinoja se të gjithë ishin të UDB-së, ndërkaq që unë vërtet nuk kam pas paramendimin, vetëm doja ta befasoja Ivicën, të cilin nuk e kisha parë një kohë të gjatë, krejt kjo vetëm për gallatë.

Krahasimi i jetës në Beograd dhe Prishtinë

BH: Çka nuk shkonte me jetën që e kishte Shkëlzen Maliqi në Prishtinë krahasuar me atë që gjeti në Beograd. Çfarë ishin dallimet ndërmjet dy mentaliteteve dhe dy kombeve?

ShM: Unë isha një individualist nën ndikimet e kulturës globale, dhe kjo me vlera të gërshetuara. Nga leximet që kisha bërë si gjimnazistë në Prishtinë, besoja në idenë se njeriu e farkon vetë fatin e tij, dhe këtë në një frymë të gërshetimit të zen budizmit dhe ideve të ekzistencialistëve, të Sartrit p.sh., se jeta është projekt i hapur. Besoja se individi duhet të kujdeset për veten, të ndërtojë veten në mënyrë sa më kreative. Mendoja se duhet dhe mund ta modeloja jetën time si një vepër arti. Por, këtë nuk e kuptoja si detyrë imediate, por që kapet ngadalë, nga përvoja, nga sprovat, madje edhe dështimet. Vetëm më vonë kam kuptuar se ky ka qenë një gabim që ka ndikuar që të mos jam i suksesshëm edhe në gjërat për të cilat kam pas prirje dhe aftësi. Në të vërtetë, ky profil, kjo ide që të shtyja vendimet për më vonë, mendoj se ka buruar nga pasiguria në veten që e kam pasur, ose si një mënyrë se si e kam shprehur atë pasiguri. Kjo pastaj është shndërruar në ves, sepse më u është bërë zakon që të lë gjërat për nesër, nuk i kam bërë menjëherë. Në kushtet kur nuk kisha shtytje as ndihmë, më ka bërë për shumë kohë të gjytmë... Dhe vetëm tronditja e viteve '80 më pat zgjuar nga kjo letargji intelektuale...

BH: Ti ke studiuar dhe jetuar gjatë në Beograd, gjashtëmbëdhjetë vjet. Cila ishte arsyeja? Nuk e kishe idenë që të kthehesh në Kosovë?

ShM: Aryeja e parë ka qenë që nuk kam qenë student tepër i zellshëm, dhe studimet e mia u zgjaten shumë. Nuk i kaloja provimet në afate, ua kisha pritesën sidomos lëndëve që ishin tepër të mërzitshme, si p.sh. pedagogjia dhe marksizmi. Kishte qëlluar që këtë lëndën e marksizmit e mbante një prej dogmatëve të marksizëm-leninizmit në Serbi, njëfarë Andrija Stojkoviçi, dhe unë nuk mund as t'i lexoja librat e tij dogmatike dhe bajate. Kështu që, si student i keq që isha, vetëm për vitin e parë e pata siguruar konviktin dhe ushqimin në menzë, që i kishin çmimet e ulëta, me beneficione, kurse katër vitet e tjera, deri sa nuk kam absolvuar, dhe po merrja pagesën mujore nga familja, është dashur që të banojë me qera dhe të ushqehem vetë, jo në mensë. Mua më brente ndërgjegjja pse nuk isha i rregullt me studime dhe që isha barrë për buxhetin familjar. Kam punuar kohë pas kohe për kooperativën e studentëve dhe disa punë tjera.

Një arsye tjetër, më e rëndësishme ishte, të them ashtu, politike. Këtu tash më duhet t'i përsëris disa gjëra që i kam treguar në një shkrim për jetën time në Beograd, që është botuar si parathënie e përkthimit shqip të librit "Ditari i Meksikos" i Vlladimir Arsenijeviçit, e më vonë edhe si rrëfim me titullin "Jeta ime në Beograd" në gazetën "Java" të Migjen Kelmendit. Ndoshta do të ishte mirë që edhe këtë shkrim timin ta kesh në këtë libër, si shtojcë.

Por, sidoqoftë, po e tregoj këtë pjesë pak më ndryshe, çdo herë ka gjëra të reja për të thënë mbi të kaluarën.

Që nga vitit 1968, raporte e mia me familjen u komplikuan, me Mehmetin u prisha politikisht, bile as që flisnim, për shkak të pjesëmarrjes time në demonstratat e Beogradit të vitit 1968 dhe angazhimin tim në një grup që vepronte brenda lëvizjes studentore në Univerzitetin e Beogradit dhe që konsiderohej ekstrem. Ne kishim qëndrime krejtësisht të kundërta për situatën në shoqërinë jugosllave dhe për Titon. Për Mehmetin zhvillimet dukeshin tejet pozitive, sepse e kishte parasysh kursin e ri që kishte marrë Jugosllavia pas rënies së Rankoviçit dhe avancimit të autonomisë së Kosovës. Kurse unë situatën e shihja ndryshe, duke krahasuar idealin për të cilin na mësonin në shkollë, me realitetin. Mua më dukej, si edhe shumicës së moshatarëve të mi, se Jugosllavia po futej në një krizë të thellë, se po ndodhte një degjenerim i regjimit komunist, ngase po instalohej një sistem i vlerave të tregut që ndikonte në rritjen dramatike të pabarazisë shoqërore...

Por, për këtë besoj se do të flasim më vonë. Këtu dua të theksoj lidhur me studimet e mia, se Mehmeti, edhe pse ishte shumë i pezmatuar dhe i lënduar me “radikalizmin” tim politik, mbajti një qëndrim bujar prindëror. Ai nuk më kërcënoi me asgjë, dhe nuk ma ndërpreu përkrahjen financiare për vazhdimin e studimeve. Në një bisedë të fundit sqaruese që kishim, ai kërkoi prej meje që të mendohem edhe një herë në mos jam në rrugën e gabuar, por sidoqoftë, edhe nëse nuk pendohem, ai premtoi se deri në fund të studimeve unë mund të llogaris se do të më dërgonte të holla për studime, tash nuk më kujtohet saktë sa ka qenë shuma, ka mundur të jetë rreth 150 ose 200 dollarë, kuptohet me kundërvlerë në dinarë. Një kërkesë tjetër ishte që të mbetem i kujdesshëm ndaj nënës, ajo po vuante shumë, morra obligimin që t’i lajmërohem rregullisht me telefon, dhe mundësisht, ta vizitoja kohë

pas kohe në Prishtinë. Kjo ka qenë një sjellje shumë fer nga ana e tij. Unë edhe pse e mbaja me kokëfortësi qëndrimin tim politik kam qenë falënderues për konsideratën e tij si prind, por edhe nuk e kisha qëllim që të prishesha me familjen. Dhe kështu edhe arritëm një kompromis, unë po jetoja jetën time në Beograd, por arrija që të shkoja shpesh edhe në Prishtinë, dhe pas disa vitesh gjërat u normalizuar, sidomos kur unë u bëra ekonomikisht i pavarur, pas vitit 1971, dhe edhe konflikti politik nuk ishte më aktual...

Paragjykimet për shqiptarët

BH: Çfarë thonin në Beograd nga fundi i viteve gjashtëdhjeta për botën shqiptare dhe si trajtohej një “provincial” i ardhur nga një vend ku vrazhdësia e të jetuarit ishte pjesë e secilës familje?

ShM: S’di si të filloj... Në atë kohë nuk kanë qenë gjithaq aktuale këto çështje që na preokupojnë sot. Nëse flasim për rrafshin e paragjytimeve në jetën e përgjithshme, ato kanë ekzistuar. Por, kanë qenë të fjetura, ose të ndrydhura në plan të dytë o të tretë... Kurse në diskursin zyrtar, ishte diçka tjetër... Ishte diçka që nuk debatohej si sot, hapur, nga pozicionet e kundërta... Për raportet mes shqiptarëve dhe serbëve bisedohej jo hapur por tërthorazi, ose në rrethet e ngushta të njerëzve në pushtet dhe të qarqeve të inteligjencës kombëtare relativisht të privileguara. Çështja kombëtare konsiderohej e zgjidhur dhe në diskursin zyrtar dhe shkencor gjithnjë trajtohej në kornizat e ideologjisë dominuese. Ndërkaq, në raportet ndërmjet republikave dhe në artikullimin e interesave kombëtare ka pasur lëvizje tektonike, sidomos në relacionet e boshtit të themeluesve të atij shteti të komponuar, pra të serbët,

kroatët dhe sllovenët. Në fillim të viteve '60 intelektualët nga Beogradi, Zagrebi dhe Lublana zhvillonin debate për kahjen e zhvillime në Jugosllavi dhe atëherë ka pasur tendenca për rirregullimin e raporteve qendër - periferi, ku serbët kryesisht anonin nga centralizmi dhe shteti sa më unitar, kurse sllovenët dhe kroatët preferonin decentralizimin. Draftët e kushtetutës së Jugosllavisë ndërroheshin mjaft shpesh, dhe gjithnjë në konceptimin dhe zgjidhjet konfrontoheshin unitaristët me federalistët. Me rënien e Aleksandar Rankoviçit në korrik të vitit 1966, kjo betejë u fitua nga forcat që angazhoheshin për reformën ekonomike dhe bartjen e pushtetit tek republikat dhe, praktikisht, për zhvillimin e shtetit në drejtim të federatës së brishtë, gati gati konfederatës, çka edhe do të realizohet me amendamentet kushtetuese të vitit 1968 dhe Kushtetutën e vitit 1974.

Në fund të viteve '60 janë diskutuar, fillimisht në qarqet e mbyllura, edhe çështjet delikate si p.sh. definimi i identitetit të myslimanëve në Bosnje dhe Hercegovinë, dhe çështja e shqiptarëve në Jugosllavi, sidomos në Kosovë, që nuk mund të mbaheshin më me një autonomi të cunguar dhe të kontrolluar. Thjesht, zhvillimi i Kosovës dhe e vetëdijes së shqiptarëve nuk mund të ndalej. Publicistika kosovare sot shpesh i thjeshtëson proceset e atëhershme duke i parë vetëm në optikën bardh e zi, ose më parë, vetëm zi. Në kohën e Rankoviçit represioni sigurisht se ka qenë i madh, por shikuar në tërësi si proces historik, represioni ka qenë vetëm një anë e medales, ajo e errët. Por nga ana tjetër, procesi ka qenë ambivalent, sepse Lidhja komuniste e Jugosllavisë dhe ajo e Kosovës, përkundër kufizimeve ideologjike, megjithatë orientoheshin me një koncept gjeneral të zhvillimit dhe të emancipimit të Kosovës që bazohej në përhapjen e arsimimit të përgjithshëm dhe zhdukjen e anal-

fabetizimit, zhvillimin ekonomik dhe social, industrializimin, përmirësimin e kushteve të jetës, luftimin e prapambetjes, zhdukjen e dukurisë së gjakmarrjes, emancipimin e gruas, etj. çka nuk mund të mos jepte edhe rezultate pozitive. Sot shpesh thuhet se ajo kohë ka qenë një burg i përgjithshëm, por nuk është kështu, sepse pas 1945-shit, komunistët mundësuan transformimin e shoqërisë kosovare dhe përgatitën brezat që do të rebelohen, fillimisht në vitin 1968, pastaj atë të vitit 1981 dhe përfundimisht alternativën e '90 dhe UÇK-në.

Serbia nacionaliste sigurisht se po rrëronte natën atë çka socializmi iluminist dhe përparimtar jugosllav po e ndërtonte ditën në Kosovë. Në llogarinë e fundit mendoj se gjithnjë më shumë përfitonin Kosova dhe shqiptarët. Udba thjesht nuk mund t'i burgoste dhe montonte proceset për të gjithë intelektualët, ekspertët dhe patriotët e vetëdijesuar. Brezi i Fadil Hoxhës dhe babait tim, prej vitit 1945 deri në vitin 1981, me kompromise dhe kthesa, e ka arritur qëllimin dhe e ka përgatitur terrenin që Kosova të bëhet faktor brenda federatës jugosllave, kurse realizimi i pavarësisë i mbeti brezave të viteve që janë lindur dhe rritur në kohën e socializmit.

Në vitet '50 komunistët edhe mund të arsyetoheshin pse serbët në Kosovë po e kontrollonin pushtetin, pikat më të rëndësishme në administratë, ekonomi dhe arsim me faktin se kishte mungesë të shqiptarëve të arsimuar dhe ekspertë. Prej viteve '60 kjo ndryshon. Pasi që për çdo vit diplomonin me qindra shqiptarë, e edhe filluan të magjistrinin dhe doktoronin në shkencat e ndryshme, në Kosovë u rritë edhe presioni për më shumë autonomi në vendosje, për zhvillim të përshpejtuar, për investime kapitale në industri, infrastrukturë dhe në kapacitete njerëzore, dhe ndodhi edhe një emancipim i madh i vetëdijes kom-

bëtare. Shkollimi po bëhej gjithnjë e më masiv dhe për çdo vjet zgjeroheshin edhe programet me përmbajtje “kombëtare” që më parë ishin të ndaluara, p.sh. shkrimtarët e traditës, shkrimtarët bashkëkohorë nga Shqipëria. Ky proces kurorëzohet me themelimin e Universitetit të Prishtinës dhe të Akademisë së Shkencës dhe të Arteve, në fillim të viteve ‘70. Ky proces emancipues dhe zhvillimor ka pas disa të meta tjera, që nuk janë hetuar, ose që i kanë shkuar për shtati nivelit të ultë të reflektimit të traditës kombëtare si një fenomen i izoluar, që pat krijuar një botëkuptim që unë e quaj albanologjik, si botëkuptim i rezervatit, e që Edvard Saidi në teori ndoshta do ta identifikonte si një variant të orientalizmit, kur i kolonizuari mendon se po përpiqet që ta luftojë fuqinë dhe mendësinë sunduese koloniale, por në të vërtetë bëhet viktimë e saj, mbron ato vlera që mendon se i sulmon tjetri, koloni, si vlera të tribalizmit, folklorit, të një tradite jomoderne, që i kolonizuari i koncepton si identitet të vetin, dhe duke mbrojtur këtë “identitet” ai e kafshon, e hanë grepin, bëhet mu i tillë çfarë e paramendon fuqia koloniale dominuese, që të fut dhe mban në një torishte, të mbyll në rezervat, të bën me kufij të një kulture të mbyllur, jo produktive, folklorike, tribale... Ky tribalizëm kulturor të bën të paaftë për të ndërtuar raporte moderne shoqërore...

Kjo duket paradoks, sepse patriotët kosovarë kryesisht dilnin nga qarqet e dijetarëve albanologë, të gjuhës, letërsisë dhe ndër historianët, ata edhe hartuan një lloj programi të emancipimit nacional të Kosovës, p.sh. në veprat në dukje monumentale të Rexhep Qosjes, por që janë të kurthuara në “orientalizëm”, siç e ka analizuar në mënyrë të sakt Enis Sulstarova në veprën “Arratisja nga Lindja“. Pasoja e kësaj që po tregoj është se ne kemi alamet institute të albanologjisë, disa institute

të historisë, kemi me qindra dhe mija studime folklorike dhe të traditës kombëtare, por nuk kemi asnjë institut modern të hajrit, që kulturën e mendësinë shqiptare dhe ato botërore do t'i shikonte dhe studionte me metoda dhe mjete më bashkëkohore pa komplekse provinciale, dhe qatë lloj garë tribale dhe nacionaliste të “afirmimit” të vlerave kombëtare që konsiderohen të amshueshme në trajtat e tyre konservatore, të një tradite statike, të palëvizshme, me atë kultin e të parëve që bëhet mjet për shtypjen e ideve të gjalla...

Mbyllja e Kosovës në tribalizëm dhe folklor

Sigurisht se kjo mbyllje në tribalizëm, e kombinuar më një përpjekje të madhe iluministe, ishte një tagër e kohës, që ushqejej edhe nga nevojat që inteligjencia dhe politika kosovare t'i kundëvihet presioneve serbe, që po ashtu ishte ngujuar edhe ajo në një tip tjetër të nacionalizmit dhe tribalizmit, në një koncept mini-imperialist dhe racist, se serbët janë fisi më i avancuar dhe më i aftë shtetformues i Ballkanit, dhe se atij i takon e “drejta” që t'i sundojnë sllavët e jugut dhe shqiptarët. Këtë iluzion ata e ushqenin që nga shek. XIX, nga koha e Garashaninit, që mendonte se serbët duhet të janë komb Pijemont i Ballkanit, bashkues të sllavëve të jugut, maksimën e cilës lëvizje e kishte formuluar reformatori i gjuhës dhe alfabetit Vuk Karaxhiqi, “Srbi svi i svuda” (në shqip “Të gjithë dhe gjithandej janë serbë”), pra se sllavët e jugut të gjithë janë serbë dhe se shtrihen gjithandej Ballkanit. Ndoshta prej kësaj ideje kanë lindur edhe ato teoritë raciste nga fundi i shek. 19 dhe fillimi i shek 20., për kinse “serbët që flasin shqip”, që pretendonte se shqiptarët, sidomos ata në Kosovë, janë në të vërtetë serbë etnik që janë asimiluar nga shqiptarët me ndihmën e Perandorisë osmane, dhe që Serbia

moderne, pasi që e kishte pushtuar Kosovën (ata e thoshin ndryshe, se e “kishte çliruar Serbinë e Vjetër”) mund dhe duhet t’i rikthejnë këta serbë të asimiluar në shqiptarë, në racën dhe etninë e tyre burimore!

Po e jap tani një shembull konkret se si funksiononte ky mekanizëm i mendimit, e që pastaj të kthehemi te tema. Kur u pata punësuar në Katedrën e Albanologjisë në Beograd më 1978, e pata gjetur në skedarin më të vjetër të bibliotekës të kësaj Katedre një kryefjalë klasifikuese që letërsinë shqipe në Jugosllavi e emëronte si “Jugoslovenska književnost na šiptarskom jeziku”, pra “Letërsia jugosllave në gjuhën shqipe” që ishte një nonsens i asaj kohe, ku sipas kësaj logjike edhe shqiptarët do të duhej të trajtoheshin si jugosllav që flasin shqip. Në vitin 1978 ky skedar nuk ishte më në përdorim, por gjendej në dy kutia të veçanta së bashku me regjistrin e librave rezervat që nuk ishin në qarkullim të hapur për studentët, por lypsej leja speciale për leximin e tyre, si p.sh. librat e Fishtës, ose botimet e kohës së Shqipërisë së Madhe, p.sh. libri i Besim Qorrit për Shqipërinë etnike, ose librat e emigracionit shqiptar, por aty ishin edhe librat po kështu të ndaluara edhe të autorëve serbë të fillimit të shekullit 20, të Ballkanikusit, Vlladan Gjorgjiviçit dhe të tjerëve. Mendoj se ky ishte kurthi, se një mendësi tribale serbe e detyronte mendësinë shqiptare që të luftonte për njohjen e të drejtës që të mos quhet letërsi jugosllave, por shqipe, dhe të kërkojë afirmimin si letërsi kombëtare jo vetëm të shqiptarëve që jetonin në Jugosllavi (shkenca nacionaliste serbe i quante këta shiptari) por si pjesë e letërsisë të kombit shqiptar në përgjithësi (për serbët shqiptarët përtej kufirit të Jugosllavisë ishin Albanci).

Çështja kombëtare

BH: Po kjo tregon se lufta për emancipimin kombëtar ka qenë e ashpër dhe në shumë nivele. Si e perceptoje ti në atë kohë çështjen kombëtare?

ShM: Nuk kam qenë i preokupuar teorikisht, e as politikisht me çështjen kombëtare. Kam lexuar literaturën për provime dhe autorët që më interesonin, p.sh. Leninin dhe austromarksistët, që ishin autoritete të pashmangshme për temën, por jo në vitet '60, më vonë. I kam regjistruar gjërat vetëm në aspektin e ndjeshmërisë personale që kam pasur rreth identitetit tim personal, dhe që unë e zgjidhja këtë duke injoruar të dy kulturat tribale, dhe duke u marrë kryesisht me “vlerat” që vinin nga bota, p.sh. duke lexuar dhe duke u bërë fan i James Joyceit, një kampion i modernës. Në vitet '60 çështja nacionale në Jugosllavi sikur e kishte formën e një ajsbergu. Ajo çka flitej zyrtarisht dhe çka lejohej të flitej publikisht për çështjet kombëtare ishte sikur një maje e tupitur dhe e zbukuruar me fraza mbi barazinë dhe bashkim-vëllazërimin, kurse volumi dhe pesha e raporteve reale, që ishte e frikshme, dhe që do të shpërthente më vonë, qëndronin nën sipërfaqe. Titoja në çdo fjalim të tij e kujtonte rrezikun nga raportet e ngrira në pjesën e padukshme të ajsbergut, duke thënë: “Ruani vëllazërim-bashkimin si bebëzat e syve tuaj!” Por, ai vetë ishte gardiani i një “kopshti idilik”, dhe me vdekjen e tij nga vëllazërim-bashkimi nuk mbeti asgjë, u shndërrua shpejt në grindje dhe vëllavrasje. Unë, në rrethin ku sillesha dhe që kishim një botëkuptim mikst anarko-liberal dhe marksist njëkohësisht, nuk e kuptonim në atë kohë mirë as Titon, e as fuqinë tektonike

të nacionalizmave. Për vetën mendoja se këto ishin anakronizma, dhe si të tillë e konsideroja edhe çështjen shqiptare dhe çështjen e Kosovës.

BH: Nuk të duket rëndë dhe komprometuese që edhe sot ta pranosh këtë mungesë të patriotizmit dhe sensit për çëshjen kombëtare dhe pozitën rreale të Kosovës?

ShM: Jo, aspak, sepse atëherë, e tregova edhe më herët, çështja e Kosovës nuk shtrohej në ashpërsinë e sotme. Në diskursin publik jo se jo, e as nuk kishte ndonjë lëvizje të fuqishme për të cilën do të dinim... Si i ri, ndoshta edhe deri në moshën 25-26 vjeçare nuk e kam diskutuar fare çështjen e Kosovës, për mua ka qenë ajo inekzistente, ndoshta sepse edhe në gjimnaz, kur krijohen botëkuptimet e para politike, shumicën e kohës e kaloja me serbët, pasi edhe mësimin e vija në klasën serbe. Por, kur them se nuk e kam pas parasysh çështjen kombëtare dhe të Kosovës, kjo nuk duhet të kuptohet se kam qenë kundër. Por, se nuk kam pas vetëdije dhe qëndrim. Mua thjesht, nuk më shtrohej si çështje, dhe as që e kam gjetur si çështje në qarqet ku sillsha.

BH: Po a nuk kuptuat ju atëherë për burgosjen e Adem Demaçit dhe represionin ndaj shkrimtarëve dhe patriotëve tjerë shqiptar?

ShM: Gazetat e kohës nuk shkruanin për këtë, ndoshta ka qenë ndonjë shënim i shkurtë. Vetëm se kur u burgos për të dytën herë, e di se e pata dëgjuar se u burgos një grup, por s'kisha asnjë parametër të formatit dhe rëndësisë, se kush është dhe çka përfaqëson Demaçi. Për te kam dëgjuar për herë të parë tamam dhe me respekt në Beograd, në qarqet e avokatëve dhe atyre që konsideroheshin disidentë ose oponencë e regjimit komunist. Më konkretisht për Demaçin kam dëgjuar prej shokëve të mi që kishin rënë në burg për "delikte" politike

nga fillimi i viteve '70, pasi që ata dolën nga burgu dhe më tregonin për bisedat që kishin zhvilluar me te në burgjet e Jugosllavisë. Edhe baca Adem shumë vjet më vonë më ka treguar se për mua kishte dëgjuar prej këtyre shokëve të mi, që edhe unë isha politikisht i angazhuar me ta, por më tha edhe diçka indikative “Nuk e kam përhapur këtë tek të burgosurit tjerë shqiptarë.”

Miqë e mi takojnë Demaçin në burg

BH: Për çfarë arsye e kishte mbajtur për vete?

ShM: Nuk më kujtohet saktë për çfarë. Kisha përshtypjen për të më mbrojtur, ose pse ekzistonte një lloj distance të angazhimit të grupit majtist të Beogradit dhe të burgosurve shqiptarë, ose ndoshta pse isha i biri i Mehmet Maliqit dhe kjo atyre do t'ju dukej e pabesueshme ose e dyshimtë. Sidoqoftë, këta shokë të mi kishin mësuar mjaft për çështjen shqiptare nga Demaçi, dhe kur dilnin nga burgu më thoshin, disa prej tyre, se Kosova është dashur të jetë me Shqipërinë.

BH: Cilët shokë?

ShM: Vladimir Mijanoviç, Pavllushko Imshiroviç dhe Lllazar Stojanoviç...

BH: Për çka ishin dënuar ata?

ShM: Vllada Mijanoviçi formalisht ishte akuzuar për delikt verbal, gjatë shërbimit të obligueshëm ushtarak e kishin akuzuar, pas një denoncimi, se kinse ka treguar publikisht një barcoletë ofenduese për Titon. Në të vërtetë, dhe këtë e dinim të gjithë, ai u dënua për udhëheqjen e demonstratave studentore të vitit 1968 dhe aktivitetet e mëvonshme

kundër regjimit. Edhe Pavlushko është dënua së bashku me gruan e tij Jelena Imshiroviç dhe Milan Nikoliqin, si një trojkë trockistësh.

Kurse Llazar Stojanoviçi, u dënua për skenarin dhe regjinë e film-it “Plastični Isus” (Jezusi plastik), - që ishte punë e tij e diplomës në Fakultetin e dremës te profesori Aleksandar Petroviç, po ai regjisor që disa vjet më parë e bëri me famë botërore Bekim Fehmiun duke ia dhënë rolin kryesor (Beli Bora) në filmin “Skupljaçi perja, ‘Mbledhësit e puplave’. Filmi ‘Jezusi plastik’ nga pjesa zhdanoviste të mbrojtësve të regjimit dhe kujdestarve ideologjik u kuptua si tallje me realitetin jugosllav dhe regjimin e Titos. Por, në të vërtetë edhe Llaza ishte dënuar si kundërshtarë i regjimit për serinë e shkrimeve kritike në gazetën “Student” në vitin 1968 dhe 1969. Më kujtohet titulli i një kozerije të tij “Pošumljavajmo Gole otoke” (është lojë fjalësh ku kuptimi i drejtë është “T”i pyllëzojmë ishujt lakuriq”, por që aludonte hapur në burgun famkeq të “Goli otokut”, nga periudha e pas vitit 1948, kur Titoja qërroi hesapet me stalinistët jugosllavë me metoda staliniste, i dërgoj me mijëra në këtë burg në një ishull shkambor në pjesën veriore të detit Adriatik).

Edhe një shok tjetër i imi, filozofi Bozhidar Borjan, është dënuar, por më pak, me kundërvajtje, për një delikt të paqenë, pse kishte botuar pa leje një revistë të studentëve të filozofisë në formën e shapilografuar dhe me qarkullim prej nja dyqind kopje, jo më shumë. Edhe atë e ndëshkuan për shkak se konsiderohej njëri prej ideologëve të rebelimit të studentëve të Beogradit në vitin 1968.

BH: A i ke pas tamam miq këta të burgosur politikë që i përmende?

ShM: Me Mijanoviçin kam qenë i afërt edhe si cimer, kemi banuar dy vjet në një dhomë në konvikt, dhe kemi qenë pjestarë në grupin politik që pushteti e quante grup ekstremist anarko liberal. Nuk kemi pas ndonjë strukturim formal, e as emër, as anëtarësi strikte, por aty gravitonim dhe bënim protesta dhe aksione të ndryshme. Vlladimiri ishte udhëheqës dhe motor i grupit, kurse një kohë, deri në vitin 1969, në shumë gjëra unë kam qenë si dora e djathtë e tij. Edhe me Pavllushkon dhe Llazarin jam shoqëruar shpesh dhe shumë, si para burgosjes, ashtu edhe pasi që dolon nga burgu. Me Llazarin jam takuar edhe së voni shpesh sepse i ka kaluar shtat-tetë vjet si punëtor i UNMIK-ut në Prishtinë. Ai ka qenë i martuar më parë me shoqen time Natasha Kandiq.

Ndërkaq Bozha Borjani ka qenë Sokrati i oborrit të Fakultetit filozofik në Beograd, kur ky fakultet ende ishte në ndërtesën e vjetër. Aty në atë oborr gdhinim kalonim shumë kohë në debate. Me te kam qenë haver i pandashëm për disa vjet, deri sa ai nuk u shpërngul në Gjermani.

BH: Miqtë që përmende kanë qenë majtistë dhe anti-titist. Po, vëreja se ti herë e lavdëron Titon, e herë del në pozita antitiste... çfarë ka qenë atëherë platforma dhe disidencë e grupit që po përmend? A nuk është qëndrimi ndaj Titos një kontradiktë`?

ShM: Kjo mbase për arsye se unë herë flas për qëndrimin tim të atëhershëm, që ka qenë antititist, por jo i skajshëm, e herë e vlerësoj rëndësinë dhe rolin e Titos nga pozita dhe dijet që kam sot, ku përpiqem që të jam objektiv dhe jo emocional. Në atë kohë nuk e kam parë vetën

si disidentë. Më shumë kisha ide reaktive, pakënaqësi për dallimet e mëdha sociale, pasurimin e shtresës sunduese, që ne të rinjtë e quanim “borgjezi e kuqe”, instalimin e ekonomisë së tregut që na turbullonte mendjen. Mendonim se po shihnim devijime serioze të regjimit dhe kishte shumë raste të korrupsionit dhe të keqpërdorimit të detyrave nga drejtorët e firmave dhe ata që në atë kohë i quanin teknokratë. Por ne nuk ishim as dogmatë të marksizmit e edhe më pak stalinistë, sepse besonim në një marksizëm dhe socializëm me fytyrë njeriu, ku kishim shumë respekt për Marks-in e hershëm, Marks-in filozof që në rininë e tij kishte shkruar disa vepra vërtetë gjeniale. Por, kuptohet, e gjithë kjo disi ishte kontradiktore në vete, të jesh antistalinist dhe antidogmat në trajtimin e teorisë marksiste, por edhe në vijën e kritikës së kapitalizmit si ekonomi e tregut që gjithnjë gjeneron pabarazi dhe eksploatimin e njeriut nga njeriu. Në rastin e Jugosllavisë, ne kemi qenë objektivisht kontradiktor duke kritikuar njëkohësisht edhe elementet e ekonomisë së programuar dhe të dirigjuar shtetërore dhe centraliste, nga njëra anë, edhe ato të ekonomisë së tregut, nga ana tjetër. Jugosllavia në atë kohë po kombinonte dhe eksperimentonte me këto dy modele inkompatibile, përmes sistemit që quhej vetëqeverisje e punëtorëve.

Qëndrimi ynë në atë kohë mbase ka qenë i ngjashëm me ato që ka sot “Vetëvendosja” e Albin Kurtit. Jo në programin konkret, sepse dallimet janë si nata me ditën. Kurti është nacionalist në rradhën e parë, kurse ne ishim kundër nacionalizmave. Ngjashmëria është në atë se kishim shumë çka për të kritikuar, por nuk kishim program dhe pozicion të artikuluar pozitiv e as subjektin i cili do të bëhej bartës i ndryshimeve shoqërore. Ne atëherë njëfardore po e humbnim besimin në klasën punëto-re, sepse ishte i qartë oportunizmi i kësaj klase, nuk

mund të zgjohej nga letargjia. Dhe sot kjo ngjanë me Kurtin që kërkon vetëvendosje në emër të popullit, por gjithnjë zhgënjehet nga populli, sepse populli, që duhet të bëhet sovran, nuk e përkrahë në mënyrë masive në rrugën për vetëvendosje. Populli është bërë realist dhe e di se Kosovës i duhet njohja ndërkombëtare, kurse për vetëvendosjen e di se është diçka që mund të kryhet brenda ditës, por sa vlen nëse të vetëvendosurin nuk e njeh askush? Dhe kështu disi ishte edhe me qëndrimin tonë ndaj Titos dhe regjimin e tij, që nuk çonte peshë në kandar sepse në atë kohë shumica e popullit ishte me Titon, madje edhe në Serbi. Dhe kështu ishte edhe në Kosovë. Kur Titoja vizitonte Kosovën, masat e prisnin me entuziazëm, dhe kjo nuk ka qenë vetëm regji dhe manipulim. Por, ja që unë në atë kohë isha kundër “kultit të personalitetit” qoftë edhe në versionin më të butë, siç e shihnin disa Titon si diktator të moderuar. Por, sot kur në Kosovë edhe adhuruesit e dikurshëm të Titos janë bërë antititist, unë përpiqem të të jam objektiv, dhe për këtë dhe disa paragjykime tjera jo rallë edhe akuzohem, sidomos nga shtypi i LDK-së, si një “titist” dhe “projugosllav”.

Parulla e bashkim vëllazërimit

BH: T’i kthehem viteve ’60. Edhe në vitin 1966 Titoja ishte i pakontestueshëm. E përmende atë thënien e tij për bashkim-vëllazërimin, e quajte frazë. A mund të shihej në atë kohë se ato janë fraza dhe se po afrohej katastrofa? A të shkonte në mend shkatërrimi i Jugosllavisë më 1966?

ShM: Po, ne mendonim se janë fraza dhe mënyra për të ruajtur pushtetin duke manipuluar me masat. Sa i përket shkatërrimit të Ju-

gosllavisë, këtë nuk e mendoja fare. Ose, edhe nëse e mendoja, nuk e merrja seriozisht. Ndonjëherë e apostrofonte edhe vetë Titoja në fjali-
met e tij, kur reagonte ndaj spekulimeve në gazetë botërore që shkrua-
nin për mundësinë e shpërbërjes së Jugosllavisë pas vdekjes së tij. Nuk
më kujtohet çka kam menduar atëherë për këtë. Nuk isha ende analist
politik si sot që të regjistroja mendimet e mia. Nuk i kam ruajtur as
shënimet me përmbajtje politike nga ajo kohë, edhe ashtu nuk kanë
pas ndonjë peshë. Kam pas vetëm një ide, që ende e kujtoj, se për ndry-
shimin e kahjes së revolucionit në Jugosllavi ishte dashur të shfrytëzo-
het fuqia e sindikatave, por jo të atyre që dirigjoheshin nga pushteti
komunist, por si sindikate të pavarura. Kemi provuar të kontaktojmë
me punëtorët e “Rakovicës” dhe të disa fabrikave tjera të mëdha në
Beograd, më duket se i dërguari ka qenë Pavlushko Imshiroviçi, dhe
një tjetër me mbiemrin Pavloviç, por punëtorët i kanë dëbuar si pro-
vokator, mezi i kanë shpëtuar dajakut, dhe ne pastaj e harruam këtë
punë. Vetëm në vitin 1981 kur në Poloni doli në skenë Solidarnoshç
si sindikatë e fuqishme populliste, më është vërtetuar disi kjo tezë
për sindikatat. Por u binda edhe në faktin tjetër se idetë e mira dhe të
frytshme duhet ta kenë edhe vendin dhe kohën kur mund të mbillern
në mënyrë që të japin fryte. Pastaj, sindikata e Leh Valencës dhe Mich-
nikut u shfrytëzua për çlirimin e Polonisë nga tutela ruse dhe si motor
i nacionalizmit polak, kurse ne e mendonim sindikatën e pavarur si
instrument për rinovimin e revolucionit të ndalur jugosllav, që ishte
iluzion i kohës. Ne nuk i kuptonim mirë trendet e zhvillimeve në atë
kohë. Vetëm sot në retrospektivë e di se edhe atëherë kishin ndodhur
gjërat që është dashur t’i kuptojmë si sinjale.

Shqiptarët e Beogradit

BH: I përmende shkarazi shqiptarët në Beograd. A nuk kishe mbështetje tek ata? Si i gjete në Beograd? Sa shoqërohej me ta? Çfarë shihje te ata dhe si ishte jeta e tyre?

ShM: Në fakultetin tim nuk kishte shumë shqiptarë. Ka qenë p.sh. Ramush Mavriqi, me të cilin nuk jam shoqëruar fare, vetëm e njihja si emër sepse ndonjëherë na ngatëronin mbiemrat, kurse me Arbën Xhaferin, kur edhe ai regjistroi filozofinë, kisha kontakte dhe më vonë jemi bërë miq. Prej shqiptarëve që i njihja nga më herët kanë qenë në studime ë atë kohë Nait Vrenezi, Gafur Kiseri dhe Bashkim Hisari.

Me shqiptarët në Beograd kam pasur raporte por jo të asaj natyre të them getoizuese, që të shkoj vetëm pas tyre, në ndejat e tyre, në shoqatën “Përpjekja” p.sh., siç bënin shumica e studentëve të tjerë. Unë nuk i kërkoja shqiptarët, por zakonisht ata më kërkonin mua. Në fillim kam pasur edhe disa shok nga Prizreni dhe Prishtina, që studionin atje, dhe me ta shihesha shpesh, p.sh. Gafur Kiserin, që ka qenë më vonë deputet në Kuvendin e Kosovës që më 2 korrik 1991 bëri Deklaratën e famshme të pavarësisë... Në xhirimin e leximit të Deklaratës, Gafuri është ai që ri pranë Muharrem Shabanit dhe Bujar Gjurgjealos, me cigare në gojë dhe ne e nguxnim më vonë se po u thoshte në turqishtën e Prizrenit: “Okò da cabuk!” ose “Lexo më shpejt!”

Po kështu jam shoqëruar edhe me Bashkim Hisarin, Petrit Imamin, Ismet Koçbashin, Arben Xhaferin dhe disa të tjerë. Më vonë, jam shoqëruar me grupin që kishte ardhur për studime në Akademinë e dramës në Beograd dhe me disa gazetarë, si p.sh. me Sylejman Kllokoçin, Selajdin Xhezairin, Enver Petrovcin, Selami Tarakun, Behlul Beqajn dhe

disa të tjerë. Shoqëri të zemrës, kam pasur me Fatmir Canën, një djal dukat gjakovar. Edhe pse ishte shumë më i ri se unë, kemi pas shoqëri shumë të mirë. Ai pastaj u largua për në Parisë. Pasi që jam kthyer në Prishtinë jam njohtuar me vajzën e axhës së tij, Alisën, me të cilën u martova. Mund të them se një pjesë e dashurisë dhe e respektit për gruan time, ishte e lidhur me Fatmirin. Por, mjerisht, Fatmiri fatin nuk e pati aq të mirë, sa emrin dhe karakterin. Pasi që ishte kthyer nga Parisi dhe po provonte ta rifillonte jetën në Gjakovë, është vrarë mizorisht nga forcat kriminele serbe gjatë natës së tmerrit dhe masakrës në Gjakovë, me 2 prill të vitit 1999, së bashku me prindërit dhe motrën...

Po kështu jam shoqëruar edhe me Marija Llalevskën (e bija e një argjendari me mbiemrin Lalaj që maqedonët ia kishin shtuar prapashtesën -evski, sepse ishte familje me prejardhje nga Shkupi, mbesë e Anton Çettës; Marija tani jeton në Spanjë). Disa të tjerë me të cilët shoqërohesha, e që i mbajë mend, kanë qenë Jugosllava Shiroka, Marina Shiroka, Shqipe Maloku, një vajzë e mrekullueshme që emrin e kishte Hasnije, e mbiemri tani s'po më kujtohet etj.

Shoqëri shumë të mirë dhe të hareshme kam pasur edhe me dy gazetarë të ndjerë, Veli Vraniqin dhe Mitalip Çoçën. Në kohën kur programi i Radio Televizionit të Prishtinës emitohej nga studio e Beogradit ata vinin në Beograd dhe më ftonin për ndeje në Skadarli ose restorantet dhe lokalet më të mira të Beogradit. Ata fitonin honorare të majme nga puna në televizion, dhe sidomos Veliu ishte qejfli i rakisë dhe i mezes dhe i donte në shoqëri studentët.

Por, miqësi më intensive dhe më kuptimplote kam pasur me tre artistë figurativë, Isak Asllanin, Tafil Musoviçin dhe Gazanfer Bajramin.

Isaku dhe Tafili janë shqiptar, kurse Gazaferi turk nga Shkupi, por i lindur në Prishtinë.

Isaku dhe Tafili nuk njihen në Kosovë as në qarqet artistike edhe pse janë artistë shumë cilësor. Isaku është me prejardhje nga Dunavi i Karadakut, por jeton në Beograd që nga vitet '70. Është një artist par excellence, shumë i fuqishëm në çdo gjë që bën, pikturë, skulpturë, fotografi apo instalim. Vetëm se Isaku ishte shumë tuaf në ndërtimin e karrierës së tij, e ka mbet i tillë edhe sot. Në vitet '80 pata provuar që ta sjellë në Prishtinë si asistent në akademinë e arteve, por nuk kisha sukses. Ishte konkursi, sigurova një lloj garance për punësimin e gruas së tij të mrekullueshme, që ishte defektologe, por ata të Akademisë e heshtën konkursin, e kishin hapur për dikend tjetër që ishte shumë më i dobët se Isaku, dhe andaj zgjodhën të mos përgjigjen fare, as nuk e refuzuan, e as nuk e pranuan Isakun. Kjo ishte mënyra se si në UP atëherë anuloheshin konkurset kur iu prishte qejfi bosave. Mëkat, sepse Isaku është artist tepër i madh, do të duhej ta çmonim edhe në Kosovë, se prej këtu i ka edhe frymëzimet.

Ndërkaq, Tafil Musoviçi ishte i lindur në Mleçan afër Kijevës por është rritur dhe shkolluar në Zemun, tani jeton në Amsterdam. Edhe Tafili ishte piktor shumë i talentuar dhe i vlerësuar në Beograd. Jemi njohur diku në vitin 1971 ose 1972, dhe pastaj takoheshim shpesh, një kohë edhe kemi jetuar bashkë, së pari ai në banesën time, kur u pat prish me babain e tij patriarkal dhe autokrat, tipik prind shqiptar. Një natë vonë më trokiti në derën e banesës time në Vozhdovcë dhe tha "Jam prish me babën, i rash me boks. A mund të ri te ti? S'kam ku të shkoj deri sa nuk të përfundohet studioja që po e bëj në tavanin e një ndërtese në Zemun." Unë i thash OK. Banesa ime ishte shumë të vogël,

i kishte jo më shumë se 12 metra katror. Ishte vetëm një dhomë dhe një kuzhinë tepër e vogël, por kishte dy shtretër. E pata pajtuar këtë banesë nga një slloven pensionist. Pastaj, kur Tafili u bë me studio në Zemun, në vitin 1981, unë pata kaluar të banoi te ai, dhe isha me te deri sa nuk vendosa që të kthehem në Kosovë. Tafili ishte tepër senzitiv për prejdardhjen e tij shqiptare, sepse ishte shkolluar në një lagje të punëtorëve dhe të të varfërve në Zemun, ku si fillorist kishte përjetuar ofendime të ndryshme në shkollë dhe në rrugë për shkak të prejdardhjes shqiptare dhe emrit. Për dallim prej meje që nuk ia varja shumë veshin ndonjë aluzioni apo vërejtjeje ironike që na bënë bashkëbiseduesit nga Beogradi, ai i regjistronte menjëherë dhe aty për aty reagonte. “A e sheh atë budallë atje?” – Më tregonte në drejtim të një piktori serb të famshëm. “Më bëri një pyetje çka e ke Torkvanto Tason!” Nofka e Tafilit ishte Taso, dhe ai piktori serb kishte bërë shaka, por Tasoja Insistonte “Nuk e ka për hajgare! Është një shkërdhatë serbomadhe. Pikturon kinse në stilin e modernizuar të freskave mesjetare serbe, ua shet në Parisë pallën e ftohtë, e në të vërtetë është vetëm një racist dhe piktor i keq.”

Mirëpo, shpesh ia qëllonte me komentet dhe reagimet. Edhe në vitin 1981, kur u pat djegur konaku i Patrikanës së Pejës, dhe në gazetën “Politika” të Beogradit pat dalë një shkrim për këtë, ai mes rreshtave lexonte që po fillonte fushata antishqiptare dhe antikosovare. “E kanë bërë vetë!”, thoshte. Në atë kohë Tafilin e kisha seizmograf të disponimeve të vërteta të njerëzve në Beograd. E kishte atë shqisën shtesë për të kuptuar dyfytërsinë e njerëzve, që publikisht tregoheshin të sjellshëm, por ai i identifikonte si të ngarkuar, dinak dhe të rrezikshëm. Por, kuptohet, ndonjëherë bëhej paranojak për këtë, sikundër që unë u tregohesha shpesh babaxhan dhe naiv.

I treti, Gazanfer Bajram, është lindur në Prishtinë, nga nëna boshnjake dhe babai turk i Shkupit. Është rritur në shtëpinë e gjyshit që ka qenë deputet në Parlamentin e ish Jugosllavisë. Gazanferi pikturonte në stilin realist autoportretet dhe tablo të natyrës së qetë, por, kishte specializuar mozaikun, dhe tani është njëri prej mjeshtërve më të njohur për mozaik në Maqedoni dhe në rajon. Gazanferi atëherë ishte bonvivan dhe ia dinte rendit, i njihte pijet, kishte shije të mirë, dhe kishte ndërtuar reputacion në kafenetë dhe restorantet e ndryshme të Beogradit. Kur vinte në restaurant, nuk miqësohej vetëm me kamerierët, por kërkonte t'i njofonte edhe kuzhinierët, dhe u bënte porosi speciale dhe i qeraste edhe ata, kështu që gjithkund pritej me respekt. Me te kam kaluar shumë kohë në kafenenë “Kolarac” në rrugën Knez Mihailova, por bënim edhe ndeje private. Gazanferi në atë kohë kishte më shumë sens për politikë se unë, në kuptimin se nuhaste raportet gjeostrategjike dhe pozitën e Jugosllavisë si një botë ndërmjet Lindjes dhe Perëndimit. Për këtë e ndihmonte edhe një pikëvështrim otoman që e kishte, jo në kuptimin e nostalgjisë për Perandorinë Otomane, - për këtë e dinte se kishte perënduar dhe nuk mund të kthehet, - por nga një qasje kontekstualizuese që i lejonte që ngjarjet dhe zhvillimet “provinciale” në rajon t'i shikojë nga një perspektivë të gjerë sintetike otomane. P.sh. kur maqedonët vajtonin pse Maqedonia është ndarë padrejtësisht në tri pjesë ai u thoshte, “Po pse atëherë bëtë kryengritjen dhe luftuat për t'u ndarë nga Perandoria Otomane? Po të ishit nën Stambollin, Maqedonia do të mbetej një.” Kështu thoshte edhe për shqiptarët, kur ankoheshin pse janë coptuar trojet etnike shqiptare. Kuptohet, e thoshte si në shaka, por mua më pëlqente ky “pikëvështrim imperial”, kur çështjet e ngujuara shikohen “nga lartë”, gjë që mundëson pro-

jektimin e zgjidhjes së çështjeve nacionale në ndërmarrjet më të gjëra sintetike, çfarë është p.sh. prej kohësh projekti i Bashkimit Evropian. Para kthimit nga Beogradi kam pas një shoqëri intensive me te, dhe edhe ai u kthye në Shkup për afërsisht në të njëjtën kohë si unë. Është martuar me vajzën e njërit nga komunistët më me nam të Maqedonisë, Krste Crvenkovskin, dhe kur unë pata filluar të shkruaja në gazetat jugosllave, Crvenkovski më ka ftuar disa herë për biseda politike dhe lavdëronte qasjen time. Edhe pse disa shqiptarë të Maqedonisë kishin rezerva për te, mua më dukej pakrahasimisht më i mençur dhe me sens për rëndësinë e çështjes shqiptare, në krahasim me numrin një të nomenklaturës së Maqedonisë në periudhën 1945-1981, Llazar Kolli-shevski.

Shqiptarofobia e Lazar Kolishevskit

Për këtë të fundit, Kolishevskin, kam një anekdotë interesante, ma pat treguar në vitet '80 një gazetar i formatit amerikan, Miodrag Dodig, që punonte për "National geographic" dhe disa gazeta të mëdha amerikane. Dodik kishte shkruar një libër për Gorbaçovin. Ai ishte me prejardhje nga Mali i Zi, madje më pat thënë se i kishte rrënjët nga Shkodra, me gjasa është prej Dodëve, nuk më kujtohet tani saktë. Ky Dodiku më pat treguar se në vitet '70, kur kishte shkuar ta bënte një intervistë me Llazar Kollishevskin, në kabinetin e tij e kishte parë një hartë të madhe të Maqedonisë, ku në pjesët verilindore dhe perëndimore ishin ngulur shumë flamuj të vegjël me ngjyrë të kuqe. Dodigu e kishte pyetur çka përfaqësojnë këta flamuj, dhe ai ishte përgjigjur: "Janë zonat e depërtimit dhe të përhapjes të shqiptarëve në tokat e Maqedonisë! Janë duke na ngadhënjyer me natalitet dhe këtu te zona e

Kumanovës, është duke u krijuar një korridor që mund të na ndajë nga Serbia!” Gazetari e kishte pyetur se çka kanë ndërmend të bëjnë. Ai ishte përgjigjur se duhet ta pengojnë këtë deri sa nuk është vonë. Po si do ta bëni këtë?, kishte instituar Dodig. Aty Kollishevski e kishte kuptuar se përpara e ka një gazetar amerikan dhe ka heshtur. Kollishevski, përndryshe, si proserb, pas vdekjes së Titos, kur edhe filloi kriza e federatës jugosllave, e pat bërë publike një akuzë për strategjinë e udhëheqjes së Titos, që përndryshe ka qenë e popullarizuar në qarqet nacionaliste serbe. Ai pat thënë se formula e Titos për drejtimin e Jugosllavisë ka qenë jetësimi i parullës: “Serbia e dobët – Jugosllavia e fortë!”...

Mos po largona shpesh nga tema? Po bëj shumë digresione...

Kontaktet me pushtetarët kosovarë në Beograd

BH: Jo, më duket perfekt që po hapen shumë dimensione...

Vetëm se dua ta kujtoj që ta përfundojmë rrëfimin për Beogradin, sepse kam ende pyetje. Me që përmende pushtetarët e Maqedonisë, po më intereson a ke pas kontakte me kosovarët që ishin në pushtet, ministra e të tjerë, që kishin poste në Beograd?

ShM: Shqiptarët e tjerë që i takoja në rastet e ndryshme ishin punëtorë dhe nëpunës të thjeshtë. Kur u punësova më 1978 në Degën e Albanologjisë të Fakultetit Filologjik në Beograd, kontaktet me shqiptarët u shpeshuan, jo vetëm me studentët, por edhe disa njerëz që punonin në organet e federatës dhe të tjerë. Por me këta nuk kisha shoqëri, vetëm me studentët.

Një gjë e kam pas konstante se gjithnjë i rija sa më larg njerëzve të pushtetit. As që kam provuar të kem kontakte p.sh. me Azem Vllasin, ose ndonjë tjetër, as për favore e as për shoqëri. S' di pse, por edhe kur më vonë shokët e të njohurit e mi filluan të bëheshin ministra, i rralloja ose i ndërpreja kontaktet me ta...

BH: Cilët për shembull?

ShM: Në Slloveni me Jasha Zlobecin, kur u bë ambasador në Bruksel, po kështu me Sllavko Gaberin, ministër i arsimit. Në Shqipëri me Edi Ramën. Në Serbi me Zoran Xhinxhiqin dhe Zharko Koraqin... Deridiku kjo ka ndodh edhe me Arben Xhaferin, por jo në këtë masë, sepse ai gjithnjë i ikte protokolit dhe shpesh ishte insistues që të shihemi. Nuk është arsyeja për këtë që unë nuk respektoj zgjedhjen e tyre që të bëhen me poste zyrtare, dhe jo që i humbas ndjenjat miqësore ose respektin ndaj tyre, por kur kalonin në pushtet, sikur vendosej një rampë e protokolit që pengon raportet e sinqerta. Por, shiko, kjo nuk është vendim racional. Më parë i ngjanë paragjykimeve që konstitujnë karakterin. Nuk di a janë "paragjykime" të lindura apo i kam formuar gjatë jetës si bindje iracionale... P.sh., asnjëherë nuk kam gjetur arsye racionale dhe pragmatike pse p.sh. nuk kam pasur makinë e as patentë shoferi, ose pse nuk vallëzoj kurrë... Ose pse kam averzion ndaj pushtetit....

BH: Po, ti e kishe pushtetin te shtëpia, babain ministër? Ato e takeje në Beograd...

ShM: Po sigurisht, por ky është raport tjetër, nuk kishim protokol, vetëm ziheshim shumë për politikë, dhe pastaj u mësuam që ti anashkalonim temat delikate dhe të flasim vetëm për gjërat familjare dhe të

përditshmërisë, dhe pak më hapur vetëm pas vitit 1981. Në Beograd, kuptohet, kur ishim pajtuar, e takoja Mehmetin kur ai vinte zyrtarisht, por jo çdo herë. Zakonisht e vizitoja në hotelin ku rrinte, ose në kafenenë e famshme beogradase “Moska”. Por nuk u shkoja në zyret as u kërkova favore funksionarëve kosovar, as atyre që Mehmeti i kishte shok. Vetëm për punësim në Fakultetin Filologjik ka pas intervenuar Mahmut Bakalli, jo me dijen time. Por edhe ai jo që të më marrin në punë, por për të vërtetuar nëse ishte e saktë se ende kisha dosjen në policinë sekrete, sepse më patën thënë, kur pata konkurruar herën e dytë, se praktikisht isha pranuar nga komisioni por kinse sigurimi shtetëror kishte penguar punësimin tim në Katedrën e Albanologjisë. Kjo ka qenë shpifje e një njeriu, që tash dua ta tregoj, si një përvojë ndër ma të këqijat që kam pas me njerëzit. Në Katedrën e Albanologjisë kam punuar katër vjet me një nga figurat më të urryera të shqiptarit që kam takuar deri më sot, dhe ky ishte Halit Tërnavci, një doktor i shpifur në çdo aspekt, intrigant dhe i poshtër si njeri. Ai e kishte anuluar konkursin e parë në të cilin isha paraqitur. Supozoja se e kishte marrë vesh prej ndonjë shqiptari që punonte në organet e federatës se unë jam ai biri i “dyshimtë” i Mehmet Maliqit, që kishte marrë pjesë në demonstratat e 1968 si antititistë, dhe kur pata kërkuar shpjegim pse po më refuzonin, ai tha “E ke ende dosjen në shërbimet sekrete.” Dhe atëherë një shok i Mehmetit, Xhabir Xhabiri që ishte ministër ose diçka e ngjashme në Qeverinë e Serbisë, e lajmëron Mehmetin, dhe ku Mahmutin, që të verifikojnë këtë. Mahmuti kishte dërguar dikend nga shërbimet sekrete të Kosovës, dhe pasi që nuk kishin gjetur dosjen time, i lajmërojnë Tërnavcit se qenkam i “pastër”. Kishin kaluar dhjetë vjet nga demonstratat, pra ishte viti 1978, dhe unë në ndërkohë isha distancuar nga politika,

nuk bëhesha gjallë me asnjë veprimtari subverzive. Por ja që me këtë shpifësin Tërnavci më është dashur që të punoja katër vite...!

Neveria nga Halit Tërnavci

BH: Çfarë probleme tjera kishe me Trnavcin?

ShM: Nuk kam qejf aspak të flas për te, por nejtë, po e them, edhe pse kjo është temë e njohur. Halit Tërnavci kishte zakon që t'i vizitonte shpesh zyret e funksionarëve të lartë të Kosovës në federatë dhe Serbi, por zakonisht nuk arrinte më larg se te shefat e kabinetëve. Kur nuk shkonte, i telefononte çdo ditë, p.sh. shefit të kabinetit të Fadil Hoxhës! Kjo për arsye se kërkonte ndonjë post politik në Kosovë ose federatë, ose ta dergonin në ndonjë ambasadë të Jugosllavisë si konsul apo nëpunës. Serbët e urrenin, por edhe e shfrytëzonin për punë të pista. Një punë që kishte bërë pas vitit 1981 ishte përgatitja e listës së familjarëve të Xhavit Nimanit që kanë qenë në pushtet, ose në pozita të larta në univerzitet dhe organizata e ndryshme, si dëshmi për nepotizmin e udhëheqësve të Kosovës në kohën kur filloi fushata kundër “kundërevolucionit” dhe “irredentizmit” shqiptar. Ma solli edhe mua atë listë që ta nënshkruaj, por refuzova, jo vetëm pse nuk i njihja emrat që përmendeshin aty, por sepse e urrej çdo denoncim. Unë po kështu e dija, Haliti e tregonte vetë, se ai po i hakmerrej Xhavit Nimanit sepse ky si Kryetar i Kosovës e kishte refuzuar kërkesën e tij, e cila ka qenë me elemente të shantazhit, të paktën ashtu ma tregonte vetë, se ai ishte edhe naiv në komunikime, që të emërohet në ndonjë post zyrtar. Këtë letër e kishte dërguar në prill të vitit 1981, dhe pasi që Nimani nuk e kishte pritur kur ky kishte vizituar Prishtinën, vendosi që të nis fus-

hatën hakmarrëse. Ai thoshte se e kishte edhe një hesap personal me Nimanin. Babai i tij kishte qenë pas Luftës së Dytë Botërore diçka si kryetar i komunës ose i rajonit të Drenicës, në Serbicë, sot Skenderaj, dhe e kishin dënuar me burg si informbiroist, kurse vendin e tij të deputetit e kishte marrë Xhaviti... Sidoqoftë, dërgimi i asaj listës ishte vetëm një nga shumë poshtërsitë që i ka bërë, dhe ajo vërtet ndikojë që Nimani të japë dorëheqjen. Një tjetër “vepër” që kishte bërë më vonë ishte botimi i një rrëfimi me shumë shpifje për Kosovën dhe shqiptarët, të cilin ia pat shkruar Miodrag Bullatoviçi, një shkrimtar tjetër serb i infektuar nga nacionalizmi agresiv serb.

Unë për sjelljet e Tërnavcit i pata treguar Mehmetit, që ishte emëruar për ministër të brendshëm të Kosovës. Ai më pat thënë “Le atë pis dhe atë vend pune. Eja në Prishtinë. Ose, nëse nuk do, le punën se unë ta paguaj për çdo muaj sa e ke rrogën, vetëm mos rri më te, sepse të dyve na shkon fytyra”. Unë vërtet e kisha prerë mendjen që ta lëshoja punën, por po e kërkoja ndonjë vend tjetër, çka ishte vështirë ta gjeja. Nuk vinte në konsiderim të më paguante Mehmeti, edhe pse ishte ministër. Familja nuk e kishte punën luks që të më mbanin edhe mua që i kisha mbushur 34 vjet. Por, pak më vonë, në vitin 1992, megjithatë vendosa të kthehem në Prishtinë. Një prej arsyeve ishte se nuk e duroja më ta shihja suratin e Tërnavcit për çdo ditë.

Udhëtimet me tren

BH: Një seancë të kësaj bisede e pate përfunduar me një udhëtim me tren që për pasojë kishte largimin tënd të parë nga politika...

ShM: Në atë kohë udhëtonim me tren...

BH: Si ishin ato udhëtime? Çka përjetonte një studentë shqiptar që shpesh ka kaluar rrugën Prishtinë - Beograd?

ShM: Relacioni ishte Fushë-Kosovë-Krlevë-Beograd, dhe pastaj vazhdonim, kur na jepej rasti, për Zagreb, Lublanë, e edhe më larg në Evropë qoftë përmes Austrisë, qoftë Italisë. Trenat ishin përplot me pasagjerë dhe kur udhëtoje natën, lëvizja me atë zhurmën karakteristike dhe monotone të rrotave rrapa-rrapa-rrap... rrapa-rrapa-rrap... të fuste në një kllapi të çuditshme që tek unë çdo herë nxiste imazhe dhe përjetime fantazmagorikë. Një lajtmotiv i kujtimeve ishin stacionet e Mitrovicës dhe Rashkës, ku çdo herë përjetoja si një kufi muzikor mes Kosovës dhe Serbisë, sepse udhëtar i rregullt ishte një i verbër që i binte kavallit, nuk e huqte asnjë herë orarin... Emri nuk më kujtohet, ndoshta ka qenë jevg ose ashkali, por kur e hapte derën e kupesë, duke ta uruar mirëmëngjesin ose mirëmbremjen, e dije se po dilje apo se po hyje në Kosovë! Të përshëndeste në dy gjuhë, shqip dhe serbisht, dhe pastaj sipas përgjigjeve ia niste melodisë me kavall, shqiptare ose serbe, dhe pastaj një çun që ishte përcjellës i tij, i mbledhte paratë që ia jepnim si shpërblim... Gjithnjë kam dashur ta bëjë një film dokumentar për këtë kasnec kufitar. Në kohën kur shkruaja edhe skenare filmash ndoshta kam bërë sinopsisin e këtij dokumentari, por si edhe shënimet tjera, i kam grisur më vonë...

Në kupetë dhe korridoret e vagonave shpesh zhvilloheshin biseda mjaft të gjalla, ndonjëherë edhe interesante, por unë nuk flisja shumë, ashtu e kam karakterin, pos kur isha me shoqëri timen. Kur udhëtoja vetëm zakonisht lexoja dhe kjo më bënte tebdil, ngase në klasën e dytë të vagonave, kaq e lejonte standardi im, udhëtonin shtresat e ulta, klasa punëtore, fshatarët serbë, rinia e të gjitha kombësive që kërkonte punë,

në përgjithësi njerëzit e shtresave sociale që mua më perceptoni si të “huaj”, dhe pasi që kisha flokë të gjata dhe mjekrën, më mbanin për “hipik”... Treni Prishtinë-Beograd ka pas dy lloj udhëtarësh, ata që e fillonin udhëtimin nga Fushë Kosova, shqiptarë dhe serbë që njiheshin mes veti më mirë por edhe kishin më shumë rivalitete dhe keqkuptime, dhe një tjetër grup që futej në tren nga qyteza Rashka, menjëherë matanë kufirit të Kosovës, dhe pastaj me stacionet e mëdha në Kralevë, Kragujevcë, etj. që ishin serbë dhe ku shumica dërmuese e tyre nuk kishin raporte me Kosovën.

Për të qenë i saktë, duhet të them se nga fundi i viteve '60 dhe në vitet '70, nuk diskutohej hapur politika. Edhe nëse flitej për raportet ndëretnike, mes shqiptarëve dhe serbëve, nuk shtroheshin në nivelin politik, por më shumë si raporte ndaj “tjetrit”, si raporte paragjykimi, të përcmimit, smirës, frikës, të bazuara në dallimet kulturore dhe civilizuese...

BH: Mendon në dallimet kulturore vetëm në kontekstin e Serbisë, apo më gjerë, në Jugosllavi...?

ShM: Para së gjithash, në raportet me Serbinë. Kuptohet, unë nuk kam udhëtuar vetëm në relacionin Prishtinë-Beograd, por edhe në brendi të Serbisë, dhe po ashtu edhe në republikat tjera të Jugosllavisë, sidomos në bregdetin e Adriatikut, që është njëra prej mrekullive të botës...

Nga viti 1972, kur u largova nga politika dhe absolvova në Fakultetin filozofik, pra i kisha kryer ligjëratat dhe më kishin mbetur 5 ose 6 provime dhe diploma, unë kam bërë një jetë mjaft të çuditshme, duke kaluar një pjesë bukur të gjatë të vitit në manastiret e njohura mesjetare të Serbisë, duke punuar si konservator i freskave.

Interesimi për Bizantin

BH: Si ndodhi që u more me konservim?

ShM: Kejt rastësisht. Pata shkuar në vitin 1971 për vizitë disa miqve piktorë që punonin në restaurimin e një manastiri mjaft të dëmtuar afër Novi Pazarit, që quhej Gjurgjevi Stupovi. Në një kapelë të vogël sapo ishin zbuluar nën shtrasat e nxira nga tymi i temjanit dhe të qir-injve piktura afreske të mrekullueshme. Dhe pasi që qëndrova aty më gjatë, gati dy javë, sepse ambienti ishte shumë i bukur për turizëm në fshat, unë kohë pas kohe i ndihmoja ekipit të konservatorëve në pas-trimin e mureve me ca kemikalie. Kjo punë ishte mjaft delikate dhe e ngadaltë, por në fund përjetoje një kënaqësi të jashtëzakonshme kur shihje se si dilnin në dritë, pak na pak, figurat dhe kompozicionet që qëlluan të janë të klasit më të lartë të artit bizantin. Pra, unë punoja nën instruksionet e konservatorëve me mjaft përkushtim dhe pata nxjerrë në dritë një kokë të mahnitshme të një engjulli. Kur pas disa ditësh erdhi shefi i ekipit, një mjeshtër i zanatit me mbiemrin Zekoviç, por që ne e thërrisnim Zeka, nuk bëri asnjë fjalë pse unë kisha punuar aty vullnetarisht, por edhe ai u mrekullua me figurën e engjëllit që unë po e zbuloja gradualisht. Unë i pata thënë se kjo kokë dhe ato figura dhe kompozicione tjera që kishin dalë në dritë janë të klasit më të lartë dhe duhet të janë të shkollës së Konstatinopojës.

“Nga e di ti këtë?”, më pyeti ai i befasuar.

I tregova se unë në fakultetin si lëndë kryesore zgjedhore, që dëgjohet gjashtë semestra, pra plotë tre vjet, e kam historinë e artit, dhe se kisha mjaft njohuri për artin mesjetar. Më e bukura ishte se të nesërmen për vizitë dhe ekspertizë erdhi një profesor i historisë së artit, Voja

Gjuriç, dhe kur Zeka i tha se unë si student jam i mendimit se mjeshtri që ka pikturuar kapelën ka qenë nga Konstantinopoja, profesori u pajtua me këtë.

“Po”, tha ai, “edhe mua më duket se është nga punëtoritë më cilësore të qendrës së Perandorisë. Po, ti, nga e dije këtë?”

“Intuita”, u përgjigja. “Mënyra e trajtimit të figurave në këto afreska ka reminishenca të qarta në artin antik, figurat janë të gjalla dhe më ‘realiste’ se zakonisht. Andaj më ka shkuar mendja se mjeshtri do të duhej të ishte nga vendi ku ka pas mundësi që t’i sheh dhe studiojë pikturat antike. Dhe ky vend mund të jetë vetëm Konstantinopoja.”

Profesori Voja Gjuriç dallonte nga shkolla serbe e historianëve të artit për faktin se artin mesjetar në Serbi dhe në Jugosllavi nuk e veçonte nga Bizanti, por e shikonte si pjesë e një tërësie. Mendonte se punëtoritë kryesore me mjeshtër më të mëdhenj kanë qenë në Konstantinopojë dhe në Selanik dhe ata kanë punuar me porosi gjithandej Ballkanit dhe në përgjithësi në botën e kulturës bizantine. Ndonjë piktorë ka mund të jetë i lindur në provincat, por është dashur të edukohet dhe pjekë zanatin të mjeshtërit e mëdhenj në qendrat kulturore të asaj kohe. Gjuriçi e dallonte artin perandorak të Konstantinopojës nga arti provincial. Ai, pra, implicite, si një provincë të tillë e konsideronte edhe Serbinë mesjetare. Serbia dhe shtetet tjera të vogla në mesjetë nuk kanë pasur sistem shkollor dhe qendra intelektuale, pos manastireve, dhe mbretërit kur vendosnin që të ndërtonin kisha apo manastire, i ftonin mjeshtërit e punëtorive më në zë të Perandorisë, që të projektonin dhe pikturonin objektet e kultit. Libri i këtij profesori, që është botuar disa vjet më pas, ishte titulluar “Arti bizantin në Jugosllavi”, dhe ky titull dhe qasja dhe vështrimi i artit mesjetar në Serbi si pjesë e artit bizantin, i

kishte zemëruar fortë figurat tjera të shkollës kombëtare serbe të historisë së artit, të cilët preferonin që trashëgiminë artistike mesjetare në Serbi ta quanin “art dhe krijimtari serbe”, produkt të “gjeniut serb”.

Sidoqoftë, nuk dua që të zgjatëm për këtë, vetëm desha të tregoj se pas kësaj epizode, jo që unë e binda vetën se mund të jam i interpretues i mirë i artit, - më parë nuk kam qenë i vetëdijshëm për këtë, por mora një ofertë prej Zekoviçit, që të bëhem pjesë e ekipit të tij. Ai do të më paguante për punën praktike të konservatorit, por edhe për disa punë logjistike dhe dokumentuese. P.sh. më pat angazhuar që të mbledhja gojëdhënat për manastirin Gjurgjevi Stupovi në fshatin që gjendej krejt pranë kishës, dhe ku ne po banonim. Mua më dukej interesante si punë, dhe e pranova, u pata bërë mik i ngushtë me Zekën dhe për 7 vitet e ardhshme, kam punuar në shumë projekte me te, edhe nga pesë e ndonjë herë edhe shtatë muaj në vit, në terren, në manastiret dhe kishat si Studenica, Ovçar Banja, Staniçenje te Piroti, në kufi me Bullgarinë, dhe disa lokalitete tjera, por edhe në Beograd në Institutin Republikan për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës.

Si u “verbërua” afreska e Simonidës në Graçanicë

Nga ai angazhimi i parë që përmenda, të mbledhjes së gojëdhënave, kam pas përfituar një njohuri, që pastaj do më shërbente shumë në reagimin ndaj propagandës antishqiptare që filloi në vitet '80, kur shqiptarët akuzoheshin se kishin dëmtuar afreskët në Manastirin e Graçanicës, që gjendet në afërsi të Prishtinës. Në këtë manastir është një portreti i mbretëreshës Simonida, princeshë bizantine që ka qenë e martuar me mbretin serb Milutinin, për portretin e së cilës poeti nacionalist serb Milan Rakiç në fillim të shekullit XX kishte shkruar një

poezi me vargjet..., ja tani mund ta gjej në internet, për disa sekonda... Interneti është shpëtim për citime... ja ku është, po e lexoj një herë në serbisht: 'Iskopaše ti oči, lepa sliko! / Večeri jedne, na kamenoj ploči, / Znajući da ga tad ne vidi niko, / Arbanas ti je nožem izbo oči!' Pra në shqip do të ishte, ky është përkthim sipas kuptimit: "Ti nxorrën sytë, pikturë e bukur, / një natë, në pllakën e gurit, / duke e ditur se nuk po e sheh askush, / Arbanasi [shqiptari] t'i nxorri sytë!". Është një poezi në zë dhe antologjike në letërsinë serbe, në të cilën, pra, akuzohen shqiptarët për primitivizëm dhe barbarizëm, kinse i paskan shkatërruar pikturat që për serbët janë të shenjta.

Ndërkaq unë në polemikat e para me intelektualët serbë pata treguar se groposja e syve është pjesë e traditës ende të gjallë të prapambetjes dhe primitivizmit në fshatrat serbe, edhe në shekullin XX, sepse në atë fshatin Gjurgjevi Stupovi pata mësuar dhe regjistruar se besimtarët ortodoksë të atij fshati dhe të rrethinës kishin zakon që të gryenin sytë ose pjesët tjera të trupit nga pikturat murale të të shenjtëve, për nevojat e "mjekimit" sepse besonin se edhe pluhuri i freskave është i shenjtë dhe shërues! Nëse kishin ndonjë dhimbje të syrit, ose në gjoks o stomak, kudo në trup, e gryenin atë pjesë në trupin e pikturës dhe nga ai pluhur përgatishnin ilaçe, qoftë si hajmali, qoftë si mehlem, dhe e vendosnin në pjesën e sëmurë të trupit si mjet shërues!

Këtë "zbulim" timin e kishte cituar dhe komentuar ekonomisti kroat Branko Horvat në librin e tij për Kosovën, që është botuar në vitin 1986. Por edhe sot e hasi shpesh në internet, kur në Google kërkoj ndonjë informatë për intervistat dhe shkrimet e mia. Referimin për këtë pohim në një nga intervistat e aktorit Bekim Fehmiu, kur ai tregonte për falsifikimet e propagandës serbe. Ja edhe ate mund ta gjej në

çast në Internet..., ja ku është, qenka në shqip, përkthim i intervistës nga javorja “Danas” e Zagrebit, ku Bekimi thotë: “Ato vite të fushatës antishqiptare pushtuan faqet e gazetave dhe programet televizive. U publikuan fotografi të montuara ku citohej poema e Rakiçit ‘Simonida’ në të cilën thuhej: ‘Një shqiptar që të nxjerr sytë’. Shkëlzen Maliqi, shpjegoi gjithçka rreth të vërtetës mbi këto vargje, se sytë e mbretëreshës Simonida nuk u nxorrën nga urrejtja, por për shkak të një riti fetar apo një supersticioni, që nuk ishte vetëm i shqiptarëve, por edhe i serbëve dhe i gjithë popujve të rajonit, ku heqja e pluhurit nga sytë apo organet gjenitale të figurave në kishë do të thoshte shërim i të verbërve ose i grave shterpe.”³

Pra, kjo ishte njëra prej dobive që kisha më vonë nga kjo, si të them, shmangje që pata bërë në jetën time, kur vendosa të punoja si konservator i afreskëve, e që pastaj e pata kurorëzuar edhe me një studim mbi estetikën bizantine.

BH: Filozofët në Kosovë, p.sh. Astrit Salihu, thonë se ke bërë një goxha studim, më origjinalin ndër autorët kosovarë dhe shqiptarë. E kam parë edhe në “Estetikën” e profesor Alfred Uçit, se për kapitullin e estetikës së mesjetës plotësisht mbështetet në librin tënd, dhe në fund të librit e ka një shtojcë me tekste të zgjedhura, ku shkrimi ytë vendoset krahas atij të Umbeto Ekos?

ShM: Sidoqoftë, ka qenë një shmangje... Fillimisht e kam realizuar si temë e diplomës. Më vonë e kam përpunuar dhe botuar një pjesë në serbokroatisht, pastaj një version më të gjerë edhe në shqip, por vetëm pjesën e parë, titullohet “Estetika e arealit bizantin”, të cilën e ka

3 Ma vonë kam lexuar analizën më të detajzuar të Bozhidar Jezernikut për këtë dukuri mjaft të përhapur në botën ortodokse...

shfrytëzuar profesori Alfrerd Uçi. Kurse pjesën e dytë nuk arrita ta përfundoj sepse gjatë luftës shërbimet serkrete serbe morrën nga shtëpia ime dhe Fondacioni Soros ku atëherë punoja të gjitha komjutorët dhe disqet, dhe ndër dokumentet që ruaja në formatin elektronik ishin edhe fajlat e plotësimeve dhe redaktimeve të pjesës së dytë të librit mbi estetikën bizantine. I kisha bërë shumë kopje të dokumenteve edhe në kompakt disqe, por ata i kishin marrë të gjitha, kështu që pas luftës kisha një përtesë të madhe që edhe një herë t'i kthehesha punës që e konsideroja të kryer...

Kosova dhe Serbia e shtatëdhjetave

BH: Të kthehem tash prapë te jeta e përditshme në Serbi... Si dukej Serbia në sytë e tua, dhe si e shihte një serb Kosovën? Çfarë e dallonte një serb të Shumadisë dhe një të Beogradit. Sa reflektohej komunizmi në Serbinë, atë nacionaliste dhe atë jugosllave, në jetën e qytetarëve serbë jashtë Beogradit?

ShM: Po, gjithnjë po futem në digresione... Por besoj se kjo që tregova, rasti me fshatin Gjurgjevi Stupovi, me paragjykimet që gjeta aty, një mënyrë të jetës tepër të konservuar, është një shembull ilustrativ se atëherë ekzistonin dy Serbia, ajo moderne e qyteteve, dhe ajo tepër e prapambetur e fshatrave. Në Serbi çuditërisht, edhe pse shteti i kishte bërë më shumë se 100 vjet, të zhvilluar ishin vetëm Beogradi dhe disa qytete. Shumica e shtëpive në brendi të Serbisë, janë shtëpi tipike të fukarait. Ato mund të shihen edhe sot, sidomos në pjesën jugore dhe në zonat malore, duken si kuti me bazën prej 30 ose 40 metra katror, dhe zakonisht janë njëkatëshe, me një ose dy dhoma, të mobiluara në

mënyrë tepër modeste. Kontrasti mes Beogradit, si qendër e madhe administrative, ekonomike dhe kulturore, dhe brendisë së Serbisë ka qenë gjithnjë drastik, dhe mendoj se edhe sot është kështu. Pos Beogradit, më të zhvilluar kanë qenë vetëm disa qytete, Nishi dhe Kragujevci p.sh., këtu s'po e përmendi krahinën e Vojvodinës, që është një rrafsh tepër i madh dhe i pasur dhe ka qenë shumë më e zhvilluar se Serbia pasi që për shumë kohë ka qenë pjesë e Austro-Hungarisë.

Gjatë udhëtimeve të shpeshta nëpër Serbi, me punën e afreskëve dhe tjera, kam vërejtur se dallimi mes fshatit në Serbi dhe në Kosovë nuk është i madh sa i përket fukarallëkut dhe prapambetjes, ishte gjendja përafërsisht e njejtë, por kishte, kuptohet, dallime të mëdha kulturore dhe të mënyrës së jetës. Para së gjithësh dallonte tipi i familjes. Në fshatin serb ishin në zhdukje lidhjet farefisnore dhe kohezioni i familjes. Familja fshatare serbe zvogëlohej gjithnjë e më shumë, ata nuk bënë më si dikur 6 deri 10 e më shumë fëmijë por kishin dy deri tre fëmijë, rrallë më shumë. Të rinjtë largoheshin nga fshati, sidomos në pjesët jugore të Serbisë. Kësaj dukurie ata edhe sot i thonë “murtajë e bardhë” ose “murtajë demografike”. Për shkak të industrializmit të rinjtë iknin nga fshatrat dhe bujqësia, dhe punësoheshin në fabrika ose punë administrative. Në vitet '70 Titoja hapi edhe kufijtë dhe bëri marrëveshje me pothuajse të gjitha vendet evropiane për udhëtimin e shtetasve jugosllav pa viza, dhe atëherë rreth 15 për qind e popullatës së Jugosllavisë ikën dhe u punësuan në Gjermani dhe vendet tjera evropiane. Kjo edhe më dramatikisht zbrazti fshatin serb nga zonat e prapambetura, sidomos jugun e Serbisë.

Kurse, te shqiptarët e Kosovës, që po kështu filluan të dallin në Evropë, struktura e familjes fshatare ishte ndryshe, e tipit më tradicion-

al, patriarkal dhe solidarë, me lidhje të forta të fafëfisnisë. Standardi i banimit dhe mënyra e jetës të shqiptarët në fshatra ka qenë dhe ende është më i lartë se të serbët, për faktin se ata preferojnë që të jetojnë në shtëpia më të mëdha, me më shumë dhoma, me odën e burrave që është zakonisht e madhe, ku oborri i shtëpisë është i rrethuar. Shtëpia e shqiptarit e ka pjesën e ndarë për gratë. Në përgjithësi fshatari shqiptar i kushton pak më shumë kujdes higjienës dhe një rregullsi strikte të jetës. Familja kosovare ishte familje e madhe, dhe kishte një strukturë molekulare të mbijetesës dhe aktiviteteve ekonomike. Kjo do të thotë, shqiptarët kombinonin të gjitha mënyrat e punës për mirëqenien e familjes. Jetohej në vëllazni, dikush punonte tokën, dikush punë shteti, qoftë edhe korier në shkollë, e dikush në mërgim, në pjesët e zhvilluara të Jugosllavisë ose në Perëndim. Por qesja, portofoli i një familje të tillë me njëzet o tridhjetë veta të aftë për punë, ka qenë e përbashkët, e mbante kryefamiljari, i cili siguronte shkallën e lartë të solidariteti dhe fjala dhe vendimet e të cilit nuk kontestoheshin. Nëse prej atyre njëzet vetave, pra nuk po i llogarisë fëmijët, po vetëm vëllazninë, por që shpesh përfshinte edhe lidhjet e ngushta solidarë ekonomike me miqtë dhe me dajët, nëse pra prej atyre njëzet vetave katër ose pesë kanë aritur që të gjejnë ndonjë punë, qoftë në Kosovë, qoftë në mërgim, dhe një pjesë tjetër e ka punuar tokën, fondi që ka grumbulluar kryefamiljari ka qenë më se i mjaftueshëm për të siguruar jetën solide për gratë, fëmijët dhe pleqtë në këtë vëllazni, ose si e quaj unë “njësi molekulare ekonomike”. Por, e veçanta është dukuria e akumulimit të jashtëzakonshëm të kapitalit, sepse nga kursimet gjithnjë grumbulloheshin shuma relativisht të mëdha për investime. Edhe familjet që në shikim të parë kishin kushte modeste të jetesës, pas disa viteve të kursimit të kryepla-

kut arrinte të grumbullonte shuma të konsiderueshme për ato kohë. Kur një familje e tillë krijonte bazën në mërgatë, ajo gjithnjë zgjërohej me të punësuar të rinj, qoftë edhe për punë sezonale. Por, kushti i vetëmbajtjes të 100 vetave ishte që ata heqnin dorë nga shumë gjëra, të kursenin në ushqim, pije, veshmbathje, sepse keryefamiljari ndoshta fitonte me tepricë, por gjithnjë ishte në investime, gjithnjë mendonte për atë se djemëve sipas radhës duhet t’u ndërtohen shtëpitë e veçanta, ose ndonjë aneksi në kuadër të shtëpisë, të fejohen dhe t’u bëhen dasmat, të zgjërohet prona e familjes etj. Ky sistem ka funksionuar deri vonë dhe sipas meje ka qenë edhe shtylla kryesore e mbijetesës ekonomike por edhe politike në vitet e vështira ’90, sidomos pasi që regjimi serb largoi nga puna rreth 150 mijë shqiptarë.

Krahasimi i diasporave

Ne ankohemi shpesh për padrejtësi, dhe sigurisht se ka qenë padrejtësi dhe terror, por ama njëkohësisht ka qenë një gabim kolosal i Serbisë ky largim i punëtorëve sepse me këtë vetëm u forcua sistemi alternativ i ekonomisë familjare të kosovarëve! Paradoksalisht, shqiptarët që po ndëshkoheshin sepse nuk u treguan lojalë ndaj Serbisë, u larguan nga ndërmarrjet socialiste dhe administrata që edhe ashtu ishin në krizë dhe vlera e punës ishte e ultë, she ata falë “pasaportave të Titos” gjetën menjëherë punë ose asistencë sociale në vendet perëndimore, duke fituar atje edhe dhjetëfishin e pagave që i kishin humbur në Kosovë! Dhe kjo jo që u mundësojë që të jetonin me standarde më të larta evropiane, por ata edhe kursenin dhe dërgonin miliona dollarë, marka dhe franga tek familjet e tyre në Kosovë. Ndërkaq, edhe në vetë Kosovën ardhja stihike e kapitalizmit kishte krijuar kushte që

të paraqiten shumë ndërmarrës dhe tregtarë të suksesshëm, të cilët i falenderonin Millosheviçit që i largoj nga puna dhe u mundësoj që të bëhen të pasur ose të fitojnë pakrahasimisht më tepër se sa kur ishin të punësuar në firmat shtetërore. Kuptohet, ka pasur edhe shumë drama, shumëkush nuk është gjetur në ato situata, por edhe ata kanë përfituar nga solidariteti.

Në Serbi po kështu ka pas proces të ngjashëm, edhe atje diaspora ekonomike dërgonte mjete familjeve në Serbi, por me që familja serbe ishte më e atomizuar, dhe ata për dallim nga shqiptarët, me vete i merrnin edhe gratë dhe fëmijë, kishte më pak fryma që ndihmonin në vendlindje dhe ishte zhdukur instanca e kryefamiljarit që mbanë portofolin e familjes dhe drejtonte me një kujdes autoritar ekonominë familjare...

Mirëpo, derisa jeta e shqiptarëve ishte më asketike, në fshatrat serbe, edhe ato të varfëra, kishte më shumë hedonizëm. Ata festonin shumë, festat fetare por edhe ato pagane, dhe hanin dhe pinin me bollëk. Nuk ishte me rëndësi cilësia sa sasia.

Serbët si popull janë më ekstrovertë, të hapur, janë të qejfit, i japin më shumë kujdes ushqimit të bollshëm, edhe gjellërat dhe skarën e kanë të llojllojshme dhe të begatshme, kurse shqiptarët janë introvertë dhe gatimet i kanë kryesisht me brumna, pite, flija, bukë me lëngë...

Në atë kohë, nuk flas për tash, se ka ndryshuar edhe fshati serb dhe ai shqiptar, me serbin më lehtë krijon komunikimin imediat, por ai pastaj tregohet më i kthyeshëm dhe i pabesë, shanin shumë dhe gënjenin, kur nuk mund të kishte besim të plotë në premtimet, kurse me shqiptarin ishte ndryshe, kontakti vendosej më vështirë, nuk hapej ndaj të huajit, ose të paktën ishte dyshues, por kur afroheshe me te, ai

gjithnjë tregohej më i saktë, i fjalës, i sinqertë. Ajo që mua më impresiononte te shqiptarët, dhe që te serbët mungonte gati plotësisht, ishte autoriteti që kishte kryefamiljari, që jo vetëm në familjen e tij, por edhe në raportet sociale, mbante një qendrim të mini mbretit. Por, kuptohet, ku autoritet më impononte vetëm nga jashtë, si fakt antropologjik, dhe si një statujë interesante e sjelljeve burrërore dhe dinjitoze të karakterit tradicional, të njeriut që ia di rendit dhe gjithnjë duhet të tregojë dhe të mbrojë nderin e vet dhe të familjes ose vëllazërisë... Mirëpo, këtë rend nuk e doja në familjen dhe lëkurën time...

Përgjasimi me Drazhën

Sa i përket çështjes së perceptimit të shqiptarëve, mund të them se në atë kohë, po flas për vitet '70, edhe pse kam kaluar shumë kohë në fshatrat serbe dhe ata e dinin se jam shqiptar, nuk kam pas ndonjë problem me këtë. Nëse kishin paragjykime, nuk i zbulonin... Një herë më pat ndodhur në manastirin Studenica që një murg më afrohet te veshi dhe më thotë: «A e di çun se i ngjan shumë Drazhës! E kam një portret të tij në dhomën time kur ai ka qenë më i ri, dhe tamam duket kështu si ti.»

Këtoë gjasim timin me Drazha Mihailoviçin, komandantin e ushtrisë mbretërore dhe njërive famkeqe çetnike, që në LDB bashkëpunuan me okupatorët e kam përjetuar edhe më vonë. Një mik i imi, Milan Qirkoviç, që kishte filluar të merrej me fotografi, më kishte bërë disa portrete artistike, që i mbante në murin e dyqanit ku shiste shtypin e huaj, dhe shpesh njerëzit reagonin të befasuar duke menduar se po shohin Drazhën në portretin tim... Ne, si kopuka që ishim në atë kohë, e pëlqenim hutinë njerëzve, sepse fotografia e Drazhës ishte

tabu... Sidomos pas 1981-shit Qira kishte zakon të tallej me mushterinjte e befasuar duke shpjeguar fotografinë kësisojit: “Ky është një mik i imi, student shqiptar, i cili ka lindur përafërsisht në kohën kur Titoja e dënoi dhe e pushkatoi Drazhën! Mendoj se zoti e ka dënuar Drazhën duke e reinkarnuar në Kosovë, në fytyrën e këtij mikut tim shqiptar!”

BH: A nuk është kjo një shaka tepër e vrazhdë dhe ofenduese?

ShM: Nuk ishte ofenduese por, ne po talleshim me gjithçka, pra edhe me vetën. Ishte një si tallje që kishin simpati të fshehtë për Drazhën dhe çetnikët, dhe i urrenin shqiptarët. Ky rrethi im në Beograd ka pas një frymë të Rableut... Pas zhgënjimit me 1968-shën, kishin prirje për veprime blesfemike, për detabuizime, tallje me gjithçka. Na pëlqente transferi radikal i kuptimit të gjërave që na çonte shpesh deri te një nihilizëm estetik. P.sh. edhe pse ishim padyshim antifashist, ne ndonjëherë këndonim publikisht edhe këngën Lily Marlen, që ishte e popullarizuar tek nacistët. Ky nuk ishte veprim i padjallëzuar sepse ne dinim çka po bënim, po qëllimisht bënim kallambure, përmbysje kup-timesh, tallje me tabutë e kohës, përafërsisht si Mbreti Ibi në komedinë e famshme avangardiste të Alfred Zharisë nga fillimi i shek XX... Bash sot kam pas një bisedë me bijën time Rozafën, ajo është 13 vjeçare, dhe në murin e dhomës së saj kishte vizatuar kryqin nacist, svastikën. Kur i thash se ky është simboli nacist, ajo tha po, e di, por mua më pëlqen shumë si shenjë dhe formë. E vërteta është se ajo këtë nuk e sheh fare si simbol të të keqës, sepse nuk e identifikon shenjën me nacizmin dhe Hitlerin. E shikon ashtu si është, jashtë llojit të adhurmit që e kultivojnë neo-nacistët, por refuzon edhe neverinë që e kemi ne si antinacistë.

Madje, kur i thash Rozafës se svastika nuk mund të përdoret në publikë, është simbol i së keqës, ajo tha se kjo nuk e intereson. Nëse

Hitleri e ka keqpërdor një shenjë tepër të bukur dhe të fuqishme, është shenja ajo që duhet të lirohet nga kjo “varësi” dhe grabitje.

Dhe vërtet, svastika si simbol i diellit është shumë më e vjetër se nacizmi dhe mbase nuk ka kuptim që të mbetet simbol i një keqpërdorimi të tmerrshëm... Kam menduar për hir të shijes dhe argumentit të Rozafës që të ringjallet svastika me ndonjë modifikim të këndit të paraqitjes, e edhe të përdoren ngjyrat tjera e kuqja, e gjelbërta, e kaltërta, e verdhja, violet etj.

BH: A do të thotë kjo se do të mund të ketë edhe një Drazhë pink?

ShM: Nuk e mendoj në këtë kuptim, sepse nuk po them se me atë shaka ne po rehabilitonim Drazhën, përkundrazi, loja jonë i ngjante një lloj reductio ad absurdum, të gjasimit. Unë në të vërtetë nuk i gjasoja pothuajse aspak Drazhës, sepse kur e shikoje në detaje asgjë nuk ishte e përputhshme: vetullat, sytë, hunda, buzët, veshët, proporcionet e elementeve të portreteve ishin ndryshe... Mirëpo, disa elemente kryesore, para së gjithash mjekra dhe syzat karakteristike me kornizën e rrumbullaktë, krijonin lidhjen imediate asociative te ata që në kishin ndonjë raport, adhures, intrigues apo refuzues ndaj Drazhës. Miku im Qira luante me këtë element, kur e pat zbuluar se disa njerëz po reagojnë, dhe më fuste shpesh edhe mua në lojë me këtë.

Çka thoshin serbët për Kosovën dhe shqiptarët

BH: Ti kthehi trenave të viteve '70. Si kontestualizoheshin në ato udhëtime tuaja dhe bisedat me serbët Konferenca e Bunjajve, Rankoviçi, Serbia dhe Beogradi?

ShM: Këto tema nuk janë diskutuar në hapësirat publike. Edhe kur bëhesha tebdil dhe nuk më njihnin se jam shqiptarë as serbët e as shqiptarët, dhe kisha mundësi që të dëgjoja bisedat e tyre, nuk më kujtohet që dikush të fliste hapur për këto gjëra. Kishte shumë ankesa ose paragjykime të tipit “këqyre surratin e këtij derri” për serbët, ose “këta fliqana janë të mbrapsht! Qajnë kur lind njeriu, dhe gëzohen kur vdes dikush!”, për shqiptarët. Por ka qenë një temë që atëherë nuk më dukej e politizuar, por që do të politizohet më vonë. Në kupetë e trenit, kur qëlloja me serbët, ata e bisedonin shpesh një çështje që i habiste shumë se ku i marrin shqiptarët gjithë ato pare për të blerë tokat dhe shtëpitë e serbëve? Çmimi i tokës dhe shtëpive në Kosovë, paradoksalisht, ishte dy apo edhe trefish më i lartë se në Serbi. Madje, ka pas zona në Serbi ku trojet kanë qenë edhe 10 fish më të lira se në Kosovë. Kjo ishte pasojë e asaj që foli më lartë, se në Kosovë ishte familja e madhe dhe këto familje kishin nevojë për zgjerim, kurse Serbia në vitet '60 dhe '70 e kishte problemin e “mortajës së bardhë”, e zbrazjes së fshatrave, e shtëpive të pabanuara dhe tokave lënë djerrinë, sepse nuk kishte kush t'i punonte. Ligji i tregut në rastin e Serbisë ishte se oferta ishte më e madhe se kërkesa. Dhe serbët e Kosovës, disa që iknin sepse kishin bashkëpunuar me Udbën, disa sepse nuk u pëlqente dominimi shqiptar, e shumica sepse ishte profitabile të shitnin pasurinë në Kosovë dhe të blenin ose ndërtonin shtëpi shumë më të madhe në Serbi, madje edhe

në Beograd, dhe po kështu tu mbetet një shumë e konsiderueshme e parave në kesh... Më vonë, në vitet '80 kjo zhvendosje e serbëve drejt veriut do të interpretohet si strategji e organizuar politike.

BH: Po, pas vitit 1974 do të ketë pas më shumë reagime serbe. Çka flitej për Mahmut Bakallin, Fadil Hoxhen, Ali Shukriun dhe të tjerët?

ShM: Në qarqet ku unë sillsha nuk komentohej shumë kjo çështje. Kishte skepticizëm për Kuhtetutën, sidomos në Fakultetin juridik ku një pjesë e profesorëve kundërshtuan avancimin e autonomisë së Kosovës dhe Vojvodinës, ndër ta ishte edhe Vojislav Koshtunica, ish kryetari i Serbisë. Por, unë e shihja më shumë si një përpjekje e Titos që pas trazirave që patën ndodh me Maspokun në Kroaci, paraqitjes së nacionalizmit ekonomik të Sllovenisë dhe konfrontimit me liberalizmin në Serbi, të sigurohet një lloj modeli konfederal për Jugosllavinë të ngjashëm me atë të Zvicrës, me pushtetin rotativ një vjeçar, çka do të pamundësonte paraqitjen e çfarëdo diktature pas largimit të Titos nga pushteti. Në qarqet intelektuale mikse në Beograd, konsiderohej se ky testament i Titos në vend të demokratizimit të vendit ofronte vetëm një decentralizim të rrezikshëm, i cili do të çon më parë në shpërbërje, jo në ruajtjen e Jugosllavisë. Unë atëherë më pak interesohesha për politikë dhe vetëm e kisha kureshtjen dhe një qëndrim skeptik se a do të mundet Jugosllavia pas Titos të funksionojë si Zvicra, me gjithë ata kryetarë anonimë që do të ndërrohen për çdo vjet. Në atë kohë Fadil Hoxha arriti kulmin a karrierës politike, por yll i politikës kosovare u bë Mahmut Bakalli, kurse Ali Shukriu dhe Sinan Hasani, u marginalizuan. Publikisht nuk kishte komente të këqija për Fadilin dhe Mahmutin, pos prej serbëve të Kosovës. Këta serbë të Kosovës i shihja rrallë

në Beograd, dhe nuk më shkonte fare muhabeti me ta sepse ishin plot mllef për gjendjen në Kosovë. Mendoja se janë pakicë, nuk ua varja fare, i injoroja, kuptohet pos disave që i kisha shok nga gjimnazi dhe nuk kanë qenë të ngarkuar me nacionalizëm.

BH: Si përshkruhej një politikan kosovar në botën serbe. A ishte i padijshëm një politikan kosovar në botën serbe?

ShM: Po, të them të drejtën kanë qenë vetëm disa politikan kosovarë të artikuluar nga brezi i vjetër Fadil Hoxha, Mehmet Hoxha, Aslan Fazlia, Veli Deva dhe Iliaz Kurteshi, kurse prej të rinjëve Mahmut Bakalli, Orhan Nevzati dhe Azem Vllasi. Kol Shiroka nuk ka qenë fort i popullarizuar në Kosovë, por ka kryer shumë punë sidomos rreth krijimit të Univerzitetit të Prishtinës. Ali Shukriu ka qenë arrogant dhe dogmat, kurse Sinan Hasani ambicioz, ndiqte edhe karrieren letrare. Harrova me e përmend Xhavit Nimanin, që ka qenë shumë i zoti jo për fjalime dhe si ideolog, por si pragmatist dhe njeriu i pushtetit. Nahil Luma, shef i kabinetit të Nimanit në kohën kur ky ishte kryetar i KSA të Kosovës, nuk di nëse tashmë e kam përmend këtë, më ka tregur se Xhavit ka qenë shumë dinak në politikë. P.sh. në një rast e kishte lënë shefin e shtatmadhorisë të Armatës së Jugosllavisë më shumë se gjysmë ore në pritje para zyrës së tij, jo pse kishte ndonjë obligim tjetër, por vetëm që t'i tregonte se edhe kryetari i Kosovës ishte dikushi në atë shtet. Gjenerali, nuk më kujtohet cili ka qenë, ishte bërë tym nga idhnimi! Por, nëse do të bëja krahasimin me elitën komuniste në republikat tjera, ndoshta edhe nuk ka pas ndonjë ndryshim të madh në cilësinë e kuadrove komuniste. Në nivelin jugosllav, në brezin e vjetër, ka pas shumë komunistë dhe udhëheqës intelektualë dhe politikan të formatit, si p.sh. Koça Popoviç, Mosha Pijade, Boris Kidriq, Milo-

van Gjilas, Edvard Kardel, Vladimir Bakariq, Velko Vllahoviç, Milosh Miniq, Latinka Peroviç, të mos përmendi edhe shkrimtarët si Josip Vidmari ose më i madhi dhe më kompleksi prej tyre, Miroslav Kërlezha. Mirëpo, shumica e liderëve komunist kanë qenë mediokër, dhe me plakjen dhe zhdukjen e brezit të vjetër, sidomos pas vdekjes së Titos, në pushtet erdhën gjysmakët dhe mediokrit.

Kadareja dhe Andriçi

BH: Po si dukej Shqipëria në sytë e Beogradit? Ke qenë ndonjëherë i provokuar se je shqiptar dhe se duhet t'i takoje Shqipërisë dhe jo Jugosllavisë?

ShM: Deri në vitin 1981 jo, pos dy situatave kur kam qenë rastësisht në shoqërinë e nacionalistëve serbë, që i kam treguar më herët ose në tekstin “Jeta ime në Beograd”. Në përgjithësi ka pas pak informata për Shqipërinë, dhe ato me paragjykimë. Unë kam qenë më 1971 në Shqipëri, por nuk e bisedoja pothuajse me askend se si e kisha përjetuar Shqipërinë. Nëse më pyeste dikush si e pash Shqipërinë i thosha se ishte vend më i varfër dhe më i përvuajtur se Rumania dhe se, mjerisht, është një vend stalinist dhe tejet i izoluar. Nëse ndonjëherë tregoja diçka më shumë, përqendroheshja te natyra. U thosha njerëzve se Shqipëria është një vend i tepër i bukur, por i ashpër. Vetëm pas afirmimit të Kadaresë ia shtoja këtij përshkrimi të thuktë edhe Kadarenë, se shqiptarët e kanë një shkrimtar të formatit botëror. Në qarqet letrare të Beogradit, ia kishin pak zili suksesit të Kadaresë, sepse asnjë shkrimtar bashkëkohorë serbë dhe jugosllavë, pos nobelistit Ivo Andriç, nuk kishte arritur suksesin e Kadaresë, të cilin e krahasonin me grekun

Kazancakis. Pak më vonë do të depërtonte në Evropë Danilo Kishi. Por disa që nuk e ushqenin zilinë më thoshin, jo vetëm për shkak të Kadaresë, se ne shqiptarët jemi popull më evropian dhe se disi më lehtë depërtojmë në Evropë. Ma pat thënë këtë një koleg i imi nga studimet, poeti Miodrag Perishiq, i cili ka qenë më vonë ministër në qeverinë e Paniqit. Përndryshe, mua Kadarenë ma patën zbuluar shkrimtarët e Beogradit, nëse nuk gabohem miku im Kazimir Qurguz, i cili më pat treguar për suksesin e Kadaresë në Francë dhe s'di si ndodhi por libri i parë i tij që e pata lexuar ishte "Gjenerali i ushtrisë së vdekur" dhe ky në përkthimin serbisht të Esat Mekullit. Nuk ishte ndonjë përkthim që më la përshtypje, por më vonë e sigurova origjinalin shqip dhe librat në shqip të Kadaresë që i ribotonte "Rilindja", pos "Gjeneralit" edhe "Kështjellën", poezitë etj., dhe u binda se Kadareja është shkrimtar i formatit të madh me një qasje dhe stil ballkanas, sepse "reflektonte" në shumicën e veprave, traumën dhe pasojat e sundimit otoman dhe fatin e njerëzve në shtetet e vogla ballkanase nën trusnin e fuqive të mëdha dhe të diktaturave.

Ishte paradoks që nga një shtet i izoluar dhe me regjim stalinist çfarë ishte Shqipëria po vinte një shkrimtar evropian, kurse serbët e kishin një kompleks të mospranimi, edhe pse e kishin nobelistin Ivo Andriq, por ai atëbotë kishte vdekur dhe sikur nuk llogaritej më si shkrimtar bashkëkohor por konsiderohej më shumë klasik i letësisë jugosllave. E përmenda më herët se vetëm Danilo Kishi, nga fundi i viteve '70, filloi të njihet dhe të çmohet në Perëndim, por në atë kohë ai pati polemika të ashpra me establishmentin kulturor të Beogradit. Në të vërtetë, ndaj Kishit Beogradi konservator dhe nacionalist në atë kohë veprroi turpshëm, praktikisht duke e leçitur dhe detyruar që të kërkojë një lloj azili

në Francë, jo politik por kulturor, i tipit të ikjes nga një fushatë vërtetë primitive dhe denigruese kundër tij. Ky shkrimtar me një identitet të ngatërruar çifut-hungarez-malazeze etj. solli një frymë të re, më shumë borhesiane dhe universale në letërsinë jugosllave, që drejtohej kundër kanonit andriqian, pasi që epigonët e tij, si edhe epigonët e Kadaresë në letërsinë shqipe, po prodhonin kryesisht letërsi me disa stereotipe .

Kush është më evropian’?

Poeti Perishiq, kur i pat cilësuar shqiptarët si popull evropian dhe i depërtueshëm, thumbonte mu atë provincializëm serbë, të cilin një shkrimtar tjetër Radomir Kosntantinoviç do ta quaj “filozofi e pallankës”, nuk di nëse kemi fjalën shqipe që do të përkthente saktë kup-timin e “pallankës”, në kupimin qytezë provinciale... Ky miku im i studimeve, tani i ndjerë, me prejardhje nga Sarajeva, edhe vetë do të rreshtohet me nacionalistët dhe fashistët serbë, duke dhënë me këtë edhe vetë dëshminë e të qenit pjesë e “pallankës”, pra një diagnozë e saktë. Por, për atë pohimin tjetër se shqiptarët janë ndryshe, se më lehtë depërtojnë në Evropë, nuk jam bindur as atëherë, e edhe më pak sot, sepse mendoj se edhe ne vuajmë nga provincializmi dhe tendenca e refuzimit të botës dhe të mbylljes në vete dhe kriteret e veçanta të “vetëvlerësimit autonom”. Vetëm se, kur e kam menduar më vonë në kontekstet e ndryshme idenë e Perishiqit, që gjithnjë e kam konsideruar enigmatike, e kam vendosur edhe në një rrafsh tjetër, më shpjegues, se serbët, si edhe rusët dhe grekët, e kanë në kulturën dhe qarqet intelektuale klero-nacionaliste, një rrymë shumë të fuqishme anti-evropiane, duke qenë të bindur se në rrënjët e besimit ortodoks dhe kulturën lindore ekziston ose mund të ndërtohet një civilizim i veçantë,

konkurent ndaj atij perëndimor, katolik e protestant. Ky insistim në përkatësinë një fryme dhe një bote tjetër, nuk është prezent te shqiptarët, madje as te ortodoksët shqiptarë, pos në ndonjë teori akcidentale dhe kontradiktore, si ajo e Aurel Plasarit në libërthin “Vija e Teodosit rishfaqet”, ku ai insistonte se vija që ndanë krishtërimin lindor nga ai perëndimorë është edhe vija që ndanë civilizimet, dhe se shqiptarët janë të historikisht të stigmatizuar dhe të “pafat” ngase kjo vijë i ndanë përgjysmë si komb, çka sugjeronte se Kosova dhe Maqedonia Perëndimore do të duhej të mbeteshin përjetësisht dhe fatalisht pjesë e Lindjes, kurse Shqipëria ka gjasa që të bëhet pjesë e Perëndimit!

BH: Për këtë ke pas një debat me Aurel Plasarin?

ShM: Po, polemika është zhvilluar më vonë, në vitet '90. Në revistën MM unë botova një artikull ku kritikoj pikëpamjen skematike të Plasarit, dhe tani gati pesëmbëdhjetë vjet më vonë, jam i lumtur se NATO, si organ ekzekutiv i Perëndimit, e ka shkelur atë tabunë e supozuar të Plasarit, dhe që së voni ka lindur edhe shteti i Kosovës, i cili me të gjitha parametrat i takon Perëndimit, madje edhe me një islam që duhet ta konsiderojmë islam perëndimor. Jugosllavia ka qenë një kontekst ku edhe serbët kanë qenë të kthyer nga Evropa dhe Perëndimi, por ata e shkatërruan vetë Jugosllavinë, dhe tani gjenden të ballafaquar me sfidën e izolimit, ose të frustrimit tashmë dyshekullor se a duhet t'ia mbajnë nga Lindja, nën sqtullin e Rusisë, apo nga Perëndimi.

Çka përfaqësonte Jugosllavia?

BH: Me që e përmende Lindjen dhe Perëndimin, si dukej jeta në Jugosllavi në kushtet e luftës së ftohtë. Si ishte pozicionuar një

sistem i tillë karshi Rusisë dhe Amerikës dhe nga derivoi fuqia dhe pesha e një vendi çfarë ishte Jugosllavia.

ShM: Jugosllavia përbën kontekstin e fuqishëm të jetës sime. Unë kam lindur në atë realitet që quhej Jugosllavi dhe për dyzet vjet, më duket se e kam thënë edhe më herët, nuk e kam menduar seriozisht mundësinë që një ditë ky shtet do të shkatërrohet. Për ekzistencën e Jugosllavisë kam filluar të dyshojë vetëm në shtator të vitit 1987, pas asaj Mbledhjes së Tetë famkeqe të Komitetit Qendror të Lidhjes së Komunistëve të Serbisë, në të cilën Slobodan Milosheviçi siguroi pushtetin absolut në Serbi duke shfrytëzuar rastin e Paraqinit, një krim të tmerrshëm në kazermën e këtij qyteti në Serbinë qendrore. Krimi i Paraqinit jep shumë indikacione për inskenim makabër. Versioni zyrtar, i cili kur nuk është hetuar nga ndonjë instancë neutrale, pohon se ushtari Aziz Kelmendi nga Prizreni, mu në ditën kur babai i tij kishte ardhur për vizitë dhe i ka sjellë robot civile ngase pas disa ditësh Azizi do ta përfundonte shërbimin, i kishte “vrrarë” në gjumë katër ushtarë tjerë nga pjesët e ndryshme të Jugosllavisë, dhe pastaj kishte bërë vetëvrasje në një zabel afër kazermës. Deri sa Beogradi pohonte se “Kelmendi ka qëlluar në Jugosllavinë”, shtypi i lirë jugosllav i asaj kohe, dhe përfaqësuesi më i denjë i saj ishte “Mladina” e Lublanës, mbante qëndrim diametralisht të kundërt, se Paraqini në të vërtetë ishte “Djegje e Reichstagut”, një krim i inskenuar nga shërbimi sekret proserb i armatës, KOS, për të akuzuar shqiptarët dhe fuqizuar “patriotizmin” serb, i cili po merrte tiparet e fashizmit dhe i cili do të çonte drejt shkatërrimit të Jugosllavisë.

Sot nuk ka shumë kuptim që të theksohen aspektet pozitive të shtetit të Jugosllavisë, sepse çuditërisht dhe në mënyrë të pashpjegueshme,

të gjitha shtyllat mbajtëse të atij realiteti, që do të mund t'i vlerësonim si afirmative dhe pozitive, janë zhdukur pothuajse pa rezistencë dhe pa lënë gjurmë, menjëherë pas shpërbërjes së shtetit. Vetëqeverisja si bosht i sistemit të brendshëm dhe ekonomik, si dhe politika e mosinkuadrimin si bosht i politikës së jashtme janë tretur si fluskat e sapunit në momentin e shpërbërjes së federatës.

Jugosllavia e dytë ka qenë një sajim inteligjent i Titos, i cili e pat gjetur formulën e ballancimit mes Lindjes dhe Perëndimit. Ai thith-te mjete, dhe siguronte favore nga të gjithë faktorët botërore me një strategji perfekte dhe dinake. Kur i duheshin fondet nga Perëndimi, Titoja gjente mënyrë që të afrohet me Moskën, dhe Perëndimi atëherë detyrohej që t'i jepte ndihma dhe kredite Jugosllavisë në mënyrë që të siguronte vazhdimin e orientimit relativisht properëndimor të këtij shteti. Ndërkaq, kur Titoja kishte nevojë për më shumë armatim nga Moska dhe Lindja, dërgonte sinjale të afrimit ndaj Uashingtonit, dhe Moskva atëherë bëhej më dorëshlire në furnizimin me armatim të Jugosllavisë. Titoja po kështu shfrytëzonte edhe faktorin e tretë, vendet e painkuadruara. Ka qenë partnere ekonomike e rëndësishme me Irakun e Sadam Hyseinit, me Libinë e Moamr Gadafit, me Iranin, Egjiptin, Indinë etj. ku përfitonte në shumë fusha, ndërtimtari, shitjen e armëve etj.

BH: Çfarë ndodhi me Kosovën me dhe pas vitit 1974. A kishte një kthim të besimi ndaj Jugosllavisë. A kishte jugosllavizëm në Kosovë dhe si dukej të jesh jugosllav, titist dhe pjesë e një sistemi të tillë?

ShM: Ka pas kushtimisht kosovar “jugosllav” por edhe antijugosllav. Lidhja e Komunistave e Kosovës i ka pas rreth njëqind mijë anëtarë

shqiptarë, pra njerëz për të cilët duhet të supozohet se kanë qenë të integruar në sistemin jugosllav. Sot shumica e tyre shiten si njerëz që kanë qenë denbabaden “patriota shqiptar”. Por, unë nuk vuaj nga skemat, mendoj se ka qenë një realitet shumë kompleks, që nuk mund të zërthehet lehtë dhe me etiketime dhe klasifikime të shpejta, zakonisht me përmbyse të vlerave ideologjike. P.sh. nacionalistët e sotëm, si Mehmet Kraja ose Jakup Krasniqi, shumë lehtë prodhojnë skema se titizmi në Kosovë ka qenë i dëmshëm dhe jo-produktiv, kurse enverizmi progresiv dhe i dobishëm për çështjen. Më 1968 dhe 1974 Kosova u fut në një hov, një elan të zhvillimit, u bënë investime të mëdha, dhe atëherë të gjithë fituan shansin, madje edhe Mehmet Kraja dhe Jakup Krasniqi, që të participojnë në atë realitet kompleks, qoftë përmes mimikrisë, qoftë si pjesë e lëvizjes ilegale, qoftë duke ndërtuar institucionet e autonomisë dhe ato kombëtare. Me të gjitha kufizimet që kanë ekzistuar, “Rilindja” si shtëpi botuese në atë kohë ka ribotuar dhe botuar shumë libra që konsiderohen shtyllat e edukatës kombëtare. Sipas meje, edhe ky ka qenë jugosllavizëm! Unë ndërkaq, nuk kam qenë pjesë e kësaj, as e LKJ-së as e edukatave kombëtare, sepse edhe në pjesët tjera të Jugosllavisë ka qenë trendi i njëjtë, dhe gjithkund promotori dhe njëkohësisht transmisioni dhe zbutësi i nacionalizmave ka qenë Lidhja e komunistëve. “Jugosllavizmi” im ka qenë jashtë kësaj sheme, i një rrjeti jashtë LKJ dhe titizmit si ideologji, i bazuar në vlerat kozmopolite, jashtë matricave kombëtare dhe nacionaliste.

Tetëdhjetat

Mbi shpërthimin e vullkanit serb

BH: Tani do të doja të kalonim edhe një herë te ajo periudhë pas kryerjes së studimeve, kur ti ishe me një këmbë në Beograd, dhe me tjetrën në Prishtinë. Është fundi i '70 dhe fillimi i '80. Vdiq Titoja dhe gjithçka ndryshojë në Jugosllavi. Në librin tënd “Nyja e Kosovës: As Vllasi as Millosheviçi”, si përmbledhje e shkrimeve publicistike të asaj kohe, është një artikull që e ke titulluar, nëse nuk gaboj, “Ushtima e vullkanit serb”...

ShM: Po, kështu është. Një prej atyre shkrimeve që i botoja në javoren Teleks, në gjuhën sllovene... Por, reflekton fundin e '80-ve....

BH: Mua më intereson fillimi i '80-ve, pasi që u ktheve në Kosovë, dhe kjo në aspektin e bindjeve që kishe atëherë. Ti në atë kohë punoje në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës. Çfarë lexoje? Çfarë ndikoi, apo çfarë ndryshoi jetën tënde? Cilat ishin idetë e një shqiptari që jetonte i integruar në botën e kryeqytetit të Jugosllavisë, dha kishte vendosur që të kthehej në vendlindje? Si e ke parë perspektivën tënde para dhe gjatë asaj thyerjeje të parë,

tërmetit të parë, të vullkanit serb, i cili më pas do të shpërthente aq fuqishëm...?

ShM: Kjo figurë e vullkanit, e thash, ka qenë një diagnozë e mëvonshme. Në periudhën për të cilën më pyet, unë nuk e perceptoja ashtu gjendjen, ose e kam menduar këtë si një mundësi mjaftë të largët. Sa për bindjet, të them të drejtën, në atë kohë unë nuk kisha ndonjë teori, ose ide udhëheqëse, ose autor apo libër të veçantë, që do ta veçoja se ka pas ndikim themelor, përcaktues... Leximet e mia kanë qenë të shumta, kisha bërë një goxha bibliotekë personale, shumica në gjuhën serbokroate dhe shqipe, dhe diçka edhe anglisht dhe rusisht. Vazhdoja të lexoja për mesjetën, për estetikën bizantine, por edhe filozofinë e kohës, librat që përkteheshin në atë kohë, kryesisht autorët marksist, të shkollës së Frankfurtit, Adornon, Horkheimerin, Habermasin, dhe sidomos Benjaminin. I lexoja edhe autorët që ishin në modë, strukturalistët dhe poststrukturalistët. Por, këto kanë qenë më shumë lexime informative, se sa studime. Nuk u thelloja shumë, nuk preokupohesha që të ndërtoja një bindje dhe teori timen, që të isha më afër me këtë apo atë autor, të përcaktohesha si marksist, apo diçka tjetër.

Ambiciet letrare

Atëherë kishte filluar debati për marksizmin, se mos është tejkaluar, mos i takonte më shumë ideologjive të shek. XIX dhe jo fundit të shek. XX, dhe nuk përkonte më me zhvillimet e proceseve dhe sfidave që Marksi dhe marksizmi as që kanë mundur t'i imanigjinonin në kohën e tyre. Unë isha relativist dhe indiferent për këtë, ose nuk gjeja përgjigjen për pyetjet që edhe nuk i shtroja qartë. Ndoshta kjo ka qenë arsyeja pse gjithnjë e më shumë po orientohesha në fushën e estetikës dhe artit,

në kohën kur po dilja nga, të them ashtu, manastiret dhe asketika e mesjetës, dhe po kthehesha në realitet, në sfidat e artit më bashkëkohor, në artin abstrakt, enformelin, minimalizmin, pop-artin etj. dhe sidomos në praktikat radikale të artit konceptual. Po kështu kam tentuar që të jam korrent me poezinë, letërsinë dhe dramturigjinë e kohës, ku gjithnjë sikur kërkoja ndonjë model për vetën, për ambicjen që të bëhem shkrimtar, por nuk e gjeja, ose kuptoja shpejt se isha me shije më i vonuar seç ishin ato modele... E pata nisur në atë kohë një poemë ambicioze, që ka mbetur e pambaruar, një torzo që i ka disa pjesë shumë të bukura dhe të fuqishme, po nuk e pata gjetë mbarimin dhe formën definitive. Nuk e kisha qetësinë dhe koncentrimin që ta kryeja si duhet. Ajo poemë ishte një frymëzim i çastit, shpërtheu fuqishëm brenda meje deri sa po udhëtoja me autobus nga qendra e Beogradit në lagjen Senjak, ku pata banur një kohë. Ishte si një delir i brendshëm. Pesëmbëdhjetë apo njëzet minuta më vinin vargjetë me bollëk sikur ishte hapur një ujëvarë e madhe e rrëfimit poetik në mua, dhe unë në atë trans po imagjinoja sikur më është paraqitur Gijom Apolineri, kinse po udhëtonim me autobus urban, rrugës Ballkanit, dhe unë po i thosha vargjet atij. Pra, ishte diçka e ngjashme me Komedinë Hyjnore të Dantes, ku poeti udhëton nëpër nivelet e ndryshme të Ferrit i përcjellur nga Virgjili...

BH: E ke shkruar shqip?

ShM: Jo serbisht, por më vonë e kam përkthyer edhe shqip ashtu si torzo... Jam i bindur se si poet nuk isha i patalentuar, por sikur më mungonte pasioni dhe përkushtimi... Në të vërtetë, deri nga mesi i '80 vonesa nuk më shqetësonte, mendoja se më mungon vetëm qetësia shpirtërore. Mirëpo, atëherë më kapi historia... Jeta ime po ndryshon-

te. Isha kthyer në Prishtinë, pas një viti u martova, më 1984 lindi edhe djali Agoni, dhe mua, si edhe të tjerët, gjithnjë e më shumë më preokuponte dhe gëlltiste politika ditore. Për më shumë u pata bërë brenda natës i “famshëm”, dhe botoja shkrime publicistike në revistat më të njohura jugosllave, dhe këto angazhime e ngulfatën poetin...

Për të shpjeguar dilemën prej shkrimtari dhe dështimin, ndoshta është më i mirë shembulli i një drame që e shkruaja nga fundi i ‘70, ku për subjekt e kisha një grup revolucionarësh në arratisje, të cilët strehohen në një manastir te një prift që ishte jatak i tyre. E kisha konceptuar ashtu që ata ishin të ndjekur për terrorizëm, por në fazën kur fillon të çahet besimi në terrorin revolucionar si mjet për ndryshimin e botës. Ideja që kisha konsistonte në atë se terrori revolucionar duhet të ballafaqohet me krizën morale kur protagonistët kuptojnë se dhuna nuk mund të shndërrohet në shtytës të revolucionit të vërtetë, sepse masa, pjesa dërmuese e popullit, mbetet indiferente, ose deklarohet kundër terrorit dhe mbron sistemin ekzistues. Në atë izolim, të lodhur nga ndjekja, disa prej revolucionarëve të imagjinuar nisën të hamenden, shtrojnë pyetjen se a është faza e atëhershme, e kisha parasysh përvojat e Brigadave të Kuqe në Gjermani dhe Itali, vetëm një moment i depressionit, i kalueshëm, një ndalesë e vogël në rrugëtimin e pashmangshëm drejt revolucionit, apo, megjithatë, një si konstantë, një mur që përherë paraqitet duke e pamundësuar ndryshimin. Nëse terrori nuk realizon qëllimin e synuar, atëherë është i paarsyetueshëm, mbetet ajo çka është, një krim i vrazhdë dhe i pajustificueshëm.

I pata shkruar nja 5 apo 6 pamje të kësaj drame, por e lash krejt kur e pat lexuar një shoqe imja dhe më tha se e kisha bërë tepër të klishezuar... Edhe pse unë e kisha parasysh, madje edhe si pikënisje “Du-

art e papastra” të Sartrit, e kuptova se më mungon qasja e kohës, sepse dramat atëherë nuk kishin më atë strukturë sartriane, por dominonte teatri i absurdit dhe eksperimentet avangardiste. Në vend të dramës unë kisha bërë dijalog filozofik apo eseistik. Dhe unë i grisa ato letra për të filluar ndryshe, por nuk e bëra fare... Tani që nuk i kam më ato skica, nuk di nëse kam gabuar, ndoshta kanë mundur të ndreqen. Por, e di saktësisht në çka kishte menduar shoqja ime, pse mendonte se shkrimi im ishte demode, sepse atëherë si model i dramës së mirë ishin slloveni/serbi Dushan Jovanoviç, kroati Slobodan Shnajder dhe maqedoni Goran Stafanovski, serbi Dushko Kovaçeviç, që dominonin teatrin jugosllav. Edhe për këtë projekt të dramës, kur e grisa draftin e parë, mendoja se duhet dhe mund të piqet, se do të mund ta realizoja më vonë. Por, ndodhi që për mua nuk kishte më “më vonë”. Sepse më vonë ndryshoi gjithçka, dhe ndryshove edhe unë. As ambicjet e mëheshme nuk kishin më kuptim. Dhe kështu, pa ndonjë traumë muzat ikën dhe unë u bëra publicist dhe analist...

Raportet kulturore Kosovë-Jugosllavi

BH: Kur fole për ndikimin e kontekstit të Jugosllavisë në një projekt drame, se po krahasoheshe me dramaturgët e kohës, më intereson mendimi yt për raportin kulturor Kosovë-Jugosllavi në atë kohë. Ndikimi i Jugosllavisë në Kosovë si bëhej? Roku, Bijelo dugme, Zdravko çoliq, Tereza Kesovia, Arsen Dediq, Oliver Dragojeviç etj, ishin fenomen i pëlqyer edhe në Kosovë. Për-

jekjet për shartimin e rokut edhe në Kosovë, a ishte pjesë e një sistemi të krijuar të ndikimit?

ShM: Ka ekzistuar në atë kohë rrjeti i televizioneve jugosllave, JRT, që prodhonte yjet e një hapësire të gjerë kulturore, jugosllave, ku edhe periferia deridiku kontribuonte, pra edhe maqedonët, sllovenët, hungarezët, pra pos serbëve, kroatëve, boshnjakëve dhe malazezëve që e kishin gjuhën e përbashkët, në atë kohë quhej gjuhë serbo-kroate ose kroato-serbe. Po, kultura jugosllave ndërtohej sipas modelit të pop kulturës botërore, dhe boshti i saj, si edhe i vetë shtetit, ishte gjuha serbokroate, dhe edhe sllovenishtja dhe maqedonishtja nuk ishin tepër larg kësaj gjuhe. Jashtë kësaj skeme ishin shqiptarët dhe hungarezët. Vetëm se edhe televizioni i Kosovës, në atë kohë quhej RTP, ishte pjesë e sistemit, dhe shumë yje të estradës jugosllave ishin yje edhe në Kosovë. Madje edhe ndikimet botërore në atë kohë vinin kryesisht përmes qendrave kulturore jugosllave, Beogradit, Zagrebit, Sarajevës, Lublanës... Edhe letërsia botërore vinte nga qendrat kulturore jugosllave, shumica e përkthimeve në shqip bëheshin nga serbokrotishtja. Edhe me rockun ishte njësoj, vetëm se me te lidhej brezi më i ri.

BH: Mos edhe lufta në Jugosllavi filloi së pari me këngët dhe grupet e Rokut? Secila republikë e kishte grupine e vet të rokut. Ishin krijuar konturat e teksteve nacionaliste. Po ndërtohej një sistem i vlerave të ndryshme ku bëhej garë me tekste nacionaliste dhe etnike?

ShM: Jo, lufta nuk ka filluar me rokun, assesi. Më parë me turbo follkun, që i ngjanë asaj që ne sot e quajmë muzikë tallava. Perëndimi i Jugosllavisë distancohej nga turbo-folku serb. Bosnja ishte e varur. Por Bosnja ishte promotor i rockut. Rocku ishte skene e këmbëshme.

Ne Beograd çmoheshin grupet Index, Azra, Film, Bijelo dugme, madje edhe Prljavo kazalishte... e në Zagreb e donin skenën e Beogradit, Idolët sidomos, por edhe Riblja Çorbën, Ekaterina Velika dhe, çka di, nuk më kujtohen më bendet e popullarizuara serbe. Unë nuk kam qenë fan i flaktë i rockut jugosllav... Kisha një shije selektive dhe isha rezistent ndaj muzikës për një arsye të çuditshme - për shkak të ndikimit që kishte në mua. Si poet që e konsideroja vetën, mendoja se muza që më rinte në krah dhe më inspironte dhe pëshpëriste fjalët gjysmë të qarta, kombinime të çuditshme konceptesh, fjalësh, imazhesh dhe vizionesh, nuk e duron muzikën, sidomos ato meloditë e muzikës së lehtë dhe zbavitëse, sepse nëse e dëgjoja në mëngjes një melodi të tillë ajo më ngjitej dhe më ndiqte tërë ditën, dhe sikur e dehte dhe bllokonte inspirimin, dhe unë nuk mund ta gjeja dhe dëgjoja melodinë dhe orën time të brendshme... S'di nëse jam i qartë me këtë... Kjo më orën do të thotë se unë vërtet në çdo moment, edhe nëse zgjohesha papritur natën, e dija orën e saktë, kuptohet, jo bash me sekonda, po disi afërsisht saktë me disa minuta tolerancë ...

Dhe këto pastaj, muza, ora, shumë interesime të veçanta që kam pas, janë zbehur dhe zhdukur, dhe jo vetëm pse kam kaluar nga Beogradi në Prishtinë, jo pse e kam ndërruar ambientin jetësor, por sepse ndodhi ai erupcioni, shpërthimi i historisë, që e bëri rrëmujë krejt Jugosllavinë, po që nuk e kuptuam menjëherë, duhej të kalonin disa vite që të bindemi se shpërthimi edhe nuk ka qenë krejt i paparalajmëruar dhe i befasishtëm, por i përgatitur në ato vite kur edhe unë po ndryshoja. Ose edhe shumë më herët, nga çarjet dhe plagët e shumta që kishte pasur ai vend, e që në një periudhë, atë të Titos, ishin mbuluar disi duke krijuar një stabilitet të përkohshëm mashtrues...

Mbi jugosllavizmin

BH: Ju që ishin rritur në Jugosllavi nuk liroheshit lehtë nga ideja e këtij shteti?

ShM: Zhgënjimi ishte proces. Disa kanë qenë që nga fillimi armik të Jugosllavisë, por e mbanin këtë të fshehtë. Disa janë vetëdijuesar me ngadalë. Ata të indoktrinuar e kanë pas më vështirë, por kur u paraqit dilema Jugosllavia apo Serbia, dhe pastaj u pa se Jugosllavia po shembet, edhe këta e kuptuan se e vetmja zgjedhje mbetet Kosova, se duhet të mbrohet Kosova dhe të drejtat e shqiptarëve. Dhe i doli boja edhe asaj kontradikte që kishte federata jugosllave, duke u vetëdefinuuar si shtet i sllavëve të jugut, ku atëherë logjikisht shqiptarët mbeteshin jashtë, si të huaj.

Këtë situatë të zhgënjimit e kam krahasuar shpesh me profilin e madh të personazheve shumë të rëndësishme të historisë shqiptare, p.sh. Ismail Qemajlin, i cili në biografinë e vetë pohon se deri në kohën e revolucionit Xhonturq, ka qenë jo vetëm administrator i dalluar i Perandorisë Otomane por edhe besnik dhe idhtarë i reformimit të saj në një federatë moderne të popujve të barabartë, ku edhe shqiptarët do të kishin hisen e vetë, njësinë federale, që do të përfaqësohej në Kuvendin qendror të shtetit të reformuar. Por, kur xhonturqit dolën me idenë e nacionalizmit turk, se në të gjitha pjesët e perandorisë popullsia myslimane është për nga kombësia turke, kjo binte ndesh me idenë e tij se shqiptarët janë komb me vete, sikur edhe grekët, bullgarët, serbët, armenët etj. dhe jo material për asimilim. Kështu, i ndjekur nga xhonturqit dhe i arratisur në Perëndim, në momentin kur filluan të krijoheshin shtetet kombëtare mbi baza etnike, Ismail Qemali kthehet

në Shqipëri dhe vihet në krye të nacionalizmës shqiptare duke e ngritur edhe flamurin e pavarësisë në Vlorë.

Edhe në Kosovën e periudhës së shkatërrimit të Jugosllavisë shumë veta kanë kaluar kësi lloj transformimi, kanë qenë administrator, profesorë, ideologë, etj. që përfitonin mjaft në federatën jugosllave, por kur kjo federatë humbi kuptimin u kthyen në atëdhetarë shqiptarë. Kjo është normale. Më 1912, pastaj edhe me Versajen, Jaltën dhe Konferencën e Parisit, Kosova kishte mbetur e ndarë nga Shqipëria, por ja që pas rënies së komunizmit u hapën disa mundësi dhe procese që ishin ndalur kaheerë. Vetëdijesimi për këtë nuk ka ndodh menjëherë, por ishte i pashmangshëm. Ka pas shumë faktorë që kanë ndikuar, por kryesori ka qenë Titoja. Për 40 vjet, që nga kryengritja e vitit 1941, ai i ka dhënë një jetë të dytë Jugosllavisë, duke e shndërruar në federatë. Pas vdekjes së tij, filloj shembja që ka zgjatë plotë 11 vjet. Në të vërtetë, nëse pavarësimin e Kosovës e marrim si aktin e fundit të shpërbërjes së Jugosllavisë, atëherë ka zgjat më shumë se një brez, 28 vjet.

A e donin shqiptarët Titon

BH: Kur e përmende sërish Titon, edhe pse kemi fol për të më herët, dua ti rikujtojmë disa fakte që meritojnë koment. Më 1979, kur e vizitoj për herë të fundit Kosovën, ky ka qenë ndoshta udhëtimi i fundit i tij para sëmundjes, në Prishtinë dolën ta presin Titon me qindra mijëra vetë. Kuptohet, ka qenë një dalje e organizuar, e punëtoreve, nëpunësve dhe shkollave, nga ana e LKJ dhe pushteti, por, megjithatë, nuk ishte vetëm detyrimi që i nxirte njerëzit në rrugë që ta shohin dhe përshëndesin lider-

in, prijësin... Pse gjithë ky popullaritet i këtij njeriu? A ka qenë edhe Titoja, siç thonë disa sot, vetëm katil dhe mashtrues kolosal i shqiptarëve, apo ka pas edhe vlera që e kanë arsyetuar kultin e tij? Më herët ke fol për qëndrimin tënd ndaj Titos, nuk do të kthehesha te kjo, por te vlerësimi yt i kultit të Titos te shqiptarët, në atë pjesën që ka qenë vullnetar, jo i imponuar, jo hipokrit, edhe deri në ato vite të kthesës. Sepse unë nuk harroj që edhe më 1989, demonstruesit në Kosovë para Komitetit i kanë bartur fotografitë e Titos, si përgjigje për Millosheviçin, dhe me këtë demonstrim lojaliteti, provuan ta shpëtojnë autonominë.

ShM: Po, sot ka shumë skema në interpretimin e asaj periudhe. Kanë ardhur brezat e ri, edhe ai i LDK-së, më vonë edhe i UÇK-së, që pretendojnë se ky realitet i ri është diçka që kanë ndërtuar ata, gati ekskluzivisht ata. Kurse, në të vërtetë, ata kanë ndërtuar dhe riparuar në shumë fusha atë çka është bërë dhe ndërtuar, kuptohet me batica dhe zbatika, në kohën e Titos. Ta marrim si shembull vetëm sistemin shkollor dhe Universitetin e Prishtinës, i cili në vitin 1991 përbëhej nga rreth 450 mijë nxënësish dhe pedagogësh e administratorësh. Pas vitit 1991, kur Serbia deshë që ta shkatërrojë këtë sistem, ai u tregua sistem mjaft rezistues, dhe nuk është vetëm merita e LDK-së apo Ibrahim Rugovës, që ai mbeti funksional. LDK-ja pretendonte se i gjithë sistemi paralel i rezistencës ka qenë zbulim i tyre, ose madje i gjeniut të Rugovës. Kjo thjesht nuk është e saktë, sepse UP-ja ka funksionuar si në kohën e autonomisë, me stafin dhe strukturën e njëjtë, madje në ato vite që punonte jashtë godinave, si universiteti i rezistencës, UP ja i ka rezistuar njëkohësisht edhe kontrollit të LDK-së, sepse ka qenë një organizëm i fuqishëm në vete edhe para LDK-së. Nuk mund ti merren, pra, meritat

atyre që e kanë krijuar këtë sistem, me sakrificë por edhe kompromise, dhe këta janë brezi i komunistëve të Kosovës, i Fadil Hoxhës, Xhavit Nimanit etj, ose edhe e Esat Mekulit... Me këtë nuk dua ta mohoj rolin e LDK-së dhe të Rugovës në fazën e mbrojtjes së legatit të autonomisë në fushat ku ka mundur të mbrohet, në arsim, në mediat, në kulturë. Në të vërtetë, rugovistët këtë e bënin me mjaftë dro, kishin kujdes mos ta përmendnin shumë legalitetin e autonomisë, sepse kërkesa ishte avancuar për republikë dhe shtet të pavarur, ndërkaq që efektivisht të gjitha shtyllat e rezistencës, ajo që shihej dhe mbante gjallë sistemin paralel të viteve '90, ishin thjesht po ato institucione të autonomisë, që Kushtetuta e Kaçanikut i kishte avancuar në institucione të Republikës së Kosovës, por që në shumë fusha mbetej pezull, vetëm projekt në letër, pa ushtri dhe institucion klasike të shtetit. Pra, kështu qëndronin punët dhe sot kjo nuk ka nevojë që të maskohet dhe mistifikohet. Ashtu sikur që nuk duhet të minimizohen dhe hudhën poshtë as meritat e Rugovës dhe LDK-së në mbajtjen e sistemit paralel, dhe internacionalizmin e çështjes së Kosovës, siç bëjnë disa partizanë dhe ideologë të UÇK-së, të cilët mendojnë se realiteti i ri ka filluar me revolucionin dhe rebelimin e armatosur. Ata i mohojnë edhe meritat e brezit të Fadil Hoxhës dhe Mahmut Bakallit, pra të kohës së autonomisë, edhe ato të brezit të Fehmi Aganit dhe Ibrahim Rugovës. Kjo nuk qëndron. Dhe këtë kosovarët e kanë ditë mirë në vitin 1989, kur ende ishte gjallë kulti i Titos, sepse ai përjetohej si një ikonë që mbronte vlerat që nuk mund të tjetërsoheshin, pra sistemi arsimor, UP-ja, kultura kosovare, shtypi..., në kuptimin se këto nuk ishin vlera "ideologjike" dhe "komuniste", por vlera të civilizimit që qëndrojnë mbi ideologjinë, duke qenë një realitet, madje edhe themel i ekzistencës moderne të shoqërisë kosovare...

Unë kam pas edhe vetë qëndrimet shumë kritike për atë se çka dhe si është ndërtuar Kosova në kohën e socializmit, por s'dua tua marrë hakun për atë çka është bërë në atë kohë. Nëse sot shikohet Prishtina, si dhe qytetet tjera, lehtë mund të konstatohet se gati të gjitha objektet publike kapitale, ku disa prej tyre kanë edhe vlera arhitektonike, apo të infrastrukturës, janë të asaj kohe...

BH: Po, sërish, ka diçka që nuk shkon këtu. Në vitin 1981 demonstruesit kosovar kishin kërkuar Republikën e Kosovës. Vetëm tetë vite më vonë ata po kërkonin mbrojtjen e autonomisë duke i lidhur flamujt Jugosllavë dhe shqiptarë. Si e shpjegon fenomenin e tërheqjes dhe politikën që prezantonte një jugosllavizëm me simbolikë flamujsh?

ShM: Nuk ishte tërheqje. Ishin struktura tjera që organizuan 1981, dhe tjera ato që organizuan 1988-shin. Ishte një manifestim i jashtëm për mbrojtjen e autonomisë. Ishte përmbledhje simbolike e idesë se Kosova mund të mbetet si e barabartë në Jugosllavi, dhe jo si e nënsh-truar në Serbi. Edhe fotografitë e Titos ishin në atë ikonografi që kishte porosinë "Tito - po, Millosheviçi - jo!" Por ato fotografi dhe flamuj nuk besoj se dolën spontanisht, por kanë qenë me porosi të liderëve komunistë të Kosovës.

BH: Azem Vllasit?

ShM: Po, edhe atij, ose Kaqusha Jasharit, apo edhe të tjerëve që udhëheqnin institucionet dhe firmat e mëdha. Në atë moment Kosova kërkonte ndihmë nga Jugosllavia, ende jo nga bota, dhe ky shtet ende ishte komunist. Ende kishte mbetur pak shpresë se niveli i pushtetit federal do të mund të ndalte agresionin serb që po merrte hov në tërë

Jugosllavinë, pasi që Millosheviçi kishte organizuar një seri mitingjesh të mëdha të nacionalistëve serb që i hakërrroheshin dhe kërcënoni të gjithë, kroatët, sllovenët, shqiptarët etj. Nuk duhet harruar se Lidhja e Komunistëve në Kosovë në atë kohë kishte mbi 100 mijë anëtarë. Protestat e nëntorit të vitit 1988 kishin për qëllim mbrotjen e kushtetutës së Kosovës, përkrahjen e lidërshiptit kosovar, konkretisht Azem Vllasit, dhe shfaqjen e një kufiri të vullnetit të shqiptarëve: deri këtu kemi qenë të durueshëm, por po kalohet vija e kuqe. Marshimet protestuese të mijëra kosovarëve nëpër acar dhe borë ia patën prish pak shijën e triumfit të madh që e ndiente Millosheviçi, pasi që ato ditë po përgadiste një miting në Ushqe, një pjesën e Beogradit në brigjet e Danubit dhe Savës, aty ku këta lumenj bashkohen. Në këtë miting thuhej se ishin mbledhur mbi një milion veta, propaganda thoshte se kanë qenë dy milion ose edhe më shumë. Ky miting i Ushqes kishte simbolikë të dyfishtë. Aty përballë gjendej selia qendrore e LKJ-së, që nominalisht ishte qendra e pushtetit në federatë, dhe Millosheviçi po e sfidonte para hundëve sovranin duke treguar se kush është zot shtëpie në Beograd. Nga ana tjetër ky vend ku Sava derdhet në Danub, dy lumenjtë më të madh të rajonit, ishte zgjedhur edhe për të shfaqur aspiratën e fuqisë rajonale, sepse simbolikisht aty ishte edhe qendra gjeostrategjike dhe politike jo vetëm e Jugosllavisë por edhe e rajonit. Të pakten ashtu besonte Millosheviçi, por nuk i doli hesapi. Lidhja e flamurit shqiptar në nyje me atë të Jugosllavisë, dhe bartja e fotografive të Titos, ishte pra një reagim ndaj ikonografisë dhe pretendimeve serbomadhe. Dhe me atë manifestim, dhe pastaj edhe grevën e minatorëve në zgafellat disa muaj më vonë, u shemben edhe iluzionet e fundit, u hoqën maskat edhe të Milosheviçit, i cili karrieren edhe ai e filloi si mbrojtës i Titos,

por edhe të titizmit kosovar. U kuptua që atëherë se kjo nuk është rruga e shpëtimit, dhe kjo edhe i dha fund komunizmit dhe jugosllavizmit në Kosovë, dhe u çel rruga për homogjenizimin që do të pjellë rezistencat e viteve '90, atë paqësoren, de atë të armatosur.

Titizmi dhe enverizmi në Kosovë

BH: Ju po thoni se komunizmi në Kosovë morri fund në atë kohë, po edhe mendime tjera. Disa thonë se konflikti ideologjik në Kosovë ndër shqiptarët në vitet '70 dhe '80 ka qenë konflikt i dy ideologjive komuniste, titizmit dhe marksizëm-leninizmit apo enverizmit, dhe edhe du lëvizjet e nëntëdhjetave i shohi9n si vazhdimësi e konfliktit të këtyre dy komunizmave. Edhe sot shpesh thuhet se LDK-ja është një çerdhe e komunizmit jugosllav. Dhe çka në këtë kontekst mendon për grupet marksiste-leniniste? Pse ndodhi që pikërisht këto grupe u bënë pjesë e një skenari dhe një ideje që zgjati për shumë vite?

ShM: Grupet marksist-leniniste sa i përket ideologjisë mua më dukeshin anakronike, sepse ato nuk ishin as marksiste e as leniniste por kryesisht staliniste. Enveri pat mbetur besnik i Stalinit dhe sundonte me Shqipërinë me tipin stalinian të diktaturës së vrazhdtë të proletariatit, nga e cila më 1956 kishte heq dorë edhe vetë Bashkimi Sovjetik. Por në Kosovë këto grupe në të vërtetë vepronin si grupe nacionaliste, për kauzën e bashkimit kombëtar. Vetëm se çështja e bashkimit në atë kohë nuk shtrohej si opcion realist. Edhe te shumica e enveristëve kosovarë po kështu mbizotëronte realizmi se në çfarë rrethana dhe kur mund të realizohet bashkimi kombëtar. Rruga për bashkimin ishte që

Kosova së pari të bëhet republikë e barabartë në federatën jugosllave. Edhe titistët kosovarë në esencë e synonin këtë, Kosovën republikë, por e kishin më të kushtëzuar, e shikonin si proces më afatgjatë, pasi që të forcohet mirë pozita e Kushtetutës së vitit 1974, që Kosovës i jepte shumë ingerenca të republikës dhe fuqinë konstitutive në federatën jugosllave. Për sfidën e enveristëve, sidomos pas demonstratave të vitit 1981, kur u kërkua publikisht republika, titistët në Kosovë thoshin se ishte paraqitje e parakohëshme dhe kontraproduktive, që Serbisë i dha pretekst për kundërshtim dhe degradimin e pozitës së Kosovës.

Në vitet '80 të dy këto opsionet u detyruan që të dalin në defansivë, dhe nga fundi i '80 pësuan edhe titistët edhe enveristët, pasi që u shemb vetë komunizmi. Lëvizja që doli në skenë më 1989, LDK-ja dhe partitë tjera, njëfarëdore arritën që të bëjnë një bashkëdyzim të dy platformave sepse kërkesa kryesore në të gjitha variantët u shpalo si kërkesa për republikë, e cila megjithatë kushtëzohej me rrethanat dhe "diktatin" e të drejtës ndërkombëtare. Kjo më së mirë është shprehur në ato tri opsionet të alternativës kosovare nga viti 1990, që shprehnin në mënyrë elastike tri mundësitë për jetësimin e Republikës së Kosovës: 1) nëse mbetet federata jugosllave, Kosova të bëhet republikë e shtatë e kësaj federate; 2) nëse rikomponohet Jugosllavia sipas parimit etnik, trevat shqiptare duhet të bashkohen në një njësi federale; dhe 3) nëse shpërbëhet Jugosllavia, Kosova duhet të shkëputet duke organizuar plebishitin për pavarësi apo bashkim me Shqipërinë. Ky elasticitet i momentit, edhe pse disave u dukej qesharak, si pavendosmëri, ishte një gjë pozitive, dhe besoj edhe shprehje e një uniteti sepse secili aty e gjente veten. Homogjenizimi dhe mobilizimi ishte i fuqishëm dhe përfshirës dhe për një kohë u harruan animozitetet, edhe pse nuk

ishin zhdukur. Atëherë, në atë atmosferë ndodhi edhe pajtimi i madh i gjaqeve... Koincidenca ishte që kur në skenë doli LDK-ja si lëvizje e madhe dhe homogjenizuese, atëherë u pat shemb edhe Muri i Berlinit si një kulm i krizës së thellë të komunizmit në Evropë, kështu që edhe grupet marksiste-leniniste në Kosovë nga ky ndyshim dolën jo pak të trullosura dhe me ndjenje të humbësve. Një pjesë e tyre në ato kushte ia mësyn LDK-së me qëllimin që “ta pushtojnë kalanë nga brenda”, por aty megjithatë mbetën inferiorë. Vetëm se ky grupacion pak më vonë luajti një rol vendimtar në kryengritjen e armatosur.

Megjithatë, duhet saktësuar se kjo kryengritje nuk ishte në thelb marksiste-leniniste, në kuptimin se synohej revolucioni apo jetësimi i enverizmit, por u paraqit me atë çka LDK-ja nuk mundi ose nuk arriti ta bëjë, e krijojë armatën e lëvizjes çlirimtare, UÇK-në. Militantizmi i këtyre djelmoshave, një pjesë e tyre janë “kalitur” burgjeve të ish Jugosllavisë, e ka pas peshën e vetë të madhe në zhvillimet historike. Sot mund të duket si një skenar, se rolet kanë qenë të parapërcaktuara, por nuk është ashtu. Është e saktë se opsionet kanë qenë aty prej kohësh, dhe rrethanat e kanë bërë që të gjitha ato t'i kanë 5 minutat e veta, dhe më në fund edhe bota e pa se çka po ndodh dhe në vitin 1999, intervenoi për ta shpëtuar Kosovën nga një agresor superior dhe i pamëshirshëm, çfarë ishte Serbia e Millosheviçit.

Qorrfermanet e Serbisë

BH: Kur e përmende Serbinë, cili ishte roli i saj në gjithë këto procese? A nuk ndërhynte dhe ndikonte fuqishëm edhe Serbia në zhvillimet me presionet, burgosjet e grupeve militante dhe të

liderëve? Serbia ka sulmuar edhe titistët, shembull janë Mahmut Bakalli, Xhavit Nimani, Pajazit Nushi, më vonë edhe Azem Vlasi, e edhe, në përpjesa më të mëdha, marksistët-leninistët, si, Mehmet Hajrizi, Hidajet Hyseni, Sabri Novosella, Bajram Kosumi, të mos përmendi brezin e Adem Dmaçit...

ShM: Po, ke drejtë, Serbia ka udhëhequr në Kosovë strategjinë otomane të “prerjes së kokave” të liderëve. Kuptohet, nuk ka mundur t’i likuidojë si me një ferman të sultanit, siç ka e përshkruar Ismail Kadare vrasjen masive e me dredhi të parisë të shqiptarëve në novelën “Komisioni i festës”. Serbia këtë e bënte përmes diferencimeve, komprometimeve, burgosjeve dhe largimit nga pushteti, në mënyrë që Kosova të mbetet pa lidërsip të aftë dhe të vendosur. Në vitin 1981 caku i parë ka qenë brezi i Fadil Hoxhës, por nuk është arritur që kjo të bëhet menjëherë. Fadili kishte ende përkrahje në nivelet e federatës. Ai do të sulmohet më vonë pasi që mediat serbe e patën nxjerrë një gjysmëfjali të tij nga konteksti i një bisede ku ai i kishte përmendur dhunimet si fenomen që del nga frustrimi i meshkujve në Kosovë, dhe në shaka kishte përmendur mundësinë që në Kosovë të “importohen” prostitutat nga jashtë. Sot një shaka e tillë të çon mendjen në moldavkat dhe ukrainaset e gjora që trafikohen nga kriminelët e ndryshëm, kurse atëherë mediat serbe spekuluan se Fadili kishte aluduar në gratë serbe dhe moralin e tyre. Dhe gratë serbe edhe e patën organizuar një protestë para shtëpisë së tij duke bërë titur “Mi nismo kurve” (Nuk jemi kurva). Kështu, Beogradi nuk zgjedhte mjete. Qëllimi ishte jo vetëm anulimi i autonomisë së Kosovës por edhe ndryshimi i Kushtetutës së vitit 1974, i sitemit jugosllav, nga konfederata, në shtet unitar ku do të rikthehej hegjemonia serbe, si popull më i madh me numër në atë

shtet. Beogradi synonte në Kosovë dhe vendet tjera instalimin e liderëve kukulla, si p.sh. atë karikaturë prej njeriu, Sejdo Bajramoviçin, një hiq si njeri e politikan, të cilin Milosheviçi e pat zgjedhur që të jetë përfaqësues i Kosovës në Kryesinë e Jugosllavisë në periudhën më delikate para shkatërrimit të federatës. Një tjetër figurë si ky në Vojvodinë ishte Mihal Kertesi.

BH: Periudha e diferencimit si dukej? Çfarë shihte Shkëlzeni në Kosovën e viteve të Vllasit? Kush ishin njerëzit e politikës dhe kush ishin intelektualët e asaj kohe? Çfarë mund të thuash për kakofoninë politike dhe intelektuale të asaj periudhe?

ShM: Ishte një atmosferë shumë e rëndë. Kur u ktheva unë në Prishtinë, diferencimi më drastik ishte kryer dhe tashti po vazhdonin bishtat, presione individuale, kontrolli i universitetit dhe mediave. Udhëheqësia kosovare në atë kohë ishte në defanzivë, është mundur të tregohet lojale por, siç e thash më herët, për ta mbrojtur autonominë dhe hequr gjendjen e jashtëzakonshme. Njerëzit më të aftë që kishte Kosova, si Mahmut Bakalli, ishin të kërcënuar dhe marginalizuar, dhe policia sekrete po ua ndiqte çdo hap të tyre. Edhe nëse Mahmuti shkonte në gjyeti, kjo bëhej problem publik. Intelektualët ishin të frikësuar, mediat po kështu. Por, ka pas njerëz me dinjitet që nuk i dorëzoheshin presioneve. Në komitetin krahinor të atëhershëm ishte krijuar komisioni ku i ftonin intelektualët që të binden për të shkruar artikuj kundër nacionalizmit shqiptar apo kundër regjimit të Enver Hoxhës dhe Shqipërisë. Kur y ktheva në Priushtinë, ishte fundi i vitit 1982, fillimi i 1983, shpesh dëgjoja storien se si Komiteti e kishte bërë një listë temash, si detyrë shtëpie, dhe anash ishin shkruar emrat e profesorëve, shkrimtarëve dhe personaliteteve publike shqiptare, që disa ishin më

afër me regjimin, disa mbaheshin më afër shkencës dhe profesionit, që duhej të bënin këto “detyra shtëpie” të lojalitetit. Kjo ishte edhe një përpjekje e udhëheqësisë kosovare, që intelektualisht nuk ishte shumë e ngritur, - i mungonte atëherë Bakalli me brezin e tij të politikanëve të shkolluar, - që të tregojnë se në Kosovë situata është nën kontroll dhe se inteligjenca e Kosovës nuk është kundër Jugosllavisë.

Pse nuk shkrova recensionin për librin “Titistët”

BH: Ti a ke pas këso detyra të shfaqjes së lojaliteti?

ShM: Unë nuk isha në parti e as në universitet. Në një moment pata një ofertë nga “Rilindja” që të bëjë një recension të librit të Enver Hoxhës “Titistët” që sapo ishte botuar në Tiranë. Nuk ishte as urdhër as kërkesë me presion, thjesht redaktorët e kishin hallin që ta gjejnë një person që do ta bënte këtë punë, sepse e kishin marrë për detyrë nga instancat më të larta. Dhe dikush ish kujtuar të më ftonte mua.

BH: E pranove? Kush ta bëri kërkesën?

ShM: Po ka qenë dikush i redaksisë së brendshme, Zenun Çelaj ose Mustafa Rushit, nuk më kujtohet saktë, dhe nuk është me rëndësi, ata vetëm e bënin detyrën që kishin, sepse edhe ata ishin nën dyshime se nuk janë vigjilentë dhe nuk po kontribuojnë sa duhet në luftimin e nacionalizmit shqiptar dhe enverizimit. Por, unë vërtetë isha shumë kureshtar për ta lexuar librin, nuk kisha lexuar asnjë gjë nga Enveri... U thash se do të doja ta lexoj dhe pastaj të vendos, dhe ata ma sollën pas disa ditësh. Ishte libër zhgënjyes, tepër i dobët, as histori as analizë e proceseve. Nuk e bëra recensionin. Jo që nuk më kruhej dora, kishte shumë sende që kisha qejf ti komentoja, por nuk isha aspak i gatshëm

që të bëja shërbimin regjimit të atëhershëm kosovar dhe jugosllav. E ndieja vetën gjysmëdisidentë. Edhe pse babain, Mehmetin, e kisha në pushtet, ishte madje në postin e frikshëm të ministrit të rendit, unë kisha rezerva ndaj pushtetit, sikur që edhe pushteti kishte rezerva ndaj meje. Nuk më pranonin e as nuk më ofronin asgjë dhe pse ti bëja një shërbim të tillë. Nga ana tjetër, të shkruaja kundër Enverit ishte diçka tepër obliguese, ta bënte një stigmë të propagandistit, që unë nuk doja ta mbaja. Po ajo Rilindja që shumicën e teksteve të mia nuk i boton-te, ose i mbante në sirtarin e teksteve që pëlqeheshin por për të cilët thuhej se “për momentin nuk janë për botim”, tani kërkonte të futem në lojë, të bëhem lojal ndaj regjimit. Nuk ishte, pra, ndonjë zgjidhje e lirë prej intelektualit që ka pikëpamje të veta kritike për Enverin, por edhe për komunizmin jugosllav. Një ide që kisha atëherë, kur e shqyrtoja mundësinë e shkrimit të këtij recensionit, ishte që ta bëja një krahasim me Eduard Kardelin, sepse e shihja si një alter-ego të Titos që zhvillonte teorinë e komunizmit jugosllav, duke i krahasuar dhe kritikuar edhe njërin edhe tjetrin, për të dalë te perfundimi se Enveri më dukej shumë më dogmat, më malok i pagëdhendur në teori, se Kardeli, i cili po ashtu më dukej si teoricien shumë i dobët. Por, nëse do ta bëja këtë, shkrimi do të bëhej i pabotueshëm. Por, pos kësaj, problemi më i madh që kisha ishte se unë nuk kisha ndonjë qëndrim dhe teori pozitive, të themi të liberalit, demokratit apo social-demokratit etj., nga e cila do të bëja shqyrtimin dhe kritikën. Unë e kisha vetëm shijën e keqe më shumë estetike, më shumë të lexuesit të zhgënjyer, që nuk bindej aspak me ato politika dhe diskurse komuniste, që kishin shkruar me një fjalor shumë të varfër, ideologjik, propagandistik dhe manipulativ. Njëfarëdore, e kisha po atë konfuzionin dhe paqartësinë e vitit 1968 kur kinse u rebe-

luam e ne në të vërtetë nuk dinim për çka ishim rebeluar, e kishim të tabuizuar monizmin dhe kapitalizmin, besonim në progres dhe se nuk ka kthim prapa në pluripartizëm dhe ekonominë e tregut.

Si fabrikoheshin disidencat

BH: Ky sinqeritet i yti më duket interesant. Në memoaret e të tjerëve nuk haset shpesh kjo qasje të them ashtu autokritike...

ShM: Po, ka edhe memoare të sinqerta. P.sh. Mihailo Mihailov, një profesor nga Zara, pohon se është bërë njëri prej disidentëve më të njohur në Jugosllavi, gati pa hiri, sepse kishte provuar me e nxjerr një revistë për shkenca sociale, por pa e marrë lejen nga pushteti. Për këtë ate e fusin në burg dhe ai bëhet pastaj disident me karrierë që ka botuar libra dhe ka mbajtur për ofesura në Perëndim. Edhe shoku i tij në burgjet jugosllave, Adem Demaçi, në biografinë që e ka botuar një gazetar nga Mali i Zi, më duket se quhet Radonçiq, pohon se burgosja e parë e tij ka qenë e kurdisur nga UDBA ku ai nuk kishte pas as grup as idenë e organizimit kundër regjimit. Por burgju e kishte vetëdijësuar për pozitën e shqiptarëve në Jugosllavi, dhe herën e dytë ka rënë në burg sepse e kishte krijuar organizatën ilegale. Unë nuk kam qenë në burg. Dhe nuk kam qenë disidentë në kuptimin e mobilizimit dhe angazhimit politik kundër regjimit. Nëse ka qenë një lloj disidence, mund të quhet disidencë e rezignimit, e tërheqjes, jo aktive...

BH: Kur e përmende disidencës dhe rezistencën ndaj regjimit, si të dukej infrastruktura intelektuale në Kosovë në atë kohë? Sa

ishte e pavarur dhe sa e afërt me pushtetin? Apo kishte edhe huti dhe detyrim që të tregojë lojalitet ndaj sistemit dhe pushtetit

ShM: Nuk mund të gjeneralizohet, por me që ishte një inteligjencë që u paraqit dhe u ngrit me sistemin, ajo edhe detyrimisht mishërohej me të. Në vitet '50 dhe '60 ishte një kastë e vogël intelektualësh dhe ajo pothuajse e tëra thithej nga pushteti ose shërbimet publike, që kishin dy aspekte të rëndësishme, edhe të shërbimit kombëtar, - të gjithë këta intelektualë në zë, ta marrë shembullin e Esat Mekulit apo Hivzi Sulejmanit, e ndienin vetën në rolin e çmuar të arsimitarit dhe mësuesit të kombit, dhe nga ana tjetër ishin edhe të bindur se i kanë hipur trenit të përparimit historik, të krijimit të një shoqërie të re, komuniste, shoqëri kjo ideale që kur të realizohet një ditë do të sjell drejtësi më të madhe. Sllogani i komunizmit ishte: Të gjithë do të kontribuojnë sipas mundësive, kurse do të marrin dhe konsumojnë sipas dëshirës. Kjo ishte sikur një ideal i parajsës komuniste. Por, më pastaj, kur u masovizua arsimi dhe dolën brezat e ri, për ta nuk kishte më vende në pushtet me automatizëm, por duhej të lariteshin, të bëheshin lojal, të shtireshin, ose luanin lojën e mimikrisë, dhe atëherë veçohet edhe një kastë tjetër e inteligjencisë që mbeti jashtë ose kundër sistemit dhe e zbuloj çështjen e pazgjidhur kombëtare. Megjithatë, Kosova ishte provincë në aspektin kulturor, sidomos deri në themelimin e Universitetit të Prishtinës.

BH: Pse intelektualët kosovar nuk dilnin jashtë kornizës kosovare. A e bënë atë për shkak të gjuhës, dijes së mangët, apo kishin frikë nga ballfaqimi publik në ish-Jugollavi?

ShM: Mendoj se kornizmi ishte edhe pasojë e një lloj vetëmbylljeje, të vetëkënaqësisë së jetës në rezervatë. Nuk kishte horizonte sepse ato nuk ishin të hapura, rrugët për botë dhe kontakte ishin të mbyllura, ose

të ndërmjetësuar dhe të varura nga kultura serbe dhe jugosllave. Aty ku intelektuali shqiptar kosovar ndihej i sigurt ishte folklori dhe bota shqiptare, bota albanologjike.

Fjalimi i Milosheviçit në Fushë Kosovë

BH: çka ishte për ty ardhja e Milosheviçit në Fushë-Kosovë- dhe pse ndodhi ai diversion politik mbi udhëheqësinë kosovare dhe mbi Kosovën në përgjithësi?

ShM: Ardhja në Fushë Kosovë ka qenë momenti i kthesës në politikën e Serbisë. Pas 1981-shit, në Kosovë intervenojë Jugosllavia, u morrën masat mjaftë drastike kundër, siç quhej atëherë, irredentizmit shqiptar, por në vitet 1984-1985, gjendja vlerësohet si më pozitive dhe ndërprehet gjendja e jashtëzakonshme. Kjo nuk i konvenonte Serbisë, sepse nuk realizojë kontrollin mbi Kosovën, ende ishte në fuqi kushtetuta 1974, nuk kishte asnjë përparim në harmonizimin e ligjeve të Serbisë me ato të Kosovës. Pas botimit të Memorandumit të ASHAS, Milosheviçi vendosi që të marrë një kurs më të ashpër në Kosovë, të rrëzohet kjo kushtetutë, jo vetëm për të vendosur kontrollin mbi krahinën që konsiderohej serbe, por edhe të instalohet hegjemonia në Jugosllavi. Për këtë i duhej Milosheviçit kriza në Kosovë, dhe e aktivizojë një lëvizje që ishte përgatitur në Fushë Kosovë, me ndihmën dhe influencën direkte të Dobrica Qosiqit, e edhe Svetozar Vukmanoviç - Tempo. Fillon manipulimi me serbët..

BH: Cfarë profili i liderit politik ishte Millosheviçi. I gatuar nga nacionalistët e Akademisë, i bërë për të ndryshuar konstalacionin e forcave politike në Jugosllavi, apo për të nisur luftën?

ShM: Millosheviçi ka qenë prodikt i komunizmit, aparatçik. Ai erdhi në pushtet si njeri i afërt i Ivan Stambolliqit, që konsiderohej më i rrezikshmi në Serbi. Paraqitjet e para të Slobos kanë qenë komuniste, si një bolshevik i ri. E njohur është afera me Pllakatin për Ditën e Rinisë, kur dizajnerët slloven kishin bërë një diversion në pllakatin, duke kopjuar një poster propagandistik nazist! Ose ishte edhe afera e gazettës “Student” të Beogradit, që Titon e paraqiste si lugar, ka qenë një ilustrim që titullohej “Kthimi i Vapirit!”. Në këto afere Millosheviçi mbronte figurën kryesore të komunizmit jugosllav dhe titizmin. Por, pastaj kur e kuptoi se komunizmi po merr fund dhe se çëshja e ditës në Serbi është ajo çka shkruante në Memorandum, ai e ndërroi pllakën dhe u bë nacionalist, ose më saktë nacional-socialist.

Millosheviçi sundonte përmes dosjeve, së pari e morri nën kontroll shërbimet sekrete dhe policinë, dhe atëherë përmes dosjeve kërcënonte njerëzit dhe arriti që ta eliminojë nga pushteti edhe mendorin e tij Stambolliqin. Më vonë, ai edhe do të ekzekutohet mizorisht si Jozef K. në “Procesin” e Franc Kafkës. ...

Ngritja e Milosheviçit ka qenë jo edhe aq puç personal i tij dhe i grupit të aparatçikëve që e patën kuptuar të parët se Titoja edhe politikisht kishte vdekur, se se troni ka mbetur i zbrazët në një vend ku edhe brezi i Titos po zhdukej fizikisht. Millosheviçin e pritën si shpëtimtar dhe prijës të gjitha institucionet e Serbisë, ato politike, edhe ato intelektuale, Akademia e Shkencave, Lidhja e Shrimtarëve, pastaj edhe Kisha Ortodokse Serbe. Por përkrahja më e madhe atij i erdhi nga Ar-

mata Jugosllave, që e kontrollin serbët, si dhe nga policia dhe shërbimet sekrete. Të gjitha këto instanca synonin që të kthehet hegjemonia serbe në Jugosllavi. Disa antikomunistë në atë korrin e përkrahësve kishin dyshime në Millosheviçin për shkak se ai vinte nga Partia Komuniste, por ai u impononte me autoritetin dhe vrazhdësinë e tij, me arogancën që shfaqte ndaj shqitarëve dhe të tjerëve... Dukej tamam si një lider që mund të kryej punë për Serbinë. Por, ndër antikomunistat dyshues kishte edhe të tillë që mendonin se është mirë që Millosheviçi t'i kryej punët e pista për Serbinë, në Kosovë dhe në Jugosllavi, e për më vonë kujtonin se do të jetë shumë lehtë që ta largonin nga pushteti. Sidoqoftë, Millosheviçi ka qenë produkt i frustrimeve, ambicieve dhe fodullëkut të Serbisë në rrethanat e caktuara historike, ashtu si ka qenë edhe Hitleri produkt i Gjermanisë në rrethanat pas Luftës së Parë Botërore. Kjo është edhe arsyeja pse Serbia pas rrënies së Millosheviçit nuk po shkëputet nga politika e tij. Psh. në politikën ndaj Kosovës Serbia nuk ka bërë shkëputje nga trashëgimia që ua ka lënë Millosheviçi, sa i përket qëndrimit se Kosova është dhe duhet të mbetet pjesë e Serbisë. Politika dhe shumica e mdiave në Kosovë besojnë se Rezoluta 1244 siguron sovranitetin e Serbisë mbi Kosovën, dhe se është vetëm çështje e kohës kur do të bindet për këtë edhe bashkësia ndërkombëtare. Në qershor të vitit 1999, kur trupat e NATO-s po hynin në Kosovë, dhe ato serbe po largoheshin me detyrim pas kapitulimit, Millosheviçi e festonte këtë moment si “fitore të Serbisë”, mu për shkak të rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit.

Kulti i intelektualit në Kosovë

BH: Si ndertohej kulti i politikanit dhe intelektualit në Kosovë. Pse ishte aq e respektuar fjala intelektual dhe si ndodhi qe një gjeneratë e tërë njerëzish kishin diplomuar në universitete të ish-jugosllavisë dhe nuk dinin serbo-kroatishten? Dhe pse intelektualët kosovar nuk dilnin jashtë kornizës kosovare? A e bënëin atë për shkak të gjuhës, dijes së mangët apo kishin frikë në ballfaqimin publik në ish-Jugollavi?

ShM: Nuk ishte problemi te gjuha. Ata e dinin gjuhën, aq sa ishte e nevojshme sepse ndryshe nuk do të mund të përfundonin studimet. Kulti i dijes që permende kishte burimin tjetër te zgjuarësia e popullit i cili disi vuante pse kishte qenë për shumë kohë i prapambetur dhe gati totalisht i paarsimuar. Nga kulti i hoxhës ose priftit, deri te kulti i mësuesit, kalohet në kultin e dijetarit dhe intelektualit, që e zë vendin e kryeplakut dhe urtakut në kultrurën patriarkale të traditës. Por, ajo që ti pyet ka të bëjë më shumë me manipulimin me dijen në ato rrethana kur edhe gjysmakët dhe kuazi intelektualët gëzonin respektin e pamerituar. Arsimimi i shpejtë dhe promovimi pa kritere kishte filluar që në vitet '50, kur Kosova kishte nevoja tmerrësisht të mëdha për kuadra në të gjitha fushat e jetës. Atëherë pos shkollimit të rregulltë organizoheshin edhe shumë kurse, shkollime një apo dy vjeçare, për kuadrot, që zëvendësonin shkollimin e plotë dhe të rregullt të atyre që konsideroheshin kuadër dhe pastaj zinin vendin në pushtet. Por, ky promovim me kurse ishte i rrezikshëm, sepse kur këta njerëz i zinin një herë pozitat, ata bënëin çmos që të mbesin në ato pozita dhe të avanconin bile, kështu që disa prej atyre kursistave që nuk e kishin as diplomën e

shkollës fillore e të mesme, arritën të bëhen ideologë, profesorë, madje e edhe me titull më të lartë - akademikë. Kjo vazhdojë edhe më vonë, në vitet '60 dhe '70, kur masovizimi i shtresave intelektuale nuk shoqërohej me kriteret të shëndosha të promovimit dhe mbrojtjes së autoritetit akademik. P.sh., kur është krijuar Universiteti i Prishtinës, politika ka ndikuar që të anashkalohen kriteret strikte akademike. Ishte një garë me Serbinë, e cila kundërshtonte hapjen e universitetit të pavarur të Prishtinës, e donte vetëm si pjesë të Universitetit të Beogradit, dhe ndër tjerash insistonte në atë se Kosova ende nuk ka kuadra për universitet cilësor. Serbia e kishte me sherr, sepse synonte kontrollin e arsimit të lartë, kurse politikanët në Kosovë për hir të instalimit sa më të shpejtë të UP-së, si institucion të pavarur, ia dhanë pushtetin "intelektualëve kursistë", që ata ta drejtojnë UP-në. Projekti ishte i rëndësishëm dhe me qëllime të mira, por nëse themelet e godinës nuk janë të shëndosha, nuk mund të presësh se ajo do të mbetet stabile. Në atë kohë të paktën është dashur që të kihet edhe një strategji e qartë e ndërtimit të kapaciteteve të UP, të jipen me plan bursat për studentët dhe asistentët më të mirë dhe më të aftë, në mënyrë që sa më shpejtë që është e mundur të kompensohet cilësia e ultë e pedagogëve që kanë drejtuar universitetin në fillimet e tij. Nuk po them se të gjithë kanë qenë të paaftë, por shumica ishte ashtu, dhe kjo shumicë "vetëqeveriste" me UP-në dhe fakultetet, dhe gjente lehtë edhe përkrahjen në strukturat e pushtetit. Po kështu, një pengesë tjetër ndoshta edhe më e madhe ka qenë pjesa serbe e universitetit, sepse UP-ja ishte në dy gjuhë, ku pjesa serbe ishte edhe më e dobët dhe më provinciale, më e prirur për politizime dhe uljen drastike të kriterëve promovuese dhe të marrjes së titujve shkencor. Shpesh këto dy pjesë të universitetit shkëmbenin "shërbimet" kor-

ruptuese duke siguruar jo vetëm diploma, por edhe magistratura dhe doktoratura që objektivisht nuk kishin asnjë vlerë akademike, por u mundësonin që këta njerëz të mbajnë katedra dhe poste të larta në UP.

Dorëheqja nga Fjala

BH: Ti ke bërë në vitin 1988, nëse nuk gabohem, një kritikë tejet të ashpër të UP-së në një intervistë që është botuar në “Start” të Zagrebit. Në atë intervistë, që këtu shumëkush ta ka zënë për të madhe, ke treguar për faktin se profesorat e UP-së janë të paaftë dhe me tituj akademikë false, doktorantura të kopjuara. Në kohën që Beogradi po sulmonte UP-në me tendencën e mbylljes, që edhe do të ndodhë pas tre kater vitesh, këto akuza kanë qenë tepër të rënda dhe tingëllonin denononcuese. Nuk po them se nuk ke pas drejtë, por politikisht a ka qenë korrekte? Si mendon sot për këtë?

ShM: Kjo ka qenë njëra prej aferave të mia më të mëdha dhe me më shumë dyshime personale sepse jam matur dhe çmatur se a duhet ta bëja e pastaj edhe ta botoja atë intervistë. Ka qenë një rrethanë mjaft e çuditshme në kohën kur kishte dështuar projekti i “Fjalës”. Unë pata dhënë dorëheqje nga posti i kryeredaktorit pas presioneve të drejtuesëve të “Rilindjes” - atëherë në krye ishin Rrahman Dedaj dhe Skender Zogaj -, por edhe të qarqeve kombëtare dhe nacionaliste, që po kështu pretendonin kontrollin e “Fjalës” dhe nuk e donin ashtu siç ishte, liberale dhe kritike...

BH: Kush ishin këto qarqe, a mund ta thosh konkretisht?

ShM: Po, ishin njerëzit e Rexhep Qosjes, dhe besoj edhe ai vetë ai në krye të fushtës... Ata e morrën për veti Fjalën dhe e degraduan, e bënë leckë albanologjike.... Unë pata mbetur disi pezull... Pas gjithë atyre angazhimeve që kisha bërë në vitet '80, polemika me akademikët serbë, shkrime dhe reagime të botuara në gazetatat jugosllave, përpjekjes që në një medium kosovar t'i ngjall debate më të guximshme për rrjedhat kulturore dhe politike, u gjeta në një pozitë relativisht defansive dhe personalisht depressive, ku isha i detyruar ta lë edhe punën në "Rilindje", në redaksinë e revistave.

Intevista në "Start" të Zagrebit

BH: Çka ndodhi pastaj? A i erdhi radha reagimit tënd dhe asaj interviste të famshme në revistën "Start" të Zagrebit?

SM: Jo menjëherë. Kjo do të ndodhë vitin tjetër... Një ditë, duhet të ketë qenë janari ose shkurti i vitit 1988, më thërret një gazetar nga Zagrebi, Darko Hudelist, me të cilin jam njohur edhe më herët, kishte bërë disa reportazhe të shkëlqyera për zhvillimet politike dhe kulturore në Kosovë, dhe më thotë se redaksia e revistës "Start" kishte shprehur dëshirë që ai të bëjë një intervistë të gjatë me mua për numrin jubilar të 500-tin të kësaj kult. reviste në ish Jugosllavi, që dilte dy herë në muaj. Unë e konfirmova, shumë rrallë kam refuzuar bisedat, dhe i tregova se pas pak disa ditësh e kisha një aktivitet në Zagreb, nuk më kujtohet cili ishte sebebi, ndoshta ishte mbledhja e jurisë së javorës "Danas" i cili ndante çmimin më prestigjios vjetor jugosllav për gazetari, dhe unë dy vite më radhe isha anëtar i kësaj jurie. Darko më tha, "Ok, atëherë

le të shihemi në Zagreb dhe ta aranzhojmë kornizën dhe përmbajtjen e intervistës”. Dhe kur u takuam në Zagreb ai më tha se e kishte idenë që të bëjmë një bisedë ndryshe për Kosovën, jo të fokusuar në marrëdhëniet shqiptaro-serbe që i mbushnin faqet e gazetave, por bisedë për zhvillimet dhe gjendjen e brendshme në Kosovë, të cilat po injorohen dhe mbeten në hije dhe të panjohura për opinionin jugosllav. Dhe si injorant që ishte edhe ai, pas dy tre vizitave që i kishte bërë Kosovës, kërkoi që të bëjmë një bisedë paraprake krejtësisht të lirë për temat nga më të ndryshmet, si përgatitje për atë bisedën kryesore të cilën thoshte se pas ca kohe gjithsesi do ta bënte në Kosovë. Dhe kështu edhe e bëmë, u takuam me një shtëpi ku ishim më të qetë se në redaksinë e “Startit” dhe ai më luti që ta inçezonte bisedën, që zgjati gati 4 orë. Ai bënte pyetje më të çuditshme edhe unë përgjigjesha pa dorëza, edhe për gjëra më delikate, duke menduar se po bisedojmë off, siç thojnë anglezët, dhe jo për publikim. Aty, pra, në pyetjet e ndieshme, unë përmendja edhe emra, kur ai insistonte për këtë, me vlerësime të ndieshme për njerëzit dhe institucionet, kurse ai tregohej mjaft i shkathtë dhe mjeshtër t’i prekur gjërat që më futnin në thellësi dhe zbardhjen e “sekreteve” dhe spekulimeve të ndryshme që unë i konsideroja të bazuara, por për të cilat si publicist profesional dhe i ndërgjegjshëm nuk do të flisja hapur dhe me emra nëse do të dija se po flas për publik, ngase kishte në ato pohime të mia shumë gjëra që supozoja se janë të sakta, por për të cilat më mungonin dëshmitë relevante. Ai më siguronte çdo herë se e interesonte konteksti real i ngjarjeve dhe zhvillimeve, dhe jo që këto gjëra të publikohen. Po kështu, nuk e dinte se sa hapësirë do të kishte në “Start”. Këtë bisedë po e zhvillonim shumë kohë para daljes së numrit jubilar, të pesëqindtë, prandaj edhe kërkonte nga unë që ti shpalosja

edhe gjërat më interesante dhe më pikantë, në mënyrë që intervista finale të dalë sa më mirë. Kur e përfunduam bisedën ai u falendërua shumë dhe tha se shumë shpejtë do ti dërgonte pyetjet për “bisedën e vërtetë”. Por pas dy javësh më erdhi letra nga Darko ku nuk ishin vetëm pyetjet por edhe përgjigjet. Ai e kishte bërë një transkript të bisedës në Zagreb, me ndonjë shkurtim aty këtu të gjërave që i ka marrë si më pak të rëndësishme, dhe në letrën përcjellëse thoshte se ishte shumë i kënaqur me këtë transkript dhe se ishte i mendimit që të botohet kështu si ishte, nëse unë do ta autorizoja, dhe se në atë rast do të botohej në tërësi dhe pa asnjë ndërhyrje. Teksti kishte 25 faqe dhe titullin “Kosova: Fshatrat e Potemkinit të pseudointeligjencës”. Tema kryesore e bisedës ka qenë intelgjencia në Kosovë, statusi, orientimet, kapacitetet, klanet, varësia nga politika... Kur e lexova e pash se Hudelisti e kishte bërë shumë mire dhe saktë, duke ndërtuar një portret timin afirmativ si intelektual dhe duke kapur të gjitha nuancat e dhura të mendimeve të shprehura në atë bisedë. Edhe sot kur e lexoj nuk kam shumë vërejtje, janë tamam mendimet e mia, shumicën do ti thosha me të njejtët fjalë edhe sot, i kam thënë tashmë ose do t'i them njejtë ose ngjashëm edhe në këtë bisedë që po e zhvillojmë pas 20 vjetësh. Megjithatë, në atë bisedë të “Startit” kishte mjaft sende që i thuash lehtë kur është biseda off, në katër sy me dikend që kërkon informim personal dhe ke besim në te, për dallim nga situata kur flet për publikë të gjërë dhe të paktën i mat fjalët, ki kujdes për keqkuptimet e mundshme, ose shqyrton dy a tre herë se a ke argumente të mjaftueshme për pohimet dhe kualifikimet të thëna si supozime dhe spekulime. E di se për botimin e këtij transkripti unë u pata konsultuar vetëm me kolegun Isuf Berishën, në atë kohë e kisha shok të ngushtë. Ia dhash transkriptin dhe i thash

se është pak “kiç”, në kuptimin e tendencës “senzacionaliste” në përdorimin e kualifikimeve kyçe si p.sh. “pseudointeligenca e Kosovës”. Zakonisht jam më i kujdesshëm në cilësimet, i bëjë të kushtëzuara dhe me saktësime, jo kështu gjeneralizuese. Kiçi gjeneralizon. Por, Isufi tha se nuk është aspak kiç, është relativisht e butë, dhe se ai vetë nëse do t’i jipej rasti, do ta bënte edhe më të ashpër. Kështu që edhe unë u binda, bëra vetëm disa korrigjime dhe saktësime të vogla në transkriptin dhe Hudelistit ia ktheva bisedën si të autorizuar. Ajo edhe u botua ashtu, e shkurtuar vetëm në disa pjesë që kishin të bëjnë me pjesëmarrjen time në demonstratat e vitit 1968.

Lufta e klaneve politike në Kosovë

BH: Kjo intervistë kishte jehonë të madhe?

ShM: Po, u bë një hata sidomos kur disa ditë më vonë u ribotua, në tre vazhdimet, me një redaktim dhe paketim tepër sensacional, në gazetën “Politika” të Beogradit. Nga Prishtina dikush kishte dërguar porosinë se është botuar kjo intervistë, më duket se këtë e ka bërë Azem Vllasi, që e konsideronte të dobishme në luftën e tij për të siguruar dhe forcuar pushtetin e tij, që sfidohej nga konkurrenca e brendshme, por sikur e kishte nënvlerësuar mundësinë e manipulimit edhe më të madh nga politika e atëhershme e Beogradit. Milosheviçi dhe njerëzit e tij e kishin vlerësuar këtë intervistë timen si të dobishme për fushatën e tyre kundër Kosovës, universitetit të Prishtinës dhe inteligjencisë dhe politikës shqiptare. Kështu m’u realizua droja që e kisha kur e vlerësoja atë si kiç potencial. Jo që kisha gabim në atë që pohoja, por ishte koha dhe konteksti nëse jo i gabueshëm (kur nuk është gabim ta thosh të

vërtetën), atëherë i papërshtatshëm. Ajo që e kisha thënë u manipulua politikisht në masën më neveritëse, por s'kisha çka t'i bëja, madje nuk isha në gjendja as të sqaroja dhe reagoja ndaj manipulimit, sepse më 15 mars të atij viti kam përjetuar një sulm të rëndë në pankreas, u shtriva në spital për disa javë, pastaj më dërguan me helikopter në Lublanë, ku jam bërë operacion nga apcesi në pankreas, dhe kjo sëmundje ime zgjati dy muaj, e edhe kur dola nga spitali edhe për një kohë isha në rehabilitime dhe dieta, humba rreth 25 kilogramë, dhe ndodhi që e gjithë furtuna dhe afëra kaloi pa prezencën time në opinion, pra pa sqarime dhe reagime shtesë...

BH: Pasojat? Sa më kujtohet ka pas reagime të ndryshme të ashpra, spekulime, akuza...?

ShM: Ka qenë mjaftë shokante për një pjesë të opinionit, por edhe ka pasur edhe përkrahje, sepse unë në atë intervistë vetëm i thoja hapur gjërat dhe problemet të cilat i thoshin edhe të tjerët, në rrethin tim po se po, por edhe më gjërë. Nuk ishte fare problemi i kësaj interviste ato që aty pohoja, sado që kritikant për inteligjencën kosovare dhe UP-në ishin të rënda. Ishte më shumë momenti ai që skandalizonte shumicën, që thoshin: “Pse tash?”, “Pse në këtë mënyrë?”; “Pse i jepet mundësi “Politikës” që ta shfrytëzojë këtë intervistë për fushatën antishqiptare?” Disa mendonin se kam rënë në grackë, e disa se e kam bërë me qëllim dhe paramendim, si një agjent i armikut. “Rilindja” e pat botuar një koment të Xhemajl Mustafës, që sigurisht e kanë ndihmuar edhe ata të redaksisë së kulturës, një grup intelektualësh që gjithnjë më kishte zët, kundërshtarë dhe oponentë në shumë situata, si Mehmet Kraja, apo Ibrahim Berisha, dhe ata theksonin në reagimin në gazetë se po gënjeja dhe që e bëra këtë si “dorë e zgjatur e Beogradit”...

BH: Ka qenë vetëm ky reagim? S'ka pas pasoja tjera?

ShM: Nuk kam mundur t'i përcjellë në atë gjendje që isha nëpër spitale, por besoj se nuk kanë qenë relevante, sepse dikush nga miqtë do t'i kishte ruajtur për mua, të paktën Isuf Berisha, i cili ishte deri diku "bashkëfajtor" për botimin e edhe pikëpamjet që i ndanim. Vetëm se pasojat kryesore nuk janë kufizuar në këto reagime dhe sforcimin e animozitetit ndaj meje në UP dhe qarqet albanologjike ose në redaksinë e kulturës të gazetës "Rilindja", përndryshe prezente edhe nga më herët. Kjo intervistë ka pasur edhe ndikime direkte dhe indirekte politike. Një pjesë e intervistës i kushtohet dukurisë së luftës joparimore për pushtet të disa klaneve lokaliste jo vetëm në kulturë por edhe në politikë. Në atë kohë ishte periudha kur po përgatiteshin listat për zgjedhjen e liderëve në pozitat kyçe të pushtetit në Kosovë, dhe Beograd po bënte presion të madh që të instaloheshin njerëzit sa më të dobët, sa më të manipulueshëm, ndërkaq që interesi i Kosovës ishte që të ketë njerëz të aftë, dhe jo liderë që shikojnë interesat klanore dhe që kanë prirje për nepotizëm. Në atë kohë në kulturë dhe mediat dominonte klani i Llapit, dhe kishte aspirata që të shtrihej edhe në politikë, në Lidhjen Komuniste dhe organet e pushtetit. Nuk them se intervista ime ka qenë vendimtare për rishikimin e përzgjedhjeve kadrovike që ishin parapërgatitur me favorizime klanore që unë i kisha denoncuar parimisht, dhe jo me emra konkret, por më kanë thënë më vonë shkrimi im ka ndikuar që të prishen këto skema, dhe kjo jo sipas dëshirës së Beogradit që bënte presione, por me propozime që e patën forcuar vijën e Azem Vllasit, për të cilin atëherë mendoja, e edhe sot jam i këtij mendimi, se ka qenë politikani më i zoti i atij brezi. Por këtu mbetet çështja se a i ka ndihmuar ky denoncim aspiratave të Serbisë, apo udhëheqë-

sisë së atëhershme kosovare, konkretisht Vllasit dhe asaj garniture që e njihnim dhe gjithnjë e më shumë tregonin shenjat se do të vendosin barrierat ligjore dhe tjera për të rezistuar ndaj presionit të Serbisë për ndryshimin e Kushtetutës dhe kufizimin e autonomisë. Prej atyre pretendentëve të tjerë për pushtet, që thuhet se janë hequr nga listat promovuese, asnjëri nuk ka qenë i profilit që do të luante ndonjë rol në politikën e LKK-së, ose që më vonë do të dallohej në lëvizjen e rezistencës. Ishte thjeshtë periudha kur presionet serbe shumëvjeçare kishin bërë rrëmujë në situatën kadrovike dhe të autoritetit në Kosovë, dhe kjo i jepte hapësirë depërtimit të grupeve dhe klaneve të aparatçikëve që ishin krijuar në bazë të lidhjeve rajonale dhe nepotiste. Kështu që ndikimi im në vendimet e Komitetit Krahinor dhe të komisioneve, nësa ka ekzistuar, mendoj se nuk ka mundur të bënte dëme.

Kritika e UP-së në kohë të gabuar?

Një temë kryesore që e debatoja atëherë me shokët më të ngushtë, të cilët po kështu kishin dyshime për momentin dhe oportunitetin e kësaj paraqitjeje time, sillej rreth çështjes së rezistencës ndaj Serbisë, dhe pyetjes se a ka qenë i mirë apo i keq denoncimi i këtitillë publik dhe tepër kritik i universitetit dhe inteligjencisë kosovare? Në ato debate unë e shtroja pyetjen e adresës së denoncimit: a i drejtohesha unë një opinionit të huaj dhe armiqësor, apo para së gjithash opinionit kosovar? Në atë kohë jo vetëm unë por edhe të tjerët, kur nuk kishim mundësi të komunikonim përmes mediave kosovare, i shtronim çështjet e ndieshme në mediat jugosllave, për të nxitur debate dhe sqaruar edhe çështjet e brendshme. Në idenë time atëherë unë nuk e sulmoja UP-në sepse isha kundër dhe kërkoja që të mbyllet universiteti, larg kësaj, por

e denoncoja në dobësitë trashanike që kishte, sepse në disa degët që unë i njihja profesionalisht, si Dega e Filozofisë dhe Sociologjisë, dhe dëgjoja nga të tjerët që edhe në degët tjera gjendja është e ngjashme, kishte aq shumë keqpërdorime dhe inkompetencë të patolerueshme, sa që dyshoja me arsye se ata doktorë dhe magjistër të rrejshëm, që pa skurpulla kishin siguruar postet dhe titujt shkencor, do të mund të rezistonin presionit serb.

BH: Pse dyshoje? Kishe fakte?

ShM: Fakte për plagjiatura, po, vetëm se nuk ishte puna te kjo. Mendoja se çdo intelektual mashtrues dhe hajdut mund të blihet dhe manipulohet lehtë në rrethanat që ishin krijuar. Po kështu besoja se UP-ja duhet të kthehet në binare tjera, të drejtohet nga pedagogët e aftë dhe të ndershëm, që e kanë edhe etikën profesionale dhe njerëzore. Dhe kjo vlente edhe për inteligjencën, mediat dhe politikën. Ky ka qenë një logjikim i kuptueshëm për ato rrethana, kur ende nuk dinim se në çfarë drejtimi do të shkojnë proceset, kur Kushtetuta e vitit 1974 ende dukej e mbrojtëshme dhe regjimi i Milosheviçit vërtetë se ishte në ofensivë të madhe, por e kishte para vetës rezistencën e disa republikave, para së gjithash Sllovenisë dhe Kroacisë, si dhe të qeverisë dhe organeve federative. Askush nuk ka mundur të parashikojë se kjo ofensivë e Serbisë do të shkatërrojë Jugosllavinë pas dy tre vjetësh, se do të bie komunizmi jo vetëm në Jugosllavi por edhe në Evropën Lindore, dhe se në Kosovë do të ndodhte me një shpejtësi marramendëse homogjenizimi dhe mobilizimi aq masiv, sa që do të rrotullohen në themel raportet politike duke nxjerr në sipërfaqe një elitë të re politike, në vend të asaj që do ta instalonte me dhunë Milosheviçi. Njera prej masave radikale që ndër morri Milosheviçi ka qenë mbyllja e pjesës shqiptare të Uni-

versitetit të Prishtinës, dhe jo manipulimi me njerëz dhe profesionistë të lig, siç e prisja, për ta lënë një universitet në shqip sa për sy e faqe, që më vonë edhe do të mbyllet krejtësisht. Dhe ky represion total, i cili provokoi edhe reaksionin total dhe organizimin e punës së UP-së jashtë godinave dhe me vetëfinancim, i dha mundësinë edhe manipulatoreve dhe hajnave, që të kthehen në heronj të rezistencës, duke krijuar rrethana edhe më të volitshme për uljen e nivelit të studimeve dhe tregti me tituj. Ata profesorë që unë i kisha akuzuar si plagjiatorë dhe të paaftë për profesionin, jo që nuk i kishte rënë as fija e flokut, por janë avancuar, kanë marrë poste të larta të dekanëve, shefave të degëve dhe senatorëve të UP. Me disa prej tyre, si me Kadri Metajn, doktor i rrejshëm që e kemi zbuluar se tezën e doktoraturës e kishte plagjiat të plotë, kam pas sqarime publike edhe në vitet '93 e më vonë, duke publikuar dëshmi shtesë dhe konkrete të plagjiaturës, por as UP-ja e as shoqata profesionale që me statutet e tyre kishin obligimin që të nisin shqyrtimin dhe procedurën e marrjes së titullit dhe të largimit nga mësimdhënia, nuk kanë ndërmarrë kurrë asgjë, të paktën të kishin bërë ndonjë komision për verifikimin e pohimeve. Nuk e bënin sepse kjo do të hapte mundësinë e shqyrtimeve edhe të rasteve të tjera të plagjiaturave dhe hajnive, e të këtillë supozohej se kishte shumë. Andaj është bllokuar kjo nismë edhe atëherë, edhe pas luftës. U përsërit sërish ajo çka kishte ndodh në vitin 1985 me aferën e zbulimit të plagjiaturës së Ali Didës.

Avancimi i plagjiatorëve

BH: Duhet ta kujtojmë lexuesit e sotëm më këtë aferë?

ShM: Po, sidomos sepse disa personalitete vazhdojnë të respektohen mbi bazat e hajniv shkencore dhe tjera. Ali Dida është i ndjerë sot, por në Prizren e kam vërejtë se nje rruge ia kanë vënë emrin e tij, sikur të ishte qytetar dhe pedagog i merituar, gjë që nuk do të duhej të ndodhte. Në intervistën në “Start” unë e kisha rikujtuar aferën me Dr. Ali Didën, për të cilin unë dhe Isuf Berisha kishim botuar në “Fjala” dëshmi të plota për plagjiaturën, si dhe dëshminë e një studenti të tij, Enver Zhinipotoku nga Ferizaji, i cili kishte marrë pjesë në një metodë origjinale të sajimit të librave, ku profesori Dida e kishte zhvilluar në teknologji të plagjiatit, ku mundi i tij më i madh ishte që në disa libra të autorëve të huaj shënonte në margjinat e faqeve numra rendor për fjalitë dhe pasuset që do ti merte nga ata autorë, pastaj këta libra janë fotokopjuar dhe është angazhuar një grup studentësh, që udhëhiqej nga Kadri Metaj, në atë kohë edhe vetë student ambicioz, që t'i prejnë me gërshërë pasuset, dhe pastaj sipas numrave i kanë renditur dhe ngjitur në letra të bardha duke sajuar kështu faqe e kapituj të librit. Më pas këta kapituj janë daktilografuar dhe u janë dhënë studentëve që të përkthehen nga serbokroatishtja, në formën e punimeve seminarike, dhe në fund këto përkthime janë lekturuar dhe korrigjuar për t'i dhënë formën e librit ku profesori ia ka shtuar faqen e titullit me emrin e autorit, doktor Ali Dida, kinse ky ishte dorëshkrimi i tij. Ky “dorëshkrim” pastaj zyrtarizohej si tekst universitar ngase sipas procedurës i bëheshin dy recensionet nga kolegët doktorë shkence, si recensionet po ashtu korruptive ose të shkruara pa e lexuar librin, dhe

edhe publikohej pastaj si literaturë e obligueshme për studentët. Kështu pra ishte sajuar dhe botuar libri universitar për filozofinë e kohës moderne, një libër paçavurë ku nuk kuptoje gjë prej gjëje sepse pasuset e ngjitura nuk kishin lidhshmëri organike të një ligjerimi normal. Ky farë profesori, thash se tashti është i ndjerë, kishte qëlluar edhe me ambicie politike, dhe në atë kohë kur ne e kishim bërë shkrimin, ishte anëtar i Kryesisë të Lidhjes Socialiste të Popullit Punonjës, një post i rëndësishëm dhe me ndikim. Me ndikimin që kishte ai e kishte ndal botimin e këtij shkrimi në përpjekjen e parë, dhe kur ne mbetëm insistues dhe unë kërcënove me dorëheqje dhe letër publike për arsyet, atëherë profesori Dida na dërgojë një ofertë përmes Rexhai Surroit, në atë kohë drejtor gjeneral i Rilindjes, se është i gatshëm që të bëjë “kompromis”, të na jep mua dhe Isufit nga një lëndë nga katër që ligjëronte në UP, nëse artikullin nuk do ta botonim. Rexhaia na tha, kur na tregoi për ofertën, se “e paskeni kap Didën me t’linat dorë”⁴, por se na ofrohej mundësia që të dalim nga kjo situatë pa u dëmtuar askush dhe të mos plas skandali publik! Sigurisht se nuk e pranuan këtë ofertë të ultë, dhe shkrimi pastaj u botua, boni pak bujë, por me kohë u harrua, kështu që Ali Didës nuk i mungoi as një qime e flokëve. E vetmja gjë pozitive ka qenë një histori që ma pat treguar i ndjeri akademik Jashar Rexhepagiqi, i cili pohonte se e kishim shpëtuar nga belaja me Ali Didën. Sepse deri atëherë që ishte botuar denoncimi ynë i plagjiaturës, Dida i bënte shumë shpesh telefonata duke e shprehur dëshirën e flaktë që të bëhet anëtar i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës. Në një rast Dida e kishte ngarkuar edhe kryetarin e LSPP, me çantën e mbushur me ato libra të tija pleh që i kishte botuar, për t’u ankuar

4 Lokalizëm = Me brek të zhveshura.

te drejtuesit e ASHAK, - në atë kohë Rexhepagiqi ishte sekretar, - pse nuk ai nuk po kandidohej dhe bëhej akademik me 10 libra të botuara, ndërsa kishte akademikë të tjerë që kishin botuar vetëm një, apo edhe gjysmë libri. Me këtë gjysmë libri aludohej tek rasti i juristit Syrja Pupovci, që ishte afër me regjimin, i cili kishte botuar vetëm një studim konçiz për Kanunin e Lek Dukagjinit dhe kishte arritur që të gradohej si akademik. Shkrimi në «Fjala» e pengoi Didën që të bëhet akademik, por jo edhe që të zgjedhet drejtor i Entit Krahinor për Marrëdhënie me Botën e Jashtme, që siguronte bursa për pedagogë dhe studentë dhe ndërmjetësonte në programet e këmbimit me fondacionet e huaja. Në ato rrethana jonormale kur nuk funksionin instancat e recensurës dhe të kritikës, këso avancime edhe të horrave ordinerë ishin të shpeshta. P.sh. me rastin e aferës që kisha unë me revistën “Thema” si organ i Shoqatës së Filozofëve dhe Sociologëve të Kosovës, ku pas largimit të Muhamedin Kullashit në Francë unë isha zgjedhur për kryeredaktor, plagjiatorët të cilëve unë refuzoja t’ua botoja shkrimet, organizuan në vitin 1994 një Kuvend puçist ku më hoqëm mua nga posti i kryeredaktorit dhe zgjodhën redaksinë e re. Unë atëherë u pata acaruar edhe me profesor Fehmi Aganin, i cili i përkrahu puçistët dhe u bë kryeredaktor i “Themës”. Nuk ishte ndonjë gjë e madhe largimi im nga revista, sa ky rilegjitimim i plagjiatorëve dhe i raporteve korruptive në Degën e Filozofisë dhe në Shoqatën e filozofëve dhe sociologëve.

Mjerimi i UP

BH: Pse nuk u vazhdua sqarimi me plagjiatorët pas luftës, në kushtet normale?

ShM: Kanë provuar studentët e UP më 2001 dhe 2002, organizata “Tjetërçqysh” e udhëhequr nga Shkëlzen Gashi, e patën publikuar plagjiaturën e Kadri Metajt dhe disa tjera në Internet, por nuk ndodhi asgjë. Madje, u organizua edhe një debat në RTK me këtë temë, ku mori pjesë rektori i atëhershëm, Arsim Bajrami, por ishte kot, vetë rektori tmerrohej që të flitet fare për këtë dukuri. Unë pohoja se plagjiatura është bërë tabu temë sepse shumica e titullarëve shkencorë dhe profesora të UP-së e kanë edhe vetë mizën pas veshit, dhe nuk duan që ta hapet kjo çështje. Në UP, flas me kompetencë për degët që i njoh profesionalisht, ende vazhdojnë praktikata e vjetra të promovimeve të doktorëve të rrejtshëm të shkencave. Para disa vjetësh pata reaguar kundër ministrit aktual të arsimit Enver Hoxhaj dhe ish rektorit dhe kryetarit aktual të gjykatës kushtetuese Enver Hasani, - atëherë nuk ishin në këto poste -, pse kishin marrë pjesë në komisionin që ia dhanë titullin e doktorit Fadil Malokut, një sharlatani që e njihja si të tillë prej kohësh, dhe që nuk meritonte jo vetëm avancimin, por edhe të ishte pedagog në Fakultetin Filozofik. Nuk kisha asgjë personale me të, thjesht ishte diletant dhe matrapaz në shkrime. Dy Enverat nuk dhanë asnjë sqarim publik për këtë skandal. Unë pata reaguar i zhgënjyer sepse ata dy ishin në atë kohë më të angazhuar për reformimin e universitetit, për vendosjen e kritereve në avancimet shkencore. Por privatisht ata më kërkuan dhe më dhanë të drejtë. Thanë se kanë qenë të mashtruar, janë futur në komision pa njohur mirë kandidatin dhe pa e lexuar tezën, vetëm

e kishin shfletuar në momentin e fundit kur nuk mund të tërhiqeshin dhe të bënin skandal, sepse në mbrojtje nuk kishte ndodhur asnjëherë që kandidatit t'i rrëzohej teza, ajo nënshkruhej paraprakisht me aprovimin e raportit të komisionit të doktoraturës, që ata e kishin bërë qorrazi dhe mbrojtja ishte formalitet. Enver Hasani u arsyetua me këto fjalë. “Babo, kisha refuzuar shumë komisione dhe te ky Maloku s’di si ndodhi që pranova, e shikova shkarazi tezën dhe referatin. Para mbrojtjes e pash se e kishim hongër por ishte bo tepër vonë me u tërheq. Nëse do ta refuzonim tezën para gjithë atyre familjarëve dhe miqëve që ishin mbledhur për të festuar titullin do të ishte e pahijshme, turp! Por e këshillova Malokun të mos ngutet për botim, sepse teza e tij do një rishikim dhe riorganizim komplet!” Ky rast me Malokun është ilustrim i mirë i gjendjes dhe të le të kuptosh se si funksionon sistemi duke i futur në gracka, intriga dhe keqpërdorime të gjithë, madje edhe ata që pretendojnë se janë kampiona të “reformave” dhe “kriterëve:.

Pse nuk u doktorua Shkëlzen Maliqi?

BH: Me që po flasim për titujt shkencor, pse Shkëlzen Maliqi nuk është doktor i shkencave filozofike, apo atyre politike? Ti e ke tezën e paraqitur në Universitetin e Zagrebit, pse nuk e bërë doktoratën? A nuk do të ishte pësia e fjalës, e kritikave dhe vlerësimeve të Shkëlzen Maliqit shumë më e madhe dhe më e respektueshme nëse do të kishte titullin Doktor? Pse nuk ndodhi kjo? Nuk më besohet se është në pyetje paaftësia ose mungesa e kohës. Ke botuar me qindra ose edhe tashmë mija artikuj analitikë, nuk të mungon aspak dija, ke metoda dhe stil të shkëlqyer të

shkrimit, dhe shtrohet pyetja ku është atëherë pengesa? Kolegët tu madje thonë se ti edhe e ke një tekst të gatshëm që mund të përpunohet shpejtë si tezë doktorature? Pse nuk e bërë këtë?

ShM: Përgjigja është e thjeshtë - nuk e kam fare atë ambicie. Për mua titujt nuk paraqesin gjë, nuk ta japin meritumin dhe autoritetin. Kur e lexoj një vepër mua më interesojnë pikëpamjet, argumentet dhe mënyra e shtjellimeve dhe jo çfarë titulli ka autori. Mund të jetë me gradën më të lartë të akademikut dhe libri i tij të jetë pleh. Dhe, e kundërta, mund të jetë një autor i panjohur dhe jashtë çdo lidhjeje akademike, e të ketë vepër gjeniale. Është e vërtetë se Zagrebi ma ka aprovuar tezën diku më 1987, pra para njëzet e sa viteve, por kjo ka qenë merita dhe angazhimi i shokëve të mi, ata kanë insistuar që të paraqitesha me tezën. Dhe unë që t'i heq qafe e pata pranuar, por kam qenë vetëm një herë në konsulta te Nadezhda Çaçinoviç, që do të duhej të ishte mentore, kurse më pas as më ka shkuar mendja për të vazhduar, edhe pse është e vërtetë se temën që e pata paraqitur dhe u aprovua, "Estetika në Bizant", e kisha pak a shumë të gatshme në vijat e trasha, dhe vetëm më duhej t'i bëja disa plotësime dhe të konsultoja literaturën e re, të botuar në ndërkohë, sepse këtë studim e kisha bërë në vitin 1978, dhe botuar pjesërisht në vitin 1980, dhe shqip më 1999. Për disa gjëra në jetë unë jam shumë tuaf, dhe njëra prej tyre është edhe kjo që nuk e dua shkollën, provimet, titujt, promovimet...

BH: Po nuk më duket e drejtë që p.sh. Alfred Uçi në historinë e estetikës disa vëllimshe që ka botuar kohëve të fundit shfrytëzon librin tënd gjërë e gjatë, citimet dhe marrjet nga studimi ytë zënë rreth 80 apo edhe më shumë faqe në vëllimin e dytë të historisë së tij të estetikës, kuptohet gjithnjë duke iu referuar burimit.

Për më shumë, në fund të librit profesori Uçi ka ribotuar edhe një ese tëndin, krahas atij të Umberto Ekos, si shkrim me vlera antologjike për atë periudhë të estetikës. Kurse Shkëlzen Maliqi nuk çmohet në botën tonë akademike, sidomos këtu në Prishtinë, nuk ka katedër të vetën, apo të paktën nuk ligjëron diku këtë lëndë për të cilën pa dyshim nuk kemi ekspert të tillë!

ShM: E po, kjo e ka arsyen e vet në atë që thash, mungesën e ambicies, e edhe një vesi tjetër që kam, e kjo është se unë nuk e kam kërkuar këtë, nuk kam konkurruar për ligjërues. Jo vetëm pse nuk e kam pas titullin dhe nuk i kam plotësuar “kushtet”, por edhe pse profesurën nuk e kam vokacion. Kuptohet, nëse do të më thërrisnin, ndoshta edhe do të mendohesha, por nuk ka pas kurrë ndonjë ftesë, madje as për ndonjë ligjëratë si ekspert i jashtëm. Më kanë ftuar në degën e historisë dhe në arkitekturë profesorët dhe asistentët, jo zyrtarisht por në orët e tyre, për tema politiko-historike. Kam ligjëruar për shkatërrimin e Jugosllavisë para 100 studentëve të Enver Hoxhajt, dhe në arkitekturë më kishte ftuar Flaka Haliti që të flas për temën e dhunës urbanistike që ka përjetuar Prishtina si kryeqytet i Kosovës nga mesi i shek. XX e deri më sot. Në degën e filozofisë disa tmerrohen edhe kur kaloj rastësisht atypari, e jo që të më thërrasin. Vetëm se unë as që vuaj për këtë. Madje, do të isha më i lumtur edhe nëse nuk do të kisha kaq shumë ftesa për të shkruar ose prononcuar për çështjet politike. Agjendat e mia personale lidhen me diçka që unë do ta quaja «interesime të lira», që të bëjë diçka krejt tjetër dhe ndryshe nga ajo që e kam obligim. Kjo është pak e komplikuar, por i ndodh njerëzve që në angazhimet dhe detyrimet publike e ndiejnë dhe dinë se nuk janë tamam vetja e tyre.

Nëntëdhjetat

Elita në “Elida”

BH: Dua të vazhdojmë të flasim për fundin e ‘80 dhe fillimin e ‘90. Si filloi dhe si u krijua skena politike në Kosovë? Si u shpërbë partia komuniste, dhe si lindi pluralizmi në Kosovë. Shkëlzen Maliqi ka qenë goxha i involvuar në këtë proces, kemi biseduar edhe më herët për këtë. Tani dua të përqendrohemi në një vend, ose një vendtakim, ëmbëltoen “Elida” që gjendet në Qendrën Sportive dhe Tregtare të Prishtinës, e cila atëherë quhej “Boro e Ramizi”. Sot është thjeshtë një ëmbëltoe e zakonshme brenda qendrës tregtare të “Pallatit të Rinisë”, kurse atëherë ishte bërë qendër e kontakteve dhe e këmbimit të ideve dhe projekteve politike. Ç’ domethënje kishte “Elida” për Shkëlzen Maliqin dhe për gjithë ata intelektualë që mbledheshin aty për të bërë politikë dhe për t’u shndërruar në politikan, me gjithë ato konspiracione, thashetheme, spiunët që ishin perreth jush?

ShM: “Elida” ishte një vend alternativë që filloi t’i konkurronte kafiterisë së madhe të bahqes së Grand hotelit, ku më parë, gjatë viteve ‘80, zakonisht pihej kafa expresso dhe bëheshin takimet e ditës... “Elida” ishte afër “Rilindjes”, aty frekuentonin gazetarët dhe intelektualët, dhe kur “Grandi” u bë i pasigurtë nga fytyrat e dyshimta agjentësh

dhe hafijesh, ku lokal në qendrën tregtare u bë më i popullarizuar. Aty tani zhvilloheshin kontaktet, konsultat dhe marrëveshjet. Por, e vërteta është se në atë kohë edhe nuk kishe shumë alternativa për vendtakime siç i kemi sot, kur Prishtina është stërmbushur me kafiteri dhe restorane atraktive me oferta për të gjitha shtresat dhe shijet. Në fillim të '90 "Elida" ishte bërë një lloj qendre informative ose qendër koordinuese joformale. Aty janë ngjizur shumë ide dhe projekte politike dhe të tjera. Po i përmendi vetëm disa ku unë vetë kam qenë pjesëmarrës ose njëri prej ideatorëve. Aty kemi koncipuar petitionin kundër diskriminimit të shqiptarëve në Maqedoni, - unë e kam bërë tekstin në emër të Shoqatës së Filozofëve dhe Sociologëve të Kosovës, që pastaj është nënshkruar edhe nga disa asociacione tjera. Pastaj, aty kemi filluar edhe një petition tjetër "Për demokraci, kundër dhunës", të cilin e kishte koncipuar Isuf Berisha, një petition tepër i rëndësishëm dhe i madh ngase u patën mbledh rreth 400 mijë nënshkrime anembanë Kosovës...⁵ Në "Elidë" shpesh jemi marrë vesh edhe për demonstratat dhe protestat që mbaheshin në atë kohë, si p.sh. nderja e qirinjve për viktimat, bërja e zhurmës në momentin kur fillonte ora policore, e të ngjashme. Edhe koncepti i "Kohës" javore, seria e parë 1900-1901, është ngjizur aty, fillimisht në bisedat e mia me Veton Surroin, e pastaj edhe me bashkëpunëtorët dhe bashkëthemeluesit, si Arben Xhaferi, Astrit Salihu, Mufail Limani, Kelmend Hapçiu, Eqrem Basha, Blerim Shala... Në «Elidë» janë mbajtur takimet joformale vendimmarrëse, p.sh. të revistës "Thema", pastaj edhe redaksia e MM-së takimin e parë e ka

5 Në Qeverinë e Jugosllavisë dhe Kuvendin e Kosovës, nëse ende ekzistojnë arkivat, janë dorëzuar paketat me rreth 40 vëllimeve me nga 300 faqe me nënshkrime! Një kopje e ka mbajtë Isuf Berisha dhe duhet ta ketë ende diku.

pas në këtë ëmbëltoje, pra kanë qenë Astrit Salihu, Fadil Bajraj, Anton Berishaj, Mufail Limani, Maksut Vezgishi dhe Migjen Kelmendi...

BH: Dhe ishte edhe ti, Shkëlzen Maliqi...

ShM: Po, kuptohet, unë e kisha përgatitur konceptin dhe i kisha përzgjedhur dhe ftuar anëtarët e redaksisë për t'i konsultuar për emër. Në atë kohë, ka qenë viti 1995, disa prej këtyre çunave nuk njiheshin mes veti fare. Propozimi i parë për emrin ishte "Shekulli 21", sepse e kishim përpara vitin 2000 dhe shpresën se do të ndodhte ndryshimi. Por, pastaj menduam që titulli duhet të jetë pak më i pazakontë dhe idenë e transformuam në atë të Mileniumit të tretë, por pastaj e bëmë që të shkruhet me numra latin, pra pikërisht MM, siç shkruhet numri 2000, e që njëkohësisht, të paktën mua, më asocionte me ato bombona laramane shumë të popullarizuara që i blinim në free shopat e aeroporteve... Për kuriozitet duhet të tregoj se dikush këtë emër të pazakontë do ta lexonte si kodim i inicialeve të babait tim, të cilin patriotët vigjilentë shqiptarë do ta dekodonin dhe tregonin nëpër publikimet shkarravina sikur që ka qenë "Horri"... Po, nejtë, kjo nuk ka rëndësi, pos që ndoshta sinjalizon paranojën e disa individëve dhe qarqeve në atë kohë sepse ata në çdo gjë, edhe këso lojë fjalësh dhe rebuse konceptuale në esencë të thjeshta, zbulonin komplete të mëdha ose porosi të fshehta diabolike...

BH: ...Projektet tjera të kohës që lidhen me Elidën, cilat ishin?

Për shembull, në "Elidë" është bërë koncepti dhe rekrutimi i anëtarëve për organizatën e parë opozitare UJDI, pastaj edhe për KMDLNJ dhe Komitetin e Helsinkit, për partitë si LDK, PSDK, Partia Fshatare, Partia e Gjellbërt, Partia Demokristiane Shqiptare etj. Në

“Elidë” ndodhnin edhe shumë gjëra tjera. Nuk më kujtohen të gjitha si të lidhura vetëm për këtë vend, sepse kishte edhe vende tjera, por them se shumica ngjizeshin aty si ide dhe projekte, ose aty bëhej debati. Kup-tohet vendi si vend nuk kishte diçka speciale, por thjesht ishte vend-takim i intelektualëve dhe politikanëve të ardhshëm. P.sh. aty që nga vitet ’80 për çdo ditë rinte Ibrahim Rugova, e mund t’i shihje shpesh edhe personalitetet si Fehmi Agani, Mahmut Bakalli, Rexhep Ismajli, Arben Xhaferi, Gani Bobi, Muhamedin Kullashi, Ali Podrimja, Azem Shkreli, Agim Mala, Ali Aliu, Jusuf Buxhovi, Bajram Kelmendi, Veton Surroi, Mufail Limani, Ylber Hysa, Mehmet Kraja, Xhemajl Mustafa, Enver Maloku... dhe shumë të tjerë, të mos e përmendi vegjëlinë e letrarëve, artistët dhe rokerët... Disa nga grupet gjithnjë rinin ndaras, shikoheshim mes veti si maca me miun, i mbanim meritë dhe inatet e vjetra dhe të reja, por kishte edhe të tillë që qarkullonin mes grupeve dhe siguronin një kohezion joformal, kolazh idesh dhe ndikimesh, që e mundësoi atë tolerancë minimale dhe homogjenizimin masiv në të cilën do të mbështetet rezistenca e viteve ‘90.

Kush dyshonte në Shkëlzen Maliqin: polemikat kulturore dhe të tjera

BH: Mua më kujtohet ndryshe, se gjithnjë ka dominuar dyshimi dhe qëndrimi kritik ndaj atyre që kishin ide. Edhe atëherë shpesh të kanë akuzuar gazetat që ishin nën ndikimin e LDK-së, si “Ril-indja” dhe “Bujku” ose javorja e LDK-së “Ora”. Pastaj me vite të tëra edhe “Bota sot” nuk prante me kritika për qëndrimet tua që i cilësonte gjithnjë si projugosllave, titiste, prokomuniste... Më

herët ke shpjeguar se këto akuza nuk kanë qenë të bazuara, por megjithatë aty ndodhi një konflikti i gjeneratave. Vetëm në vitet e para, kur u prish monizmi dhe u krijuan partitë, kishte një si kohezion, po mendoj në Këshillin e Partive Politike Shqiptare të Kosovës, e një kohë vepronte edhe Këshilli i Partive Politike Shqiptare të Jugosllavisë, dhe ti dhe Veton Surroi ishit anëtarë të këtyre forumeve. Por, edhe pse ju rregullisht bashkëpunonit me Këshillin, ose në forumet tjera të rezistencës, në mediumet e LDK-së, si dhe në traktet e lëvizjeve ilegale marksiste-leniniste, vazhdonin akuzat ndonjëherë edhe shumë të rënda për tradhti...

ShM: Kjo që tregon ka ndodh pak më vonë, kur lëvizja e rezistencës u rrit dhe u pjek. Por, unë po mendoja për fillimet dhe ngjizjet e ideve dhe projekteve, që kanë ndodh në atë vendtakim, ku prodhoheshin për çdo ditë bakllavat dhe ëmbëlsirat tjera, por edhe alternativat politike për realitetin e hidhur. Ajo që ti përmende, ato akuza publike për tradhti, ishin simptomat e një sëmundjeje të kohës.

Nuk ishin diçka e re këto akuza. Për vetën e di se që nga vitet 1985 e tutje, në qarqet kulturore më mbanin si njeri të dyshimtë, sidomos pas botimit të kritikave mbi filmat e prodhimit kosovar, “Njeriu prej dheu” i Agim Sopit dhe “Proka” i Isa Qosjes, e edhe të shkrimeve dhe analizave politike tjera ku si pikënisje e kisha një diskurs parimisht antinacionalist, që shumë vetave nuk i pëlqente, ose edhe zemëroheshin, sepse ata e preferonin dhe e kultivonin një mendësi nacionaliste dhe nuk kishte mënyrë që t’u pëlqeja atyre...

BH: Ishte ndoshta paradoksale që Shkëlzen Maliqi me Veton Surroin kishte më shumë mirëkuptim, të mos them edhe përkrahje, në qarqet jugosllave se në Kosovë...

ShM.: Në ato kohërat e fillimit të krizës jugosllave unë dhe Surroi ishim pjesë të forumeve dhe aksioneve të rezistencës kosovare, por nuk e mohoj se shpesh kishim afërsi edhe me forcat demokratike dhe anti-nacionaliste në Jugosllavi, bashkëpunonim me ta jo vetëm në kuadër të UJDI-t, por edhe me lidhjet tjera në konferencat që sponzoroheshin nga ndërkombëtarët. Nga ana tjetër gazetarët dhe publicistët si p.sh. Mehmet Kraja, Gani Mehmeti e disa të tjerë, nuk harronin të na etiketonin si tradhtar çdo herë që ne kritikonim qëndrimet dhe veprimet monopoliste të LDK-së dhe të Ibrahim Rugovës.

Për më shumë, ka pas atëherë edhe kritika të vetë fenomenit “Elida”, p.sh. nga Halil Matoshi, që e shihte si një ambient koti ku rrinë ca intelektualë të pandërgjegjshëm dhe bëjnë qejfe të shturura ... Matoshit në atë kohë edhe rok muzika i dukej moralisht e dëmshme për rininë kosovare, një modë dekadente perëndimore, dhe kështu e shihte edhe Elidën, si një “seli” të dekadencës dhe imoralizmit intelektual...

BH: Po a i gjen sot edhe pjesërisht të arsyeshme ato etiketime që i bëheshin Shkëlzen Maliqit si projugosllav? A ka qenë për ty edhe Jugosllavia, si komunizmi, në një kuptim të ngjashëm, temë e ndaluar? Kur filloi periudha e Millosheviçit, rënia e Ivan Stamboliqit, kthimi i Ali Shukriut në politikë dhe gjithë ajo periudhë e “Dogadjanje Naroda”(“Ndodhja e popullit”), a ishte i bindur se kjo gjuhë dhe kjo politikë po e shkatërronte Jugosllavinë?

ShM.: Unë kam botuar shumë shkrime mbi këto tema në periodikun jugosllav, mbase një kronikë të tërë, një pjesë e të cilave i kam botuar

në librin “Nyja e Kosovës”, në vitin 1990. Është një botim i çuditshëm i shtëpisë botuese KRT nga Lublana, që doli në shqip, dhe u distribuua në Kosovë dhe Maqedoni me mjaft vështirësi, kryesisht përmes disa shitësve ambulante... Aty, në ato tekste, mendoj se kam bërë kritikën paraprake të projektit serbomadhi dhe të pasojave me të cilat kërcënohej jo vetëm federata jugosllave por edhe stabiliteti dhe paqja në rajon. Ky libri është botuar para shkatërrimit të Jugosllavisë, dhe mendoj se aty i kam disa diagnoza të sakta për pyetjen që e shtrova. Tani së voni, saktësisht pas 20 vjetësh, e kam ribotuar këtë libër pa ndërhyrje edhe në ato tekste që sot mund të lexohen si huqje... Kam bërë vetëm disa ndryshime stilistike dhe ndreqje gabimesh, për hir të qartësisë... Prandaj nuk e kisha zgjat më shumë këtë temë, në libër është e elaboruar mjaft mirë...

Censura dhe autocensura në komunizëm

Por, ka diçka që tani dua ta them rreth pyetjes, që ka të bëjë me censurën, ose më saktë, autocensurën që ka ekzistuar në atë kohë të intelektualët, ndaj komunizmit dhe Jugosllavisë. Sot ka shumë veta që deklarohen zëshem dhe me krenari sikur gjithnjë kanë qenë anti-jugosllav dhe antikomunist, por unë dyshoj në sinqeritetin pjesës më të madhe të tyre. Nga përvoja ime e di se ka ekzistuar cenzura dhe autoblokada... Të pata treguar më herët se unë nuk kam qenë komunist i bindur, por megjithatë, më duhet të pranoj se qëndrimi im i atëhershëm për komunizmin dhe sistemin në të cilin jetonim ka qenë pashpjegueshëm i (auto)censuruar. Mendimi im për komunizmin nuk ka shkuar asnjëherë, të them ashtu deri në fund, deri në konsekuencat që duhet t'i nxjerr mendimi i lirë. Në atë kohë, sidomos në vitet '80,

në skenën intelektuale dhe politike botërore zhvilloheshin debatet e mëdha mbi krizën e marksizmit dhe të idesë dhe, sidomos, të praktikës socialiste. Shumë autor të njohur perëndimor, disa prej tyre ish marksistë, pohonin se marksizmi dhe socializmi janë projekte të shekullit XIX, dhe se nga fundi i shekullit XX po bëheshin anakrone, nuk jepnin më përgjigje për problemet aktuale dhe ato të ardhmërisë. E unë nga gjithë këto lexime dhe shqyrtime nuk e pata nxjerr asnjëherë përfundimin e logjikshëm se dalja nga kriza e komunizmit mund të jetë kthimi nga sistemi monist në sistemin shumëpartiak. Kur e mendoj mekanizmin e bllokadës së mendimit tek kjo pikë, më duhet të pohoj se vetë kjo temë nuk ka qenë ndonjë tabu i shpallur, ose diçka që unë i kisha frikë ta mendoja ose ta thosha, por thjesht nuk e shihja si zgjidhje e nyjes ku ishte ngatërruar sistemi jugosllav dhe komunizmi në përgjithësi. Por, ka qenë një moment i përndritjes, kur e kam kapërcyer bllokadën. Diku në vitin '89 e pata lexuar një intervistë të Vladimir Gligorov-it,⁶ e botuar në javorën “Danas” të Zagrebit, ku ai pohonte hapur se nga kriza jugosllave nuk do të ketë dalja pa e thyer monizmin dhe monopolin e partisë komuniste, pra pa instalimin e pluripartizmit dhe kapitalizmit. Po e parafrazoj mendimin, ndoshta ka qenë fjalia edhe më e thjesht, por kjo ishte ideja. Dhe ajo fjali mi hapi aty për aty sytë dhe horizontet. E kuptova përnjëherë se komunizmi po shembet duke i lënë vend sistemit shumëpartiak dhe se edhe dalja nga kriza e komunizmit është në përqaftimin e demokracisë perëndimore... Dhe atëherë e kam menduar se çfarë miopi paskam qenë me vite të tëra, që nuk kisha llogaritur me këtë mundësi... Nuk e kam shënuar saktësisht

6 Vladimir Gligorov, ekonomist, i biri i Kiro Gligorovit, lider komunist nga Maqedonia i ranguar lartë në nomenklaturën titiste..

momentin, a ka qenë në kohën e trazirave në Romani kur u përmbys dhe u vra Nikolae Çausheku, apo në kohën e rënies së Murit të Berlinit, apo megjithatë më herët, kur më erdhi kjo përndritje. Besoj se ka qenë pak më herët, sepse pas shëmbjes së murit dhe rënies si domino të regjimeve komuniste nuk do të ishte aspak çudë të çoja mendimin deri në fund, por është dashur të jetë më herët, më shumë e lidhur me krizën jugosllave e jo me krizën e lindjes komuniste.

“Detabuizimi” i Jugosllavisë

BH: A e kishe edhe për Jugosllavinë kësi lloj tabui? Më kujtohet se një herë pate thënë, nëse nuk jam gabim në librin e Momçillo Petroviçit ku ai bisedon me intelektualët dhe politikanët kosovarë, Rugovën, Qosjen, Demaçin etj., edhe ti je aty, - një konstatim si ky: Me që ne shqiptarët u bëmë një popull i panevojshëm dhe i rrezikshëm për Jugosllavinë, atëherë vendosa ta ndërroi kursin dhe bindjen time për atë shtet.

ShM: Ndoshta, por mua nuk më kujtohet në atë formë. Në atë libër unë e them se jam vetëdijesuar kombëtarisht kur lexoja shpesh propagandën serbe që pohonte se kosovarët nuk e duan statusin e republikës për Kosovën për hir të barazisë, por si një hap që do t’ua mundësonte shkëputjen nga Jugosllavia. Ajo propagandë dhe fushatë serbe ishte aq e poshtër dhe fashiste, aq shumë e bënte gogol çështjen e bashkimit kombëtar, sa që e kapa vetën duke menduar, e pse jo? Pse serbët duhet të janë të gjithë në një shtet, e shqiptarët nuk e paskan të drejtën për bashkim?

Keqkuptimet për qëndrimin tim dhe intelektualëve dhe politikanëve tjerë kosovar që akuzoheshim se jemi projugosllav, burojnë nga vlerësimi ynë i pozitës së shtetit jugosllav në raportet ndërkombëtare, në kohën kur ishte vështirë të paramendohej dhe projektohej shpërbërja e këtij shteti. Edhe alternativa kosovare e viteve të shkatërrimit të Jugosllavisë, llogariste me disa opsione, përkatësisht tri opsione, ku ideja kryesore ishte ajo e pozitës së barabartë të Kosovës, ju kujtohet: nëse mbetet Jugosllavia, Kosova të bëhet republikë e barabartë me republikat tjera; nëse rikonstruktohet federata sipas parimit etnik, atëherë edhe shqiptarët e Jugosllavisë duhet të kanë të drejtë të krijojnë një njësi të vetën etnike, pra Kosova, Maqedonia Perëndimore, pjesët e Malit të Zi dhe Lugina e Preshevës, do të duhej të krijonin ajo që quhej Kosova e Madhe. Dhe opcioni i tretë ishte, nëse shpërbëhet Jugosllavia, atëherë dhe Kosova duhet të shkëputet si republikë e pavarur, ose të ketë edhe të drejtën e bashkimit me Shqipërinë. Ka qenë një periudhë e stuhishme e asaj krize, dhe ne që provonim të mendonim me kokët tonë dhe llogarisnim variantet e daljes nga kriza, me një qasje realiste, sigurisht se bienim ndesh me ata që projektonin dëshirat në realitet dhe çdo qasje realiste si e jona u dukej si tradhti. Tani ka të tillë që mendojnë se ata me idealizmin e tyre të atëhershëm, kanë qenë në të vërtetë më vizionar, më parashikues e edhe më realist se ne. Ndoshta edhe kanë pjesërisht të drejtë, por mendoj se nuk është e vërtetë se proceset kanë ndodhur sipas skenareve të tyre idealiste dhe maksimaliste, por kanë qenë procese të ndërlikuara, ku edhe ne si realista, edhe lëvizja që orientohej me disa opsione dhe vizione, edhe faza e rezistencës paqësore rugoviane më vonë, kanë kontribuar në gjetjen e rrugës drejt pavarësisë, pasi që në lojë është futur me fuqinë e saj vendimmarrëse,

bashkësia ndërkombëtare ose, më saktë, fuqitë perëndimore: SHBA-të, Britania e Madhe, Franca, Gjermania etj.

Fundi i autonomisë

BH: Viti 1989 ishte vit i presioneve të mëdha për ndryshimin e Kushtetutës dhe sistemit. Milosheviçi nxit lëvizjen populiste me militantët nga Kosova. U organizuan mitingjet masive në Kosovë, Serbi, Vojvodinë, Bosnje dhe Malin e Zi. Këto fallanga ultranacinaliste ia mësynë edhe republikave perëndimore, por atje dështuan, në Lublanë nuk u lejuan që të bëjnë miting... Kulminacioni ishte mitingu në Ushqe, aty ku lumi Sava derdhet në Danub. Aty u tubuan disa qindra mija veta, e propaganda e Slobos rrente se ishin disa milion! Në Kosovë Milosheviçi nuk le asnjë lider komunistë, pas burgosjes së Azem Vllasit, nuk e lë më as Kaqusha Jasharin, as Riza Sapunxhiun... Instalon figura qesharake në pushtet, si Sejdo Bajramoviçin, i cili zëvendësoi Sapunxhiun në Kryesinë e Jugosllavisë.

ShM: Po, ky Sejdo ka qenë një kumarxhi dhe anonimus absolut. Milosheviçi tallej me kosovarët, sepse ua zgjodhi një “përfaqësues” karikaturë, një hiç, mbase për ta përçuar porosinë se shqiptarët në shtetin e tij janë hiçgjë... Ka qenë kjo vërtetë një periudhë e frikshme kur Serbia e sfidonte hapur federatën, duke tentuar që ta vendos hegjemoninë. Dukej sikur nga Fushë Kosova, një qytezë e vogël pranë Prishtinës, që praktikisht ishte një paralagje dhe zonë industriale e kryeqytetit të Kosovës, po dirigjohet me federatën. Në këtë qytezë në atë kohë jetonte një komunitet i kolonistëve serbë që numëronin jo më shumë se

disa mija veta, por ata shkruanin peticione, organizonin demonstra-
ta dhe shpallnin urdhëra politikë që ua caktonin agjendën 24 milionë
vetave, sa i kishte banorë Jugosllavia! Kur ndodhte ndonjë incident në
Fushë Kosovë, p.sh. në shtëpitë e serbëve vendoseshin tabelat “Kuća
na podaju!” (Shtëpia në shitje), ose bëhej zhurmë se shqiptarët përd-
hunojnë serbet nëse ndodhte që ndonjë çun të fërkohej rastësisht për
ndonjë gocë të kombësisë tjetër, mediat bënin namin dhe mblidheshin
komitetet qëndrore ku debatohej me orë të tëra se si serbët e Kosovës
janë të shtypur, se po dëbohen me “plan” nga vatrat e tyre, se në Kosovë
janë qindra vendbanime ku nuk ka më asnjë serb... Dhe asnjë nga këto
pohime nuk ke guxuar t’i kundërshtojë. Kuptohet, pas këtij grushti ra-
dikalësh serbë në Fushë Kosovë, jo edhe aq politikisht të ngritur, qën-
dronte Beogradi, shërbimet sekrete, qarqet nacionaliste dhe kishtare,
mediat dhe në krye të piramidës, baballarët e kombit si Dobrica Qo-
siqi, dhe si më i fuqishmi, vetë Sllobo, i cili edhe ishte ngrit në pushtet
në Fushë Kosovë duke u premtuar që “Askush nuk guxon t’ju rrah”, dhe
ata u patën bërë, për një kohë, thjesht gjallesa të paprekshme.

Në gazetatat serbe dhe televizionet mbizotronte diskursi ekstrem ant-
ishqiptar, i cili shumë shpejt u bë edhe antislloven, antikroat dhe an-
timysliman. Çdokush që ua thoshte serbëve se janë në gabim dhe se
po punojnë edhe kundër interesave të veta, ata ua kthenin me qortime
dhe ofendime të paimagjinueshme deri atëherë, e edhe me kërcënime
se do të ketë luftë dhe gjaku do të shkojë si rekë... Duhet kujtuar ru-
brikën famëkeqe në “Politika”, gazetën ditore më të vjetër në rajon, e
cila për disa vjet i hapi faqet e saja për reagime të qytetarëve që ti-
tullohej “Odjeci i reagovanja!” (Jehonat dhe reagimet), që nxorri në
shesh të gjitha plehrat, nacionalizmin, shovenizmin, racizmin dhe na-

zifashizmin serb. Ishin këto fushata zakonisht të orkestruara, ku sulmoheshin, kërcënoheshin dhe frikësoheshin kundërshtarët e Sllobos dhe të projektit serbomad. Beogradi nuk zgjidhte mjete, me dhunë u imponua ndryshimi i Kushtetutës së Kosovës të vitit 1974, pastaj edhe i Kushtetutës të Serbisë...

BH: Votimit për ndryshimin e Kushtetutës i ka mbet një hije, sepse i thanë po shumica shqiptare. Kuvendii Kosovës i kësaj legjislature të fundit komuniste nuk qe në gjendje që të mbrojë autonominë më gishtërinj, vetëm dhjetë deputet ishin kundër. A kanë qenë ky Kuvend në nivelin e përgjegjësisë? Dhe, së dyti, çfarë do të ndodhte sikur shumica të votonte kundër?

ShM.: Besoj se në atë rast Millosheviçi do të gjente ndonjë marifet tjetër, ndoshta do të humbte pak kohë, por gjithësesi do ta arrinte qëllimin... Vetë pat deklaruar kur erdhi në pushtet se qëllimet t'i realizojë me mjete ligjore dhe kundër ligjit... Por, ky lloj i analizës se çka do të ndodhte nëse do të veprohej ndryshe, mendoj se çon në spekulime të kota. Është e vërtetë se në mars të vitit 1989 shumë pak delegatë të Kuvendit të Kosovës votuan kundër ndryshimit të Kushtetutës, që kufizonte autonominë dhe hapte rrugën për kontrollin e plotë të Serbisë mbi Kosovën. Ajo mbledhje është mbajtur në rrethana të kërcënimeve dhe frikës, kur mbi 400 intelektual kosovarë ishin dërguar në izolim, praktikisht ishin në paraburgim pa vendim të gjykatës dhe pa procedurë hetimore. Ata madje u rrahën brutalisht në burgun e Vranjes. Po kështu, Azem Vllasi, Aziz Abrashi, Burhan Kavaja dhe një grup minatorësh të "Trepçës" u burgosën dhe po prisnin gjykimin për 'fajin' e organizimit të protestave të minatorëve dhe punëtorëve disa muaj më parë. Ndaj çdo delegati shqiptar të Kuvendit të Kosovës, sepse ashtu

quheshin deputetet në atë kohë, ishte bërë presion i madh dhe janë frikësuar në mënyra të ndryshme. As vetë procesi i votimit nuk ka qenë në rregull, përreth dhe brenda Kuvendit ka qenë policia, në sallën e mbledhjeve janë futur agjentët e shërbimeve sekrete dhe shumë “mysafirë” që edhe ata i kanë çuar duart në momentin e votimit... Më kujtohet se një ditë para seancës i pata takuar dy delegatë që betoheshin së do të votojnë kundër, por nuk e mbajtën fjalën... Më vonë vetëm e ulnin kokën nga turpi dhe nuk tregonin se çka u kishte ndodhë.

Deklarata e Pavarësisë e 2 korrikut 1990

Mirëpo, është interesant se një vit më vonë, legjislacioni pasues komunist, sepse ai i marsit të vitit 1989 nuk ka qenë i fundit komunist, shfaqti qëndrim të kundërt. Me 2 korrik të vitit 1990 delegatët shqiptar në Kuvend aprovuan Deklaratën e pavarësisë që Kosovën e shihte si njësi të veçantë në federatën jugosllave. Kjo legjislaturë e re mendohej se do të jetë edhe më e dëgjueshme se ajo e mëparshme, por ndodhi kthesa dhe për Deklaratën e Pavarësisë dhe shpalljen e Republikës në Kaçanik me 7 shtator 1990, u siguruan 117 vota. Mendoj se ky ndryshim reflekton zhvillimet e kohës. Në korrik të vitit 1990 frika nuk ishte më e vogël se në mars të vitit 1989, por një vit më parë homogjenizimi nuk e kishte arritur kulmin e tij dhe ndër komunistët shqiptarë që ishin në pushtet dhe përfaqësonin popullin ende kishte të tillë që besonin se ngushtimi i autonomisë nuk do të jetë i plotë dhe afatgjatë dhe se ende do të ketë hapësirë për manovrime, pasi që pritej që Millosheviçi dhe nacionalizmi serb do të mundën nga qeveria federale e Ante Markoviçit dhe Lidhja e Komunistëve të Jugosllavisë. Por kur edhe LKJ u shpartallua në janar të vitit 1990, e edhe Markoviçi nuk arriti që të

bëjë kthesën, të gjithë në Kosovë e edhe në Jugosllavi e kuptuan se nuk ka më kthim parapa, madje në Lidhjen e Komunistëve të Kosovës, që do të shndërrohet në Partinë Socialiste të Serbisë nuk mbet pothuajse asnjë nga shqiptarët titistë dhe autonomistë, ndërkohë që nga dhjetori dhe janari i vitit 1990, flamurin e mbrojtjes të interesave kombëtare në Kosovë e morri Ibrahim Rugova dhe LDK-ja, si dhe partitë tjera që u formuan krahas procesit të shpartallimit të LKJ-së dhe LKK-së.

Një shkrim paralajmërues në “Oslobodjenje”

BH: Dekada e '90 filloi me shembjen e komunizmit, siç e shpjegove, por jo vetëm në Jugosllavi. Kemi fol për këtë periudhë edhe në kapitullin e parë të kësaj bisede të gjatë. Po më intereson se çfarë parashihje se do të ndodhte më pas. Jo ajo që ke shkruar në atë kohë, por për atë që është shfaqur më vonë si proces real. Çfarë mendonte intimisht Shkëlzen Maliqi për tërë procesin?

ShM: Shiko, kështu si e shtrove pyetjen, del se paskam qenë në lajthitje dhe vetëm më vonë jam vetëdijesuar për proceset. Por, unë nuk mendoj se ky është shpjegim i saktë i raportit mes realitetit dhe reflektimit të tij. Jo vetëm unë por shumë veta, intelektualë dhe njerëz të thjeshtë, i kanë reflektuar proceset me një ngecje të kuptueshme, sepse historia zhvillohej më shpejt se që mund ta kapte arsyeja drejtimin dhe ku po na çojnë realisht zhvillimet. Në shkrimet e mia të asaj kohe i kam përmend pasojat e mundshme, edhe shkatërrimin e Jugosllavisë, edhe luftën, edhe anulimin e plotë të autonomisë së Kosovës. Ka qenë një intervistë e imja me Halil Matoshin, pas botimit të librit “Nyja e Kosovës” e botuar në “Zëri”, diku në qershor të vitit 1990, ku

e pata thënë se shumë shpejt Serbia do ta zhbëjë autonominë, sepse kjo atëherë shihej qartë, edhe pse në letra dhe me inercion Kosova i kishte ende Kuvendin, Kryesinë dhe Qeverinë dhe delegacionin e vet në Kuvendin e Jugosllavisë... ky i fundit formalisht e kishte edhe fuqinë e vetos për çdo vendim, madje edhe për atë të ndryshimit të statusit të Kosovës në federatë dhe në Serbi, kuptohej, nëse do të pyetej fare për këtë. Problemi ndërkaq qëndronte në atë se Serbia punonte me të madhe në shkatërrimin e gjithë këtyre themeleve të Jugosllavisë së Titos. Më kujtohet një bisedë që kisha me kryeministrin Jusuf Zejnullahu po në atë kohë kur e kisha botuar intervistën me Matoshin. Nuk e kam njohur mirë Jusufin, as që ishim shokë, por kishte rastisur një premijerë e dramës së Agim Malës në Teatin e Kombësive në Shkup, dhe pas premijerës Agimi më pyeti nëse dua që të kthehem me makinën e kryeministrit në Prishtinë. Dhe gjatë rrugës, në mercedesin luksoz të kreut të qeverisë së atëhershme, po bisedonim për krizën dhe çfarë do të mund të ndodhte me Kosovën. As Jusufi e as Agimi nuk pajtoheshin me skepticizmin tim që kisha shfaqur ato ditë, se autonomia e Kosovës do të asgjësohet. Ata mendonin se institucionet janë të paprekshme, madje se sistemi është më i madh dhe më i fortë se Millosheviçi, të cilit do t'i thyhen hundët në një moment forcat dhe interesat që janë mbi te.

Por, tani që e kërkoja në memorien e kompjuterit intervistën me Matoshin, nuk po më del, e kam diku vetëm kopjen e gazetës. Por, më doli këtu një shkrim i asaj kohe, i botuar në gazetën “Oslobodjenje” të Sarajevës, që titullohet “Kosova: Lufta me mjete tjera”. Ky është një shembull i reflektimit tim të atëhershëm, me të gjitha oshilimet dhe të panjohurat, dhe nuk është se nuk tregon esencën e krizës dhe proceseve. Ja disa citate nga ky shkrim “Muajve të fundit Kosova është

libanizuar deri në fund. Çarja mes etnive e është e plotë, administrata shtetërore dhe ekonomia janë në gjendje kaotike, administrata që premtonte se shumë shpejtë do të stabilizojë gjendjen në Kosovë, është duke ndërmarrë masa gjithnjë e më dëshpëruese dhe absurde, që vetëm ia shtojnë vajin zjarrit! Mbretëron një pasiguri e plotë dhe frika se dhuna shtetërore më në fund do të provokon një rebelim të përgjithshëm të shqiptarëve dhe gjendjen e shtetrrethimit dhe të luftës së gjatë. Gjendja aktuale në të vërtetë edhe mund të quhet si gjendje lufte, jo vetëm për shkak të prezencës së shtuar të milicisë dhe ushtrisë, që është ashiqare një aneksim militar i Kosovës i realizuar nga regjimi i Millosheviçit në marrëveshje me pushtetin qendror të federatës si një kompensim për kinse “anulimin” e gjendjes së jashtëzakonshme, por është gjendje lufte sepse në të gjitha frontet tjera, politike, ekonomike, shoqërore, informative, kulturore etj., po zhvillohet një luftë e pamëshirshme ndëretnike “me mjete tjera”, jo ende luftë e armatosur. Ndryshe nuk mund të shpjegohen intervenimet e milicisë së Republikës së Serbisë në rastin e mbajtjes së mbledhjeve të këshillave të punëtorëve të kolektivëve të firmave të mëdha kosovare, që para disa muajsh janë “integruar” në firmat e mëdha të Serbisë, por që shumica e punëtorëve dhe organet drejtuese duan që sërish t’i pavarësojnë [nga Serbia]. Ose prania e milicisë në kolektivet në rastet kur gjykatat pas procedurave të rregullta i kthenin në punë drejtorët që më parë ishin shkarkuar ose edhe burgosur, me qëllim që të pengohet realizimi i këtyre vendimeve! Strategjia e Millosheviçit është e qartë: të instalohet kontrolli sa më i drejtpërdrejtë mbi Kosovën përmes anulimit të ingerencave autonome nëse duhet edhe me mjete të dhunshme. Kosovës duhet t’i merren të gjitha elementet e shtetësisë, çdo autonomi politike

dhe ekonomike. Kushtetuta ende valide e vitit 1974, që vjet u korrigjua në favor të opsionit të Millosheviçit, por që Kosovës ia lë një autonomi mjaft të lartë, faktikisht është shfuqizuar, pasi që regjimi serb i rezervon vetës të drejtën ekskluzive për interpretimin dhe aplikimin e tij... Shndërrimi i gjendjes së jashtëzakonshme në Kosovë në gjendje permanente krize është bërë nevojë jetike për regjimin serb, sidomos pasi që në lindje të Evropës regjimet bolshevike filluan të bien si kullat prej letrës dhe kur demokratizimi dhe instalimi i sistemeve shumëpartiake u bënë të pashmangshme edhe për Jugosllavinë dhe Serbinë. Nëse Serbia dhe Kosova do të demokratizoheshin në rrethanat kur Kosova formalisht ende gëzon shkallën relativisht të lartë të autonomisë, sepse e ka Kuvendin e vet, institucionet autonome dhe lidhjet e pavarura me federatën - do të vihen në pyetje frytet e “revolucionit antiburokratik” që u realizuan me mund të madh. Andaj regjimi i Millosheviçit e ka imperativ vendosjen e kontrollit të plotë mbi Kosovën para demokratizimit, para zgjedhjeve të lira. Në Kosovë nuk duhet lejuar assesi mbajtjen e zgjedhjeve të lira para se Serbia të sigurojë instrumentet e majorizimit të shumicës shqiptare në nivelin e Republikës së Serbisë. (...) Shqiptarët më nuk kanë asnjë iluzion as për regjimin e Millosheviçit, as për opozitën demokratike serbe (e cila opozitë, kur bëhet fjalë për Kosovën, i jep përkrahje regjimit duke ia lënë kryerjen e punës së pistë të shtypjes së vullnetit të popullsisë shumicë në Kosovë); dhe nuk kanë iluzion as për Jugosllavinë. Mund të pritet se në Kosovë së shpejti në mënyrë legale do të ketë nismë për shkëputjen e Kosovës nga Serbia. (...) Politika ekstremiste e Millosheviçit dhe terrori shtetëror kanë për pasojë dhe kontraefekt një homogjenizim masiv kombëtar të shqiptarëve. Vazhdimi i politikës të “disciplinimit” shtetëror të shqiptarëve

nuk do të kontribuon aspak zgjidhjes së çështjes së Kosovës. Përkundrazi, kjo çon drejt gjendjes kur lufta me mjete tjera shndërrohet në luftë me të gjitha mjetet, në atë gjendje kur shqiptarët do të binden që Kosova është nën okupim, dhe serbët do të veprojnë si okupatorë.”

Kur do të përfundojë kriza në Kosovë

Këto janë pra pjesë të shkëputura nga një shkrim i imi, i botuar në Sarajevë në qershori të vitit 1990, ku qartë ravijëzohet thelbi i krizës, madje edhe drejtimet e zhvillimeve, por ka qenë vështirë të parashikohet se si do të jetë dalja nga kriza, dhe kur dhe si do të ndodhë kthesa.

Se si e perceptoja unë problemin e daljes nga kriza, mund ta ilustrojë me një anekdotë të asaj kohe. Pas grevës së “Trepçës” një komshike që shpesh e vizitonte nënën time, teta Manushe quhej, shumë shpesh më pyeste se kur do të përfundonte ajo katrahurë që na kishte kapluar. Unë i jepja përgjigje të tërthorta, zakonisht më optimiste, por një herë i thash atë që e kisha bindje, se proceset historike si kjo kanë kohëzgjatje goxha të mëdha, ndonjëherë duhen deceniet për të dalë nga kriza... I thash se për çlirim të Kosovës duhet minimum 20 vjet! Ajo më shikoj me hidhërim dhe tha : “Heu, e çove shumë gjatë, kushedi se a do të jem gjallë ta shoh lirinë?” Me këtë dua të them se nuk ka qenë lehtë të jesh profet në ato situata ku shumë faktor janë në lojë dhe veprimet janë të ndërvarura. Ajo që e dija ishte se proceset janë të pakthyeshme, se çështja e Kosovës po shtrohej me tërë ashpërsinë dhe se kërkon zgjidhje meritore. Ndoshta kisha, si edhe shumë të tjerët, besim pak të ekzagjërues në demokraci, se zgjedhjet e lira janë të pashmangshme, dhe se herët apo vonë do të nxjerrin në pah dhe sigurojnë ngadhënjimin e vullnetit të shumicës. Por, pasi që e shtyeja këtë pashmangshmëri

njëzet vjet përpara, që ashtu edhe ndodhi për afërsisht me shpalljen e pavarësisë në vitin 2008, ky profetizim megjithatë ishte një intuitë racionale.

BH: Po e kuptoj tash poentën, por në disa intervista që kemi zhvilluar në vitet '90, ti jepje përgjigje më optimiste se kjo. Ke thënë se kriza e Kosovës do të zgjidhet në vitin 1996!

ShM: Po, ashtu është, nuk kam qenë parashikues. Kam mendu se lufta në Bosnje do të përfundoi më herët dhe se pastaj e ka rendin Kosova. Sepse problemet ashtu renditeshin në deklaratën e parë të Grupit të Kontaktit të vitit 1993, ku projektohej përfundimi i krizës së Jugosllavisë: e para Bosnja, pastaj Maqedonia dhe në fund Kosova. Bosnja ishte në flakë por nuk parashihej ta humb sovranitetin, fuqitë e mëdha e lënin të hapur çështjen e rregullimit të brendshëm pas luftës; Maqedonia sigurohej se nuk do të ketë coptim; më 1993 Kosova ishte në fund të listës dhe të agjendës dhe me subjektësi më pak të qartë, mendohej se do t'i rikthehet një autonomi e lartë, ose zgjidhje e brendshme në Republikën Federale të Jugosllavisë, që do të mund të ishte edhe republikë. Këto ishin qëndrimet e fuqive të mëdha! Dhe unë bazohesha në to, veçse e dija se është hendek i madh mes parimeve dhe reales, dhe proceset mund të kanë shumë dredha dhe ngecje. Por, kur i bëja “profetizimet” nuk bazohesha vetëm në analizën racionale. E kisha parasysh edhe atë që e quanim “mbajtje e shpresës gjallë”, sepse jetonim në një atmosferë tejet depressive, në gjendje të pritjes pa lëvizje dhe rezultate të prekshme. Shumë veta më thoshin, mos na thuaj realitetin por na gënje ngapak, sepse kështu na ushqen shpresën. Me piktorin Rexhep Ferri shpesh pinim kafën e mëngjesit te Qafa, dhe edhe ai kishte dëshirë që të bëja prognoza, kur do të mposhtet Millosheviçi.

I thosha çdo herë se nuk e ka gjatë, vetëm edhe 500 ditë. Po kështu tha edhe herën e kaluar, ma kthente ai me hidhërim. E, po, treni i historisë paska vonesa në itinerer që nga starti, i thosha.

Angazhimet në Alternativën kosovare

BH: Nëse i lëmë anash këto aspekte të rrëfimit, që janë ilustruese për kohën, tani dua të ndalem në një çështje tjetër, ato të aktivizmit të Shkëlzen Maliqit. Ti vazhdoje të shkruaje shkrime që janë kronikë e vërtetë e asaj kohe, por ishe i angazhuar edhe në profilizmin e skenës politike. Pas UJDI-t ishe themelues dhe kryesues i Partisë Socialdemokrate, dhe ke qenë edhe anëtar i dy Këshillave, i Këshillit Koordinues të Partive Politike të Kosovës, dhe i Këshillit Koordinues të Partive Politike të Shqiptarëve në Jugosllavi. Këto kanë qenë organizime të rëndësishme të asaj kohe, ku bëhej strategjia e rezistencës por kishte edhe përplasje konceptesh. Cili ka qenë kontributi i këtyre këshillave?

ShM: Këshillat kanë qenë me rëndësi, por në esencë me një funksion më shumë fasadë, sepse qendrat e pushtetit real të rezistencës ishin tjetërkund, në instancat dhe tek personat tjerë. Në fillim këshillat u instaluan për të siguruar koordinimin e partive politike në mungesë të një qendre të pushtetit real. Motivi i dytë për ekzistimin e këtyre këshillave ishte që të krijohet imazhi se rezistenca e Kosovës është “pluraliste”, me potenciale të mjaftueshme demokratike për mbajtjen eventuale të zgjedhje të lira. Këshilli përbëhej prej gjashtë partive: LDK-së, Partisë Parlamentare, Partisë Fshatare, Partisë Demokristiane Shqiptare, Partisë Socialdemokrate dhe Partisë Republikane. Kjo e fundit më

vonë u përjashtua, pa zhurmë. Ata të LDK-së nuk e donin përfaqësuesin e kësaj partie me një arsyetim që nuk e dinim se a është i saktë. Thoshin se nënën e paska serbe. Më vonë nuk ftohej sepse konsiderohej parti tejet marginale. Në takimet zakonisht merrnin pjesë 7 deri 9 veta, LDK-ja me tre apo katër përfaqësues, Ibrahim Rugova, Fehmi Agani, Ali Aliu dhe ndonjë tjetër, Veton Surroi nga PPK, Hivzi Islami nga PFSH, Ramush Tahiri nga PSHDK, dhe Shkëlzen Maliqi nga PSDK. Deri sa Këshilli koordinues ishte aktiv, në vitet 1990-1992, zakonisht mbanim mbledhjet në këtë përbërje, ose me ndonjë zëvendësim.

Në një periudhë kur Lidhja Demokratike e Kosovës dhe Ibrahim Rugova patën siguruar primatin, përkrahjen dhe autoritetin dominues në popull, këta këshilla, sidomos ai i Kosovës, shërbenin edhe si një lloj amortizuesi për ambiciet e lënduara të dy liderëve që patën mbet jashtë boshtit të lëvizjes së rezistencës. Bëhej fjalë për Rexhep Qosjen, autorin më prominent të librave mbi çështjen kombëtare, dhe Adem Demaçin, që konsiderohej lider i organizatave ilegale dhe të burgosurve politikë që janë angazhuar për bashkimin kombëtar. Këta dy, me rrethet e përkrahëve, kërkonin që rezistenca të udhëhiqet jo nga LDK dhe Rugova, por nga një Këshill Kombëtar, ose Këshill Nacional-çlirimtar. Qosja, i cili e kishte refuzuar postin e kryetarit të LDK-së kur kjo organizatë u themelua, kërkonte që në Këshillin Kombëtar të përfshihen të gjitha personalitetet eminente dhe me autoritet, dhe kjo do të ishte një instancë mbi LDK-në dhe Rugovën. Rugova dhe LDK-ja nuk e pranonin këtë logjikë. Thoshin se koordinimi dhe Këshilli tashmë ekziston në nivelin e bashkimit të partive që ishin themeluar deri atëherë, dhe se këto nivele janë të hapura edhe për personalitetet dhe organizatat tjera, andaj nuk ka nevojë për një hijerarki të re jashtë asaj që kishte fituar

besimin e qindra mijëra vetave që aderuan në LDK, parti dhe lëvizje kjo që e kishte edhe respektin e partive të tjera që bashkëpunonin me Rugovën. Kuptohet, ne partitë e vogla si quheshim, nuk ja mbanim anën Rugovës dhe LDK-së ashtu kot, ose për ndonjë përfitim, por nga realizmi në vlerësimet e ndikimeve. Qosja vërtetë gëzonte autoritet të madh si autor dhe mendimtar në disa qarqe intelektuale, por jo edhe autoritetin përi shkathtësi politike, siç ai mendonte për vetën, duke u krahasuar me baballarët e dikurshëm të kombit. Ndërkaq, Demaçi nuk ishte aq insistues në fillim, sapo kishte dal nga burgu dhe e gjeti vetën më shumë në angazhimin si autoritet moral, e morri drejtimin e Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, dhe nuk e kontestonte publikisht primatin e Rugovës dhe LDK-së. Këtë do ta bëjë hapur më vonë kur par vlerësuar se LDK-ja dhe Rugova po e degjenerojnë lëvizjen me mosveprimin dhe inertizmin.

Presionet e pasuksesshme të Rexhep Qosjes

BH: Si dukeshin këto takime me Qosjen dhe Demaçin?

ShM: Kur mbanim këto takime të zgjëruara, pos Qosjes dhe Demaçit ftoheshin edhe disa personalitete tjera dhe aty bisedoheshin tema të mëdha, për të cilat edhe nuk gjenim gjuhë të përbashkët. Takimet zakonisht kalonin me tensione. Rugova shpesh i bojkotonte, arsyetohej se është i zënë... Më vonë këto takime u radhuan, dhe ne vazhduam punën si Këshill, në përbërjen e ngushtë të liderve të partive, zakonisht me agjenda mjaft operative, duke diskutuar dhe marrë vendime për disa çështje të ndieshme si p.sh., statusin e Kuvendit dhe të Qeverisë në ekzil, ose shqyrtonim në disa seanca rresht ndryshimet në Qeveri në

mënyrë që legjislatura e kohës së autonomisë e cila e pat shpall Republikën në Kaçanik, t'ë reflektojë ndryshimet që patën ndodh në skenën politike. Rezultat i këtyre bisedave ka qenë zëvendësimi i qeverisë së Zejnullahut me atë të Bujar Bukoshit. Në Këshill janë diskutuar edhe deklaratat dhe platformat strategjike që reflektonin pozitën e Kosovës në Jugosllavinë që po shkatërrohej, duke u nisur prej atij trepikëshi parimesh: një, nëse Jugosllavia mbetet shtet sovran federal, Kosova kërkon statusin e republikës së barartë; dy, nëse ndryshohen kufijtë e brendshëm në Jugosllavi sipas parimit etnik dhe Jugosllavia mbetet shtet sovran, shqiptarët kërkojnë krijimin e një republikë shqiptare që pos Kosovës do të përfshinte edhe Maqedoninë Perëndimore, Luginën e Preshevës dhe pjesët e Malit të Zi të banuara me shqiptarë; dhe tre, nëse federata jugosllave shpërbëhet në disa njësi të pavarura shtetërore, shqiptarët/kosovarët kërkojnë të drejtën për referendum ose plebishit për të krijuar shtetin e pavarur ose për t'u bashkuar me Shqipërinë.

Po kështu, në Këshillin Koordinues kemi shqyrtuar dhe marrë vendime e për çështjet e organizmit të rezistencës, për sistemin shkollor që do të quhet sistem paralel por që në të vërtetë ishte vazhdim i sistemit të mëparshëm të autonomisë në rrethanat e reja. Kemi marrë edhe vendimet për mbajtjen e referendumit për pavarësi në shtator të vitit 1991, si dhe për mbajtjen e zgjedhjeve të lira në maj të vitit 1992. Kanë qenë këto aktivitete themeltare të lëvizjes shtetformuese, që në dukje ndonjëherë perceptoheshin si kërkesa në letra, sepse nuk kishim fuqi implementuese, pos në disa segmente të jetës siç ishin shkollat, shtypi, sporti, një pjesë e sistemit shëndetësor, puna humanitare etj., por që megjithatë kishin shumë rëndësi, e mbanin popullin të mobilizuar,

dhe krijonin një imazh të mirë në botë, se jemi popull i civilizuar i cili dhunës shtetërore serbe i përgjigjet me vetorganizim dinjitoz.

Kontributi i Këshillit Koordinues të Partive

Politike në Kosovë

BH: Prej vendimeve që i përmende, disa më duken goxha të rëndësishme, si p.sh. organizmi i referendumit dhe i zgjedhjeve të lira, që edhe ia dolët të realizohen. A ka pas përplasje rreth këtyre organizimeve, konceptuale ose procedurale?

SHM: Të them të drejtën, për të dyja këto vendime ne bënim vetëm një lloj amini, nuk ishte diçka që ishte pjesë e qartë e strategjisë që e përpunonim më parë. Dua të them se vendimi për këto ishte marrë diku tjetër, dhe ne vetëm informoheshim dhe jepnim pëlqimin, kurse punën operative më tej e bënte LDK-ja, sepse ishte organizim i madh, dhe kontributi i partive të vogla ishte simbolik. Për referendumin nuk më kujtohet saktësisht, por ka qenë vendim unanim. Në atë kohë të gjitha republikat e federatës, e madje edhe pjesët e rebeluara të vetësh-palluar autonome të krahinave serbe, i patën mbajtur referendumet, dhe ishte nevoja që këtë ta bëjë edhe Kosova, dhe më vonë e kanë bërë edhe Maqedonia Perëndimore, që një kohë emërtohej Ilirida, e edhe Lugina e Preshevës e pat mbajtur një referendum ku kërkohesh se kjo trevë t'i bashkohet Kosovës.

Ndëkaq për ndryshimet në Qeveri dhe organizimin e zgjedhjeve ka qenë ndryshe. I patëm mbajtur shumë seanca, në një periudhë edhe nga disa brenda javës, dhe nuk gjenim gjuhë të përbashkët. Problemet nuk ishin te parimet por te njerëzit që do të merrnin qeverinë. Për kryemi-

nistër propozonim shumë emra, sërish duke filluar nga Qosja dhe disa të tjerë, por nuk kishte pajtim. Më vonë u pajtuam se për këtë duhet të vendos LDK-ja, atyre u takonte si subjekt më i madh dhe më me ndikim. Dhe u përqendruam te ministria e jashtme, ku mendonim se do të mund të kishim një përfaqësues me ndikim. Unë dhe Veton Surroi e patëm propozuar Mahmut Bakallin për këtë post, ishte politikani më me përvojë që e kishim në atë kohë, madje Titoja në vitet e fundit të jetës së tij i jepte misione diplomatike në botën arabe, dhe sikur e përgatiste që një ditë të merr edhe funksionin e shefit të diplomacisë, të paktën ashtu flitej në atë kohë. Për këtë sikur e kishin përkrahjen e shumicës në Këshill, madje edhe të Fehmi Aganit, dhe kjo çështje sikur u patë vendos, diskutonim për emra të tjerë, unë p.sh. para propozua Xhafer Shatrin për ministër të informimit pasi që e kishte atëherë funksionale një Qendër të informimit në Zvicër. Por, për Bakllin pas një dy jave LDK-ja na informoi se disa degë janë shprehur vendosmërisht kundër, sidomos Dega e LDK-së në Gjakovë. Ne nuk kishim si ta vërtetonim këtë dhe Bakalli mbeti jashtë. Kështu ndodhi edhe me disa emra tjerë që shqyrtonim për ministra të resoreve, vetëm Shatri për çudi mbeti në listë. Pas nja 6 javësh të neglizhimit, në njërën nga mbledhjet LDK-ja doli me propozimin që kryeministër të bëhet Bujar Bukoshi, që atëherë ishte i afërt me Rugovën, dhe kjo u aprovua.

A është dashur të mbahen zgjedhjet e vitit 1992

Ndërkaq, për zgjedhjet e lira ne vazhdimisht kërkonim organizmin e tyre sa më parë që të kemi një kuvend shumëpartiak, por Rugova zakonisht bëhej i shurdhër dhe nuk deklarohet fare. Na injoronte për këtë. Por një ditë, më duket se ka qenë 4 maji i vitit 1992, na thirrën

urgjentisht dhe mbajtëm mbledhjen në Selinë e LDK-së, përkatësisht në Godinën e Shoqatës së Shkrimtarëve, ku është sot Muzeu i Pavarësisë. Zakonisht i iknim mbledhjeve në këtë objekt, sepse në vitin 1991 për një muaj e kishte mbyllur policia, dhe ne e dinim se aty kishin vendosur shumë çimka për përgjime. Mbledhjet më të rëndësishme i mbanim diku tjetër, në shtëpinë e Fehmi Aganit ose të Ali Aliut, në Dragodan. Por atë ditë Rugovës i ngutej, dhe na tha se ka vendos që zgjedhjet e lira të mbahen më 22 ma. Pra, të gjitha përgatitjet, listat dhe operacioni i ndërlikuar i votimeve do të duhej të kryheshin brenda 18 ditësh. Veton Surroi ishte kundër, kërkonte më shumë kohë, thoshte : “Nuk bëhen zgjedhjet në këtë mënyrë, është tallje me demokracinë!” Të tjerët kishin ndonjë vërejtje dhe paqartësi, por e pranuan pa ndonjë rezistencë. Edhe unë isha mjaft i mllëfosur, bile e ngrita pak zërin kur i flisja Rugovës, duke i thënë se kjo nuk ka kuptim, pasi që ne disa muaj propozonim organizmin e zgjedhjeve dhe ai na injoronte, kurse tani po na shtynë që ta bëjmë punën me një nguti të madhe që nuk garanton rregullsinë... Por, pasi që kemi qenë për mbajtjen e zgjedhjeve, i thash se do të përpiqem që Partia Socialdemokrate të dakordohet dhe të dalim edhe na në zgjedhje me kandidatët. Veton Surroi e pa se kishte mbetur vetëm dhe e dha një pëlqimin të kushtëzuar, duke thënë se duhet të konsultohet me organet e Partisë Parlamentare, të cilën e drejtonte në atë kohë. Pasi që dolëm nga mbledhja unë pata me te një polemikë interne dhe mospajtim të plotë për vendimin. Unë i thosha se zgjedhjet edhe ashtu në ato kushte nuk mund të janë zgjedhje të lira dhe tamam, me rregulla, më shumë janë edhe një demonstrim i vullnetit, dhe institucionalizim i pluralizmit që ka më shumë gjasa të pranohet në botë, sepse do të kemi një kuvend, president (ato zgjedh-

je ishin edhe presidenciale) dhe qeveri të dala nga spektri i partive të ndryshme. Ai mendonte se do të jetë improvizim i dëmshëm. Dhe si përfundim, të dy kemi pas probleme me udhëheqësitë e partive, por të gjithë u futem në lojë. Në kryesinë PSDK-së, dominonte mendimi se partia nuk është e gatshme për zgjedhje, nuk e kishim idenë as se si do ti bënim zgjedhjet interne në parti dhe selektimin e kandidatëve për kuvend. Unë insistoja që ta nxjerrim edhe një kandidat për president, që Rugova të mos garonte si emër i vetëm, kjo nuk është mirë për imazhin demokracisë në Kosovë. Dikush u kujtua për Demaçin, që atëherë ishte në një udhëtim në SHBA, e patëm gjet telefonin e tij dhe e pyetëm, por ai u faleminderua dhe e refuzoi. Atëherë unë mendova të kandidohem vetë, jo pse mendoja që kam gjasa, por thjesht për efektin, që Rugova të ketë një kundërkandidat, por nuk arrita ta shtroja këtë si çështje në kryesinë e PSDK-së, sepse ata me të cilët u konsultova thanë se do të humbja në mënyrë katastrofale. Unë këtë nuk e kisha shumë gjale, por ata insistonin se nuk do të dëmtohesha rëndë vetëm unë personalisht, por edhe partia.

Rreth kësaj më kujtohet edhe një gjë interesante pas përfundimit të takimit në zyrën e Rugovës. Kur dolëm nga aty, përfaqësuesi i Partisë Fshatare, ishte Jusuf Bajraktari në atë mbledhje, mu drejtua i çuditur dhe me goxha vërejtje si si kam mundur t'i flas ashtu me tone të ashpra presidentit Rugova! Unë i thash se Rugovën e kam shok dhe nuk mendoj se e kam ofenduar, por e kam shprehur një mllef pasi që na krijojë një situatë të tillë. Kjo punë është dashur të bëhet para shumë kohe, dhe jo kështu shkel e shko! Por, si edhe Vetonit, i pata thënë se duhet ta bëjmë, s'kemi qare. Do të ketë kohë më vonë për zgjedhje të lira dhe sipas rregullave.

Manipulimi me zgjedhjet, një hile e Fatmir

Sejdiut

BH: Dha a kanë qenë të lira?

ShM: Jo, aspak. Kanë qenë organizim i LDK-së, dhe ata janë kujdesur që të sigurojnë fitoren absolute të LDK-së dhe Rugovës. Ka qenë një moment shumë i keq në komisionin zgjedhor, kur po përcaktonim rregullat dhe e qitëm shortin për renditjen e partive në listat zgjedhore për 100 zona. Ishin në konkurrencë sa më kujtohet gjashtë apo shtat parti. Dhe në short LDK-së i ra numri 5 ose 6. Ne e patëm përfunduar punën e komisionit, kur na ftojë sërish me urgjencë Fatmir Sejdiu, profesor i fakultetit Juridik, si kryetar i Komisionit që ishte, dhe tha se shorti duhet të përsëritet. Nuk kishte argumente të forta për këtë, por thjesht ishte tepër insistues, ashiqare ngase LDK-ja nuk donte që të ishte aq poshtë në listën e partive. Unë nuk arrita ta bindja se kjo nuk është në rregull, dhe çështja u mbyll kur shumica e pranoj përsëritjen e shortit. Dhe kur e mendova më mirë, thash më vete se kjo ndoshta edhe nuk ka rëndësi, edhe ashtu zgjedhjet do t'i fitojë bindshëm LDK-ja. Vetëm se kjo hile linte, si edhe shumëçka tjetër lidhur me arogancën e LDK-së, një hije të keqe të poshtërimit të vazhdueshëm të “partive të vogla”. Më shumë çuditësha me profesorin Fatmir Sejdiu që mendonim se është personalitet neutral dhe jurist, që duhet të respektojë rregullat dhe shortin që herën e parë edhe vetë e konsideronte të rregullt. Por kur pas pak kohe u shpall përbërja e re e Kryesisë së LDK-së, nuk u befasova kur aty doli edhe emri i Fatmir Sejdiut.

Pse dështoi Forumit Demokratik i Kosovës

BH: Po në atë kohë është bërë edhe një përpjekje tjetër për organizim alternativë të lëvizjes, i cili do të dështoj si ideja e Këshillit Nacional-çlirimtar të Qosjes. Alternativa kosovare e pat organizuar një tubim të madh në sallën e kuqe të Pallatit të Rinisë, ose Qendrën e Boro e Ramizit, siç quhej në atë kohë. Cila ishte platforma e këtij tubimi në dizajnimin e së ardhmes politike. A e kishit idenë se çfarë po bënit?

ShM: Po, e kishim shumë të qartë se çka donim. Ka qenë një projekt parashikues për situatën në të cilën ishte Kosova, kur po prisnim ndalimin e punës së Kuvendit të Kosovës dhe një gjendje ku nuk do të mund të dëshmohej lehtë legjitimiteti i kërkesave të shqiptarëve si shumicë dërmuese e popullsisë së Kosovës. Në atë kohë në çekoslllovakia ishte krijuar Forumi demokratik i opozitës, kurse unë e kisha parasysh edhe idenë e Osvobodilna Fronta (Fronti i çlirimit) të popullit slloven gjatë Luftës së Dytë Botërore, kur të gjitha partitë sllovene u bashkuan me një ide, për çlirimin në Slloveninë nga okupatorët. I lanë të gjitha ndasitë ideologjike për kauzën e çlirimit të vendit. Edhe neve na duhej një bashkëpunim i tillë dhe jo sektarizmi në lëvizjen për çlirim. Ideja e Forumit Demokratik të Kosovës ishte që ta mbajmë një Kuvend gjithëpopullor, me 500 pjesëmarrës, pjesëmarrësit e të cilit do të delegoheshin nga partitë politike sipas një projekcioni të madhësisë dhe ndikimit të secilës parti që në atë kohë ishte aktive. Nuk jam i sigurtë se si i patëm ndarë karrigët në atë tubim, por e di se e kishim aprovuar parimin e fuqisë dhe se LDK-ja i ka pas të deleguar rreth 300 veta, (komplet udhëheqësinë qendrore, të degëve dhe anëtarët e

spikator), Partia Parlamentare delegoj rreth 60 veta, Partia Fshatare, Partia Demokristiane dhe Partia Socialdemokrate deleguan nga 30 veta, dhe disa parti dhe organizata tjera të sapoformuara kishin deleguar edhe ato nga 10 veta, gjithsejt rreth 50. Mund të mos jam i saktë në këto numra, por ato kanë me këso proporcione. Kishim frikë se Kosova së shpejti do të mund të mbetet pa një kuvend funksional, dhe këtë Forum e shihnim si zëvendësim të denjë të përkohshëm, i cili do të shërbente si një organ legjitim përfaqësuar, dhe i cili që do të mund të zgjidhte edhe organet ekzekutive të përkohshme të lëvizjes çlirimtare, që do të ishin në ballë të rezistencës dhe do të funksionon deri në mbajtjen e zgjedhjeve të lira. Në përgatitjen e konceptit, të mënyrës së punës dhe të deklaratës themeluese kemi punuar disa ditë në shtëpinë e Arbën Xheferit në Hajvali. Në këtë grup punues më kujtohet se kanë qenë Fehmi Agani, Veton Surroi, Hivzi Islami, Ramush Tahiri, unë dhe Arben Xhaferi, ku i fundit më shumë si zot i shtëpisë që na siguronte freskimin dhe kushtet për punë. Ndoshta ka qenë edhe ndonjë tjetër, por këta i mbaj në mend. Deri në momentin final, kur edhe u mbajt ky tubim i madh, nuk kishim asnjë problem, salla ishte plotë, atmosfera dhe porositë serioze, në binën qendrore rinim shtatë veta kryetarë të partive, në krye me Rugovën, kurse Mehmet Kraja i caktuar nga LDK-ja e lexoj deklaratën mbi qëllimet dhe platformën e Forumit. Për sa më kujtohet, ka qenë një datë nga fundi i qershorit të vitit 1990 kur u mbajt ky tubim. Por, të nesërmen në mëngjes, në gazetën “Rilindja” doli një artikull i Mehmet Krajës, ku ai kritikonte ashpër idenë dhe rrjedhën e Forumit! Ai që e kishte lexuar deklaratën, tani po distancohej dhe po e minonte krejt projektin! Çka kishte ndodhur? Pas tubimit të Forumit ishte organizuar një mbledhje urgjente e Kryesisë së LDK-së ku është

konstatuar se Forumi është një organizim dhe trup që nuk përputhet me vendin dhe rolin e LDK-së, sepse kishte tendencën që ta ul poshtë dhe barazon partinë dhe lëvizjen më të madhe, me partitë tjera që kanë ndikim marginal. Nuk di se kush nga udhëheqësia ishte ndier i prekur me formatin e Forunit, por problemi kryesor në perceptimin ka qenë roli që e pat marrë Veton Surroi në atë tubim, si moderator dhe ai që e jepte fjalën, dhe që dikujt i është dukur si përmbysje dhe kërcënim ndaj LDK-së dhe lidershipit të Rugovës.

Ambicja e papërmbajtur e Veton Surroit

BH: A ka qenë kërcënim?

ShM: Ka qenë një moment që ne që e organizuam tubimin nuk e kishim reflektuar mirë. Kemi pas kujdes më përfaqësimin për afërsisht proporcional të pjesëmarrësve, por jo edhe në çështjen e drejtimit të tubimit, që ia patëm lënë Vetonit, ose ai ishte imponuar disi si tepër me ambicien e tij të shprehur, që ka mundur të linte përshtypjen se Forumi është një ndërmarrje pothuajse puçiste e tij, që ai të vihet në krye të lëvizjes. Fehmi Aganit dhe të tjerëve nuk na ka shkuar mendja se kështu do të perceptohet kjo nismë, Vetoni vërtetë ishte personi më agjil në atë ndërmarrje, dhe disi edhe e kishte imponuar vetëm sikur ka qenë personi kyç dhe ideator i ndërmarrjes, dhe këtë disa në LDK-ja e morën si një ambicie të papranueshme për ta, kështu që e lanë menjëherë projektin, duke mos ia varr veshin as argumenteve të Fehmi Aganit.

Më vonë Forumi mbajti edhe disa tubime tematike, ku merrnin pjesë Demaçi dhe disa të tjerë, por pa LDK-në ai do të shuhet shpejt si edhe nisma e Qosjes.

Ylli i Rugovës dhe rapsodia e Sheratonit

BH: A ishte rrjedhojë e dështimit të projektit të Qosjes e edhe ky i përshkruar si ambicie e Surroit, që ylli i Ibrahim Rugovës të bëhet i pakontestueshëm dhe i paprekshëm...

ShM: Ai ishte bërë i tillë që nga pranvera e vitit 1990, sidomos pas atij Hearingu në Kongresin Amerikan, seancë dëgjimore për çështjen e Kosovës në praninë e palës kosovare dhe asaj serbe. Amerikanët ia patën dhënë Rugovës një sigurim special sepse tërë kohën e ruanin 10 top agjentë dhe nuk na linin që të afroheshim pranë tij edhe neve që ishim anëtarë të delegacionit nga Kosova. Dikush e kishte kërcënuar Rugovën nga qarqet ekstreme serbe në SHBA, dhe për këtë arsye ai kishte sigurimin si të një kryetarit të shtetit. Më vonë spekulohet se këtë kërcënimin e kishte shpikur Lobi shqiptar që e drejtonte Joseph Di-oguadi, ish kongresmeni amerikan me prejardhje arbreshe. Por, nuk besoj se shërbimet amerikane do të ishin kaq naive, pos në rastin se me këtë donin edhe neve të partive të ndryshme të demonstrij se ata e çmojnë dhe veçojnë jashtë mase Rugovën. Gjithësesi, ky respekt i jashtëzakonshëm për Rugovën edhe pati efekt, sepse në Kosovë më pas u përhap edhe fama se Rugova është i “përzgjedhuri i Amerikës”. Rapsodi kosovar Agim Gashi e pat lançuar në atë kohë një këngë legjendare me çifteli për darkën e Sheratonit që e pat organizaur lobi shqiptar dhe aktivistët e diasporës. Më duket se ka qenë me 20 prill

të vitit 1990. Pesë orë fjalime të zjarra... Orkestra tërë kohën rrinte në pritje, dhe nuk ariti të bëjë fare muzikë. Dioguardi ishte show-men i përsosur, të gjithë folëm me rrallë, kemi qenë në delgacion mbi 15 veta dhe po kështu folën edhe përfaqësuesit e diasporës. Kur më erdhi rradha mua, ishte bërë vonë dhe unë e bëra një shaka se duhet t'i lëmë orkestrës pak hapësisër që ta tregoj vetëm dhe të na kësaq me muzikë. Por, pastaj thash se është mirë që festojmë, por se kemi edhe shumë punë para vetës. U thash se do të doja që një tubim të tillë madhështor ta organizonim edhe në Prishtinë kur Kosova të çlirohet. Salla sërisht brohoriti "Free Kosova! Free Kosova!" Prita edhe pak që të qetësohen dhe shtova edhe diçka, që disa nuk e pritën mirë. U thash se edhe më madhështore do të jetë kur një kësi festim i lirisë të mbahet edhe në... Tiranë! Para binës ku flisnim ishin disa aktivista të grupeve marksiste leniniste dhe një njëri që i dirigjonte dhe më duket se e ka pas vazhdimisht kontaktin me Abdi Baletën, që ka qenë o ambasador o përfaqësues i Shqipërisë në OKB. Kur e përmenda Tiranën, që atëherë ishte ende nën regjimin komunist të Ramiz Alisë, këta marksistët-leninistët ose më saktë enveristët, u stepën nga hutia, por salla e kuptojë porosinë dhe brohoritën. Vetëm më vonë enveristët do të më qortonin korridoreve të hotelit. Unë me kaq e përvendova fjalimin. Më vonë Halil Matoshi e pat botuar në "Zëri" një transkript nga fjalimet e Sheratonit, dhe nga ky shkrim Agim Gashi e pat sajuar Rapsondinë e Sheratonit, me të cilën u tallesha se ja se sa lehtë është të hysh në letërsinë epike legjendare: duhet të jesh në vendin dhe kohën e duhur, dhe ta kesh me vetën kronistin. Por, kjo ishte pjesa e jonë shqiptare e asaj historie, ku si personazh i vërtetë legjendar do të dal vetëm Rugova, si i përzgjedhuri i amerikanëve, dhe i adhuruari i masave në Kosovë.

Rugova si i përzgjedhuri i Amerikës

BH: A ishte Ibrahim Rugova i përzgjedhuri i Amerikës? Edhe ambasadori i Amerikës në Jugosllavi Warren Zimmerman mbante takime të shpeshta me Rugovën. Si i shihje ti takimet e Rugovës me Zimmermanit?

ShM: Për takimet e veçanta që kanë nuk dua të spekuloj, por disa herë kam qenë në takimet e përbashkëta dhe e di se ambasadori nuk na thoshte asgjë më shumë se që thoshte edhe publikisht. Ishin fjalë përkrahëse për qëndrimin e kosovarëve në krizën jugosllave, por të formuluar me kujdes. Apelonte për durim dhe avancimin e demokracisë. Pas këtyre takimeve ngandonjëherë Rugova dilte me deklarata tejet euforike se “SHBA-të përkrahin kërkesat e Kosovës!” dhe kjo na bënte të çuditëshim, e ndonjëherë besoj se Rugova është demantuar dhe qortuar për këto “keqinterpretime” por ato kanë qenë politikisht tejet funksionale.

BH: Në çfarë kuptimi funksionale?

ShM: Po, ato kishin dy adresa, një lidhësi i Serbisë që e dinte se amerikanët janë më afër me qëndrimet e kosovarëve. E dyta, këto ishin porosi shprese për popullin e Kosovës, që i perceptonte se Amerika është me ne, dhe Rugova di çka bon, duhet ta ndjekim në rrugën e tij. Kurse, amerikanët edhe nuk ishin në ndonjë tleshe të madhe, ata e demantonin jo me ndonjë zell të madh, që kështu edhe ata i dërgonin porosi kërcënuese Beogradit se duhet ta ndryshojnë politikën ndaj Kosovës.

BH: A ishte përcaktuese platforma paqësore që Rugova e shpalli botërisht pas këtij takimi ajo e fuqizoj Rugovën si lider?

ShM: Pritja dhe durimi ishin imperative të kohës. Kosova nuk kishte asnjë parakusht për konfrontim të hapur. Në atë kohë këtë e kanë ditë edhe radikalët në radhët e shqiptarëve, që thoshin se Kosova nuk mund të çlirohet pa kryengritje të armatosur dhe luftë. Rugova vetëm e përshtati strategjinë e vet me gjendjen e mundësitë reale që i kishim në atë kohë. Nëse Zimmermani i thoshte prisni, ai e vlerësoj këtë, por u thoshte njerëzve se Amerika është me ne. Dhe ka pas drejt në instancën e fundit. Ka pas njerëz që bënin presion mbi Rugovën që të ushtrojë politikë më agresive, madje edhe të pëgatitet dhe nis luftën. Ai ka pas një takim me Franjo Tudjmanin në Zagreb, në kohën kur kishte filluar lufta në Kroaci, dhe Tugjmani i kishte ofruar armatim Kosovës që të fillojë lufta edhe në Kosovë. Një dëshmitarë që ka qenë në atë bisedë me gjeneralin Tugjman, nuk më kujtohet emrim i tij, më pat thënë se ai e këshillonte Rugovën se momenti kur po zhvillohet lufta në Kroaci është shumë i volitshëm edhe për Kosovën, sepse forcat serbe do të ngarkoheshin tepër duke luftuar në dy fronte. Por, Rugova as që e dëgjonte, e injoroi pëlotësisht ofertën. Kështu që ata që e kanë përcjellur u patën tmerruar, aty me te ka qenë gjenerali i armatës jugosllave, Tom Berisha. Ka qenë mendoj sot, vendim i drejtë i Rugovës, sepse ai e kuptonte se fronti i dytë i duhej Kroacisë, që ishte në hall nga serbët e rebeluar dhe përkrahja aktive dhe agresore e ish armatës jugosllave që u bë armatë serbe. Tugjmani e kishte hallin Kroacisë, jo të Kosovës. Këtë nuk e kuptonin as disa në Kosovë që janë angazhuar për rekrutimin e djelmoshave kosovarë që kishin ikur nga kazermat e ushtrisë jugosllave në Kroaci, dhe atje nuk kishin status të qartë, disa u bashkuan me ush-

trinë kroate e të tjerët ishin në pritje, Gjenerali Tom Berisha dhe disa të tjerë janë angazhuar që ata të mobilizohen në ushtrinë e Kosovës, të marrin trajnime atje nga kroatët dhe pastaj të përgatiten për kryengritjen në Kosovë. Fami Agani dhe Veton Surroi patën shkuar në krye të vetës për këto biseda me kroatët, pa ndonjë mandat të qartë. Unë kam qenë kundër, sepse këtë nuk e bisedonim as në konsultat që i mbanim në Këshillin Koordinues të Partive Politike Kosovare. Në fund edhe nuk doli asgjë nga kjo puna, sepse nuk kishte bashkërenditje dhe disponim. Kështu ka ndodh më vonë edhe me trajnimet ushtarake të të rinjëve nga Kosova në Shqipëri. Kanë qenë projekte të pakoordinuara, dhe Rugova me filozofinë dhe qasjen e tij ka qenë pengesë për përfundimin e tyre. Në të vërtetë, mungonte përkrahja nga bota, nga fuqitë perëndimore. Pa përkrahjen e tyre nuk ka qenë mençuri që të fillohet rezistenca e armatosur. Kër Këtë Rugova e dinte, ose i kanë sugjeruar hapur, sepse gjithnjë flitej se ai e ka pas një këshilltar të afërt amerikan i cili i tregonte se çka duhet të bëjë në momentet kritike ose kthesë, siç ishte p.sh. ai vendimi i papritur i tij që të organizojmë zgjedhjet. Kam dëgjuar që të spekulohet për disa emra që kanë qenë hije amerikane e Rugovës, por unë nuk kam ndonjë dijeni të drejtëpërdrejtë për këtë dhe nuk dua që të spekuloj me këta emra këtu. Por, është e padyshimtë që gjatë viteve '90 amerikanët dhe britanezët kanë qenë tejet prezentë me diplomaci në Kosovë, dhe shumë më pak gjermanët dhe francezët, e edhe më pak italianët. Dhe që nga vitit 1990 Rugova ka pas një përkrahje të madhe nga Perëndimi, sidomos nga amerikanët. Në çdo moment kritik për lëvizjen dhe për të personalisht, ai ftohej në Uashington, dhe po kështu në Londër, Paris dhe Bon. Dhe kjo e ricementonte popullaritetin e tij në Kosovë tek masat, dhe i zmbrapste kundërshtarët e tij si Qosjen, i

cili shpesh tepronte me kritikën ndaj Rugovës me një gjuhë dhe akuza krejtësisht të pamatura. Në periudhën kur Rugova gëzonte popullaritetin e mbi 90 % të kosovarëve, ta akuzosh Rugovën se është tradhëtar dhe punon për interesat e Serbisë dhe regjimit të Millosheviçit ka qenë budallakë e madhe politike, një lloj i të mëshuarit me kokë për muri që të eliminon nga politika serioze. Këtë gabim edhe e ka paguar Qosja kur ka tentuar më vonë që të futet në politikë. Unë ia pata prognozuar në një shkrim se partia e tij nuk do të mbledh më shumë vota se sa i nxënë 40 autobusa, dhe ashtu edhe doli.

Niveli dhe përgaditja politike e intelektualëve të Kosovës

BH: Pasi që përmende Qosjen si opozitar dhe intelektual me nam, po më intereson vlerësimi yt për intelektualët kosovarë. Në çfarë nivelesh ishin ata gjatë viteve '90; a ishin vetëm entuziastë, patriotë nationalist apo kundërshtar të rastësishëm ndaj proceseve dhe Rugovës?

ShM: Nuk mund të jap ndonjë përgjigje sqaruese për këtë. Intelektualët kanë qenë në të gjitha taboret, edhe në LDK, edhe në partitë tjera të spektrit që ishte pjesë e lëvizjes së rezistencës, që atëherë quhej alternativa e Kosovës, e edhe në ato subjekte që mbetën jashtë, si individë çfarë ishin Qosja dhe Demaçi, ose edhe grupe, lëvizje dhe parti që kushtimisht ende vepronin me qelula "ilegale". Do të duhej të bëhej një studim i publikimeve të asaj kohe që të shihet e gjithë lepeza e qëndrimeve politike por edhe kulturore të intelektualëve. Neve na mungojnë këso hulumtime kritike dhe të thelluara që mbështetet në analizat e

shkrimeve dhe rrëfimeve për atë kohë. Por, unë e kam bindjen, dhe këtë e kam shprehur në një studim që e kam botuar në vitin 2001 që titullohej “Pse ka dështuar rezistenca joviolente”⁷ se intelektualët tonë, duke përfshirë edhe Rugovën konceptualisht nuk kanë qenë të artikuluar mjaftueshëm. P.sh. nuk ka shkrime të Rugovës që mund të pasqyrojnë qartë dhe shtershëm botëkuptimin e tij për rezistencën paqesore.

BH: Si do ta përmbledhje këtë botëkuptim të Rugovës, sot?

ShM: E kam shprehur atëherë mjaft mirë në shkrimin që përmenda. Mund të citojë disa pjesë, nëse nuk mendon se e ngarkojnë këtë rrëfim.

7 Në shtator të vitit 2011 e kam publikuar këtë studim në anglisht si separat në kuadër të edicionit MM.

Pse dështoi rezistenca paqësore

Filozofia paqësore e Rugovës

BH: Nëse karakterizon profilin e Rugovës prej intelektual, pse jo.

ShM: PO filloj pra nga ky konstatim: “Ideja dhe lëvizja joviolente lidhen me liderin e lëvizjes, dr. Ibrahim Rugovën. Edhe pse njeri i pendës, respektivisht kritik letrar, dr. Rugova ishte gjithnjë koprrac në artikulumin e pikëpamjeve të veta politike. Edhe ‘filozofia e joviolencës’ që ai e promovonte, e cila e bëri të lavdishëm, nuk është artikuluar më qartas në artikuj dhe fjalime. Në thelb, politika e tij ishte më tepër pragmatike se sa e bazuar në një teori dhe filozofi. Pikëpamjet e tij për joviolencën si metodë e luftës politike mund të gjenden në një formë pak më sistematike në librin e Marie-Françoise Allain dhe Xavier Garmische: Ibrahim Rugova: La Question du Kosovo, i cili është në të vërtetë një libër bisedash që autorët francezë i kanë zhvilluar me Rugovën.⁸”

8 *Ibrahim Rugova: la Question du Kosovo*, Entretiens avec Marie-Françoise Allain et Xavier Galmiche, Fayard, Paris 1994. Botimi shqip: Ibrahim Rugova: Çështja e Kosovës, Dukagjini 1994. Të gjitha citatet në këtë kapitull, pos nëse nuk është cekur ndryshe, janë nga botimi shqip i këtij libri.

Kjo ishte hyrja dhe pastaj vahdoj: “Nga përgjigjet e Rugovës fitohet përshtypja se ‘filozofia e joviolencës’ e Rugovës është më parë një improvizim se një politikë teorikisht dhe praktikisht e menduar. Duke e konsideruar veten si ‘realist, dhe jo fantast’, Rugova politikën e joviolencës e sheh si të vetmen alternativë që shqiptarët e Kosovës e kishin në rrethanat e dhëna shoqërore dhe raportin e forcave që mbretëronin në Jugosllavi. Rugova e vlerësonte situatën si dramatikisht të pafavorshme, sepse pohon se bëhet fjalë për ‘një gjendje më të rëndë se sa gjendja e luftës’. Mbi Kosovën, pas abrogimit të autonomisë, u shfaq një ‘rrezik i madh nga spastrimi etnik’. Në rast lufte, konsideron ai, gjithsesi do të ‘bëheshin masakra’ ‘edhe më tragjike nga ato në Bosnjë edhe në Kroaci’. Rugova nuk e fsheh se ka frikë, respektivisht ‘që gjërat do të mund të dilnin jashtë kontrollit’, ç’gjë ai e vlerësonte si një ‘hyrje në katastrofë’. Në rrethana të tjera atij i dukej, dhe për këtë ai gjeti mbështetje te masat shqiptare me disponim realist, që përgjigjja më e mirë politike është vetëkontrolli: ‘vetëkontrolli na është imponuar për shkak të terrorit’, thotë ai në një përgjigje. ‘Qëllimi i politikës sonë është ta shmangim tragjedinë’, respektivisht pengimi i gjenocidit mbi shqiptarët e Kosovës. Për t’u mos u fituar përshtypja e një defetizmi të plotë, të shkaktuar prej frikës nga epërsia e serbëve, Rugova në përgjigjet tjera ka theksuar edhe efektet pozitive dhe çliruese të mospërgjigjes me dhunë ndaj dhunës serbe. Ai theksonte ‘traditën e durimit’, si dhe ‘kulturën e solidaritetit’ te shqiptarët, si shpjegim për vetëkontrollin e lartë, si dhe ndjenjën e ‘autoritetit moral’ dhe ‘fitores morale’ të lëvizjes shqiptare : ‘Ata e kanë pushtetin, ne autoritetin’. Rugova konsideron se ajo fitore morale bazohet te liria e brendshme që e fituan shqiptarët: ‘Ne tani në Kosovë kemi një liri të brendshme. E kemi lirinë e sho-

qërisë shqiptare. Ne jemi të shtypur, por jemi të organizuar.' Aktiviteti ynë nuk është i orientuar drejt luftës, por ka qëllim tjetër; ne kemi lirinë e brendshme, psikologjike, dhe këta janë hapat tanë të parë drejt realizimit, një ditë, të lirisë fizike dhe kolektive.' Ai është i ndërgjegjshëm se ky projekt është me rrezik dhe i pasigurt, të cilin shqiptarët 'e paguajnë shtrenjtë', por është i bindur 'se njerëzit mund të shpëtohen me metodat e qeverisjes demokratike'. Në rrethanat e asaj kohe për Rugovën qëllim kryesor ishte të shmangej lufta, por ai megjithatë shpresonte 'që në një afat më të gjatë mund të korrej edhe fitore'. Autorët francezë të librit e citojnë historianin dhe liderin opozitar serb, Ivan Gjuriqin, i cili ngjashëm me Rugovën konsideronte 'se çdo ditë që kalon përfaqëson një fitore për shqiptarët. Në disa kontekste të tjera Rugova fliste në mënyrë të mjegulluar se 'aspiratat shqiptare janë konkretizuar' ose madje që 'në Kosovë funksionon vetëm sistemi ynë'. Rugova, megjithatë, nuk kishte ide më të qarta se si do të mund të arrihej fitorja në një periudhë më të gjatë, sepse angazhohet jo vetëm për politikë joviolente por edhe për politikë pasive të pritjes, kundër çfarëdo aktivitetesh me rrezik potencial. Për këtë arsye ai konstaton saktë se 'rezistenca shqiptare nuk është gandiste', për të cilën e dinte se angazhohej për rezistencë aktive dhe demonstrata e protesta të vazhdueshme kundër regjimit represiv. [Howard Clark në librin e tij për rezistencën joviolente konstaton se 'Rugovizmi nuk ka të bëjë asgjë me gandizmin, dhe madje as me pacifizmin në kuptimin e mirëfilltë të fjalës: Për më tepër është keqinterpretim nëse ai quhet pacifist. Mbi të gjitha ai është një pragmatist. Ai e ka ndjekur politikën paqësore në kuptimin e përgjithshme të fjalës, por në një fazë si dukët e favorizonte krijimin e sistemit të mbrojtjes të Kosovës, dhe më vonë ka punuar në favor të intervenimit të NATO-s.

Pokështu, ai nuk ka qenë gandist. Strategjia gandiane e joviolencës është aktive, duke insistuar në vetë-besimin, programin konstruktiv dhe rezistencën civile, ngase filozofia personale e Gandit mbështetet në dialogun mbi të Vërtetën.⁹ ‘Në këso kushtesh nuk mund të organizohen manifestime paqësore publike, sepse është bërë jashtëzakonisht e rrezikshme të dilet në rrugë’, pohon Rugova. Sado që situata ishte ‘tmerrësisht e padurueshme’, vetë fakti i ‘rrezikut për vdekje’ e imponon strategjinë e pritjes, ‘sepse ajo është rruga e vetme, pa alternativë.. Strategjia e pritjes e Rugovës megjithatë nuk është krejtësisht e papërmbajtje. Ajo bazohet në bindjen se Kosova gjendet në një lloj mbikëqyrjeje dhe në mbrojtjen e bashkësisë ndërkombëtare. Qëllimi kryesor i Rugovës dhe i LDK ishte ndërkombëtarizimi i çështjes kosovare. Çështjen kosovare ‘duhet afirmuar në planin ndërkombëtar’. Rugova ka një ‘besim të pakufishëm tek institucionet ndërkombëtare’, edhepse ndonjëherë shpreh ndonjë dozë dyshimi, tradicionale ndër shqiptarët, se ‘Evropa është e shurdhër’ ndaj faktit që Kosova është shndërruar ‘në një burg dhe kamp përqëndrimi të madh’. Mirëpo, ai besonte te mbështetja dhe ndikimi pozitiv i Shteteve të Bashkuara, si fuqi udhëheqëse botërore, si dhe tek ideja që faktorët ndërkombëtarë herdokur do të detyrohen ta ‘shpërblejnë politikën e jo violencës dhe të paqes’. Kur bëhet fjala, ndërkaq, për vizionin e zgjidhjes politike për Kosovën, Rugova ka patur ide mjaft të reduktuara dhe të përgjithësuar, të cilat i përsëriste fjalëpërfjalë çdo javë në konferencat me gazetarë që mbaheshin të premteve në ora 11, në selinë e LDK-së. “Nacionalizmi demokratik’ i tij bazohej mbi idenë e ‘Kosovës si një shtet neutral, të hapur ndaj Serbisë dhe Shqipërisë, si dhe Malit të Zi dhe Maqedo-

9 Howard Clarc, *Civil Resistance in Kosova*, Pluto Press, London 2000. 6

nisë' Kosova e pavarur, si një shtet i hapur, do të krijohej 'nëpërmjet protektoratit ndërkombëtar', për të cilin ai konsideronte se ekzistojnë 'bazat juridike'. Dr. Rugova gati asnjëherë nuk i ka shpjeguar këto ide të tij. Ideologu dhe veprimtari kryesor në parti ishte nënkryetari i LDK-së, Fehmi Agani, profesor i sociologjisë. Ai edhe në vetë partinë konsiderohej për njërin nga bashkëpunëtorëve të ngushtë të qarqeve me ndikim të nomenklaturës së mëparshme komuniste.¹⁰ Agani, ndërkaq, ishte një faktor mjaft i pavarur dhe, ndryshe nga Rugova, që ndalej te frazat dhe premtimet e thata, zhvillonte një politikë ditore aktive dhe i përcaktonte drejtimet ideore dhe praktike strategjike të veprimit politik të LDK-së dhe të lëvizjes shqiptare. Dr. Rugova po ashtu kishte një vizion tepër rudimentar të Ballkanit, si të një 'bashkësie të popujve të vegjël dhe të barabartë', po edhe për shqiptarët në Kosovë besonte 'që kanë kulturë shtetformuese' dhe një 'forcë të brendshme të madhe'.dhe nga ana tjetër pohonte, si një mbështetje për opcionin e tij, 'që serbët janë në të vërtetë të ndërgjegjshëm se Kosovën nuk mund ta mbajnë edhe më tej me forcë'"

Në vazhdim të paraqitjes së ideve nga ky ese konstatoj:

"Idetë që u parashtruan këtu nuk janë, thjesht, një përmbledhje e thjeshtëzuar e konceptit të Rugovës të rezistencës joviolente. Në esencë, idetë e tij mund të përmbliidhen vërtet pa dëmtime thelbësore në tri faqe, të cilat ai vazhdimisht dhe sërish i ka përsëritur. Megjithatë, kjo varfëri e elaborimit të ideve dhe argumenteve nuk ka ndikuar shumë te populloriteti dhe ndikimi i tij. Në fuqizimin e funksionit të tij prej liderit të pakontestueshëm dhe, për një kohë, të pazëvendësueshëm, kanë ndikuar shumë faktorë të tjerë, dhe jo aftësitë e tij personale dhe thellësia

dhe fuqia e mendimit, aq më pak shkathtësia e tij udhëheqëse ose politike. Rëndësinë më të madhe për pozicionin e tij politik dhe autoritetin në masa e kishte mbështetje që Rugova e mori, që nga momenti i daljes në skenën politike, nga faktorët ndërkombëtarë, në radhë të parë nga SHBA dhe fuqitë evropiane. Kjo mbështetje e kishte rritur deri në maksimum karizmën e tij brenda vendit. Mirëpo, korelacioni i karizmës dhe ndikimit ishte në të vërtetë dykahësh. Në kontaktet me shtetarët, diplomatët, ekspertët dhe gazetarët e huaj, Rugova impresiononte me idetë e tij të matura rreth zgjidhjes politike dhe demokratike të çështjes kosovare. Mirëpo, mbështetja që e gëzonte në botë ishte e kushtëzuar nga mënyra me të cilën ai e kontrollonte Kosovën. Politika botërore, e cila ishte e papërgatitur me krizën jugosllave dhe nuk kishte përgjigje adekuate ndaj saj, dëshironte paqe në Kosovë, me çdo kusht. Ndryshe nga luftat në Kroaci dhe Bosnje, të cilat konsideroheshin luftëra të brendshme dhe lokale, që nuk kanë reprecusione ndërkombëtare më të fuqishme (pastrimi etnik në Bosnje për bashkësinë ndërkombëtare ishte para së gjithash një problem moral dhe jo gjeostrategjik (ky opinion është suportuar haptazi, në shumë artikuj, p.sh. nga Henry Kissinger), një luftë e mundshme në Kosovë, si dhe në Maqedoni, është parë në dritën e të ashtuquajturit ‘efekti i dominos’, respektivisht të zgjerimit vargor në një luftë të rrezikshme regjionale, e pastaj edhe më të gjerë evropiane, e cila do ta rrezikonte paqen dhe stabilitetin botëror. Për këtë arsye presidenti amerikan George Bush, i vjetri, në vitin 1991 e shpalli doktrinën e famshme të ‘vijës së kuqe’ të rrezikimit të interesave vitale nacionale të SHBA-ve dhe Paktit NATO, nëse lufta do të zgjerohej në jug të Jugosllavisë, respektivisht në Maqedoni dhe në Kosovë (Në *Christmas warning* thuhet: ‘Në rast të konfliktit në Kosovë

që do të provokohej nga Serbia, SHBA do të jetë e gatshme të përdorë forcën ushtarake kundër serbëve të Kosovës dhe vetë Serbisë.’¹¹ Politika e Rugovës e joviolencës dhe e pritjes, respektivisht e moshyrjes në kurrfarë rreziqesh, u konvenonte të gjithëve. Jo vetëm Aleancës Perëndimore, por edhe Serbisë e cila në kohën që zhvillonte luftërat në Kroaci dhe Bosnje nuk dëshironte të kishte të hapur edhe një ‘front jugor’, shumë më delikat. Lufta, në atë periudhë, nuk u konvenonte as shqiptarëve në Shqipërinë amë, e cila si shtet po kalonte nëpër një krizë të thellë, as shqiptarëve në Kosovë, të cilët kishin mbetur edhe pa format rundimentare të sistemit të mbrojtjes. Edhe pse shumë bashkëbisedues vendorë dhe të huaj të Rugovës e vërenin, siç do të shprehej më vonë Tim Judah, se ai është ‘një bablok i jashtëzakonshëm’ (*He is extraordinarily dull*¹²), në rrethana të dhëna kjo thjesht nuk ishte thelbësore, ose konsiderohej për një mimikri dhe hipokrizi të llojit të vet.”

Pra, këto ishin në pika më të shkurta pikëpamjet e mia mbi politikën e Rugovës, që edhe sot mendoj se sintetizojnë esencën e rezistencës të viteve ’90, ndonëse zhvillimet kanë qenë, kuptohet, shumë më komplekse, dhe ka pas shumë ngjarje dhe lëvizje që do ta ilustronin më mirë rrëfimin tim.

11 Presidenti amerikan George Bush (i vjetri) më 24 dhjetor 1992 i pat dërguar regjimit në Beograd të ashtuquajturin “Paralajmërim të krishtlindjeve” Tim Judah, *Kosova, War and Revenge*, Yale University Press, New Haven and London, 2000 73; shiko edhe *The Kosova Report: Conflict, International Response, Lessons Learned - The Independent International Commission on Kosova*, Oxford University Press, 2000 , 56.

12 Tim Judah, *Kosova, War and Revenge*, 61.

Konvertimi i intelektualëve

BH: Në shkrimin që citove, ti ke qenë edhe mjaft kritik ndaj Rugovës, sepse analizon pse ka dështuar rezistenca paqësore. Ndoshta do të kthehem tek kjo më vonë, kur të kalojmë te paraqitja e UÇK-së. Ajo që më intereson është edhe atmosfera e asaj kohe kur ikonografia nacionaliste shihej gjithandej. Në Kosovë njerëzit kishin nevojë dhe ishin në një fazë të shpërlarjes së vetvetes duke u shndërruar në patriot dhe nationalist të egër. Deri atëherë shumica ishin me regjimin e vjetër, por u kthyen vrullshëm, sikur nuk e kanë pasur një të kaluar të themi, të servilitetit, nëse jo edhe të shërbimit të hapur regjimit të mëparshëm. Nga buronte kjo dëshirë e madhe për ta mbuluar të kaluarën? Sa e ndershme ka qenë kjo intelektualisht?

ShM: Nuk e gjykoj vetë aktin e ndryshimit. Njerëzit kanë të drejtë që të ndryshojnë bindjet, të kuptojnë se kanë qenë në rrugën ose me mendime të gabuara, të zhgënjehen në një ide dhe të kapën për ndonjë ide tjetër. Nëse dikush më parë ka besuar në komunizëm, dhe pastaj i është kthyer nacionalizmit, shkaktar ka mundur të jetë edhe kriza dhe shembja e komunizmit, dhe në atë katastrofë ideologjia më e afërt kolektivistike që atyre u dukej e kapshme, ishte nacionalizmi, aq më parë kur në Jugosllavi ndodhi kriza e madhe në raportet ndërnacionale dhe u shfaq një ultranacionalizëm militant serb, që nuk mund të mos nxiste paraqitjen e nacionalizmave reaktivë. Nuk ka mundur në ato situata të vazhdohet me retorikën e vëllazërim bashkimit, të solidaritetit dhe Të pajtimit etj. etj. Vetëm Adem Demaçit i lejohej në atë kohë që të fliste me një retorikë që të gjithë e shihnin si tejet të çuditshme, disa edhe e

pëqeshnin hapur, pasi që ai serbët i quante jo vetëm fqinjë të parë, por edhe “vëllazër dhe motra”. Ai e kishte kreditin jashtëzakonisht të madh, kishte kaluar 28 vjet nëpër burgjet e Jugosllavisë komuniste, dhe mund të bënte apel për një bashëpunim mes popujve të Ballkanit, si popuj të barabartë, në atë projektin e tij të Ballkanisë, që në esencë ringjallte parullat e vjetra të socialdemokracisë në fillim të shek. XX, që përmbledheshin në formulën: “Ballkani – i ballkanasve”. Ishte jo vetëm gjeneroze por edhe e guximshme të pohohet se vëllazërimi demaçian është në interesin edhe të vet popullit serb. Në kohën kur ideologët dhe militantët serb ishin egërsuar de bërë agresivë deri në skajshmëri, Demaçi demonstronte një lloj figure si të zbutësit që i afrohet bishës së tërbuar me qëllime të mira! Vetëm se Demaçi ishte përjashtim, kishte pak përkrahës, sepse atyre që më parë besonin në solidaritet dhe në barazi mes popujve dhe etnive, kriza e viteve ’80 dhe ’90 ua prishi çdo iluzion dhe ata u kapën për atë çka e kishin më të afërt, o religjionin, o nacionalizmin, ose të dyjat, si një amalgam që ua mundësonte retushimin e së kaluarës. Për dallim nga Demaçi i cili fliste nga fuqia e viktimizimit të tij, këta intelektualë që i quajte servila të komunizmit, ndonjëherë, kur rrëfeheshin për të kaluarën, e arsyetoheshin se komunizmi jugosllav në një aspekt konsistonte edhe në afirmimin e vlerave kombëtare, pra edhe atyre shqiptare në Kosovë që në kohën e Rankoviçit u shtypën mjaft, por më vonë Titoja e korrigoj kët politikë. Argumenti ka qenë kështu: nëse ne ishim servilët e regjimit, e bënim këtë ngase na lejohej afirmimi i vlerave kombëtare, të një shqiptarizme kulturore por edhe politike. Në një bisedë me drejtorin e “Rilindjes”, poetin Rrahman Dedaj, në vitin 1987, kur ai po më qortonte për radikalizmin tim në redaktimin e revistës “Fjala” sepse botoja shkrimet që kundërshtonin

nacionalizmin serb, ai më pat thënë se disa nga këto shkrime është dashur që t'i censurojë sepse ashtu janë kohërat. Vetëm se, vazhdoj Dedaj, kjo nuk është fytyra e vërtetë e “Rilindjes”. Misioni kombëtar dhe patriotik i kësaj ndërmarrjeje është p.sh. botimi i completeve të klasikëve të letërsisë shqipe, dhe këtu po ma tregonte vitrinën në zyrën e tij ku i kishte të rradhitur kompletet e Naim dhe Sami Frashërit, Fan Nolit, De Radës, Ndre Mjedës dhe të autorëve të tjerë, me ato kopertina të gjelbërta dhe geramat e titujve të shtypura me ngjyrë ari.

Te shumica e intelektualëve që u transformuan brenda natës duke e ndërruar këmishën e kuqe me këmish kuq e zi, e gjejmë arsyetimin se pozicioni i tyre i vërtetë ka qenë ai i mimikrisë, se kanë qenë edhe atëherë për çështjen kombëtare dhe afirmimin e kulturës dhe politikës kombëtare, por është dashur që të veprohet brenda kornizave të kohës dhe si aktivistë të LKJ-së, përkatësisht LKK-së. Sigurisht se ka pas mjaft komunizëm të shtirur, por më parë ka qenë mimikri profitabile dhe me motive karrieriste, dhe jo ndonjë pozicion çfarë tani paraqitet, se ka qenë veprimtari patriotike brenda kalasë së kundështarit, për ta rrënuar atë, për të avancuar çështjen kombëtare. Ajo që unë e shoh te ky brez kameleonësh, që ua zë për të madhe, nuk është transformimi, por mediokriteti, se zakonisht shumica prej tyre edhe nuk kanë bërë asgjë me vlerë gjatë jetës në mimikri, e as pas “konvertimit”. Sa më mediokër që janë, aq më agresivë janë në nacionalizmin e tyre. Disa madje janë pafytyrësisht hipokrit dhe pasi që kanë konvertuar edhe vetë, po merren me konvertitët tjerë, guxojnë që të diferencojnë edhe të tjerët, shumë shpesh duke bërë dallimin mes “intelektualëve titistë”, që ata i shohin si intelektualë me bindje komuniste por të integruar në sistemin jugosllav dhe antikombëtar në formatin e tyre, nga njera anë, dhe

“intelektualëve enveristë”, që kanë punuar në mimikri brenda sistemit jugosllav, por paskan qenë komunistë që e kanë afirmuar çështjen, paskan qenë kombëtarisht të orientuar pozitivisht, nga ana tjetër. Kur janë në pyetje intelektualët, profesorët dhe autorët e librave ose veprave artistike, nuk ka arsye për këso hetimesh dhe zbardhesh të biografive, a kanë qenë me Titon për publik dhe me Enverin privatisht, apo i kanë adhuruar, çka di, kampionët e demokracisë perëndimore... Ajo çka mund dhe duhet të vlerësohet janë veprat e tyre, dhe tek kjo kam frikë se puna nuk qëndron mirë për ta...

Roli i tri shoqatave

BH: Në atë kohë, në fillimin e viteve '90, shumë gjëra silleshin rreth tri shoqatave: Shoqatës së Filozovëve dhe Sociologëve, Shoqatës së Shkrimtarëve dhe Institutit Albanologjik. Diçka kishte edhe Instituti i Historisë i cili konsiderohej shumë komunist dhe i pavlerë?

ShM: Edhe kjo që tha mund të jetë objekt i studimeve kritike, që mungojnë në Kosovë. Shoqatat që përmende kanë qenë të rëndësishme në një periudhë kur Kosova nuk kishte institucione përfaqësuese ose kaluan në ekzil. Shoqatat, kur kishin mundësi dhe vullnet luanin rolin e ndërmjetësuesit. Në Shoqatën e Filozofëve ndodhën angazhimet e rëndësishme politike kur drejtimin e saj e kishte Isuf Berisha dhe unë u bëra kryeredaktor i revistës “Thema”. Ne i dhamë rëndësinë e zërit të një organizate të ndërgjegjshme të shoqërisë civile. Por, kur u themeluan organizatat politike, nuk kishim më nevojë për shoqata. Te filozofët problem ishte që një pjesë e anëtarëve filluan të shfaqnin pakënaqësi

dhe bënin opstrukcione, sepse Isufin dhe mua na përjetonin si uzurpatorët e shoqatës që ata e konsideronin si ndonjë dyqan të tyre, për interesa të prestigjit ose edhe të ndonjë përfitimi material, të ndonjë fondi sado të vogël. Por kur këta filozof dhe profesora mediokër dha abuzues e rimorrën kontrollin e shoqatës, ajo humbi në rëndësi dhe u zhduk në letargjinë e mosbërjes së asgjëje. Te Shoqata e Shkrimtarëve nami mbeti më gjatë, sepse në selinë e saj ndodhej Kryesia e LDK-së dhe një kohë aty ishte Zyra e Rugovës, Presidenca. Rugova ishte në krye të LDK-së, kishte fituar zgjedhjet për President të Kosovës në vitin 1992, dhe vazhdonte ta mbante edhe postin e kryetarit të Shoqatës së Shkrimtarëve. Dhe pasi që Rugova ishte i zënë me aktivitete politike, shtetërore dhe diplomatike, punën me këtë shoqatë do të duhej ta bënte sekretari Milazim Krasniqi, por ai ndejti në atë post si një hije e Rugovës trefishin a katërfishin e mandatit të paraparë me statut, pa e mbajtur kuvendin e shoqatës dhe pa zhvilluar asnjë aktivitet letrar për të qenë. Edhe ashtu roli i ndërmjetësimit për këto shoqata nuk zgjati shumë, pasi që çështjet e përfaqësimit dhe angazhimeve politike kaluan te partitë dhe këshillat që koordinonin aktivitetet e alternativës. Në maj të vitit 1992, pasi që Rugova u zgjodh për president dhe LDK-ja siguroj pushtetin me përparësi të bindshme në vota, ndodhi edhe marginalizimi i alternativës dhe partive të vogla. Ishte një tentim që të mbahej mbledhja konstitutive e kuvendit që ishte zgjedh mr 22 maj, diku nga fundi i qershorit të vitit 1992, por e gjithë lagja rreth ndërtesës së Medresës së re, ku ishte paraparë që të mbledheni, ishte rrethuar nga forcat e mëdha policore. Më vonë Rugova dhe LDK-ja nuk lejonin që të konstituohet Kuvendi, ishin të kënaqur me monopolin në drejtimin e lëvizjes, e cila edhe nuk lëviste fare, u kthye në retorikë të xhumave

kur Rugova mbante konferencat për shtypë, pra çdo të premtë, dhe deklarata dhe takime me diplomatë të huaj.

Deputet në Kuvendin paralel të Kosovës që nuk u mblohdh kurrë

BH: Edhe Shkëlzen Maliqi ishte zgjedh deputet i atij Kuvendi. A ke qenë i involvuar në aktivitete për aktivizimin e këtij institucioni që ekziston pezull, vetëm në letër. Ndonjëherë thuhej se po punon në komisione? A kishte komisione të tilla dhe a ke marrë pjesë në punën e tyre?

ShM: Ka pas disa tentativa dhe peticione të deputetëve, me rreth 50 nënshkrime, edhe unë e pata përkrah nismën, për aktivizimin e Kuvendit, por ishte kot. Na thoshin se nuk ekzistojnë kushtet dhe se nuk duhet të provokojmë situata krize. Në fillim edhe unë dëgjoja se janë aktivizuar disa komisione ad hok të këtij Kuvendi por unë nuk i merrja ftesat për shkakun se LDK-ja kontestonte mandatin tim. Komisioni zgjedhor kishte bërë një si marifet kur janë vetifikuar mandatet e partive, duke vendosur që decimalet e përqindjeve të disa partive që nuk mjaftonin për sigurimin e mandatit të plotë shtesë, konkretisht të Partisë Parlamentare, Partisë Fshatare dhe Partisë Demokristiane Shqiptare, t'i shtohen Partisë Socialdemokrate, e cila nuk e kishte kaluar pragun prej 1 për qind. Komisioni me pëlqimin e këtyre tri partive, edhe pse kjo është kundërshtuar nga LDK-ja, morrën vendimin që Partia Socialdemokrate të dërgoj emrin e deputetit të kësaj partie, dhe në kryesi u vendos që të jam unë deputet. Më sa më kujtohet edhe Komisioni kishte sugjeruar emrin tim. Unë isha kandidat në Prizren, në zonën ku

ka pas kandiduar Edita Tahiri, dhe ajo kishte fituar bindshëm, por edhe unë kisha marrë rreth 500 vota, ndonëse aktivistët e partisë lajmëruan se pas parregullësi me që një grumbull i madh i fletëvotimeve të asaj zone ishin dërguar në një zonë zgjedhore krejtësisht tjetër. Sidoqoftë, edhe liderët e atyre tri partive, e edhe në kryesinë e socialdemokratëve, mendohej se unë meritoja që të bëhem deputet, duke vlerësuar kështu aktivitetet e mia të deriatëhershme në këshillin e Partive por edhe si publicist. Për çudi, në vitin 1996, mandati im fiksohet sërish kur presidenti Rugova vendosi që të vazhdohet mandati i këtij Kuvendi në letër. Komisioni zgjedhor i kishte dërguar partive që të përtërijnë listën e deputetëve të tyre, por ishte në hall me vendin e deputetit që i takonte Partisë Socialdemokrate, sepse kjo parti ishte ndarë në dy fraksione që nuk mirreshin vesh se cilës duhet t'i takojë ky mandat. Atëherë komisioni u kishte propozuar që unë të mbetem në listën e deputetëve, edhe pse e kisha lëshuar partinë në fillim të vitit 1993 dhe nuk ia mbaja anën asnjë krahu, as atij që drejtonte Kaqusha Jashari, as atij që i mbeti besnik Luljeta Pula Beqirit. Dhe me këtë u pajtuan të dy palët. Më patën thirrë avokati Bajram Kelmendi dhe një tjetër anëtar i komisionit zgjedhor dhe më binën që ta pranoj mandatin e ri. Kështu, të dy mandatet e deputetit i pata fituar në tavolinë. Vetëm se mbeti një angazhim në letër jo vetëm për mua por për krejt Kuvendin.

Afera rreth idesë për pjesëmarrje në zgjedhjet serbe

BH: Si ndodhi largimi nga Partia Socialdemokrate, që në fillim e drejtoje ti vetë, e pastaj e zgjodhët për kryetare Luljeta Pulën,

e në parti aderoj edhe Kaqusha Jashari, që dikur ishte në krye të Lidhjes së Komunistëve të Kosovës, dhe e hoqën pasi që u konfrontua hapur me Milosheviçin.

ShM: Nuk kam qenë liderë i lehtë për partinë sepse nuk kisha disiplinë të mjaftueshme dhe publikoja shumë shkrime dhe kisha aktivitete politike jashtë partisë, që nuk ishin gjithnjë të pëlqyeshme për Kryesinë dhe degët. Për shkak që më kritikonin shpesh se po shfaqja publikisht mendimet që “i bëjnë dëm partisë”, ose marrë pjesë në aktivitetet dhe bisedimet që paraprakisht nuk i paraqitja për aprovim, unë u pata tërhequr vullnetarisht nga posti i kryetarit që e mbaja nga viti 1990 di në vitin 1992. Kryetare e zgjodhëm Luljeta Pulën. Unë, nëse nuk gabohem, mbeta nënkryetar dhe përfaqësues i partisë në këshillat koordinues, por që rëndësia e tyre atëherë ishte zvogëluar shumë. Në vjeshtë të vitit 1992 ndodhi një aferë publike që krijoi mjaft zhurmë në opinion, kur unë dhe Veton Surroi dhamë gati njëkohësisht deklaratat, aspak të koordinuara, se kosovarët duhet të mendojnë për pjesëmarrje në zgjedhjet që po mbaheshin në Serbi. Ne nuk po thoshim se duhet të marrim pjesë në zgjedhjet që ishin shpallur atëherë, sepse nuk kishte kushte, por ftonim të reflektohet mundësia e zgjerimit të frontit dhe të metodave të rezistencës duke zgjedhur deputetët nga Kosova në Parlamentin e Serbisë. Nuk më kujtohet se çka ka thënë saktësisht Surroi, por për vetën e di mirë motivim dhe çka pretendoja. Në atë kohë kishim mjaft sugjerime nga diplomatët e huaj e edhe opozita në Beograd, se duhet të mendohej për një strategji e cila do të pamundësonte rizgjedhjen e Millosheviçit në postin e kryetarit të shtetit. Ai ashiqare manipulonte me votat e serbëve në Kosovë, por edhe votat fiktive të shqiptarëve, kështu që në start siguronte mbi 10 % përparësi në man-

date. Opozita serbe na dërgonte porosi “Na ndihmoni ta përmbysim Milosheviçin, atëherë do të jetë më lehtë që të gjejmë zgjidhje politike për Kosovën”. Vetëm se nuk premtinin asgjë konkrete se si do të dukej ajo zgjidhje e tyre. Edhe diplomatët bënë presion që të bashkëpunojmë me opozitën serbe. Por, unë nuk e dhash deklaraten për shkak të këtyre sugjerimeve. Ajo ndodhi pas disa bisedave interne që kisha zhvilluar në qarqet intelektuale, ku shqyrtonim idetë se si mund të dalim nga kriza dhe inercioni në veprime. Në ato biseda unë dhe Gani Bobin kishim mendim të njëjtë se nuk duhet nënçmuar assesi fuqinë e përfaqësimit të zërit të shqiptarëve në Beograd. Nëse partitë politike shqiptare janë vendosmërisht kundër pjesëmarrjes në zgjedhjet serbe (“E shpallëm republikën tonë në Kaçanik, nuk mund të votojmë në një shtet të huaj!”) a nuk do të ishte një mundësi e mirë që në zgjedhjet serbe të garojë një listë e kandidatëve të pavarur shqiptarë, që në programk do të kishte pavarësinë e Kosovës dhe për këtë do të angazhohej në çdo seqacë të Kuvendit të Serbisë. Nuk ishte kjo ndonjë ide origjinale, por e kishim parasysh përvojën e lëvizjes çlirimtare irlandeze, që për shumë dekada e ka pas një krah militant dhe një krah parlamentar, të angazhuar për të njëjtim qëllim, pavarësinë e Irlandës. Kjo thjesht ishte një ide pragmatike mbi zgjërimitin e formave të rezistencës. Megjithatë, kam qenë i vetëdijeshëm se sa do të jetë vështirë që të realizohet. Edhe në atë grupin që e patëm biseduar këtë çështje, nuk më kujtohet se kush ka qenë pos Gani Bobit, as ky i fundit nuk u deklarua qartë se a do të kandidonte ai vetë në një listë të pavarur. Vërejtjet që kishim për idenë ishin këto: Po, ku do t'i gjejmë kaq shumë ‘tradhëtar’ që do të shkonin në Beograd për të përfaqësuar idenë e pavarësisë? Pengesa tjetër ishte edhe rreziku real se lista nuk do të votohej fare, sepse shqiptarët do t'i

bojkotojnë zgjedhjet. Hilja tjetër e sigurtë do të ishte ajo që komisionet e Sllobos që i kontrollojnë zgjedhjet do të bëjnë çmos që lista të mos futet fare në parlamentin serb. Pastaj, edhe nëse do të arrinte qëllimin, në pëarlament deputetet e listës së pavarur për pavarësi do të ishin nën presione dhe kërcënime që mund të paralizojnë efektshmërinë dhe ndikimin. Gjatë bisedës unë isha njëri prej atyre që thosha se ideja është utopi, ka vetëm mundësi teorike për jetësim. Megjithatë, kur më patën ftuar një ditë nga gazeta “Borba”, (ose “Nasha Borba”) e Beogradit me telefon, me pyetjen standarde pse shqiptarët po i bojkotojnë zgjedhjet kur është e qartë se me këtë heqin dorë prej njërit nga mjeteve më demokratike që do të kontribuonte në përmirësimin e pozitës së tyre, unë rrash në kurth dhe filova të përgjigjesha me këto argumente që i përmenda lartë. Por, kur gazetari u bë insistues dhe pyeti a ka kon-dita dhe mundësi që shqiptarët të marrin pjesë në zgjedhje, mua më shpëtoj përgjigja se është një mundësi teorike, dhe përmenda se duhet reflektuar mundësinë e participimit të një liste për pavarësi të Kosovës. Bëhej fjalë për model, jo për diçka që do të ndodhte as në ato zgjedhje e as në rë ardhëm e afërt, por dikur më vonë, nëse rrethanat do të lejojnë këtë. E ata të “Borbës” nuk kanë qenë fer me theksimin tim, por e botuan deklaratën time në ballinë të gazetës, madje me titull bombastik se unë, Maliqi i ftojë shqiptarët që të dalin në zgjedhje. Në Kosovë kjo nuk u prit mirë, gazetat e kontrolluara nga LDK-ja bënë komente të ashpra, na qortuan si trathhtarë, edhe mua edhe Surroin, kujtonin se jemi pjesë e ndonjë komploti të përbashkët, ndonëse ne të dy as që kishim komunikuar. Çështja ishte se ne reflektonim në mënyrë të pavarur një problem që na mundonte, se çfarë do të janë pasojat nëse do mbetemi nën kontrollin e Serbisë për një periudhë më të gjatë, dhe një-

kohësisht nuk do të kemi as mundësi për organizimin e ndonjë revoltë dhe kryengritje të armatosur, e cila do të përkrahej nga bota? A duhet mbetur pasiv dhe pa ide të aplikueshme politike, apo duhet kërkuar edhe format tjera të ndikimit politik, madje edhe duke bashkëpunuar me opozitën në Serbi për t'i bindur se pavarësia e Kosovës është me interes edhe për zhvillimin e demokracisë në Serbi dhe në rajon. Në gjithë atë zhurmë më kujtohet se Ibrahim Rugova pat thënë një vlerësim që e transmetoi radio stacioni Dojçe Velle, pas të cilës deri diku su ndalen osde u zbuten sulmet. Rugova pat thënë se “Maliqi dhe Surroi janë djemt tanë”, kështu diçka.

Refuzimi i postit të lartë në qeverinë e Paniçit

BH: Si ishin reagimet në Partinë Socialdemokrate? A ishte kjo arsyeja për dorëheqje?

ShM: Në Kryesinë e partisë e kisha lehtë që ta sqaroj rrethanat dhe idenë e deklaratës. Sidoqoftë ata më dhanë një qortim të fortë sepse mendonin se kam dëmtuar rëndë edhe imazhin e partisë. Vetëm se dorëheqjen nuk e dhash atëheë, ajo do të ndodh në fund të janarit ose fillim të shkurtit të vitit 1993, kur plasi një lloj konflikti mes Luljeta Pulës dhe Kaqusha Jasharit, dhe partia u nda në dy fraksione, që secila pretendonte se është Partia socialdemokrate e vërtetë. Unë në fillim isha më afër me Pulën, sepse në taborin tjetër ishin Kadri Metaj, Ramush Mavriqi dhe disa të tjerë që përherë kisha maospajtime me ta, edhe në profesion edhe në politikë, por në një kuvend ku përplasja u bë e madhe, me sharrje dhe akuza të neveritshme, (Metaj më kërcënoi me hakmarrje personale dhe familjare për shkak se e kisha publikuar

dëshminë se teza e tij e doktoratës ishte plagjiat), u neverita shumë edhe nga fjalori i pamatur dhe etiketues i Luljeta Pulës dhe e lëshova atë kuvend dhe partinë, duke i ndërpre të gjitha kontaktet me të dy fraksionet. Në të njejtën kohë partinë e pat lënë edhe Arben Xhaferi tek i cili gjeja më së shumti përkrahje. Xhaferi pat vendos që të kthehet në Tetovë ku e morri drejtimin e Partisë Demokratike Shqiptare dhe bëri një karrierë tejet të sukseshme politike.

BH: Ishte ky largim i plotë nga politika, apo vazhdonin sfidat? Është fol atëherë në shtypin e Beogradit edhe për një ofertë të Millan Paniçit, që të marrish në post të lartë në qeverinë e tij. Sa kanë qenë të vërteta këto pohime?

ShM: Pas largimit nga partia unë u angazhova në Fondacionin Soros, në degën e këtij fondacioni të madh që kishim arritur ta hapim në Kosovë. Kurse oferta e Paniçit ka qenë më herët, në fillim të vitit 1992. Atij i duhej një zëvendëskryeministër shqiptar në Qeveri dhe dikush i kishte sugjeruar që të bisedohet me mua. Nuk jam takuar me te por me Tibor Varadin që ishte ministër i drejtësisë në qeverinë e paniçit. Kam qenë në një konferencë të Forumit etnik në Beograd, dhe Dushko Janjiçi gjatë pauzës për drekë të konferencës më ftojë që të shkojmë në restorantin e Klubit diplomatik në rrugën Terazije në qendër të Beogradit, sepse kishte takim me një person interesant që kishte dëshirë të më takonte. Ishte pikërisht Tibor Varadi, profesor i jurisprudencës, hungarez nga Vojvodina, që kishte hyrë në qeveri. Ai më tha se Paniçi është i hapur për bashkëpunim, se ka ndërmend të bëjë ndryshime të mëdha në politikën ndaj Kosovës, t'i rihap shkollat dhe kthejë drejtësinë për të gjithë, të bashkëpunoj me Rugovën dhe të gjitha partitë tjera. Madje, ai e ka rezervuar edhe një post të zëvendëskryeministrit,

e ndoshta edhe ndonjë post ministror për dikend nga Kosova që ka integritet dhe ndikim në Kosovë. Unë i thash se Qeveria e Paniçit në Kosovë shkakohet me dyshime, mendohet se është vetëm një truk i Milosheviçit për të përmirësuar marrëdhëniet me Perëndimin. Sa i përket ofertës për post i thash se Paniçi nuk ka gjasa që të gjejë asnjë personalitet të formatit, i cili do të angazhohej në qeverinë e tij, çfarëdo favore t'i ofroheshin. Secili që do të pranonte këtë post do të nënshkruante aktin e vetëvrasjes politike. Mund të gjejnë eventualisht ndonjë tip si ai që e kishte promovuar Milosheviçi, ndonjë Sajdo Bajramoviç të ri, por kjo do të ishte turp edhe për qeverinë e Paniçit dhe pa asnjë ndikim pozitiv në Kosovë. Varadi pohoj se nuk e duan një person kukull, por me integritet, dhe unë i thash se kërkojnë të pamundurën, se nuk e njoh askend me integritet që do t'i hynte kësaj pune. Dhe kështu e përfunduam drekën dhe ai shkoj. Pasdite, Janjiçi më tha se varadi kishte pas ndërmend që të më propozojë mua atë post të zëvendëskryeministrit, por ishte dekurajuar nga pohimet e mia të prera se nuk ka person të tillë. Ato ditë në gazetata e Beogradit u patën botuar informatat se unë qenkam kandidat për këtë post, madje Milorad Perishiçi që e kam pas shok të studimeve, si ministër i informatave të Paniçi, në një gazetë komentonte këto lajme duke pohuar se atij i pëlqen ideja e emërimit tim. Migjithatë, unë zyrtarisht nuk kam pas asnjë ofertë as bisedë të mëtutjshme. Nuk kam qenë person i përshtatshëm për këtë kombinim, assesi...

Promotor i shoqërisë civile dhe i artit

bashkëkohor

BH: Pse ke qenë i bindur se nuk ka të tjerë që do ta pranoin ofertën për post?

ShM: Nuk u kam thënë se nuk ka fare, ata do ta gjenin ose do ta blenin nëse do të insistonin. Por, u thosha se ai person nuk do të ketë integritet dhe ndikim. Në çdo rrethanë ai do ta luante kukullën për Paniçin dhe Milosheviçin. Pastaj, edhe vetë Paniçi ishte një lloj kukulle, Millosheviçi e largoi shumë shpejtë nga politika.

BH: Shkëlzen Maliqi kishe filluar të heshtë dhe sikur nuk e gjente veten në tërë këtë mishmash ngjarjesh?

ShM: Nuk kam heshtur asnjëherë, por tërë kohën shkruaja artikuj dhe merrja pjesë në konferenca. Kam shkruar çdo javë një koment në “Zëri”, praktikisht si kryeartikull, rubrika quhej “Ballkanalie”, dhe po kështu edhe për mediumet e huaja dhe në hapësirat e ish Jugosllvisë, e më rrallë edhe për gazetatat në Shqipëri dhe Maqedoni. Vetëm se nuk isha më në politikë si aktivist partiak. Më shumë jam angazhuar në organizmin e shoqërisë civile, në suportin e OJQ-ve, në kuadër të Fondit për Shoqëri të hapur. Në vitin 1996 pata përgatitur një projekt për ndihmë arsimit në Kosovë, që punonte në kushtet e vështira. Xhorxh Soros na pat dhënë 2 milion dollarë për asistencë sistemit të edukimit dhe unë e udhëhoqa atë projekt. Zyra e Sorosit i ka ndihmuar edhe mediat, madje edhe Bujkun.

Një interesim të veçantë kam pas për artin dhe kulturën. E kam ndihmuar Teatrin Dodona kur e drejtonte Faruk Begolli, ku pos teatrit

e patëm themeluar edhe galerinë dhe qendrën kulturore, që u bënë institucione të rëndësishme të viteve '90, sepse e mbanin gjallë shpirtin dhe humorin e njerëzve. Po kështu kam ndihmuar edhe afirmimin e një skene shumë interesante të artit bashkëkohor, me shkrime por edhe punë kuratoriale, p.sh. e pata organizuar në Beograd një ekspozitë të artit bashkëkohor të Kosovës që titullohej "Përtej". Në atë ekspozitë patën marrë pjesë Sokol Beqiri, Mehmet Behluli, Maksut Vezgishi dhe Ilir Bajri, ky i fundit me një kompozicion hapësinor. Në atë kohë të rezistencës së përgjithshme u pat paraqit edhe një art i rezistencës, siç e pata quajtur në një shkrim, që ishte njëkohësisht kritikë ndaj regjimit dhe represionit serb, por edhe ndaj rrjedhave artistike akademike dhe të ndaluara në kohë, në Kosovën që artistikisht po bëhej ishull autist, pa kontakte me zhvillimin e artit në botë. Sokol Beqiri dhe Mehmet Behluli reflektonin në mënyrë më të freskët realitetin por edhe mjetet e sjhprehjes në art, duke realizuar për herë të parë instalime, intervenime publike, performansa dhe video-art. Këto të gjitha ishin risi për Kosovën që mjedisi ynë nuk i kuptonte, nuk kishite asnjë përvojë me këto medime, ose u dukshin si improvizime dhe tallje. Për mua ato nuk kanë qenë risi sepse deri sa isha në Beograd, në fillim të viteve '70 kam qenë shumë i afërt me artistët konceptual të rrethit të Marina Abramoviç, Zoran Popoviç, Urkom Gergelj, Rasha Teodosijeviç, Nesha Paripoviç, Goran Gjorgjeviç e disa të tjerë. Ku i fundit, Gorani, ka qenë nga Kosova, nëna e tij Didare ka qenë e familjes Dukagjini nga Prizreni. Arti konceptual në Beograd dhe disa qendra tjera jugosllave, në atë kohë sfidonte tradicionalizmin dhe modernizmin në Jugosllavi, dhe ka qenë mabese stili ose lëvizja e parë internacionale që po zhvillohej në të njëjtën kohë, ose pothuajse paralelisht me tendencat dhe lëvizjet e

njejta në skenën botërore. Beogradi dhe sidomos Qendra Kulturore e Studentëve konsideroheshin në atë kohë si njëra prej pikave më interesante të artit konceptual në botë, dhe në Takimet e prillit, aty vini si mysafir dhe prezentonin punët artistët, kritikët dhe shkrimtarët më të famshëm të kohës: si Joseph Beuys (Bojs), Akile Bonito Oliva, poeti i beat gjeneratës Allen Ginsberg etj., etj. Unë në atë kohë i kam bërë shkrimet dhe reagimet e para ku reflektoja avangardën në art dhe statusin e artit konceptual. Një shkrim që e pata botuar në buletin e Takimeve të prillit, i kushtohet Bojsit, ligjeratës të tij që e pata dëgjuar, ku ai shpaloste konceptin e tij të “skulpturës sociale”, që konsisonte në modelimin si artist të shoqërisë duke ndikuar në ndryshimin e tij, në arsimimin e tipit çlirues nga paragjykimet dhe rolet sociale të parapërcaktuara nga kapitalizmi. Qasja ime ndaj konceptit të Bojsit ishte kritike, sepse unë si student sapo e kisha dhënë provimin e filozofisë gjermane, dhe duke menduar nga margjinat e “Filosofisë së frymës” së Hegelit, i bëja vërejtje Bojsit se koncepti i tij është utopi, diçka e parrealizueshme, sepse artikulimi dhe argumentimi nuk është në nivelin që e ka filozofia gjermane. Kështu diçka ishte qasja ime, pak si konservatore në kuptimin se si student i ri, duke injoruar intencat artistike, po e kritikoja artistin me një qasje filozofike dhe ideologjike. Me këtë shkrim pata një peripeti sepse fillimisht, drejtoresha e Galerisë së SKC-së Bilana Tomiç ka qenë kundër botimit të reagimit, ndërkaq që disa anëtarë të redaksisë kanë qenë pro botimit. Pas dy ditësh është arritur një kompromis që teksti të botohet me disa shkurtime të karakterit të censurës (janë hequr disa kualifikime për Bojsin që janë vlerësuar si ‘ofenduese’). Njëri prej atyre që ka qenë për botimin integral të tekstit (emrin e tij e kam harruar) më ka propozuar që ate ta ripunoj dhe se ai

do ta botojë në numrin special të gazetës “Student”, ku ishte redaktor. “Studenti” në atë kohë kishte tirazh, lexueshmëri dhe ndikim të konsiderueshëm. Unë e kisha bërë versionin e zgjerruar, por fatkeqësisht vetëm në një kopje, dhe ai nuk është botuar me arsyetimin se “është zhdukur” ose “vjedhur nga dikush”. Përkrahësi im që e kishte porositur tekstin këtë “zhdukje” e konsideronte si censurë të vetë qarqeve avangardiste për faktin se në atë kohë pothuajse tërë esteblishmenti oficial politik dhe artistik i Beogradit, (pos një grupi të ngushtë të vijës liberale në partinë komuniste serbe - Marko Nikeziq, Latinka Peroviç etj.) ka qenë kundër artit konceptual dhe ky sulm i imi, që vërtet mund të konsiderohej si “konservator”, është parë si i dëmshëm për SKC-në dhe projektin e afrimit të artit jugosllav me artin më avangarëd bashkëkohor.

Këto kontakte dhe interesime të mia të hershme për avangardën dhe artin konceptual, më kanë ndihmuar që të njoh menjëherë legjitimitetin e tendencave të reja në artin kosovar, që i patën inicuar Sokol Beqiri dhe Mehmet Behluli, e më pastaj i kanë vazhduar edhe Erzen Shkololli, Albert Heta, Jakup Ferri, Dren Maliqi, Lulzim Zeqiri, Driton Hajredini, Alban Muja, Fitore Isufi Koja dhe të tjerët. Këta artista që patën mjaft sukses në skenën ndërkombëtare, dhe nuk kishin shumë përkrahje në Kosovë,

Gjetën edhe përkrahjen e Sislej Xhafës, i cili ishte afirmuar në Itali nga fundi i viteve '90. Ky angazhim i imi në skenën e artit bashkëkohor, e pjesërisht edhe në skenën avangardiste letrare, përmes revistës MM, ka qenë një lloj azili im i dytë nga politika, i ngjashëm si ai i viteve '70 kur po punoja në konservimin e freskave në mansatiret mesjetare. Por, kësaj here nuk jam shkëputur gati asëpak nga shkrimet publicistike,

por punoja paralelisht, për gazeta për të fituar bukën, dhe me artistët kryesisht pa pagesë, vetëm si entuziast dhe dashamirë i artit dhe të guximit që të ndryshojë nëse jo realiteti, atëherë mënyra e vështrimit dhe reflektimit të tij në art.

Pse dështoi rezistenca paqësore

BH: Nga mesi i viteve '90 në Kosovë ndihej lodhja. A ishte Konferenca e Dejtonit fundi i paqes në Kosovë? U zbeh liderizmi, u ashpërsuan marrëdhënjet edhe në LDK, shumë njerëz, sidomos të rinjtë ikën jashtë Kosovës, por u paraqitën edhe grupet ilegale më armë, të gjitha këto e karakterizojnë këtë periudhë.

ShM: Po Dejtoni ishte kthesë e madhe në disponimet. Rrymat radikale në lëvizjen shqiptare që në fillim ishin tepër skeptike ndaj rezistencës joviolente. Ato konsideronin që Kosova mund të çlirohet vetëm me rezistencë aktive, që nënkuptonte edhe rezistencën e armatosur dhe kryengritjen. Grupet më radikale, posaçërisht ato në Evropën Perëndimore (LPK, LKÇK), filluan me përgatitjet për kryengritje. Në ato përgatitje ishte e përfshirë edhe qeveria kosovare në ekzil, e cila dispononte me fonde të konsiderueshme të mbledhura nga diaspora shqiptare dhe e cila ra në konflikt të hapur me Rugovën dhe me LDK-në. Në nëntor të vitit 1995 u mbajt në Dejton Konferenca Paqësore për Bosnjën dhe Hercegovinën. Pritja e kosovarëve që në këtë konferencë do të shqyrtohet edhe çështja kosovare nuk u realizua. Kosova as që është përmendur në dokumentet e kësaj konference. Politika e rezistencës joviolente që nga ai çast filloi në mënyrë të përsheptuar ta humbasë kredibilitetin. Kundërshtarët e Rugovës, psh. Qosja, flisnin

publikisht që Dejtoni ka shënuar “fundin e iluzioneve që bashkësia ndërkombëtare do t’i dëgjonte kërkesat e Kosovës për pavarësi”.

Përpjekja për të influencuar procesin e Dejtonit

BH: A ka pas shansë Kosova që të influencojë procesin e Dejtonit? Çka ka bërë politika e Kosovës kur u caktua fillimi i negociatave në bazën e ushtrisë amerikane në Dejton? Pse atje nuk kishte përfaqësues të Kosovës, as si vëzhgues. Riçard Hollbruku, i cili më vonë do të ndërmjetësoj dhe udhëheq edhe negociatat për Kosovën, ka pranuar se Kosova është lënë jashtë Dejtonit për shkak se ky ka qenë kushti i panegociueshëm i Milosheviçit.

ShM: Ka qenë një zhgënjim i madh anashkalimi i Kosovës në Dejton. Për rëndësinë e kësaj konference kemi qenë të vetëdijshëm prej momentit kur u caktua, nga fundi i verës të vitit 1995. Rugova dhe LDK-ja sikur nuk e kuptonin këtë. Në shtator të vitit 1995, unë jam angazhuar në një mision të ndikimit të Rugovës, që e patën inicuar Mahmut Bakalli, Azem Shkreli dhe Bajram Kelmendi. Që të tre tani janë të ndjerrë, por letra që ia kishin dërguar Rugovës, duhet të jetë në arkivën e pasur të Bakallit, ndoshta edhe në arkivën e Rugovës. Unë nuk kam qenë i përfshirë në hartimin e asaj letrë, por pasi që autorët e kishin shkruar dhe dërguar, kishin kaluar disa javë dhe Rugova nuk kishte dhënë asnjë përgjigje, dhe nuk ka dashur t’i pranojë në bisedë, ku donin që edhe gojarisht t’ia prezentojnë pse politika kosovare duhet të jetë më aktive dhe të sigurojë pjesëmarrjen në Dejton. Dha pasi që nuk kishin sukses, një ditë më patën thirrë mua dhe kërkuan që të ndërmjetësoj në përpjekjet e tyre që të takohen me Rugovën. Ata mendonin

se unë mund të kam ndikim te ai, mbase për arsye që më konsideronin përkrahës të politikës së Rugovës, sepse në shkrimet e mia e sulmoja ashpër Qosjen, kurse ndaj Rugovës shfaqja pikëpamje kritike për disa çështje që ndikonin në imobilizimin e lëvizjes, por në përgjithësi kisha qasje më arsyetuese. Unë në atë kohë nuk komunikoja shpesh me Rugovën. Ai kishte kaluar në rezidencën e re në lagjen Velania, dhe po izolohej nga publiku, në një shkrim e pata quajtur president që banon në pallatin as në qiell as në tokë, si një mbret i politikës pezull, diçka në këtë frymë. Dhe kur e lexova letrën e Bakallit dhe shokëve, edhe pse u thash se nuk besoj se mund të kam ndikim në Rugovën, e pranova që ta vizitoj. E luta mikun tim Nail Luma, që ka qenë i afërt me Rugovën prej kohësh, ta aranzhoj takimin, sepse e dija se e viziton ngandonjëherë familjarisht. Dhe ai na ftoj një mbrëmje te rezidenca e re. Ishte një ambient luksoz, me komodinat dhe fotelat të stilizuara me gravura dhe ornamente pak si të tepruara, por ai na priti ngrohtë, po flisnim gjëra të ndryshme, që lidheshin me kujtimet e dikurshme kur punonim në një barakë, kanë qenë vitet 1987-1989, dhe disi si zor kalonim në tema politike. Ashtu patëm ndejtë më shumë se një orë në atmosferë të ngrohtë dha ai na shërbente me verë të kuqe. Në një moment unë e njoftova për qëllimin e ardhjes time, dhe e pyeta nëse është në dijeni dhe nëse e ka lexuar letrën për rëndësinë e Dejtonit. Ai tha po, dhe i falenderoj miqtë por sikur nuk donte të vazhdonte bisedën për këtë temë duke thënë se gjithçka është nën kontroll. Nuk më lente hapëzire për interenim dhe e kthente bisedën në gjëra tjera. Atëherë unë bëra përpjekje që të zhvilloj disa për argumenteve nga letra, dhe që ishin edhe pikëpamjet e mia, për ate se ndaj fuqive të mëdha duhet të kihet politikë aktive, sepse aty gërshetohen interesat e ndryshme,

dhe duhet patur kujdes nga ndonjë dredhi ose gjysmëzgjdhje, e frika kryesore ishte se Kosovën do të mund ta lënë me një autonomi të kufizuar brenda Serbisë. Rugova e dëgjoj argumentin, por nuk deshi që të futet në dialog. Më tha: “Shkëlzen, nuk mund ta imagjinosh sa na duan amerikanët!” Ai sapo ishte kthyer nga një vizitë në Uashington, dhe tregonte se si sekretari i shtetit Uoren Kristofer e ka pranuar me ngrohtësi të jashtëzakonshme, e ka ulur pranë vetës (“rrinim gju më gju!”) dhe garantuar se Kosova do të jetë nën kujdesin e SHBA-ve dhe se koha po punon për ne. çdo herë që bisedën doja ta ktheja te frika nga anashkalimi i Kosovës në Dejton, ai e kthente bisedën në gjëra tjera, ose e përsëriste atë bindjen e tij se Amerika na do pa masë! Kjo vizitë kështu përfundojë pa sukses, dhe unë u ktheva të Bakalli, Shkreli i Krasniqi, edhe vetë i dëshpruar, dhe i sigurova se nuk ka gjasa që ta takojnë Rugovën. Të shpresojmë se ai ka drejtë dhe se di më shumë se ne mund ta supozojmë. Por, të gjithë ishim mjaft skeptik.

Paraliza e lëvizjes

Kështu, Rugova dhe LDK vazhduan me politikën e mosveprimit dhe paralizën e lëvizjes, duke llogaritur edhe më tej te internacionalizimi dhe ndihma e bashkësisë ndërkombëtare. Tim Juda e përshkruan kështu situatën “(Rugova) dukej që ishte kaplua nga një formë e paralizës politike. Ai lëvizte nëpër Prishtinë me audinë e tij presidenciale, por nuk bënte thjesht asgjë.” Për më shumë, pas Dejtonit dukej se bashkësia ndërkombëtare në njëfarë mënyre e kishte rehabilituar edhe Millosheviçin dhe regjimin e tij, sepse ai kishte marrë rolin e garantit për realizimin e marrëveshjes për Bosnjën. Vetëm SHBA-të kishin rezerva më të hapura ndaj Serbisë, respektivisht regjimit të Milloshe-

viçit, duke insistuar në vazhdimin e të ashtuquajturit mur të jashtëm të sanksioneve për Beogradin, përderisa të mos zgjidhet çështja kosovare. Faktorët ndërkombëtarë, përfshirë këtu edhe KB, në thelb as që kishin instrumente gjegjëse dhe efikase për tejkalimin e tensioneve ndëretnike në Kosovë dhe as për pengimin e një konflikti të hapur të mundshëm. Jugosllavia, respektivisht Serbia, ishte plotësisht jokooperative, po edhe e përjashtuar nga organizatat ndërkombëtare. Monitorimi i vazhdueshëm i krizës, para se gjithash së shkeljes të të drejtave dhe lirive të njeriut, si dhe raportet e shumta kritike dhe notat e drejtuara qeverisë në Beograd nga institucione dhe asociacione ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut nuk kishin gati kurrfarë ndikimi mbi politikën e Beogradit. Në të vërtetë, që nga maji i vitit 1993, kur në Uashington u nënshkrua marrëveshja e Fuqive të Mëdha rreth parimeve të zgjidhjes të krizës jugosllave, me të cilën ranë dakor që Bosnja dhe Hercegovina duhet të mbetet Union, që integriteti i ish IRJ Maqedonisë nuk guxon të rrezikohet dhe që Kosova duhet të kthejë një shkallë të lartë autonomie në kuadër të RF Jugosllavisë, regjimi i Millosheviçit privimin e vet nga politika irrendentiste ndaj pjesës serbe të Bosnjës e kompensoi me ndërprerjen e të gjitha formave institucionale të kontrollit ndërkombëtar të situatës në Kosovë, për të cilat kishte rënë dakord më parë. Beogradi i ndërpreu negociatat për Kosovën në kuadër të një grupi të posaçëm për Kosovën pranë Konferencës Paqësore të Gjenezës për Jugosllavinë, dhe poashtu i tërhoqi akreditivat për Misionin e Përhershëm të OEBS-it në Kosovë. Duke iu referuar parimit të moscenimit të kufijve të brendshëm në ish Jugosllavinë, për çka këmbëngulte edhe Grupi i Kontaktit i Fuqive të Mëdha, Beogradi që nga maji i vitit 1993 Kosovën e trajtonte ekskluzivisht si një “çështje të

brendshme të Republikës së Serbisë”. Lëvizja kosovare mbeti në njëfarë mënyre e vetmuar dhe e braktisur, respektivisht ishte kapluar nga politika e inercionit. Rolin e ndërmjetësuesit për zgjidhjen e problemeve konkrete, siç ishte çështja e normalizimit të punës të sistemit shkollor, për të cilat qeveria në Beograd tregonte gatishmëri për të biseduar e morën mbi vete organizatat humanitare joqeveritare. Me 1 shtator 1996, organizata humanitare e Vatikanit Shën Egjidio, pas negociatave sekrete të zhvilluara midis përfaqësuesve të qeverisë serbe dhe ekipit negociator kosovar, në krye të të cilit ishte Fehmi Agani, e arriti marrëveshjen për normalizimin e punës së shkollave. Marrëveshjen e nënshkruan ndaras S. Millosheviç dhe I. Rugova. Në atë moment dukej se është gjetur një model për tejkalimin e tensioneve me qasjen hap pas hapi, i cili nga njëra anë do t’i ofronte disa satisfakcione konkrete për lëvizjen shqiptare dhe njëkohësisht do ta siguronte kooperativitetin e regjimit serb. Mirëpo, problemi me këtë marrëveshje qëndronte te fakti se ajo mbeti e bllokuar në fazën e implementimit, sepse dy palët nuk arritën të bien dakord rreth masave konkrete dhe dinamikës së realizimit. Në vend që ta ndihmojë politikën e Rugovës, ajo shkoi në dëm të saj, sepse i zgjoi shpresat që nuk mund të realizoheshin. Në mënyrë të posaçme ishin të zhgënjyer studentët e Universitetit të Prishtinës, të cilët punonin në kushte më të rënda. Studentët, në dhjetor të vitit 1996 ia shkruan një petition Rugovës, për të cilin kishin mbledhur rreth 500 nënshkrime, me të cilin Rugovës dhe LDK-së i jepnin një afat ultimativ prej dy muajsh për realizimin e marrëveshjes, respektivisht që studentëve t’u ktheheshin objektet e okupuara të fakulteteve dhe të mundësohej liria e plotë e punës për universitetin shqiptarë.

Kryengritja e brendshme

Një vit më onë, me 1 tetor të vitit 1997, Unioni i Studentëve nuk ishte më i gatshëm t'i dëgjoj premtimet boshe të Rugovës dhe të bashkëpunëtorve të tij. Kontrollin mbi Unionin e Studentëve e morën rrymat radikale në lëvizjen shqiptare, të cilat e akuzonin Rugovën për tradhti, kolaboracion me regjimin serb. Me 1 tetor të vitit 1997 studentët dhe arsimtarët organizuan demonstrata paqësore, të cilat policia serbe i pengoi me përdorimin e forcës. Kjo ngjarje shënoi fundin e karizmës së pakontestueshme të Rugovës dhe ndikimit mbi masa. Në fund të nëntorit të po atij viti, në varrimin e një viktime të represionit serb, UÇK-ja, deri në atë kohë misterioze, u shfaq publikisht për herë të parë në një tubim në regjionin kosovar tradicionalisht kryengritës, në Drenicë, ku UÇK u prit me duartrokitje frenetike dhe me miratim. Rugova dhe LDK-ja nuk kishin përgjigje dhe një strategji gjegjëse për kundërvënien efikase kësaj kryengritjeje të brendshme. Në shkurt të vitit 1998, disa javë para masakrës mbi civilët që policia e kreu në fshatrat e Drenicës, Likoshan, Qirez dhe Prekaz, me ç'rast Serbia faktikisht hyri në luftë, LDK-ja u shpërbë në krahun militant dhe në atë pacifist.

UÇK, në të vërtetë nuk u çua në kryengritje vetëm kundër pushtetit serb në Kosovë, por njëkohësisht përfaqësonte edhe një kryengritje kundër "regjimit të brendshëm" dhe pushtetit paralel që ishte organizuar nën udhëheqjen e Rugovës dhe LDK-së. Kjo do të thotë që lëvizja kosovare së pari ishte kontestuar dhe rrezikuar përbrenda, që pastaj të sulmohej dhe praktikisht të shkatërrohej nga regjimi serb. Në luftë, lëvizja e rezistencës civile praktikisht kishte mbetur pa kokë dhe e çorientuar, duke mos kuptuar dhe duke mos pranuar si realitet faktin që UÇK-ja ishte një përgjigje alternative, shqiptare ndaj krizës. Rugova

kur nuk e ka pranuar UÇK-në si një forcë autentike të rezistencës, duke pohuar se fjala është për një “komplot serb”, respektivisht për “mercenarë me të cilët dirigjon policia sekrete serbe”.

Është e padyshimtë se Rugova dhe LDK-ja në masë të madhe i kanë kontribuar imobilizimit dhe atrofisë të lëvizjes të rezistencës civile, respektivisht ndjenjës së shtërpësisë së plotë dhe papersektivës të zgjidhjes paqësore dhe demokratike të krizës kosovare. Suksesi i kësaj lëvizjeje të madhe dhe unike është varur nga ajo sa ishte e përgatitur dhe e aftësuar të kontrollojë situatat e krizës që kanë mundur ta shkaktonin luftën. Deri në vitin 1997 në atë lëvizje kanë ekzistuar mekanizma të caktuar për kontrollimin e zhvendosjes së disponimit të masave drejt kryengritjes së hapur. Në fund të vitit 1997 një gjë e tillë nuk ishte më e mundur jo vetëm për shkak të provokimeve serbe, të cilat kanë qenë të pranishme edhe më parë, por edhe për shkak të vetëverbërimit dhe miopisë të udhëheqjes të lëvizjes së rezistencës civile. Në atë kohë, në të vërtetë, dolën në shesh dobësitë organizative dhe udhëheqëse të lëvizjes, e cila kishte vënë një qëllim tepër të lartë (pavarësinë e Kosovës), pa asnjë instrument serioz për realizimin e tij, dhe e cila duke dashur ta shmangë luftën me “strategjinë” të ngathtësisë, pritjes dhe mosveprimit, në njëfarë mënyre i topiti dhe i paaftësoi edhe sistemet vetjake të alarmit për rrezikun e luftës. Dobësia themelore e lëvizjes kosovare të rezistencës civile konsistonte me faktin që ajo, duke marrë mbi vete funksionin e brigadës zjarrfikësve, kishte harruar t’i mbush rezervuarët e ujit për shuarjen e zjarrit edhe në vetë stacionin e zjarrfikësve ku ajo bënte kujdestari.

Zgjidhja e krizës është dashur prandaj të kaloi në kompetenca të bashkësisë ndërkombëtare. Ajo, në mars të vitit 1998, reagoi më ven-

dosshmërisht, duke u përpjekur ta pengoi luftën dhe të arrij një marrëveshje politike bazuar në parimet për të cilat kishin rënë dakord në kuadër të Grupit të Kontaktit në maj të vitit 1993. Fuqitë e Mëdha, SHBA, EU dhe Rusia ia kanë imponuar Beogradit pranimin e procesit negociator, duke u kërcënuar se në të kundërtën do ta përdornin forcën kundër palës më të fuqishme dhe më agresive në konflikt. Lëvizja kosovare e rezistencës joviolente përjetoi thyerje të plotë në pranverë të vitit 1998. Regjimi serb e kuptonte vetëm gjuhën e forcës. Megjithatë, rezistenca shumëvjeçare civile dhe joviolente nuk ishte krejtësisht e kotë. Ajo i ka dhënë argumentet politike dhe morale për faktorët ndërkombëtarë të involvuar në zgjidhjen e krizës për arsyetimin e intervenimit ushtarak kundër politikës serbe agresive dhe gjenocidiale.

(Biseda është zhvilluar në disa seanca në periudhën 2007-2011)

SHTOJCË

TRI RRËFIME

Shkëlzen Maliqi

Mbi normalitetin

Refleksione rreth mashtrimeve personale dhe të gjeneratës, rreth lindjes dhe fuqizimit të fashizmit serb, rreth shpërbërjes së Jugosllavisë, mbi ikjet nga Beogradi dhe mbi strategjitë e karantinës dhe strategjitë e tjera të rezistencës ndaj së keqes, të frymëzuara nga libri i Vlladimir Arsenijeviçit “Meksika: ditari i luftës”

Në fund të majit të vitit 2000 Fadil Bajraj ma solli një disketë me dorëshkrimin e librit më të ri të Vlladimir Arsenijeviçit. Vëllai i tij, Xhevdeti, ia kishte dërguar librin me e-mail nga Maksiko Siti i largët. I propozonte që libri të përkthehet në gjuhën shqipe. Fadili më tha asoherë: “Unë mendoj që librin duhet përkthyer dhe botuar, por do të dëshiroja të di çfarë mendon ti për librin dhe për idenë që ai të botohet në gjuhën shqipe. Do të ishte mirë nëse ti do ta shkruaje parathënien. Në njëfarë mënyre ti je i ngërthyer në gjithë këtë histori, siç do ta shohësh edhe nga dorëshkrimi, po as unë nuk njoh njeri tjetër që do ta bënte një hyrje më të mirë”. Unë i thashë që kam shumë obligime, por që diçka megjithatë do të shkruaj, në mos asgjë tjetër një shënim të shkurtër, nëse e vlerësoj që libri përmban pjesë delikate që duhet shpjeguar. Ky do të jetë libri i parë i një shkrimtari serb që pas një kohe më të gjatë do të botohej në Kosovë. Të gjithë do ta lexojnë me thjerrëz. Duhet të jesh sa i guximshëm aq edhe i kujdesshëm që ky botim të mos ketë një efekt kontraproduktiv.

Librin “Meksika: ditari i luftës” e lexova me një frymë. Arsenijeviçi, të cilin nuk e njoh personalisht, në një vend e përmend edhe emrin tim. Unë vërtet isha i përzier në një pjesë të “intrigës”, nëse mund të them kështu, që është rrëfyer në të tijn “ditar të luftës”. Unë, në të vërtetë, në nëntor të vitit 1998 isha lutur nga Bashkim Shehu, i cili punonte në Barcelonë për Parlamentin Ndërkombëtar të Shkrimtarëve, që t’ia rekomandoj një shkrimtar kosovar për projektin e ofrimit të azilit për shkrimtarët e rrezikuar. PNSH kishte në dispozicion banesa dhe mjete për qëndrimin e shkrimtarëve (për një ose dy vjet) në disa qytete evropiane dhe në Meksikë, dhe meqenëse edhe në vitin e parë të luftës në Kosovë kishte shkatërrime të mëdha dhe zhvendosje të mëdha të popullatës, Bashkimi m’u lut që ta njoftoj nëse midis shkrimtarëve kosovarë ka të tillë që janë të rrezikuar ekzistencialisht. PNSH ka mundësi që menjëherë t’i ofrojë ndihmë një shkrimtari, e nëse ka më tepër të tillë, PNSH do të kërkonte bursa të reja nga qytetet donatore.

Mua m’u kujtua menjëherë poeti Xhevdet Bajraj, i cili pas masakrës së korrikut të vitit 1998 dhe peripecive të mëdha kishte arritur të largohet nga vendlindja e tij, Rahoveci, dhe të strehohet me familjen në Prishtinë, ku kishte marrë një banesë me qira. Nuk kishte kurrfarë të ardhurash. E ndihmonte i vëllai i tij më i vjetër, Fadili, po edhe unë nga fondi i revistës MM ia jepja 200 DM për muaj, ku Xhevdeti e kishte botuar një seri vjershesh të shkëlqyeshme, bruto dhe të fuqishme (“Lulet e egra”). Xhevdeti ishte në një depresion të thellë dhe azili do t’i bënte mirë. I thashë Fadilit që ta thërriste Xhevdetin dhe ai, pa u menduar gjatë, e pranoi ofertën, sepse kushtet që i ofronte PNSH ishin vërtet të shkëlqyeshme.

Pasi Bashkimi më mori me telefon herën tjetër, më luti që të mësoja, por me kujdes, nëse ndoshta Xhevdeti do të kishte diç kundër nëse do t'i jepej azili letrar në Meksiko Siti bashkë me një shkrimtar nga Beogradi. “Quhet Vladimir Arsenijeviç. Ata, në të vërtetë, do të vendosen në dy banesa fqinje, që janë në përfundim e sipër”. Unë i thashë Bashkimit se nuk besoja që kjo do t'i pengonte Xhevdetit. “Nuk e di nëse Xhevdeti ka dëgjuar për Arsenijeviçin. Ai është një shkrimtar i ri, ndërsa ne në Kosovë tash e dhjetë vjet, nëse përjashtohet “incidenti” provokues, siç është organizimi i ekspozitës “Përtej” në Qendrën për Dekontaminimin Kulturor në Beograd (e kisha përgatitur unë), i kishim ndërprerë lidhjet kulturore me Serbinë.” I thashë Bashkimit që ato ditë, fare rastësisht, e pashë te një mik, gjatë udhëtimit në relacionin Beograd-Prishtinë, romanin e Arsenijeviçit “Nën kuvertë”. E lexova një pjesë në autobus dhe pastaj e huazova librin për dy ditë që ta përfundoja. Arsenijeviçi për këtë roman e ka marrë shpërblimin e NIN-it, i cili është një lloj Gonkuri jugosllav. “Është e vërtetë që Xhevdeti është pakëz i traumatizuar nga ato që i ka përjetuar në Rahovec, dhe më vonë gjatë fshehjes nëpër male, por nuk besoj që fqinjësia e një shkrimtari serb do të përfaqësojë ndonjë problem të madh për të. Përkundrazi, mendoj se do t'i ndihmojë që në një botë aq të largët dhe të ndryshme, aq më parë që nuk e flet spanjishten, ta ketë fqinj Arsenijeviçin.” Ashtu edhe u bë. Xhevdeti kishte dëgjuar nga shtypi (ne në atë kohë në Kosovë i lexonim ende gazetat dhe javoret serbe, posaçërisht ato anti-regjim, “Naša Borba” dhe “Vreme”) për Arsenijeviçin dhe e dinte që ai kishte një përcaktim kundër regjimit. “Nëse asgjë tjetër, presupozoj që e dëgjojmë të njëjtën muzikë” – më tha Xhevdeti.

Në ditarin e Arsenijeviçit lexuesi do ta ndjekë gërshetimin e çuditshëm të fateve të tre azilantëve letrarë, dy shqiptarëve, Bashkim Shehut dhe Xhevdet Bajrajt, dhe të një serbi, Vlladimir Arsenijeviçit. Bashkimi së ka takuar kurrë Arsenijeviçin, por ka komunikuar me të me ditë dhe muaj të tërë vetëm me telefon ose e-mail. Xhevdeti do ta njoftonte në Meksikë.

Edhe Xhevdeti edhe Vlladimiri kishin vështirësi të mëdha për të arritur në Meksikë. Rrugëtimet e tyre dramatike deri në Meksikë janë përshkruar ose rikonstruktuar gjer në detaje në ditar. Unë isha gjithë kohës i njoftuar me këto peripeci, nëpërmjet Fadilit, me të cilin isha refugjat në Tetovë që nga marsi deri në korrik të vitit 1999, ose nëpërmjet Bashkimit, i cili lajmërohej shpesh me telefon nga Barcelona.

Megjithatë, në ditarin e Arsenijeviçin mua më intrigoi më shumë ajo pjesë e shënimeve që i kishte marrë në Beograd, në kohën e bombardimeve. Ajo pjesë e ditarit jo vetëm që e rrumbullakësonte dhe përplotësonte rrëfimin për udhëtimin në Meksikë, të cilin e dija, por ajo inkuadrohej në një rrëfim tjetër të papërfunduar, të cilin e lidha me historinë time personale të marrëdhënieve me Beogradin. Unë, në të vërtetë, kam studiuar dhe jetuar në Beograd që nga viti 1966 gjer më 1982. Në studime kam shkuar në moshën 19 vjeçare, ndërsa u ktheva në Prishtinë kur i kisha mbushur 35 vjet. Edhe më vonë kam qëndruar shpesh në Beograd, kryesisht me punë, si bashkëpunëtor i Fondacionit Sorros. Ne që nga viti 1993 e kishim kancelarinë e Fondacionit në Prishtinë, selia e të cilit ishte në Beograd.

Kur u largova nga Beogradi, në vitin 1982, isha i njohur vetëm në rrethin e miqve. Në Prishtinë fillova të shkruaj tekste të angazhuara publicistike dhe politike, të cilat më bënë të njohur për opinionin beo-

gradas dhe atë më të gjerë, jugosllav. Në Beograd kam patur shumë miq dhe të njohur, të cilët më respektonin edhe kur nuk pajtoheshin me qëndrimet e mia politike. Natyrisht, kisha edhe shumë armiq, si dhe ish miq dhe të njohur, të cilët e kthenin kokën në anën tjetër kur më shihnin. Që nga viti 1982, rrethi i miqve dhe i të njohurve po ngushtohej disi. Beogradin, ku më parë ndihesha mirë, e përjetoja disi me bezdi. Me kalimin e viteve, ai bëhej gjithnjë e më i largët, gjithnjë e më refuzues. Njerëzit që i takoja atje dhe me të cilët punoja ishin pak a shumë o.k., por më dukeshin si oaza në shkretëtirë. Ka ndodhur shumë herë që prej autobusit ose makinës të shkoja drejt e në mbledhjet e caktuara që më parë, dhe me ta përfunduar punën, nuk kisha kurrfarë dëshire të mbetem ose të takoj njeri. Nëse isha i deturuar ta kaloj natën atje, në ndonjërin prej hoteleve gjithnjë e më të mjerë beogradas, më së shpeshti në “Moskë”, para fjetjes e ndieja vazhdimisht neverinë e qëndrimin në një qytet që më ishte bërë i huaj. Nuk e kuptoja më. Nuk mund të isha më i sinqertë dhe spontan as me shokët dhe të njohurit. As ata nuk i kuptoja më. Është e vërtetë që përpiqeshim të fusim ca forma racionaliteti në ato marrëdhënie. I investonim fondet e Sorrosit për zhvillimin e shoqërisë civile, në media, NGO, kampet e të rinjve, edukatë... Por, e bënim këtë në një rrethim të së keqes dhe kërcënimit të përhershëm me luftë. Ishim të pafuqishëm para të keqes, edhe pse e mashtronim veten se gjoja po i kundërviheshim duke investuar në ardhmërinë, në njerëzit e rinj, në projekte të shëndosha, të cilat do ta sillnin ndonjëherë një kthesë...

Unë që më 1992, kur filloi lufta në Bosnjë, e konsideroja Beogradin fajtor. Mendoja, sikur të kishte drejtësi në botë, atëherë do të duhej që Beogradi të bombardohej menjëherë, si hakmarrje për të ligat që vinin

prej tij. Në Kosovë i bindja miqtë se ky është një opsion serioz, se në NATO kanë filluar me numërimin. Rrethimi dhe bombardimi i Sarajevës, krimet në Bosnjë, nuk mund të kalojnë pa intervenim. Mirëpo, në atë kohë presidenti i atëhershëm i Francës, Fransoa Miteran, aterroi në aeroportin e Sarajevës, ia bëri një shërbim shumë të keq Bosnjës, po edhe bashkësisë ndërkombëtare. Serbët arritën ashtu ta kryejnë pjesën më të madhe të punës, dhe vetëm pas tre vjetësh NATO do ta zhvillonte aksionin e parë të bombardimit në historinë e tij, kundër serbëve boshnjakë. Beogradi arriti të shpëtojë asoherë. Millosheviçi u bë, madje, “paqekrijues”.

Në Kosovën e vitit 1998 po përsëritej historia me agresionin serb dhe spastrimet etnike. Faktorët botërore kësaj radhe nuk lejuan që të mashtrohen. Pasi më 24 mars të vitit 1999 Javier Solana dha urdhërin për të bombarduar Beogradin dhe objektet ushtarake në Serbi, gëzohesha që, ja, hakmarrja e drejtë kishte goditur më në fund atje ku është dashur të orientohet mu në fillim. Serbia nuk u dënua vetëm për shkak të Kosovës, por edhe për luftërat në Kroaci dhe Bosnjë.

A thua divorci im me Beogradin erdhi tepër vonë, tani kur gjithçka kishte marrë fund? Nuk e di. Bombardimi ma ka sjellë edhe një rreth të ri zhgënjimi me miqtë dhe të njohurit që kishin qëndrime kundër regjimit dhe që e mbështesnin zgjidhjen demokratike të çështjes së Kosovës, por në një situatë kur nuk kishte më zgjidhje tjetër, përnjëherësh filluan që të angazhohen në mënyrë abstrakte kundër çdo të keqeje dhe dhune, duke i barazuar veprimet e regjimit të Millosheviçit me “dhunën” e forcave të UÇK-së dhe të NATO-s. Kjo ishte trishtuese dhe tragjike, për ata vetë para së gjithash.

Nëse NATO në rastin e Kosovës, si fundja edhe në Bosnjë, veprimi si një polic botëror, kjo nuk ndodhi pse Aleanca Perëndimore dëshironte ashtu kot ta përdorë forcën dhe fuqinë e vet, por pse edhe në marrëdhëniet ndërkombëtare, si edhe në jetën e rëndomtë, duhet të ekzistojnë forcat e rendit dhe të paqes, të cilat i parandalojnë dhe dënojnë krimet. Imagjinojeni vetëm një situatë banale, ku një bandë kriminelësh ushtron dhunë të vazhdueshme mbi civilët. Këta civilë në një moment nuk mund t'i durojnë më zullumet dhe, edhe pse janë shumë më inferiorë, vendosin t'i bëjnë rezistencë bandës. Policia, e cila ndoshta nuk ishte më e përkushtuara në veprimet kundër bandës gjithnjë derisa të keqtrajtuarit nuk u çuan në kryengritje, detyrohet të ndërvejojë më vendosmërisht për të penguar masakrën. Kjo, fundja, është puna e policisë, d.m.th. t'i mbrojë njerëzit nga dhuna. Po, tani, pacifistët e mjerë dhe parimorë, edhe ata beogradas edhe ata botërorë, nuk e merrenin në konsideratë këtë situatë elementare, kur intervenimi i forcave të rendit është i pashmangshëm, por konsideronin, ashtu "parimisht" dhe në mënyrë abstrakte, që çdo zbatim force është jolegjitime. "Ne jemi kundër çdo dhune dhe për zgjidhjen e konflikteve në rrugë paqësore!" Ky dënim "parimor" i çdo lloji dhune ishte tamam ajo që e dëshironte Millosheviçi. Ai konsideronte që është sovran dhe zot shtëpie dhe që askush nuk guxon të përzihet në "punët e tij të brendshme", në ç'mënyrë dhe me cilat mjete e zgjidh ai kryengritjen e UÇK-së. Mund të vras dhe dëboj sa të dua civilë shqiptarë, sepse të gjithë ata janë terroristë potencialë. Mund ta djeg dhe bëj shkrumb e hi gjithë Kosovën, sepse ajo është tokë serbe.

A është dashur që shqiptarët të sillen vetëm si dele para kasapit? Disa nuk kanë bërë ashtu, dhe për këtë arsye kanë organizuar kryengritje

dhe kanë themeluar UÇK-në. Faktorët botërorë kanë zhvilluar dialog me Millosheviçin një vit të tërë, ndërsa ai negociatat dhe UÇK-në i shfrytëzonte si arsytim për të vazhduar me krimet. Vazhdoi të rrafshojë me tokë fshatra të tëra, dhe vazhdoi me dëbimin dhe vrasjen e civilëve. Grumbullonte gjithnjë e më shumë forca ushtarake në Kosovë. Nuk e pranoi planin e paqes. Ç'u kishte mbetur tjetër policëve botërorë pos ta dënonin kriminelin? Dhe ashtu që u bombarduan para së gjithash forca dhe fuqia serbe, objektet dhe efektivat ushtarake.

Në fillim të majit të vitit 1999, si refugjat në Tetovë, e pata dhënë një intervistë për revistën e Splitit "Feral Tribune". Ato ditë isha i tronditur nga lajmi se në Kosovë qe burgosur dhe likuiduar Fehmi Agani. Profesor Agani ishte një njeri i madh, mendja më e ndritur ndër politikanët kosovarë, diplomat dhe mjeshtër i veprimit taktik, negociatori kryesor kosovar, ishte disa herë më superior se të tjerët, madje edhe nga Ibrahim Rugova, edhe pse krijonte përshtypjen që vepron nën hijen e tij. Ai i tërhiqte fijet e politikës kosovare, derisa Rugova kryesisht humbiste kohën kot me imazhin e tij dhe mitet... Isha aq i zemëruar dhe i dëshpëruar për shkak të ekzekutimit gjakftohtë të Aganit, sa që në një intervistë për "Feral Tribune" mezi e prita pyetjen që do të më çlironte nga lidhjet e të kaluarës. Ndarjen me Beogradin duhej ta shpallja publikisht. Milenko Jergoviç, i cili e bëri bisedën, më pyeti: "Në një numër të 'Svijet'-it sarajevës, z.Dragomir Ollujiq e ka ritreguar bisedën telefonike me Ju dhe vuri re që, pa marrë parasysh miqësinë dhe njohjen e gjatë, ndjehej neveritshëm më pas. Çfarë janë sot marrëdhëniet tuaja personale me miqtë beogradas dhe si i shihni ato në të ardhmen?" Unë iu përgjigja: "Më vjen keq, por mua nuk më kujtohn detajet e bisedës

me Ollujiqin. Por, nëse ai e ka përdorur fjalën neveri, ajo tani, shikuar në retrospektivë, më duket e saktë. Unë kam jetuar vërtet gjatë në Beograd, pastaj, pas kthimit në Kosovë, vazhdova t'i mbaj kontaktet me njerëzit normalë atje. Por, tani ka ardhur koha dhe më është bërë e neveritshme gjithë çka ka të bëjë me Beogradin. Po të kisha një karakter hakmarrës, do të thosha që Beogradi e meriton fatin e Sodomës dhe Gomorës! Por, meqë nuk jam i tillë, në vete them me qortim: kush u ka faj atyre që nuk e kanë braktisur gjer më tani Beogradin dhe Serbinë, atë strofull plaçkitësish dhe kriminelësh! Pasi ndodhi e gjithë kjo, pasi që disa shokë më thirrën nga Beogradi, unë përpiqesha të bisedoj normalisht, por nuk mund ta davarisja përfytyrimin e qytetit me murtajë, që ata, shokët e mi, të jetojnë atje në atë, më falni, qelbësirë, midis "target orgjive", hipokrizisë së gjoja "pafajësisë", qëndrimit "çfarë i kemi bërë ne zotit", nga i cili depërton racizmi më cinik ndaj shqiptarëve, meqë ata, gjoja, "nuk kanë lidhje çfarë po ndodh ashtu në Kosovë", që "nuk ndjehen fajtorë" dhe as që u "intereson" fare se çka po bëjnë shteti dhe regjimi i tyre në Kosovë. Unë kam turp sot nga Beogradi dhe e kam një ndjenjë se nuk do të shkelë më këmba ime në të përderisa të mos dekontaminohet një herë e mirë. Po pra, nuk kanë mundur të ndodhin aq lehtë edhe Vukovari, edhe Sarajeva, edhe Srebrenica edhe, tani, Kosova, dhe që Beogradi "liridashës" dhe "liberal" i rrethit të dyshit fle vazhdimisht me ndërgjegje të pastër. Nëse asgjë tjetër, do të duhej të kenë vërtet turp, dhe jo t'i aktrojnë "viktimat e pafajshme të agresionit të NATO-s".

Pas leximit të dorëshkrimit të Arsenijeviçit unë e ndjeva që nuk mund të shkruaj një parathënie të zakonshme për të tijin "ditar të luftës". Nëse vërtet shkruaj diçka, atëherë kjo duhet të jetë rrëfimi im

për Beogradin. “Ditarin e luftës” e përjetova si një lloj guri të mbramë në mozaikun e gërshetimit të ngjarjeve dhe fateve, me të cilat jo vetëm që përfundojnë “ikjet” e tyre në Meksikë, por edhe ikjet dhe azilet tjera, ku bëjnë pjesë edhe ikjet e mia nga Beogradi, deri tek ai dimensionin që në një intervistë tjetër, në gusht të vitit 2000, e shpreha për Radion B2-92, se “Kosova po largohet nga Serbia me një shpejtësi drite”. Kup-tohet, “largimi me shpejtësinë e dritës” përfaqëson vetëm një metaforë për procesin historik të pashmangshëm të fragmentimeve etnike dhe territoriale, por unë megjithatë edhe pas këtyre deklaratave ndarëse e ndieja se herët a vonë do të detyrohem për t’u ballafaquar me çështjen se çfarë në të vërtetë kishte ndodhur me Serbinë dhe Beogradin, ku një kohë mund të jetoje relativisht mirë dhe i lirë, për të dëshiruar pastaj në fund që ai të asgjësohej si Sodoma e Gomora? Ditari i Arsenijeviçit më shërbeu si një nxitje për rishqyrtimin e përvojës dhe iluzioneve të mia.

Unë e kam njohur dhe përjetuar Beogradin në fund të viteve ’60 dhe ’70. Për fatet tona vendoste ende në atë kohë politbyroja komuniste. Në vitin kur u shkarkua Aleksandër Rankoviç, më 1966, unë e mbarova shkollën e mesme në Prishtinë dhe u nisa për studime në Beograd. Midis katër opsioneve për studime që më tërhiqnin, pikturës, dramaturgjisë, letërsisë dhe filozofisë, e zgjodha këtë të fundit.

Kur arrita në Beograd, si një provincialist mendjemadh dhe që kishte lexuar shumë, ngjanin ndryshime të mëdha në federatën jugosllave dhe në shoqëri. Tito dhe Kardeli, me “shokët”, të cilët pak a shumë u venin pas prijësve, e filluan rikonstruktimin e themel të shtetit jugosllav. Në vend të federatës unitariste me një aparat të fuqishëm policor dhe represiv, për të cilën angazhoheshin Rankoviçi dhe, siç presupozohej,

pjesa më e madhe e serbëve, u ndërtua një model i ri, hibrid, i shtetit të decentralizuar, faktikisht konfederal, por me armatën unike, e cila e kishte rolin e garantuesit që shteti do të mbeste unik. Që nga rënia e Rankoviçit deri te Kushtetuta e vitit 1974, Serbia që e trenditur dhe e traumatizuar politikisht që nga themeli, që do të vërehej qartë pas vdekjes së Titos në vitin 1980 kur, e ushqyer me “çështjen kosovare”, shpërtheu lëvizja serbe unitariste dhe revanshiste, e cila edhe e solli Millosheviçin në pushtet.

Vetëm disa muaj pasi i kisha regjistruar studimet, në Fakultetin e Filozofisë filluan trazirat e studentëve, të cilat, si një të ri të papërvojë, më hodhën në amëzën e madhe të politikës. Gjithçka filloi me demonstratat studentore kundër intervenimit amerikan në Vietnam. Policia, për çudi, reagoi tepër brutalisht. Ne kishim përleshje të ashpëra me policinë edhe para ambasadës amerikane, edhe para qendrës kulturore amerikane. Ishte dhjetori dhe në rrugë kishte borë. Policia na sulmoi e para dhe pa kurrfarë paralajmërimi, posa dolëm nga salla ku u zhvillua mitingu. Mua, pasi turma u shpërnda pakëz, më goditën aq gjakatarisht me shkop gome saqë edhe një muaj më vonë e kisha një xhungë të madhe në kokë. Ne iu përgjigjëm më vonë policisë me gurë dhe copa akulli të ngrirë. Policia na sulmonte me topa uji dhe shkopinj gome, po kishte edhe mbi kuaj. Atëherë e pashë për të parën herë që kuajt nuk donin të shkojnë mbi masën. Kuajt ngriheshin arithi dhe i rrëzonin kalorësit e vet me pajisje të rëndë dhe me helmeta, të cilët plandoseshin mbi asfaltin e ngrirë si kunguj.

Si reagim ndaj këtij brutaliteti policor, gjatë vitit 1967 do të krijoheshin bërthama studentësh të pakënaqur dhe me përcaktim “revolucionar”, nga të cilët do të përftohej lëvizja studentore beogradase,

kryesisht me orientim të majtë. Botëkuptimi ynë i asaj kohe më duket sot mjaft konfuz. Ne ishim për Marksian e ri dhe për “komunizmin me pamje njerëzore”, por edhe me një përcaktim antiliberal, respektivisht ishim kundër eksperimenteve që po i bënte regjimi i Titos, d.m.th. kombinimit të shtetit të dirigjuar partiak, por të decentralizuar, me disa elemente të ekonomisë së tregut.

Si student i vitit të parë, pak a shumë rastësisht u gjeta në rrethin e kolegëve më të vjetër, të cilët do të bëheshin bërthama radikale e lëvizjes studentore dhe kryengritjes së vitit 1968. Në të vërtetë, më kujtohet që një ditë prej ditësh, diku në pranverë të vitit 1967, në kurtin e godinës së Kapitenit Misha, ku gjendej në atë kohë Fakulteti i Filozofisë, m'u afrua Millosh Vasiq, të cilin e njihja përciptazi, për të më thënë në konfidencë se ka përshtypjen që unë kam një “surat konspirativ”, ç'gjë për të që një garancë e mjaftueshme se mund t'i bashkohem grupit që i organizonte aksionet e protestës dhe demonstratat kundër luftës në Vietnam, për lirim të Mikis Teodorakisit, për mbështetjen e Rudi Duckes, për solidarizim me studentët polakë, etj., etj. Edhe para qershorit të vitit 1968, kur shpërtheu kryengritja, unë kisha marrë pjesë në disa takime konspirative dhe gati komplotiste (gjithçka i ngjante literaturës revolucionare që e lexonim: garsoniera të vogla, në të cilat tuboheshin 20 deri 30 të rinj dhe ndonjë vajzë, për të diskutuar me pasion e vrull për vazhdimin e revolucionit nën prizmen e devijimeve serioze të komunizmit jugosllav). Në ato takime i planifikonim aksionet dhe grupet për presion me qëllim që të revidohen proceset dhe të rrëzohet nga pushteti “borgjezia e kuqe” dhe tipi i ri i “kultit të personalitetit”. Ishim në thelb anti-titistë, edhe pse unë kurrë nuk munda ta shqiptoj fjalinë “E urrej Titon”, për ç'gjë këmbëngulnin posaçërisht dy aktiviste

radikale dhe hysterike (njëra nga ato, Klara Mandiq, u bë e njohur më vonë, ndërsa emri i tjetrës nuk më kujtohet), dhe me të ato e testonin lojalitetin ndaj përkatësisë në grup. Unë u përgjigjesha vazhdimisht: “Unë jam kundër kultit të personalitetit, por thjesht nuk ndiej urrejtje. Nuk mund t’ju gënjej”.

Pas vitit 1968, gjithnjë deri në mbarim të vitit 1969 ose fillim të vitit 1970, unë isha njëri ndër pjesëtarët më të rinj dhe me siguri më naivë të të ashtuquajturit grup studentor anarkist-liberal në Fakultetin e Filozofisë, në krye të të cilit ishte Vladimir Mijanoviç, të cilin e quanim Vllado Revolucioni. Ideolog i grupit ishte Bozhidar Borjan. Vllado Revolucioni ishte shok dhome imi për një vit e gjysmë në konviktin e studentëve “Ivo Lllolla Ribar”, ndërsa Borjanin e kisha shokun më të mirë. Borjani, i cili e lexonte shumë në atë kohë Leninin, ma merrte për të madhe që nuk punoja mjaft në “ngritjen teorike” dhe pse nuk kam mjaft “ndërgjegje të përgjithshme”, por ne në të vërtetë pajtoheshim shkëlqyeshëm dhe para së gjithash kënaqeshim me ndjenjën e lirisë dhe të joseriozitetit. Ne ishim “dy kopuka”, çka do të thoshte se kënaqeshim duke bredhur qyetetit dhe duke përqeshur të gjitha gjërat e shenjta. Krahas revolucionit dhe lëvizjes, ne kënaqeshim edhe në seancat speciale të përqeshjes së ikonave të socializmit dhe regjimit, duke bërë shaka të pakripë me Ttiton dhe Jovanka Brozin, me vetëqeverisjen, bashkim-vëllazërimin, mosangazhimin, etj. Në këto seanca kam njoftuar shumë njerëz spirituozë, vëllazërit Dragan dhe Zoran Minderoviç, Velimir Qurgus – Kazimir, Svetllana Sllapshak, Natasha Kandiç, Llazar Stojanoviç dhe të tjerë, të cilët kishin më vonë karriera intelektuale të suksesshme dhe të cilët e ruajtën integritetin e lartë shpirtëror e moral.

Në vitin 1970 ky grup yni ishte pak a shumë i shpërndarë, ashtu siç qe thyer edhe lëvizja studentore. Vllada Mijanoviç, Millan Nikolliq, Pavllushko Imshiroviç, Jellka Kllaiq, Llazar Stojanoviç, t'i përmend vetëm kryesorët, u dënuan me burg, po jo menjëherë, por në fillim të viteve '70. Unë në atë kohë isha tërhequr tashmë nga grupi, më shumë për arsye familjare (babai im ishte në atë kohë ministër në qeverinë kosovare dhe anëtar i Këshillit të Federatës, dhe pasi e kishte ofruar dorëheqjen në të gjitha funksionet politike për shkak të aktiviteteve të mia politike, unë dilemën e madhe morale që e kisha për shkak të vuajtjeve të mundshme që mund t'i pësonte e tërë familja e zgjidha ashtu që dola nga grupi. Këtij vendimi i kishte kontribuar edhe ndjenja e zhgënjimit dhe mungesës së perspektivës në lëvizjen studentore, si dhe zhgënjimi me angazhimin politik përgjithësisht. Unë në atë kohë fillova të shoqërohem më shumë me ca piktorë, dhe për të siguruar ekzistencën, kam punuar shtatë vjet, kryesisht në muaj vere, si konservues dhe restaurues freskash, dhe mu në manastiret serbe (në Studenica, Gjurgjevi Stupovi te Novi Pazari, në Manastirin në Ovçar Banja, etj.). Në vend të politikës, edhe pse nuk isha njeri religjioz, në atë kohë filloi të më tërheqë mistika. Ishte ky azili im i parë, "ikje nga jeta - në manastire", pra në Mesjetë, e cila më shfaqej në pamjen e Bizantit. Pak më vonë edhe do ta shkruaja një libër, asnjëherë të mbaruar deri në fund, "Estetika e Bizantit", i cili ka mbetur vetëm si një mesakt në bredhjet e mia intelektuale para se të më tërhiqte përsëri dhe të më zhyste në amëzën e saj të fatumit – politika...

Diku në fund të viteve '70, duke i zgjatur vazhdimisht studimet dhe duke u marrë me gjithçka ngapak (letërsi, film, filozofi, estetikë, art,

politikë...), por me asgjë dhe përfundimisht në mënyrë serioze, e kisha një periudhë kur e zbulova praninë kërcënuese të një Beogradi tjetër nëntokësor, të tullitur dhe të egër, të cilin nuk e kisha vënë re më parë. Ndoshta isha më herët tepër i ri dhe naiv prandaj nuk e vëreja, ose ai Beograd i egër edhe vetë fshehej me mjeshtëri dhe ishte në defensivë para titizmit superior, këtë nuk mund ta rikonstruktoj sot vetëm nga përvoja ime personale.

Në fund të viteve '70 unë isha politikisht ende mjaft naiv, posaçërisht sa i përket fatit të federatës jugosllave. Vazhdova të jetoj në Beograd, më shumë me inerci. Jetoja në një vakuum kohor, pa një orientim më të qartë politik dhe pa vizion për të ardhmen. Në thelb, ushqeja edhe më tej një neveri ndaj politikës, si më 1970. Elani revolucionar studentor i vitit '68 më kishte kaluar, nuk kisha më iluzione për gënjeshttrat e utopisë socialiste, dhe e kisha më se të qartë rrezikun e idesë dhe praktikës së krijimit të “njeriut të ri”. Nuk isha i zhgënjyer vetëm me burokracinë socialiste dhe kultin e personalitetit, por e vëreja, në pajtim me bindjet e asaj kohe, se në të vërtetë as që kishte një material kualitativ për “njeriun e ri”. Shtresat e mesme dhe më të ulëta të shoqërisë beogradase (dhe jugosllave) ishin të ngarkuara me paragjykime dhe sentimentet e fuqishme nacionaliste, por të ndrydhura në atë kohë. Ajo që është më e qenësishme, zbulova, po edhe unë isha në një aso pozite, që shumica e njerëzve jetojnë në mënyrë oportuniste në një siguri të rrejtshme, mbi humnerat e mungesës së shpresave, të nënshtruar manipulimeve. Në atë kohë m'u duk që e kisha kuptuar natyrën e totalitarizmit të majtë dhe të djathtë. Fashizmi nuk është diçka që u ka ngjarë vetëm italianëve dhe gjermanëve, por ai është një sëmundje shoqërore që e ka një matrix universale të natyra e njeriut dhe rrethanat shoqërore të caktu-

ara, dhe që është një kërcënim që ekziston në mënyrë latente në çdo shoqëri. Në një rrjedhë të këtillë të të menduarit ka ndikuar me siguri lektyra që e lexoja në atë kohë, librat e Vilhelm Rajhut dhe Erih Fromit, por edhe disa njohje empirike dhe intuita që më thoshte se Beogradi po shkonte drejt një fazhistizimi të përshpejtuar.

Unë e ndjeva atë valë kërcënuese disa vjet para vdekjes së Titos (1980) dhe demonstratave kosovare (1981), kur shpërtheu papritmas në sipërfaqe dhe u bë përcaktim dominant politik në trajtën e nacional-socializmit revanshist serb, krahas të cilit u nisën pastaj edhe nacionalizmat e tjerë, që do ta shkaktonte shpërbërjen e shpejtë të federatës jugosllave.

Diagnostifikimi im i hershëm i oshëtimës së fashizmit që do të pasonte ishte, megjithatë, i mjegulluar. Pasi në manastiret serbe takoja dhe zhvilloja polemika me nacionalistët dhe rojalistët serbë, të cilët ishin posaçërisht të ndieshëm ndaj çështjes së Kosovës, mua më dhimbeshin për shkak të anakronizmit të tyre dhe të kuptuarit të dobët të realitetit të ri. Nuk e vëreja rrezikun tek ata. Më dukeshin të vetmuar dhe të humbur, si njerëz të margjinave që nuk e vërenin se kulti i personalitetit të Titos ishte në të vërtetë më i pranishmi ndër serbët. Një pikëpamje dominante e asaj kohe, jo vetëm imja por edhe e qarqeve ku bëja pjesë, ishte se “nuk ka kthim të se vjetrës”. Nuk e konsideronim serioz as Qosiqin, as ASSHA (SANU), në kohën kur ata po punonin për ringjalljen e nacionalizmit serb. Tek ata vërenim vetëm një ndryshk shoqëror, “hekurishte të vjetra”, “reaksionin” që do të kalbej dhe zhdukej natyrshëm.

Intuita ime për fashizmin serb nuk u zgjua nga lart, nga apelet e Qosiqit, por prej së poshtmi, nga tektonika e humorit të njerëzve të

rëndomtë, të cilët po e harxhonin dalëngadalë iluzionin për komunën dhe socializmin, për ta parë veten ashtu në një situatë të rrezikshme të mungesës së çfarëdo themeli dhe, për këtë arsye, të nënshtrueshëm ndaj manipulimeve.

Unë në ato kohë nuk mora kurrfarë shënimesh për këtë intuitë timen, duke konsideruar se ndoshta po e teproja ose po hyja në sindromin e shqiptarit të frustruar në Beograd, mbase mjaft të pranishëm te shumë kolegë nga Kosova dhe Maqedonia, të cilët studionin në Beograd. Unë, siç e kam thënë, isha i akomoduar shkëlqyeshëm në mileun intelektual dhe kulturor të kryengritjes studentore të vitit '68. Mirëpo, kjo ishte kryengritje pa një qëllim të qartë. Ne dëshironim ta ndreqnim atë që s'ndreqej dot dhe ramë shpejt në një gjendje të pashpresë. Shoqja ime e studimeve, Gornka Matiq, e kishte thënë me një rast një definicion të shkëlqyeshëm – që ne ishim një gjeneratë e cila refuzonte të rritej. Ndoshta problemi, megjithatë, qëndronte te fakti se ne e kishim tejkaluar tashmë socializmin, por këtë nuk e dinim. Sikur regjimi të që më i ashpër dhe më represiv, me siguri që edhe ne do të bëheshim më radikalë dhe më seriozë. Mirëpo, ashtu siç e kishim tejkaluar socialimin ne intelektualët dhe jetonim në një vakuum, edhe njerëzit e rëndomtë jetonin po ashtu në një vakuum, pa bari, duke iu kthyer dalëngadalë paragjyqimeve të vjetra.

Pasi Beogradi reagoi në vitin 1981 me shkallën më të lartë të tërbiimit shovinist ndaj shqiptarëve të Kosovës, mua kjo aspak nuk më befasoi. Beogradi normal, liberal dhe kozmopolit, me ndonjë përjashtim, nuk e kuptonte në fillim se çfarë po ngjante. Kjo elitë që nga Beogradi kishte krijuar një qytet botëror, ose që më parë jetonte në iluzionin se ai

është i hapur dhe pa paragjykime, ishte një fenomen e çuditshëm. Elita liberale beogradase ishte pjesërisht në një lloj konkubinati konformist me komunizmin, pjesërisht e distancuar nga ai, por në tërësi jetonte e izoluar nga rrjedhat kryesore subkulturore, sociale e ideologjike në Serbi, ku bënte kërdrinë turbo-folku dhe ku dalëngadalë po krijonin çerdhe edhe pasionet turbo-politike, të cilat mund të ishin fare lehtë të infektuara, ashtu siç ndodhi më vonë, me nacionalizmin dhe shovinizmin. Kjo elitë “botërore” beogradase në të vërtetë i përçmonte dhe nënvleftësonte shtresat më të ulëta shoqërore dhe (jo)kulturën e ardhacakëve nga fshati dhe nga provinca, të cilët për afër njëzet vjet e kishin katërfishuar ose pesëfishuar popullatën e qytetit dhe dalëngadalë po ia zënin frymën, fizikisht dhe shpirtërisht. Një shfaqje teatrore e ngritur në kult e gjeneratës “botërore” liberale ishte “Radovani III”, e cila u shfaq vite me radhë në Ateleun 212, e njohur për ekzekutimet mjeshtërore të Zoran Radmilloviçit, në të cilën përqeshej deri në pafundësi primitivizmi i fshatarit serb që ka ardhur të jetojë në Beograd, i cili vuante për Serbinë pastorale. Por, pasi Radovani i përçmuar dhe i përqeshur e kuptoi që Beogradi dhe Serbia nuk kishin më zot shtëpie, ai zbriti nga skena e Ateleut 212 dhe u nis të pushtojë komitetin dhe institucionet nacionale (kishat, akademitë, lidhjet e shkrimtarëve...), që t’ua tregonte përqeshësve se ata në të vërtetë ndodheshin në një pozitë komike të lolove intelektuale.

Beogradi liberal dhe i hapur e mbështeste, fjala vjen, Vojisllav Sheshelin, vojvodën çetnik të mëvonshëm dhe marionetën e qeverive të Millosheviçit, pasi ai i qe nënshtruar represionit të regjimit komunist. Edhe unë, në kohën kur isha anëtar i kryesisë së Lidhjes së Filozofëve të Serbisë, e kam nënshkruar peticionin për lirimin e tij nga

burgu. Për të dihej që është një Radovan fodull, një sharlatan që kishte ambicje radikale intelektuale dhe politike, por e mbështetën për arsye se asoherë askush nuk e konsideronte për një njeri serioz. Aq shumë gemë të verbëruar. Askush prej nesh nuk e parashikonte thyerjen tepër të shpejtë të komunizmit, edhe pse në atë kohë filluam të përcillnim debatet e intelektualëve perëndimorë, të cilët Marksini dhe lëvizjen komuniste i konsideronin ideologji të “vjetroara” të shekullit 19, të cilat përfundojnë domosdo në totalitarizma.

Regjimi komunist vërtet bënte marri duke gjykuar Sheshelin për shkak të teksteve të pabotuara. Ata në të vërtetë e promovuan dhe e bënë të famshëm si një lider radikal nationalist, ndërsa ne që ishim kundër deliktit verbal e ndihmonim me naivitet një promovim të tillë. Pasi që Shesheli dhe turbo-sharlatanët e tjerë erdhën në pushtet, duke kolaboruar me nomenklaturën e përtëritur të Millosheviçit (përderisa në vende të tjera komunizmi po shpërbëhej, në Serbi ai u ripërtërit dhe hyri në aleancë të rrezikshme dhe agresive me nacionalizmin), ishte tepër vonë. Njerëzit normalë filluan ta braktisin Beogradin dhe Serbinë, ndërsa ata që vendosën të mbeten, zgjedhën kryesisht strategji beninje dhe shterpe të rezistencës, ose vendosën për strategji të ndryshme karantine. Të mbyllur në qarqet e veta dhe kështjellat e vogla të normalitetit, ata prisnin që të kalojë mortaja nacionaliste, shoviniste dhe fashiste, duke e bindur edhe veten edhe botën që epidemia nuk mund të zgjasë shumë, dhe që, pasi të perëndojnë Millosheviçi dhe Shesheli, Serbia do ta tregojë përsëri fytyrën e saj normale.

Në “Ditarin meksikan” të Arsenijeviçit në shumë vende kyç e kam hasur, të intonuar në mënyra të ndryshme dhe të nuancuar, idenë e

normalitetit të karantinës. Pasi kishte vendosur të mbajë ditat që nga dita e tretë e bombardimeve të Beogradit, prej nga nuk kishte arritur të ikë me kohë, Arsenijeviç e ndien vazhdimisht se ndodhet në pozitën e një viktime të pafuqishme dhe të pafajshme, mbi të cilën janë turrur fuqitë superiore të së keqes, vendëse dhe botërore, në përpjekje që ta mundin shpirtërisht dhe ta asgjësojnë fizikisht. “Se jetojmë në një absurd të dhemshëm, shkatërrimtar – s’ka më kurrfarë dyshimi. Askush, ama bash askush, këtë e dimë shumë mirë, as vendi ku jemi lindur për të ekzistuar, as bota të cilës do të duhej t’i përkisnim, nuk është mik Yni. Dhe meqë askush nuk përkujdeset për Ne, na ka mbetur vetëm një gjë: të përkujdesemi për vetveten”. Strategjia e rezistencës që e ka zgjedhur ai është “përpjekja për ta ruajtur normalitetin”. Arsenijeviç shënon: “Po përpiqem ta rregulloj para-jetën time të vocërr. Fëmijët më ndihmojnë në këtë përpjekje të gjithmbarshme që ta ruaj normalitetin”. Por, kjo përpjekje për të qenë normal përfaqëson një lloj mundjeje të vazhdueshme me realitetin pasionant dhe me amplitudat e humorit, të cilat sillen që nga sulmet e ndjenjës së pafuqisë dhe dekurajimit, deri te vetëkurajimi dhe ndjenja e rëndësisë dhe krenarisë për arsye se gjendet midis atyre që janë të ndryshëm, të cilët, ja, kanë mbetur thjesht normalë para një orteku të tillë jonormaliteti. Në çastet kur e kaplonte një ndjenjë e pashpresë, Arsenijeviç do të shënojë që “njerëzit humbasin betejë mbas beteje me sprovat nga më të ndryshmet, dhe normaliteti i tyre dalëngadalë po epet”. Në një vend tjetër, pasi i ka parë i tmerruar përmasat dhe fuqinë e së keqes, ai për një çast do t’i çojë duart edhe nga karantina e normalitetit: “Është e pamundur, madje amorale, të jesh – normal. Nuk duhet, pra, as të provosh. Ai privilegj ne, thjesht, nuk na është dhuruar”.

Por, ditët e ardhshme ai kthehet përsëri në sheshin e betejës për të drejtën e të qenit normal: “Jetojmë normalisht pa marrë parasysh të gjithat – asgjë nuk mund të na ndalë.” Për më tepër, Arsenijeviç do të shënojë që “normaliteti, duket, është religjioni ynë këto ditët më të fundit...”. Ky religion karantine i llojit të vet do të nënvizohet edhe më fort, megjithëse i përzier me një dozë ironie të hidhur, në shënimin ku qëndrimi i njerëzve të rëndomtë ndaj bombardimeve dhe të keqes përgjithësisht promovohet në një vlerë në vetvete, për zbulimin e së cilës thotë që është aq i rëndësishëm sa ia vlen të paguhet edhe një çmim i tmerrshëm: “Por, njerëzit tani për tani janë aq të shkëlqyeshëm, saqë njeriu do të dëshironte të jetojë vazhdimisht nën këso rrethanash jonormale, nëse ato janë kusht për Normalitetin tonë kolektiv të pritur aq gjatë.” Në një moment do ta shënojë me krenari apotheozën e shkurtër kushtuar karantinës kolektive: “Ne, Normalët”.

Por, jo rrallë, ai ndien edhe një zhgënjim dhe mëni ndaj botës, e cila nuk sheh që atje, në atë strofull të së keqes që po bombardohet, ka edhe njerëz normalë dhe të shëndoshë: “Vallë, e ka njeri të qartë që Ne ekzistojmë në këtë vend të rrënuar, të cilin është aq e lehtë ta mbulosh me bomba?”

Mirëpo, strategjia e karantinës tek Arsenijeviçi është tepër e brishtë. Ai në të vërtetë ka një dëshirë të vazhdueshme që të ikë nga gracka në të cilën u gjend rastësisht, sepse para bombardimit nga Parlamenti i Shkrimtarëve e kishte marrë ftesën për qëndrim prej një viti në Meksikë, i cili për shkak të rrethanëve ishte shtyrë për disa muaj. Bombardimi e kishte gjetur Arsenijeviçin në përgatitje e sipër për atë udhëtim të gjatë, i cili mbase ishte një ikje nga realiteti pasionant dhe i ndyrë. Bombardimi dhe mbyllja e kufijve, frika nga mobilizimi, e shty-

jnë që vazhdimisht të mendojë për largimin nga vendi, për të arritur disi në Meksikë, prej nga merr çdo ditë mesazhe me e-mail, kurajime, këshilla si të veprojë... Për të karantinë e vërtetë nuk është Beogradi, ku nuk ndjehet as i sigurt as komod, as si njeri, por Meksika, e cila bëhet një simbol i vërtetë i ikjes dhe i realizimit të normalitetit: “Digjem tashmë përbrenda që të lëviz nga këtu, drejt Meksikës, drejt normalitetit, në rrugën e gjatë, por gjithsesi eksituose, për të cilën nuk do të shkruaj tepër gjithnjë derisa të mos gjendem në Anën Tjetër”. Dhe pasi, më në fund, e kishte vendosur që ta kalojë ilegalisht kufirin me Bosnjën, në stacionin e parë të udhëtimit të tij drejt Meksikës, në Sarajevë, ai përsëri e shënnon në ditarin e tij zbulimin e normalitetit, ngapak i çuditur që po e gjen edhe atje ku tanimë e kishte bërë kërdrinë një luftë e tmerrshme dhe shkatërrimtare: “Njeriu nga Beogradi, prej të gjitha vendeve në planet, vjen në Sarajevë që t’i gjejë Lirinë dhe Normalitetin, që i ka aq të pakta te shtëpia e tij”.

“Ditari meksikan” i Vlladimir Arsenijeviçit nuk është vetëm një histori për ikjen. Ajo është dyfish ose trefish e gërshtuar me një gjë që ai gjithsesi është dashur ta ndiejë, edhe pse nuk e quan ashtu, si një “fatum shqiptar” të llojit të vet. Edhe në fillim, edhe në mes, edhe në fund të rrëfimit të tij, fati i tij, ikja e tij, janë të lidhur me shqiptarët. Ft-esën për azil në Meksikë ia dërgoi Bashkim Shehu, shkrimtar shqiptar, edhe ai vetë refugjat në Berceleonë, ku ishte i angazhuar si koordinator i Parlamentit Ndërkombëtar të Shkrimtarëve. Arsenijeviçi s’e ka takuar kurrë Bashkimin, as që ka ditur për të para se ky t’ia dërgonte një mesazh me e-mail rreth azilit. Ajo që tek Arsenijeviçi ka lënë mbresë të tmerrshme të një lloj mallkimi të fatit, ballkanik, ishte lufta e vet She-

hut për të mbetur normal pas gjithë atyre gjërave që i kishte përjetuar. Historia e Shehut ishte e errët dhe e rëndë, dhe ndoshta mund të kategorizohet, edhe pse çdo kategorizim duket i pashpresë për raste të këtilla, në rubrikën e “revolucionit që i ha fëmijët e vet”, respektivisht të “molo hut të stalinizmit”. I ati i Bashkim Shehut ishte dora e djathtë e diktatorit komunist të Shqipërisë, Enver Hoxhës, gjithnjë derisa nuk kishte rënë në ‘faj’ dhe kishte kryer vetëvrasje, ose, që është më shumë për t’u besuar, qe ekzekutuar. Të këqijat që satrapi i Enverit, si shef i policisë sekrete dhe kryetar i qeverisë shqiptare, ia kishte shkaktuar popullit shqiptar për vite të tëra, pas vrasjes së tij do t’i përjetonte familja e tij. Bashkimi, i biri i tij më i ri, e kishte fatin, ose fatkeqësinë ndoshta, sepse e gjithë familja e tij ka pësuar, që pas burgjeve, torturave dhe viteve të kaluara në qeli, ta presë rënien e komunizmit në Shqipëri dhe lirimin e tij personal. Arsenijeviçi nga letërkëmbimi i tij elektronik me Bashkimin, në shënimet e tij e tërheq si një fije vendimtare të fatit që i lidh, si diçka të ngjashme, megjithëse shumë më të tmerrshme dhe të përjetuar me vuajtje shumë më të mëdha, apotheozën e normalitetit, duke cituar fjalët e tij: “Më është dashur shumë forcë që të mbetem normal gjatë kohës që e kam kaluar në izolim të plotë”.

Çka është e kundërt me normalitetin? Çmendia. Ne të gjithë kemi jetuar në çmendi, dhe të gjithë jemi përpjekur, secili në mënyrën e vet, të mbetemi normalë, aq sa kjo ishte e mundshme dhe e lejuar në kushtet kur edhe ne vetë qemë të “magjepsur me utopinë e komunizmit”. Për dallim nga Bashkim Shehu, sepse edhe unë jam “fëmijë i komunizmit” dhe një lloj kipci i tij kosovar. Në të vërtetë, edhe babai im ishte një ushtar i spikatur i revolucionit dhe shef i policisë kosovare në vitet

pesëdhjetë, kur edhe në Kosovë zhvillohej lufta klasore kundër “reaksionit borgjez” dhe të tjerëve, çka nënkuptonte burgosje dhe tortura për kundërshtarët e regjimit, dhe pastaj për të dytën herë, që nga viti 1981 gjer më 1984, kur u burgosën në masë dhe iu nënshtruan torturave me mijëra “kundërrevolucionarë” kosovarë, “irredentistë” dhe “nacionalisë” shqiptarë. Por, për dallim nga Bashkimi, e kisha fatin, ose më parë privilegjin, që nuk u detyrova ta paguaj edhe personalisht çmimin për mashtrimet dhe mëkatet e babait tim, jo aq për arsye të disidencës sime beninje të mëhershme të vitit 1968 ose, më vonë, për shkak të angazhimit politik dhe publicistik që nga viti 1983 gjer më tani, sa për shkak të rrethanave të tjera që mbretëronin në Jugosllavi dhe në Kosovë, ku regjimi totalitar ishte shumë më selektiv, që të gjitha format revanshiate prej mollohu dhe të tjerat i ushtronte në mënyrë më selektive. Nuk marr guximin as t’i krahasoj “traumat tona atërore” me fustofeliste, të cilët në emër të të bërit mirë - bënin keq, meqenëse unë nuk kisha kurrfarë vule mollohu në fatin tim dhe nuk kam kaluar në burg as edhe një ditë të vetme, dhe jo më, si Bashkim Shehu, vite të tëra në burg. Mirëpo, marr guximin të them megjithatë që jetën time e kam kaluar në zgrip të çmendisë, vuajtjeve dhe frikës, duke e paguar ashtu çmimin e normalitetit tim me kompromise që isha i detyruar t’i bëj për arsye se megjithatë pajtoheshja të jetoj në një botë gënjeshtresh dhe nën regjime që të tjerëve u kanë shkaktuar vuajtje të mëdha, ndërsa në mua i asfiksonin prirjet e lirisë së profesionit, që, fjala vjen, të merrem me ato që i konsideroja vokacione të mia natyrore: me poezi, filozofi, letërsi. Fakti që jeta ime ishte shumë më normale nuk do të thotë se ishte më e lirë se e tyre. “Angazhimi” im politik ishte në të vërtetë diçka si një “punë e detyruar” dhe “larje e mëkateve dhe ndërgjegjes së papastër”

për të cilat “angazhimi” ishte ndoshta vetëm shfajësim. Ndoshta “fati” im i vetëm ishte fakti që në situatën e anijethyerjes historike ndodhesha në barkën për shpëtim, me të cilën mund të pluskoja nëpër kohë të keqe, duke e ushqyer iluzionin që edhe anijethyerve të tjerë më pak fatlumë mund t’ju ndihmoja ta gjenin veten, ose të paktën të hapja rrugë drejt një realiteti tjetër, më të mirë. Dua të them që normaliteti im nuk ishte kurrë e tipit karantinë, edhe pse kisha edhe tundime dhe përvoja të tilla. Unë vetarsyetohesha me idenë e angazhimit sartrian, duke ndjekur porosinë që intelektualit duhet të jetë i angazhuar kundër të keqes dhe padrejtësisë. Normaliteti i karantinës më dukej ndonjëherë si një lloj tradhtie intelektuale dhe shoqërore, si dorëzim ose lëshim pe ndaj të keqes. Në këtë kuptim, derisa po e lexoja librin e Arsenijeviçit, konsideroja që ky tip normaliteti është më tepër në cep të dorëzimit dhe pranimit të primatit të së keqes, madje ndoshta edhe të arsyesimit të saj implicit, sesa mbrojtje e dinjitetit njerëzor, të cilin duhet kërkuar jo në fshehje dhe ikje, por në kryengritjen aktive.

Normalitetit të karantinës, të Arsenijeviçit dhe ca shokëve të mi nga Beogradi, si dhe nga Prishtina, ia shihja për të madhe pse nuk kishin po atë masë mirëkuptimi dhe simpatie për kryengritjen, siç e kishin ndaj njerëzve të rëndomtë dhe fatmjerëve, të përulurve dhe të nënshtruarve, të cilët i dërrmonin dhe shkatërronin pamëshirshëm forcat e së keqes dhe tufanet fatkobe të revolucioneve ideologjike dhe nacionale. Konsideroja që është tërësisht e pamenduar dhe e padrejtë, nëse jo edhe shenjë e verbërimit vetëmashtrores, dënimi që ata ua bënë kryengritësve kosovarë, të cilët e kanë krijuar Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës. “Eh, po të mos ekzistonte UÇK-ja, kjo nuk do të ndodhte”; ose: “Të gjithë ata janë të njëjtë. Edhe ata janë kriminelë...”; “Për luftë

duhen dy të marrë” – më thoshin edhe disa miq, të cilët e kritikonin publikisht dhe pa kompromis regjimin e Millosheviçit dhe luftën e tij në Kroaci dhe Bosnjë, ndërsa në Kosovë, pasi filloi kryengritja, e gjetën mundësinë të jenë “njësoj” kritikë edhe ndaj UÇK-së, siç ishin kritikë edhe ndaj Tugjmanit, ndonjëherë edhe ndaj Izetbegoviçit dhe Rugovës. Disa prej tyre ishin të ashtuquajturit “jugo-nostalgjikët”, të cilët ato kohë të dikurshme, kur të gjithë ne gjoja ishim “bashkë”, i konsideronin të mira dhe normale, ose gati normale, por, ja, tani të tërat i prishi ai maskarai Millosheviç dhe “separatistët” e ndryshëm. Nuk do të dëshiroja t’i qes në ankand nivelet e përgjegjësive dhe fajeve, ose bashkëpjesëmarrjet e hapura, të fshehura ose të pavetëdijshme në krimet. Por, më duket tepër normale që normalitetit të karantinës t’ia kundërvë edhe normalitetin e kryengritjes kundër të keqes. Fakti që ajo zhvillohej në kushtet e luftërave etnike të “ndyra”, nuk ua jep të drejtën karantinorëve që të ushqejnë neveri ndaj kryengritësve që çohen në mbrojtje të shtëpive dhe jetës së tyre. Të paktën, do të duhej ta respektonin të drejtën për të zgjedhur. Midis karantinës kryesisht shterpe dhe angazhimeve publike të pafuqishme, si mënyra për t’iu kundërvënë të ligës, nga njëra anë, dhe rreziqeve të kryengritjes, kur të keqes i kundërviheni me masën e saj të dhunës dhe çmendisë, nga ana tjetër – kush duhet të vendosë për vlerat dhe përparësitë e mbrojtjes së lirisë dhe dinjitetit njerëzor?

Rrëfimi për dhjetorët e Ibrahim Rugovës¹³

S'ka aspak dyshime që Ibrahim Rugova, që këto ditë mbush 60 vjet, do të zgjedhet sërish në postin e preferuar të presidentit të Kosovës. Gjasat që kjo të mos ndodh janë vetëm teorike. Në përgjithësi gjërat më të rëndësishme në jetë Rugovës i ndodhin në dhjetor, një muaj i bekuar për te. Në një dhjetor të vitit 1944, pra në kohën kur Kosova sapo ishte çliruar nga gjermanët, në familjen Rugova në një fshat të komunsës së Istogut lind Ibrahim si djal jetim pasi që babai i tij, që kishte qenë ballist, vritet nga komunistët jugosllav. Ka qenë muaji dhjetor i vitit 1989 kur Ibrahim Rugova hyri në dyert e mëdha të politikës duke u zgjedhur kryetar i grupit nimsëtarë që themeloi Lidhjen Demokratike të Kosovës. Mbeti kryetar i LDK-së deri më sot. Dhe në dhjetorin e 2004-shit Rugova do të rizgjedhet për kryetar për periudhën katërvjeçare që sipas të gjitha parashikimeve do të jetë vendimtare për arritjen e statusit të merituar të Kosovës, ate të pavarësisë. Me Ibrahim Rugovën në krye.

Në qarqet “oborrtare” që e rrethojnë presidentin e Kosovës, ka të tillë që mendojnë se Ibrahim Rugova është një politikan jashtë formatave të zakonshme ngase i është ngarkuar bara e një misioni historik.

13 Artikull i botuar më 2004 në revistat “Java”, Prishtinë, dhe “Klan”, Tiranë.

Rugova shikohet si një burrë i veçantë, i arrirë, evlia, i zgjedhur dhe i dërguar nga zoti që të shërbejë si shpëtimtar i Kosovës. Edhe pjesa e popullit që e voton dhe e adhuron Rugovën, pokështu kultivon këtë besim mbi misionin e veçantë dhe historik të Rugovës.

Sot rreth 2 / 5 e kosovarëve nuk i besojnë Rugovës. Nuk ka qenë gjithmonë kështu. Në fillim Rugova kishte përkrahjen thuajse unanime të popullit të Kosovës. Zhgënjimet nisën pastaj me ngadalë, duke u shpeshtuar dhe radikalizuar në pjesën e dytë të dekadës së luftërave në ish Jugosllavi, dhe kulmuan në vitet 1998 dhe 1999. Gjatë luftës Rugova me gjithë partinë e tij dukeshin të çorientuar, kurse gjatë bombardimeve edhe të humbur. Atëbotë unë e pata bërë një analizë ku teza kryesore ishte se politika e Rugovës është e vdekur. Por, edhe pse Rugova ishte në një lloj depresioni kurse LDK-ja në defansivë, pas zgjedhjeve të vitit 2000, raportet ndryshuan dhe Rugova me gjithë LDK-në ridëshmuar përkrahjen e mazhorancës së kosovarëve. Rugova u rikthye në lojë dhe fitoi të gjitha zgjedhjet e pasluftës, edhe pse jo aq bindshëm si në vitin 1992 dhe 1998.

Dhe nëse i shikojmë zhvillimet në Kosovë që nga dhjetori i vitit 1989, kur Rugova u zgjodh kryetar i LDK-së, nuk mund të mos vërehet se e gjithë kjo periudhë i takon Rugovës, se ai është konstanta e vetme krahas të gjithë sfiduesëve të jashtëm dhe të brendshëm që kanë punuar në këtë ose në atë mënyrë për dobësimin dhe eliminimin e tij. Të gjithë sfiduesit dhe kontestuesit e Rugovës kanë humbur, duke filluar prej Rexhep Qosjes dhe Adem Demaçit, e edhe diktatorit serb Millosheviç, kurse ai është rikthyer vazhdimisht dhe ende ka gjasa të mëdha që të sjallë atë që kishte premtuar qëmoti – pavarësinë e Kosovës.

Rugova i ka mundur katër herë në zgjedhje edhe sfiduesit që pa bekimin dhe përkrahjen e tij e patën filluar luftën, dhe që me 1999 mendonin se e kishin dërmuar përfundimisht jo vetëm Serbinë, por edhe Rugovën dhe LDK-në. Edhe pse me ndihmën e NATO-s fituan luftën, politikanët dhe partitë të dala nga lufta nuk e gjetën çelësin se si duhet fituar në paqe. Në vend që krahu i luftës të përçajë dhe ngadhënjëj mbi LDK-në, LDK-ja dhe Rugova arritën që pas zgjedhjeve të fundit të përçajnë krahun e luftës, duke e bërë koalicion me AAK-në e Ramush Haradinajt. Si qëndrojnë punët aktulisht, Rugova sërish, të paktën simbolikisht, mbetet në krye të procesit të përcaktimit të statusit të Kosovës.

Ky tregim i imi për Rugovën nuk mund të sqarojë enigmën e suksesit të tij, pse ai mbeti gjithë këto vite kryefaktor në politikën kosovare. Megjithatë, shpresoj se do të mund të hedh dritë në disa elemente të së kaluarës që flasin jo vetëm për te, por edhe për mjedisin dhe mentalitetin tonë që e favorizuan kultin e Rugovës. Nëse do të mund të ndërtohej një histori e kahjeve impersonale të proceseve në vitet '80 e '90 të shekullit të kaluar, e deri më sot, mendoj se do të mund të mbledheshin shumë dëshmi se në ato procese edhe Rugova ka qenë dhe ka mbetur një figurantë, por me një fat të jashtëzakonshëm të shquarjes funksionale, që nuk lejonte fundosjen dhe zhdukjen e tij pa u krye vetë procesi dhe "misioni" në ballë të të cilit gjendej ai. Thënë më thjesht nuk besoj se roli i Rugovës ka qenë i përcaktuar nga providenca, se ka të bëjë me "përzgjedhjet" e fuqive madhore fatpërcaktuese. Për mua e vërteta e tij është më bizare, më e përtokshme, por megjithatë me peshën që krejt këto 15 vite i bënë vite të Rugovës.

Ate çka do të dëshmoj në mënyrë skicuale në këtë shkrim, se si e kam njohur dhe përcjellur Rugovën, sidmos në fillimet e karrierës së tij prej politikani, nuk duhet të lexohen e të kuptohen si pretendim për rishkrimin e një historie ende të papërfunduar të çlirimit dhe të pavarësisimit të Kosovës. Janë këto vetëm dëshmi subjektive, pjesërisht të dokumentuara.

Ede forma e rrefimit tim është më shumë e tipti të frymëzimit të çastit, dhe jo e bërë me plan dhe pastaj e krehur. Do të ndalem me këtë rast në disa momente.

Po filloj me idenë e providencës, edhe kjo subjektive dhe e karikuar. Nëse në storien e Rugovës megjitahtë ka elemente të providencës, atëherë edhe unë për vetën mund të them se paretëdijëshëm kam qenë i shfrytëzuar si instrument i saj. Kjo për arsye se në fillimet e bërjes së Rugovës politikan, çka ai në asnjë mënyrë nuk ka qenë deri në vitin 1986, e mbase edhe deri më 1989, edhe vogëlsia ime ka pasur gisht dhe ndikim të konsiderueshëm..

Më sa e di unë kam qenë redaktori i parë në Kosovë që ka porositur dhe botuar një reagim politik të Ibrahim Rugovës, në kohën kur ai njihej vetëm si kritik letrar. Edhe kjo, koincidentalisht, kishte ndodhur në dhjetor të vitit 1986, kur unë isha kryeredaktor i revistës “Fjala”. Rugova atëbotë kishte marrë pjesë në një tubim në Beograd të organizuar nga Shoqata e Shkrimtarëve e Serbisë, që tradicionalisht mbahej për nder të ditës së çlirimit të Beogradit, me titullin “Takimet e Tetorit”. Atë vitë, pra më 1986, ishte një vjeshtë e rëndë dhe përplotë tensione në Kosovë, si dhe në vetë Serbinë. Ibrahim Rugova kishte marrë pjesë si përfaqësues i Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës në takimin që për temë kishte një titull alarmant dhe deomethënës për

gjendjen e shpirtave në Serbinë e asaj kohe: “Apokalipsi sot”. Gjatë secancave shkrimtarët dhe intelektualët serbë, që e kishin nisur dhe nuk e ndalnin fushatën e egër kundër shqiptarëve dhe popujve të tjerë në ish Jugosllavi, provokuan disa herë Rugovën që ta merrë fjalën dhe të deklarohet rreth akuzave të rënda në adresë të shqiptarëve të Kosovës se ata i urrejnë serbët, se kanë bërë krime nga më të pabesueshmet, se ëndërrojnë krijimin e Shqipërisë së Madhe, e të ngjashme. Në një moment Rugova nuk durohet dhe del në foltore jo për të kërkuar falje për ato akuza të shpifura, e as për të shfaqur lojalitet ndaj Serbisë, por për të shprehur një kundërshtim ndaj akuzave. Në të vërtetë, ai kishte folur krejt shkurt, vetëm disa fjali, por tejet të guximshme dhe domethënëse. Po e citoj diskutimin e tij në tërësi: “Në bisedën e djeshme rreth tryezës së rrumbullaktë në gjuhën serbokroate u insistua disa herë që edhe unë të them diçka për Kosovën, e cila, siç u tha edhe sot këtu, është një ‘apokalips i përjetuar’ apo konkretisht do të thosha, që fare nuk e pranoj. Lidhur me këtë do t’i thosha disa fjalë. Tash pesë a gjashtë vjet po çajmë kokën me Kosovën dhe me nacionalizmin, sa që është bërë punë vërtet e mërzitshme, e padurueshme. Mund të them se në disa kumtesa dhe diskutime që i dëgjova këtu diskursi ishte në nivel të shtypit të verdhë dhe të një ‘politike të verdhë’. Kam pritur nga shkrimtarët që në frymë të vokacionit të tyre të flasin për Kosovën si humanistë. Pastaj këtu vëreja edhe një dyfytërsi të madhe: në njerën anë për vete kërkohet demokraci, e për të tjerët një represion dhe negacion total. Mendoj se për Kosovën duhet kërkuar më shumë demokraci, humanizëm dhe mirëkuptim e më pak represion, se do të jetë më mirë. Ju falënderit.” (Fjala, 1-15 XII 1986, fq. 14)

Pasi që kishte folur Rugova, reagimet kanë qenë tejet të ashpra., duke i dhënë edhe më shumë zjarr pohimeve se e gjithë Kosova, duke përfshirë edhe shkrimtarët edhe politikanët, është antiserbë dhe ushtruese dhe përkrahëse e politikave kriminele antiserbe. Shtypi ditor në Kosovë që në atë kohë censurohej dhe vetëcensurohej nuk e pat përcjellur fjalën e Rugovës dhe polemikën që kishte provokuar në Takimet e Tetorit, kështu që unë si kryeredaktor i “Fjalës” kisha kërkuar nga ai që ta sjell fjalën e tij, si dhe një shkrim nga korespondentja e Rilindjes nga Beogradi, Alida Berisha, ku do ta sqaronte kontekstin dhe çka është folur në atë rast.. Fjalën e Rugovës, e titulluar “Më shumë demokraci për Kosovën e më pak represion”, e përcjellur edhe me një koment të tij kontekstualizues, e pata botuar në faqet e fundit të revistës që të mos hetohet menjëherë nga censorët kujdestarë të “Rilindjes”. Jehona e këtij shkrimi në qarqet intelektuale të Prishtinës ka qenë shumë më e madhe seç mund të paramendohet sot kur e shihni si një lajm dhe deklaratë të shkurtër në faqet e një reviste kulturore që zakonisht nuk është konsideruar medium që krijon dhe plason opinionet e rëndësishme, pos në disa periudha, ndër to edhe gjatë 10 muajve sa unë e drejtoja revistën (tetor 1986 - qershor 1987).

Mund të them se botimi i këtij reagimi të Rugovës, për çka kam qenë i qortuar nga drejtorët e atëhershëm të “Rilindjes” (Rrahman Dedaj, Rexhep Zogaj), mbase ka ndikuar një krijimin e një opinionit të parë publik për Rugovën se ai ka potenciale prej prej politikani me vizione dhe guxim. Ideja qëndronte në atë se Rugova kishte shfaqur me ndershmëri rezistencën ndaj fushatës së egër të nacionalizmit serb, dhe këtë në vetë qendrën e represionit, në Beograd. Ky deklaram i Rugovës mbase ka mundur ta luante rol në propozimin dhe zgjedhjen e Rugov-

ës për kryetar të Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës, kur ai zë një vend të spikatur prej zëdhënësi të inteligjencës shqiptare në periudhën tejet sfiduese që po e priste Kosovën, kur gradualisht do të ngulfaten dhe mbyllen të gjitha institucionet e autonomisë.

Në kohën kur Rugova ishte zgjedhur kryetar i Shoqatës së shkrimtarëve, unë kisha dhënë dorëheqje nga revista “Fjala” dhe po punoja si animator në “Bashkësinë kulturore-arsimore të Kosovës”. Zyret i kishim afër në barakat pranë stadiumit të qytetit dhe nuk kalonte asnjë mëngjes pa u takuar me Rugovën, ngase ai e pëlqente shumë kafënë e kuririt të Bashkësisë Kulturore-Arsimore, një rom që përndryshe ishte adash i tij, edhe ai quhej Ibrahim. Duke pirë kafet e famshme të Ibros, kemi ndërruar shumë llafe për aktualitetet politike dhe kulturore. Kam pasur kështu mundësi që në periudhën 1986-1989 të përcjellja se si po rritej marramendshëm fuqia reprezentuese e kryetarit të Shoqatës së Shkrimtarëve, se si ai po bëhej një zë i pavarur krahas shtypjes, mbylles dhe heshtjes së institucioneve të tjera të autonomisë. Për aq sa zbrapshin zyrtarët e autonomisë, Rugova bëhej më i zëshëm. Edhe pse gjithnjë ishte fjalëpak dhe i kursyer në vlerësime, kryetari i shoqatës pozicionalisht ishte bërë i vetmi vend legal nga i cili artikulohej publikisht një zë i rezistencës kulturore dhe politike. Ky zë ishte bërë edhe më i fuqishëm për shkak se në atë kohë edhe lëvizjet nëntokësore të grupeve marksiste-leniniste, të cilat organizonin rezistencën dhe demonstratat, kishin rënë përkohësisht në një amulli dhe huti, që zvogëlonte ndikimin e tyre në masat, për shkak të rrënies së shpejtë të komunizmit në Evropën Lindore.

Në pranverë të vitit 1988 Rugova edhe një herë del në qendër të vëmendjes të opinionit më të gjërë, kur nga qarqet politike imponohet

mbajtja e një tryeze të dy shoqatave të shkrimtarëve, ku do të shfaqeshin pikëpamjet e intelektualëve shqiptarë dhe serbë për krizën galopante kosovare. Tempa i krizës diktohej nga Beogradi, ku në krye të fushatës ishin shkrimtarët, qarqet e Kishës Ortodokse Serbe dhe Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Serbisë. Ky “dialog” pat filluar me provokimin e famshëm të shkrimtarit Millan Komneniq, i cili i drejtohet hapur pjesëmarrësve shqiptarë në bisedë me fjalët: “Zotëri, ne jemi në luftë!” I tërë “dialogu” edhe u zhvillua në frymën e luftës së fjalëve, dhe kjo edhe ndikojë që edhe në Kosovë, në formën më të zbehtë, të fuqizohet ideja se rezistenca ndaj politikës serbe nuk mund të formulohet nga organet përfaqësuese të autonomisë së atëhershme, por nga instancat e pavarura intelektuale çfarë ishte Shoqata e Shkrimtarëve e Kosovës, ose edhe disa tjera si Shoqata e Filozofëve dhe Sociologëve, Shoqata e Arsimtarëve të Gjuhës Shqipe e ndonjë tjetër. Ashtu sikur që akademikët, shkrimtarët dhe klerikët ndikonin fuqishëm në opinionin dhe shtetin serb, edhe në Kosovë intelektualëve u shtroheshin detyrat e njejtë, që të krijonin një front të rezistencës ndaj aspiratave gllabëruese serbe. Disa organizime të rezistencës bëheshin ad hoc, si psh. nënshkrimi i petitionit të 212 intelektualëve kundër ndryshimit të dhunshëm kushtetutës të Kosovës (shkurt 1989). Por peshë më të madhe kishin objektivisht instancat e organizuara shoqërore, aty ku veprimtaria ishte e mundshme, dhe ndër këto autoritet dhe rol më të madh e më të shquar kishte Shoqata shkrimtarëve në krye të së cilës ishte Ibrahim Rugova.

Politizimi i Shoqatës së Shkrimtarëve do të kontribuojë në ngritjen e peshës së postit të Rugovës në atë të përfaqësuesit të interesave reale politike dhe kombëtare të shqiptarëve të Kosovës. Pasi që në shkurt të vitit 1989 dështoj greva e minatorëve dhe ajo gjenerale si përpjekje fun-

dit për të mbrojtur Kushtetutën e Kosovës që i garantonte autonomi të gjërë dhe pëfaqësim direkt në federatën jugosllave, në muajin mars Serbia rivendosi kontrollin e plotë mbi Kosovën. Ndër masat represive që ndër morri Serbia ishte izolimi për 4 muaj (një pjesë u rrahën brutalisht) i rreth 400 intelektualëve shqiptarë dhe burgosja dje gjykimi i Azem Vllasit, ish lider komunist i Kosovës, si mbrojtës i fundit i Kushtetutës së vitit 1974. Këto masat e jashtëzakonshme e lanë Kosovën jo vetëm pa pëfaqësues llogjitar në ato pak institucione marionete, por ndikoj që edhe krejt elita intelektuale dhe politike, si Rexhep Qosja, akademikët, Universiteti i Prishtinës etj., të mbesin për dhjetë muaj publikisht të pabëzën.

Në atë periudhë të tmerrshme të rivendosjes së gjendjes së jashtëzakonshme, të orës policiore, të kontrollit të plotë të proceseve, i vetmi fanar i rezistencës, edhe ai me dritën e dobësuar, kishte mbetur Shoqate e Shkrimtarëve me kryetarin e saj, Ibrahim Rugovën. Kur ato ditët ne pinim kafënë e mëngjesit në barakën tonë që rastësisht ndodhej krejt afër selisë së policisë serbe, nuk na ndanin as 100 metra, frikën e përdishtme ne e kishim më afër se këmishën; ndiheshim se jemi të kërcënuar vazhdimisht dhe këte edhe e diskutonim hapur mes vete. Rugova ishte shumë i vetmuar në lëvizjet publike, ngase frikësohej se një ditë thjesht do ta likuidonin agjentët serb, duke inskenuar ndonjë pretekst arsyetues. Në ndihmë atëbotë i vinte vetëm i ndjeri Nahil Luma, drejtor i BKA-së ku punoja, përndryshe shok i tij gjatë studimeve, i cili me një makinë Reno 4 mjaft të shkalmosur e merrte dhe e kthente te banesa Rugovën, atëbotë në lagjën Lakërishte të Prishtinës.

Në atë kohë edhe unë isha ndër të rrallët që botoja shkrime të hapura kritike për regjimin serb në shtypin slloven, kroat dhe boshnjak.

Për dallim nga Rugova, shkrimet, intervistat dhe deklaratat e mia konsidroheshin autoriale dhe private, kurse pesha e fjalës së Rugovës ishte njëfardore më e zyrtarizuar, e një kryetari të vetëm autonom që i kishte mbetur Kosovës. Fjalët e tij që përcilleshin nga mediat e jashtme, sidomos ato në gjuhën shqipe, si BBC-ja, Zëri i Amerikës, Dojçe vele etj., kishin jehonë të madhe në popull. Dhe unë, që edhe vetë kisha frikë prej ndonjë sulmi të agentëve serb, e këshilloja shpesh Rugovën që të vazhdojë të flas hapur sepse kështu do të jetë më i mbrojtur. Nëse do të strukej dhe bëhej i pabëzanë, regjimi dhe policia sekrete serbe do ta kishin cak më të lehtë, sesa kur i drejtohet pothuajse çdo ditë mediave. Mediat botërore dhe komitetet e ndryshme për të drejtat e njeriut, si Amnesty International, ose Komiteti i Helsinkit etj., por edhe qeveritë e shteteve demokratike që po vëzhgonin nga afër proceset në Jugosllavi dhe Serbi, ndikonin që edhe regjimi i Beogradit të jetë më i vëmendshëm në represionin ndaj figurave të spikatura publike, sado që i bënte pengesa. Dhe kjo periudhë dhjetëmuajore e pabëzansë të atyre që pretendonin rolin e prijsëve shpirtëror dhe politikë të Kosovës, si Rexhep Qosja psh., dhe e prezencës së madhe publike të Rugovës, do ta përmbysë skemat e mëparshme të respektit duke e ngritur Rugovën me të shpejt në figurë qendrore publike të rezistencës, i admiruar nga të gjithë.

Megjithatë, në atë periudhë të drejtimit të Shoqatës Rugova nuk jipte shenja sa deklarimet e tij kanë lidhje me ambiciet politike. Edhe kur kishte thënë në një intervistë për "Shpiglin" e Gjermanisë se në rast të humbjes të të drejtave shqiptarët do të mund të fillonin luftën çlirimtare, ai nuk e kishte ndërtur ende profilin publik të një liderit politik, por konsiderohej më shumë një zë kontestues intelektual.

Në dhjetor të vitit 1989 Ibrahim Rugova edhe një herë merr pjesë në inicimin e një procesi me pasoja largëvajtëse, që do të përcaktojë fatin e tij, por edhe të Kosovës. Sërish pra ndodh një dhjetor dhe sërish një pjesë e ndikimit të “providencës” lidhet me idetë dhe veprimet që s’kishin të bëjnë me Rugovën, por me të tjerët, ku ratësisht e me pahirë edhe unë luajta një rol që në vorbullin historik të përfshihet kryetari i shkrimtarëve Ibrahim Rugovaj.

Më 1989, derisa në Kosovë ishin ngrirë proceset dhe Serbia po sundonte me regjim policor dhe masat vetëdorëzuese të organeve me autonomi formale që i kishin mbetur Kosovës, në pjesët tjera të Jugosllavisë, po thyhej me shpejtësi të madhe sistemi monist. Organizata e parë opozitare e quajtur Shoqata për Iniciativë Demokratike e Jugosllavisë, ku nga Kosova ndër themeluesit kemi marrë pjesë Muhamedin Kullashi dhe unë, dhe që angazhohej për vendosjen e sistemit pluri-partiak në federatën jugosllave, kishte arritur që të trimërojë grupet e ndryshme në republikat jugosllave që të formojnë parti opozitare, kryesisht nacionale (sllovene, serbe, kroate etj.). Meqë ne në Kosovë po vonoheshim në këto procese, nga vjeshta e vitit 1989, unë me disa bashkëmendimtarë kishim filluar përpjektjet që të themelojmë të paktën degën e organizatës më pak kontestuese, pra të asaj Initiative, për të ngjallur edhe në Kosovë jetën politike dhe zyrtarizuar alternativat dhe opozitën regjimit serb. Dhe derisa ne po rekrutonim njerëz për iniciativën demokratike, diku në tetor të atij viti një grup shkrimtarësh (Jusuf Buxhovi, Mehmet Kraja etj.) na njohtuan se ata megjithatë më me qejf do të angazhoheshin në krijimin e një “partie tonë shqiptare”, siç e quanin. Ramë dakord që nismat të bëhen paralelisht, sepse nëse partia nacionale nuk do të lejohej, ajo e iniciativës demokratike do të mund

të merrte persipër që të ngjall jetën e ngulfatur politike në Kosovë. Dhe ne arritëm që me 9 dhjetor të themlojmë degën koosvare të Iniciativës jugosllave demokratike, ku lancuam një emër të ri, Veton Surroin.

Me rastin e krijimit të degës ndodhi një incident, i cili ndikoj që Rugova të kyçet në përgatitjet për krijimin e asaj partie tjetër, që do të quhet LDK. Ne kishim rezervuar dhe paguar një sallë ku do të mbahej tubimi themelues, por për çdo eventualitet, pasi që i parandjenim pengesat, kishim marrë lejen e Ibrahim Rugovës, që nëse nuk do të na lejohej shfrytëzimi i sallës që kishium paguar, ta shfrytëzojmë selinë e Shoqatës së shkrimtarëve si vendtubim. Dhe ashtu edhe ndodhi. Sallën që kishuim paguar e gjetëm të mbyllur, dhe kaluam te shoqata ku na prsite Rugova.

Dy javë pas kësaj, pasi që nuk u ndalua Iniciativa demokratike, ishte paraparë edhe themelimi i Lidhjes Demokratike të Kosovës. Buxhovi dhe organizatorët tjerë nga leksioni që ne e kishim marrë më herët me dyertë e mbyllura, ishin përcaktuar disa ditë para 23 dhjetorit që edhe mbledhje themltare e LDK-së të mbahet në selinë e Shoqatës së Shkrimtareve. Dhe kur vendosën për këtë nismëtarët u kujtuan që të pyesin Ibrahim Rugovën nëse edhe ai ka dëshirë të jetë ndër themeluesit e LDK-së, për çka më herët sikur nuk i kishte shkuar mendja. Rugova kishte thënë po.

Ndërkaq, nismëtarëve të LDK-së nbuk i ka shkuar as mendja se Rugova do të mund të ishte kandidat për kryetar. Ai do të propozohet ditën e fundit, praktikisht para fillimit të tubimit, pasi që të gjitha figurat tjera të mëdha (Rexhep Qosja, Fehmi Agani etj.) për arsye të ndryshme kishin refuzuar, ose janë treguar të rezervuar, që në ato rrethana të marrin përgjegjësinë e drejtimit të LDK-së. Dhe kur zgjedhja

ishite ngushtuar në emrat e iniciatorëve të parë, konkretisht në Jusuf Buxhovin, dikush ishte përmendur se ai nuk do të ishte zgjedhje më e mirë dhe ka propozuar Ibrahim Rugovën si kryetar të përkohshëm, deri sa partia të mos stabilizohet. Dhe Rugova ishte përgjigjur me po.

Ata që kanë qenë të involvuar në propozimin dhe zgjedhjen e Rugovës (në tubimin themelues të LDK-së kanë marë pjesë rreth 30 veta) pohojnë se po-ja i tij është thënë disi babëlokçe, pa u menduar dhe u theluar shumë. Por ja që kjo po-ja do të dal një po historike.

Disa miq të mi, që atëherë më thoshim: çka do të kishte ndodhur me Kosovën nëse ti nuk do të kujtoheshe se në Prishtinë ekziston hapësira e Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës? A do ta abortonte historia dhe providenca Rugovën si politikan, duke i dhënë shansin dikuj tjetër? Dhe cila do të ishte atëherë pasoja për lëvizjen çlirimtare?

Kjo për abortin prej shumë kohës ka mbetur shaka ndër miqtë e mi, që më konsiderojnë “fajtor” pa pandehje. Por tani që Rugova po i mbush 15 vjet të lindjes së tij politike, dhe kur ka gjasa që edhe të maturohet si kryetar i Kosovës së pavarur, po mendohem se mos fuqia e tij, dhe fati i tij, ka qenë në ate se në ato çaste historike ai megjithatë kishte qëlluar të jetë një zot i vogël, relativisht i lirë dhe i papenguar, ndër shkrimtarët. Ani pse me sjellje babëlokçe, ky zot i vogël i hapësire prej diku rreth 50 metrave katror, megjithatë mbante çelsat e të vetmit territor të lirë i Kosovës. Më vonë kemi kuptuar se në atë hapësirë ishte ndjellur njëri prej embrioneve të lirisë dhe pavarësisë. Por jo edhe i vetmi. Dhe jo edhe vendimtar.

Fara e pavarësisë

Kujtim për Fehmi Aganin dhe Gafur Kiserin

Shumë njerëz kanë kontribuar, në mënyrat e ndryshme, për pavarësinë e Kosovës. Në të vërtetë, kur thuhet se pavarësia është vullnet i shumicës dërmuese të qytetarëve të Kosovës, atëherë merita për pavarësi dhe vetëvendosje i takon të gjithë individëve që konstituojnë këtë vullnet. Por, kuptohet, gjithnjë ka grupe dhe persona që janë angazhuar më shumë për pavarësi e edhe artikulumin dhe përhapjen e atij vullneti. Shumë prej tyre kanë dhënë jetën për liri dhe pavarësi, ose nuk kanë pas fat që të presin ditën e pavarësisë.

Në këtë shkrim unë dua të bëjë homazh për dy njerëz të merituar për pavarësinë, që nuk janë ndër të gjallët. Arsyet pse i veçoj nga qindra dhe mija të tjerë janë personale. I kam njohur mirë, kam bashkëpunuar me ta, dhe dua të dëshmoj për ta në ditën e pavarësisë. Njeri ka ndër-tuar goxha themele, është njëra prej shtyllave të rezistencës së nëntëdhjetave. Tjetri ka dhënë kontribut më modest, por të rëndësishëm. Është i brezit tim, e kam pas shok që nga fëmijëria, dhe vdiq para disa javësh, nuk arriti që t'i gëzohet pavarësisë.

Agani, shtylla e rezistencës

Heroi im i parë personal është Fehmi Agani. Atë do të doja ta shihja gjallë në ditën e pavarësisë. E kam njohur në vitin 1983, kur kishte statusin e profesorit të “diferencuar”. Gëzonte respekt dhe autoritet të madh në qarkun e intelektualëve me të cilit u pata afruar pas kthimit në Prishtinë. Këta ishin Gani Bobi i ndjerë, Rexhep Ismajli, Hivzi Islami, Muhamedin Kullashi, Mensur Raifi, Nait Vrenezi e disa të tjerë. Në atë kohë një epitete të qëlluar për profesor Aganin e pata dëgjuar prej një burimi të pabesueshëm, nga ministri i punëve të brendshme të Kosovës, Mehmet Maliqi, babai im. Hafijet që përcillnin Aganin dhe rrethin e tij në Fakultetin filozofik dhe lokalet publike ku takohej me njerëz, e kishin njoftuar Mehmetin se i biri i tij po shoqërohet me personat që po syrvejoreshin nga regjimi komunist si të dyshuar se po veprojnë, siç thuhej atëherë, “nga pozitat e nacionalizmit dhe irredentizmit shqiptar”. Mehmeti një ditë më pat pyetur për këta shokë se çka kam me ta. I thash, janë kolegë, bisedojmë tema profesionale, sociale dhe aktuale. “Po a e di ti se ata janë të afërt me Fehmi Aganin?” Po, i thash, por çka keni ju me te? “Është truri i irredentës”, tha. Dhe pastaj shtoi edhe diçka që gjithnjë e kisha parasysh për 16 vjetët e ardhshme që kontaktoja me Aganin: “Është dinak dhe i pakapshëm. Mjeshtër i madh”.

Aganin vërtet e kam njohur si mjeshtër të madh të politikës. Nuk shtyhej asnjëherë në plan të parë. Ishte njeri modest, por i idesë, duke punuar për qëllime strategjike edhe me taktika dhe platforma më afatshkurtra, deri edhe ato ditore. Në LDK që nga fillimi ai i mori përsipër të gjitha punët e ideologut: programet, platformat, kumtesat, reagimet, komentet, shpjegimet..., të gjitha këto i formulonte vetë ose kalonin

redaktuarën e tij. Pastaj, ishte i palodhshëm në kontaktet me diplomatë dhe gazetarë, jepte intervista të përditshme, udhëhiqte negociatat, jepte instruksione dhe këshilla për njerëzi nga terreni. Kushdo që paraqitej te ai ishte i mirëpritur. Pa përtesë gjente kohë për të gjithë. Nuk ishte rob i partisë. LDK-ja ishte vetëm instrument për qëllimin. Kur nuk haste në mirëkuptim të Kryesisë së LDK-së, punonte me të urtit të tjerë të kombit (Gazmend Zajmin, Mahmut Bakallin, Azem Shkrelin, Bajram Krasniqin etj.) në përgatitjen e Deklaratës së Pavarësisë së vitit 1990, Kushtetutës së Kaçanikut etj. Në të gjitha negociatat ishte ai Mjeshtri i Madh që në shikim të parë bënte “kompromise” për çështje dytësore, por aspak për ato esenciale.

Si ia prishëm o ndreqëm lojën Kris Hillit

Se çfarë negociator ishte Agani tregon një rast kur bashkëpunuam. Në shtator të vitit 1998 Kris Hilli që ndërmjetësonte në negociatat mes Beogradit dhe Prishtinës kishte sjell një propozim për statusin e Kosovës duke thënë se është platformë amerikane. Rugova që aprovonte pa fjalë krejt çka i vinte nga amerikanët, e kishte përkrahur, por kur e lexoi Agani u skandalizua dhe gjeti mënyrë që t’ia japë propozimin Baton Haxhiut, edhe pse ishte dokument rezervat, që ta botonte në “Koha ditore” dhe kështu të demaskohet. Batoni ma jep mua për koment dhe unë kur e lexova i thash se ky nuk mund të jetë dokument i amerikanëve por është i Beogradit, përmban projektin e një autonomie shumë të kufizuar kulturore për Kosovën. “Është test i Hillit”, i thash Batonit, “se sa mund të lëshojmë pe”. “Po, shkruje këtë”, më tha ai. E shkrova komentin duke e kritikuar ashpër përmbajtjen e tij, duke e dekon spirua atë, por nuk thash gjë për burimin, nga e morëm dokumentin.

Sidoqoftë, ideja kryesore e Aganit ishte që të sigurohet ndërkombëtarizimi i çështjes së Kosovës, pa të cilën e dinte se Kosova nuk do të ketë pavarësi. Kur nisi kryengritja e UÇK-së, punonte në dy fronte, edhe me kryengritësit, edhe me miopët e LDK-së, që sedra ose droja nuk i linte që ta përkrahnin rezistencën e armatosur.

Pas Konferencës së Rambujesë dhe fillimit të bombardimeve të Serbisë Agani i kishte thënë familjarëve se ndërkombëtarizimi kishte arritur kulmin dhe se rezultati i intervenimit të NATO-s do të jetë largimi i ushtrisë dhe policisë serbe nga Kosova. Pavarësia është e pashmangshëm, kishte thënë, duke shtuar: “Tashti edhe nëse vdes, jam i qetë. Misioni im ka mbaruar!”. Pas disa ditësh kriminelët serbë e zbritën nga treni që ishte nisur për në Shkup, dhe e kishin kthyer nga kufiri. E kishin njohur dhe vrarë mizorisht me urdhrin e krerëve të Serbisë.

Në veprën e Aganit, që është botuar nga “Dukagjini” në tetë vëllime, gjendet esenca më e elaboruar e mendësisë shtetformuese të Kosovës, si një monument i pashlyeshëm historik. Andaj edhe po dëshmoj për Fehmi Aganin, se ishte Mjeshtri i Madh i Pavarësisë.

Fara e Gafur Kiserit

Tregim tjetër ia kushtoj mikut tim të ndjerë Gafur Kiseri. Ka vdekur ditët e para të këtij viti (2008). E kam pas mik të zemrës. Jemi shoqëruar në vitet '60 në Prizren. Luanim futboll me Nakën (Elshani), Isuf Vraniqin, Ismail Makasçiuin – Gërbën e ca të tjerë, dhe kishim një jaran të shëndosh rinore. Pastaj, me Gafurin shkua për të studiuar në të njëjtën kohë në Beograd. Unë një kohë banoja ilegal në dhomën e tij në konviktin “Rifat Burxheviç”. Në vitin 1967 na erdhën shokët nga Prizreni, Gafuri dhe unë i kishim blerë biletat për ta, për të shikuar

ndeshjen e përfaqësueseve të Jugosllavisë dhe Shqipërisë në futboll. Ne anonim hapur për Shqipërinë “Kuq e zi! Kuq e Zi!”, edhe pse përfaqësuesja shqiptare humbi bindshëm. Serbët na kthenin me një shtrembërim të fjalës ofendues “Kur-qe-zi!”, që në shqip mund të përkthehet si “karuca”.

Nga fundi i viteve 80, Gafuri u zgjodh delegat në Kuvendin e Kosovës, të fundit të legjislaturës komuniste. Pas ndryshimit të dhunshëm të Kushtetutës në vitin 1989 dhe rishpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme, delegatët e Kuvendit që ishin zgjedhur me kujdes, nuk kishin as më të voglin iluzion se çfarë synon regjimi i Milosheviçit. Në qershor të vitit 1990 Gafurin e takova në Gjakovë. Unë kisha shkuar atje me Anton Kolë Berishën te Lulëzim Gërçina dhe Ruzhdi Bakalli, kërkonim fonde nga ndërmarja “Eremiku” për revitën e Shoqatës së filozofëve dhe sociologëve, “Thema”, dhe aty e gjetëm Gafurin dhe Bujar Gjurgjealon, që ishin deputet të Kuvendit të Kosovës autonome. Ata kishin ardh për konsultime me kolegët delegat nga Gjakova se si do të duhej të reagonin ndaj provokimeve serbe në seancën e ardhshme të Kuvendit, për të cilën e dinin se do të mund të ishte vendimtare. Pritej suspendimi i autonomisë. Në bisedë e sipër, kur po flisnim për statusin e Kosovës në Serbi pas Luftës së Dytë Botërore, unë e pata thënë një mendim se asambleja e Kosovës ka të drejtë historike që të vendos për fatin e Kosovës. “Ashtu si pat vendos për bashkimin me Serbinë në vitin 1944 në Prizren, ku Kuvend ka të drejtë të marrë edhe vendimin për shkëputjen e Kosovës nga Serbia!”, u pata thënë.

Si u rebelua Kuvendi i Krahinës?

Në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës disa ditë më vonë kjo fjali do të dëgjohet dhe do të jetë shkas për fundin e atij Kuvendi. Deri sa me orë të tërë po zhvillohej beteja konceptuale mes komunistëve që tani ishin ndarë në dy taborë kombëtare, në orët e vona në foltore do të dalë Ruzhdi Bakalli, që kishte qenë në atë bisedë që u pat zhvilluar në zyrën e drejtorit të kombinatit Erreniku. Bakalli që kishte një stil pasionantë të debatimit në një moment i thotë kryetarit të Kuvendit në sy, (më duket se e ka pas mbiemrin Jokanoviç), i pakënaqur që ky po përpiqej t'ia merte fjalën, po e parafrazoj sipas kujtesës: “Shoku Jokanoviç, ky është Kuvend i Kosovës, unë jamm deputet dhe ju nuk mund të ma merrni fjalën. Fundja, e dimë ne se cili është qëllimi i juaj. Por, ju siguroj se ku Kuvend në vitin 1944 e ka marrë vendimin që Kosova t'i bashkohet me Serbinë, dhe po ky Kuvend edhe mund të vendos që Kosova të shkëputet nga Serbia!” Pas kësaj fjalie Jokanoviçi i “skandalizuar” dhe i zemëruar ndërpreu seancën dhe pas kësaj delegatët shqiptarë nuk janë lejuar më që të hyjnë në Kuvend.

Në ditët e ardhshme kur një grup delegatësh “rebel” kuptoi se Serbia e ka ndërmend që të asgjësoi autonominë e Kosovës, fillimisht ishin më sa më kujtohet nja 20 veta (ndër ta unë i njihja vetëm Xhemajli Bajrajn, Ilaz Ramajlin, Gafur Kiserin, Bujar Gjurgjealon, Muharem Shabanin, Ruzhdi Bakallin dhe Sabri Hashanin), filluan konsultimet për deklarimin e pavarësisë së Kosovës, në bazë të mandatit që e kishin nga votuesit shumicë të Kosovës. Në këto konsulta isha përfshirë edhe unë. Mblidheshim në një banesë në rrugën e Goleshit, sot Rexhep Luci, s'idi e kujt ka qenë, dhe shqyrtonim idetë për tekstin e deklaratës dhe procedurat, dhe çka të bëhet nëse policia serbe, e cila e kishte okupuar

ndërtesën e Kuvendit, nuk lejoi që të mbahet seanca në sallën e Kuvendit. Alternativa ishte që mbledhja të mbahet në ndonjë sallë tjetër, ose para hyrjes në Kuvend. Edhe pse shumicës u dukej e çuditshme, ideja për demonstrim para detyrës u përkrahu edhe nga aktivistja amerikane Eva Brently, dhe kështu edhe ndodhi. Gafuri me shokët ndërkohë agjitonte te delegatët që kishin qëndrim më hezitues që të nënshkruajnë deklaratën e pavarësisë. Gafuri herë më lajmëronte me gëzim se i kishin bindur 78 delegatë, e herë me zemërim pse 29 të tjerë ishin “zhdukur”, ose e përkrahnin idenë por gjenin ca arsye të mos e nënshkruajnë menjëherë. Pastaj numri u rrit, - presioni i opinionit dhe familjarëve ishte i fuqishëm, - u mbledhën me sa më kujtohet nënshkrimet e 114 prej 117 delegatëve shqiptarë dhe mungonin 7 që të mbushet kuota për vendim të plotfuqishëm, 120 + 1, e dy të tretave të delegatëve. Serbet e kishin instalua prej kohësh, edhe pse Kosova kishte autonomi shumë të gjerë, që shqiptarët të mos e kanë 2/3 e deputetëve për vendimet e mëdha si ky për shpëtim të Kosovës nga Serbia.

Deklarata e pavarësisë është lexuar me 2 qershor 1990 tek dera e hyrjes së Kuvendit. Gafuri rrinte pranë Bujar Gjurgjealos dhe Muharrem Shabanit, që lexuan arsyetimin dhe Deklaratën. Gafuri e thithte cigaren me nervozizëm, dhe nga buzët e tij në një moment sikur lexoja se po thoshte në turqishten e Prizrenit, “Oko da çabuk!” “Lexo ma shpejt”. Më vonë, pas shpalljes së Republikës së Kosovës dhe aprovimit të Kushtetutës Kaçanikut, Kuvendi i rebeluar u largua në ekzil, kush në Kroaci, Slloveni dhe vendet perëndimore, kush në Turqi, Maqedoni dhe Shqipëri. Gafuri ishte fillimisht në Kroaci, pastaj në Shkup. E takoj atje shpesh dhe e ngucja se si e po e thithte cigaren ditën e Deklaratës, duke i thënë Bujarit dhe Muharremit që të lexonin më shpejt tekstin e

deklarstës mbi pavarësinë që atëherë nuk kishte gjasa të realizohej, por se nuk ishte as utopi. Gafuri që e kishte nofkën Tiçen (turqisht gjëmbë, thumb) sepse kishte qejf të ngucej dhe të këmbente shakatë, përgjigjej: “Shiko, u tutsha mos po na ndërprejnë! Ishte shumë të rëndësishme që aty të lexohet fjala pavarësi, sepse më dukej sikur ne po e mbjellim farën që një ditë do të çel lulën e pavarësisë së vërtetë!”

Azili dhe rezili

Ekzili i tyre ishte i vështirë, merrnin ca ndihma, jo edhe aq rregullisht, nga Qeveria në ekzil. Në fillim, deri sa grupi më i madh i delegatëve të Kuvendit ishte ende në Zagreb dhe Lublanë, në Prishtinë kishim bërë plan Veton Surroi, Ylber Hysa dhe unë, - nuk më kujtohet ideja e kujt ka qenë, por them se i ngjanë ideve të Yllberit, atij i shkrepnin në atë kohë këso kombinime – që delegatët e ikur të futen kolektivisht në Konsulatën gjermane në Zagreb për të kërkuar mbrojtje ose azil politik. Me këtë mendonim se delegatët e Kuvendit do të ishin të mbrojtur dhe të siguruar personalisht në rast se do të qëndronin më gjatë në ekzil, por dobia më e madhe do të ishte se do të ndërkom-bëtarizohej në mënyrë më dramatike çështja e marrjes së dhunshme të autonomisë, si edhe afirmimi i vetë aktit të vetëvendosjes, i deklarimit të pavarësisë nga shumica deputetëve të Kuvendit të atëhershëm. Ne konsultoheshim nga Prishtina për çdo ditë me Gafurin, por dikush e kishte stopuar këtë skenar tonin. Nuk e kam marrë vesh kurrë pse u prish ky plan. “Nuk kërkuam azil, u bëmë rezil”, - ma tha një herë Gafuri në Shkup në vitin 1994.

Kuptohet, nuk e di nëse kërkimi i azilit në Perëndim do të kishte ndikim te komisioni i Badinterit. Ne atëherë e shihnim si të dobishme,

sepse bota do të duhej të merrte një vendim rreth suspendimit të autonomisë duke e shikuar shumë kohë para komisionit të Badinterit bazën e kushtetutës jugosllave, ku Kosova e kishte të drejtën e vetos dhe subjektësi konstitutive në federatë. Por, ja që kjo nuk ndodhi. Sidoqoftë, shoku im Gafuri ka bërë çka ka qenë në mundësitë e tij për pavarësinë të shpallur në mënyrë legale. Por, nuk arriti ta shijojë këtë pavarësi që sot shpallet përnjëme, në koordinim me Perëndimin.

Gafuri vdiq në janar në Prizren. Fatkeqësisht, unë fare nuk e mora vesh deri para disa ditësh. Ai viteve të fundit jetonte në Dubrovnik, nuk kisha ditur që është kthyer. Kur mora vesh, u pikëllova dyfish, për vdekjen e shokut, e edhe pse nuk arriti që të marrë pjesë në ceremoninë e shpalljes të pavarësisë që ta sheh frutin që doli nga fara që ai besonte se e kishte mbjedhur me shokët në vitin 1990.

(Ky rrëfim është botuar në gazetën Express, më 17 shkurt 2008).

Shënime për autorin

Baton Haxhiu, i lindur me 1967, është gazetar, analist dhe publicist i njohur nga Prishtina.

Është fitues i çmimit prestigjioz CPJ International Press Freedom Award .

Aktualisht është drejtor në Klan Kosova, ndërsa ndër librat tjerë duhet veçuar librin “Lufta Ndryshe”.

Përmbajtja

HYRJE	3
Si u bëra i famshëm “brenda natës”	3
Intelektuali i parë që reagoi ndaj fushatës antishqiptare	7
Lavdatat dhe kërcënimet	12
Formula e kundërgoditjes	14
Paralajmërimi i luftës	18
Si e njoha nacionalizmin serb?	20
Themelimi i organizatës së parë opozitare	24
Greva e Trepçës.....	27
Tubimi në Cankarjev Dom të Lubjanës?.....	31
Shkatërrimi i Jugosllavisë ndodhi në Kosovë	34
GJASHTËDHJETAT	38
Familja ime.....	38
Gjyshi im Haziri, çau sh i sultan Abdylhamitit	39
Mehmeti jetim, furaxhi në Shkup dhe komunist	41
Historia e emrit tim: Linda si Bajram, e kthyen në Shkëlzen	44
Daja Sadik Stavileci dhe Enver Hoxha: një histori apokrife	45
Ndikimi i komunizmit	48
Zhgënjimi me Titon	52
A vdes prijësi?	55
Shkollimi në Kosovën komuniste	57
Prizreni: Bicikleta Pirrelli	59
Prizrenasit flasin turqisht në Vatikan.....	61
Shkollimi im në gjuhën serbe dhe Procesi i Prizrenit	63
Vuajtjet e adoloshentit	66
Përcaktimi për filozofi.....	68
Ikja nga mentaliteti provincial.....	71

Si u binda se nuk ka zot?.....	72
Lektyra rinore	74
JETA NË KRYEQYTETIN E JUGOSLLAVISË	76
Studimet në Beograd.....	76
Raportet me Mehmetin	79
Filozofia e pastër	80
Frika nga revanshizmi rankoviçian.....	81
Si ishte Beogradi në vitin 1966	85
Virusat e nacionalizmave shkatërrues	87
GJASHTËDHJETË E TETA.....	89
Demonstratat e studentëve në Beograd.....	89
Demonstratat kundër luftës në Vjetnam	91
Angazhimi në grupin anarho-liberal.....	93
Demonstratat e vitit 1968.....	96
Çka kërkoni studentët?.....	99
Paraburgimi	101
Bisedat informative në polici	105
Dinakëria e Titos ndal protestën	106
Largimi nga grupi anarho-liberal	110
VITET E SHTATËDHJETA	113
Shqiptari me plis në Beograd.....	113
Krahasimi i jetës në Beograd dhe Prishtinë	118
Paragjykimet për shqiptarët.....	121
Mbyllja e Kosovës në tribalizëm dhe folklor.....	125
Çështja kombëtare.....	127
Miqte e mi takojnë Demaçin në burg	129
Parulla e bashkim vëllazërimit.....	133
Shqiptarët e Beogradit	135
Shqiptarofobia e Lazar Kolishevskit.....	140
Kontaktet me pushtetarët kosovarë në Beograd.....	141
Neveria nga Halit Tërnavci.....	144
Udhëtimet me tren	145
Interesimi për Bizantin	148
Si u “verbërua” afreska e Simonidës në Graçanicë.....	150

Kosova dhe Serbia e shtatëdhjetave	153
Krahasimi i diasporave	156
Përgjasimi me Drazhën	158
Çka thoshin serbët për Kosovën dhe shqiptarët	161
Kadareja dhe Andriçi.....	164
Kush është më evropian?.....	166
Çka përfaqësonte Jugosllavia?.....	167
Tetëdhjetat	171
Mbi shpërthimin e vullkanit serb	171
Ambiciet letrare	172
Raportet kulturore Kosovë-Jugosllavi.....	175
Mbi jugosllavizmin.....	178
A e donin shqiptarët Titon	179
Titizmi dhe enverizmi në Kosovë.....	184
Qorrfermanet e Serbisë	186
Pse nuk shkrova recensionin për librin “Titistët”	189
Si fabrikoheshin disidencat	191
Fjalimi i Milosheviçit në Fushë Kosovë.....	193
Kulti i intelektualit në Kosovë.....	196
Dorëheqja nga Fjala	198
Intevista në “Start” të Zagrebit	199
Lufta e klaneve politike në Kosovë.....	202
Kritika e UP-së në kohë të gabuar?	205
Avancimi i plagjiatorëve	208
Mjerimi i UP	211
Pse nuk u doktorua Shkëlzen Maliqi?.....	212
NËNTËDHJETAT	215
Elita në “Elida”	215
Kush dyshonte në Shkëlzen Maliqin: polemikat kulturore dhe të tjera	218
Censura dhe autocensura në komunizëm.....	221
“Detabuizimi” i Jugosllavisë.....	223
Fundi i autonomisë	225
Deklarata e Pavarësisë e 2 korrikut 1990.....	228

Një shkrim paralajmërues në “Oslobodjenje”	229
Kur do të përfundojë kriza në Kosovë	233
Angazhimet në Alternativën kosovare	235
Presionet e pasuksesshme të Rexhep Qosjes	237
Kontributi i Këshillit Koordinues të Partive Politike në Kosovë	239
A është dashur të mbahen zgjedhjet e vitit 1992	240
Manipulimi me zgjedhjet, një hile e Fatmir Sejdiut.....	243
Pse dështoi Forumit Demokratik i Kosovës.....	244
Ambicja e papërmbajtur e Veton Surroit	246
Ylli i Rugovës dhe rapsodia e Sheratonit	247
Rugova si i përzgjedhuri i Amerikës.....	249
Niveli dhe përgaditja politike e intelektualëve të Kosovës	252
PSE DËSHTOI REZISTENCA PAQËSORE.....	254
Filozofia paqësore e Rugovës	254
Konvertimi i intelektualëve	261
Roli i tri shoqatave.....	264
Deputet në Kuvendin paralel të Kosovës që nuk u mbloodh kurrë... ..	266
Afera rreth idesë për pjesëmarrje në zgjedhjet serbe	267
Refuzimi i postit të lartë në qeverinë e Paniçit.....	271
Promotor i shoqërisë civile dhe i artit bashkëkohor.....	274
Pse dështoi rezistenca paqësore	278
Përpjekja për të influencuar procesin e Dejtonit.....	279
Paraliza e lëvizjes	281
Kryengritja e brendshme	284
SHTOJÇË: SHKËLZEN MALIQI “TRI RRËFIME”	287
Mbi normalitetin	289
Rrëfimi për dhjetorët e Ibrahim Rugovës.....	315
Fara e pavarësisë Kujtim për Fehmi Aganin dhe Gafur Kiserin	328
Agani, shtylla e rezistencës.....	329
Si ia prishëm o ndreqëm lojën Kris Hillit	330
Fara e Gafur Kiserit.....	331
Si u rebelua Kuvendi i Krahinës?	333
Azili dhe rezili.....	335

ISBN 978-9951-641-18-0



9 789951 641180 >